

# SAH

15 • 2022, ISSN 227-8346

Albanological Studies - History

## Studime Albanologjike Histori

REVISTË SHKENCORE E DEPARTAMENTIT TË HISTORISË  
TË FAKULTETIT TË HISTORISË DHE TË FILOLOGJISË  
TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS





|                       |                       |
|-----------------------|-----------------------|
| Studime Albanologjike | Albanological Studies |
| Histori               | History               |

15 • 2022

# Studime Albanologjike - Histori

Numri 15, viti 2022

Revistë shkencore e Departamentit të Historisë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës

DREJTORI I REVISTËS

Prof. dr. Sabri Laçi

KRYEREDAKTORE

Prof. dr. Valentina Duka

SEKRETARE SHKENCORE

Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni (Papa)

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

Prof. dr. Ilira Çaushti

Prof. dr. Migena Leskoviku

Prof. dr. Petrit Nathanaili

Prof. asoc. dr. Çlirim Duro

Prof. asoc. dr. Ermal Baze

Prof. asoc. dr. Eva Hyskaj

Prof. asoc. dr. Gentiana Kera

PËRGATITËN PËR BOTIM

Andi Rembeci

Enriketa Pandelejmoni (Papa)

ISSN 227-8346

Shtypur nga shtëpia botuese: TRIPTIK

© Pronë e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës

Rruga e Elbasanit, Tiranë, Shqipëri.

dep.histori@fhf.edu.al, <https://www.fhf.edu.al/departamenti-i-historise/>

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Të gjitha pjesët e këtij botimi janë të mbrojtura me të drejtën e autorit. Çdo përdorim jashtë kufijve të rreptë të ligjit për të drejtën e autorit, pa lejen e botuesit, është e ndaluar.

Ky botim është me peer reviewed.



Departamenti i Historisë  
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë  
Universiteti i Tiranës

# STUDIME ALBANOLOGJIKE

## HISTORI

Numri 15, viti 2022



Tiranë, 2022

# Albanological Studies - History

Volume 15, 2022

A Publication of the Department of History of Faculty of History and Philology,  
University of Tirana

JOURNAL'S DIRECTOR

Prof. dr. Sabri Laçi

EDITOR-IN-CHIEF:

Prof. dr. Valentina Duka

SCIENTIFIC SECRETARY:

Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni (Papa)

EDITORIAL BOARD

Prof. dr. Ilira Çaushti

Prof. dr. Migena Leskoviku

Prof. dr. Petrit Nathanaili

Prof. asoc. dr. Çlirim Duro

Prof. asoc. dr. Ermal Baze

Prof. asoc. dr. Eva Hyskaj

Prof. asoc. dr. Gentiana Kera

EDITED BY

Andi Rembeci

Enriketa Pandelejmoni

ISSN 227-8346

Shtypur nga shtëpia botuese:

© Faculty of History and Philology, University of Tirana

Rruga e Elbasanit, Tiranë, Albania.

dep.histori@fhf.edu.al, <https://www.fhf.edu.al/departamenti-i-historise/>

All rights reserved.

All parts of this publication are protected by copyright.

Any utilisation outside the strict limits of the copyright law, without the permission of the publisher, is forbidden.

This publication has been peer reviewed.

A CIP catalogue record for this book is available from the National Library of Albania.



Department of History  
Faculty of History and Philology  
University of Tirana

# ALBANOLOGICAL STUDIES

## HISTORY

Volume 15, 2022



Tirana, 2022





# Përmbajtja

## ARTIKUJ

ANDI REMBECI

Aspekte historike dhe kulturore librore të Beratit gjatë shek. XIV-XV, nga kronikat e kodikëve të dorëshkuar të British Library të Londrës dhe Magdalen College të Oksfordit 13

ESMERALDA KOLANECI

Principata jetëshkurtër e Vidit, pasojë e formulës së dështuar londineze 45

EVA HYSKAJ

Lidhja e Kombeve dhe "Probleme shqiptare" të Mehdi Frashërit 59

ERMAL BAZE

Kristo Dako, Udrou Uillson dhe "Çështja e Adriatikut" 71

PETRIT NATHANAILI

Problemi i statusit ndërkombëtar të Shqipërisë rreth kufijve të saj (1920-1926) 81

MIGENA LESKOVIKU, EVGJENI BASHARI

Minoritetet dhe mbrojtja e tyre në veprimtarinë e Lidhjes së Kombeve 93

ENRIKETA PANDELEJMONI (PAPA)

Janusi romak në politikat kolonialiste dhe moderniste  
të Italisë ndaj shtetit të ri shqiptar (1914-1943) 105

VALENTINA DUKA

28 apo 29 Nëntor: një shqyrtim kritik i dokumenteve  
arkivore shqiptare 129

ALBAN SHAHU

Propaganda në fazën përmbyllëse të luftës për eliminimin  
e institucioneve fetare në Shqipëri 1966-1967 139

PRANVERA TELI (DIBRA)

Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në Konferencën për  
Bashkëpunimin në Evropë (OSBE) 153

## RECENSIONE DHE BOTIME TË REJA

Ermal Baze, *Jeta Agrare në Komunën e Shkodrës gjatë  
shek. XIV-fillim i shek. XV: një vështrim socio-ekonomik* 181

Enriketa Pandelejmoni, Gentiana Kera, Valentina Duka,  
*Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes  
materialeve arkivore dhe burimeve sekondare* 185

Enriketa Pandelejmoni, *Shkodra. Family and Urban Life  
(1918 - 1939)* 188

ENRIKETA PANDELEJMONI

Margo Rejmer, *Mud Sweeter Than Honey: Voices of  
Communist Albania* 190

DOKTORATA 195

# Contents

## ARTICLES

ANDI REMBECI

- Historic and cultural aspects of Berat during the 14<sup>th</sup>-15<sup>th</sup> centuries as seen in historical notes contained in manuscripts of the British Library of London and Magdalen College of Oxford 13

ESMERALDA KOLANECI

- Vid's short-lived principality, a consequence of the failed London formula 45

EVA HYSKAJ

- "The League of Nations and Mehdi Frashëri's "Albanian Problems." 59

ERMAL BAZE

- Christo Dako, Woodrow Wilson and the "Adriatic Question" 71

PETRIT NATHANAILI

- The Problem of Albania's International Status and the Debates Concerning Its Borders (1920-1926) 81

MIGENA LESKOVIKU, EVGJENI BASHARI

- Minorities and their protection in the activity of the League of Nations 93

ENRIKETA PANDELEJMONI (PAPA)

Roman Janus in the modernist and colonial policies of  
Italy towards the new Albanian state 1914-1943 105

VALENTINA DUKA

November 28th of 29th. A Critical Review of Albanian  
archival sources 129

ALBAN SHAHU

Propaganda in the final stage of the war for the elimi-  
nation of the religious institutions in Albania (1966-1967) 139

PRANVERA TELI (DIBRA)

Albania's membership process in the Conference on  
Security and Co-operation in Europe, (OSCE) 153

## REVIEWS AND NEW PUBLICATIONS

Ermal Baze, *Jeta Agrare në Komunën e Shkodrës gjatë  
shek. XIV-fillim i shek. XV: një vështrim socio-ekonomik* 181

Enriketa Pandelejmoni, Gentiana Kera, Valentina Duka,  
*Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes  
materialeve arkivore dhe burimeve sekondare* 185

Enriketa Pandelejmoni, *Shkodra. Family and Urban Life  
(1918 - 1939)* 188

ENRIKETA PANDELEJMONI

Margo Rejmer, *Mud Sweeter Than Honey: Voices of  
Communist Albania* 190

PHD DISSERTATIONS 195

## ARTIKUJ - ARTICLES



*Andi Rembeci*

ASPEKTE HISTORIKE DHE KULTURORE LIBRORE TË  
BERATIT GJATË SHEK. XIV-XV, NGA KRONIKAT E  
KODIKËVE TË DORËSHKRUAR TË BRITISH LIBRARY TË  
LONDRËS DHE MAGDALEN COLLEGE TË OKSFORDIT<sup>1</sup>

---

HISTORIC AND CULTURAL ASPECTS OF BERAT DURING THE 14<sup>TH</sup>-15<sup>TH</sup> CENTURIES AS SEEN IN HISTORICAL NOTES CONTAINED IN MANUSCRIPTS OF THE BRITISH LIBRARY OF LONDON AND MAGDALEN COLLEGE OF OXFORD

**ABSTRACT:** Among the manuscripts that belong to the Additional archive of the British Library in London, there are a considerable number of manuscripts originating from Epirus. At present, four manuscripts have been identified as being produced or used in the city of Berat. They are two manuscripts of the British Library: Additional 37007, Additional 37008 and two manuscripts of the College of St. Mary Magdalen in Oxford: Magdalen College gr. 9 and Magdalen College gr. 16. In this paper we will present historical data regarding the literary culture of Berat, based on information coming from the aforementioned codices that belong to the Italo-Byzantine tradition of book production of Epirus, as proved by their characteristics. 1. The codex Additional 37007 dates to the 13th-14th century. It is written on parchment and contains the four Gospels. It contains musical notation. On a vellum sheet (bifolio) connected to the main volume there is an inventory from the year 1399 listing the books and precious objects of the Monastery of St. Nicholas of Perondi (Pendarchondia) near Berat. In this inventory are mentioned two historical figures connected with the city of Berat: Theodore III Muzaka, referred to as the "Lord of Berat" (early 15th century), and Balsha II (of Zeta, who ruled Berat from c. 1360 to 1385),

---

1. Artikulli është prezantuar për herë të parë në Konferencën Ndërkombëtare Albanologjike kushtuar Gjergj Kastriotit-Skënderbeut në 550-vjetorin e vdekjes "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, koha në të cilën jetoi dhe gjurmët që la në histori", mbajtur në datat 1-3 nëntor 2018.

who is presented as the donor of the silk curtain that was used for the royal doors of the altar. Also, the inventory contains information about Berat during the disturbed period resulting from Ottoman incursions during the 14th and 15th centuries.

2. The second codex Additional 37008 is a Lectionary written in 1413 by the copyist Georgios Siderocastrites in the city of Berat, at the expense of the "most respected lord" of the city, Nicephoros Louvros, and his wife Maria Kirikalena. On the folio 1r of the manuscript is found another inventory that names 28 codices, which were the property of the church of St. Marina in Berat. Also, the codex offers information about the price of the codices that can be used to gain insight into the economic life of the Albanian territories and the circulation of Byzantine coins there, providing information on their value in relation to the Venetian Ducat.

3. The third codex of Magdalene College gr. 9 was written in the second half of the 12th century and contains the four gospels. It was produced in Constantinople and contains decorations of the Blütenblattstil type. A latter bifolio of the 14th century has been added to the codex, that contains a history of the death of Balsha II on 1385 in the battle of Savra, Lushnja, against the Ottoman troops, allies of Karl Thopia (the ruler of Kruja and Elbasan, 1358-1388).

4. The last codex, Magdalen College gr. 16 appears to date from the 14th century based on paleography. It contains the Introduction in Logic and Introduction in Physics by the Byzantine scholar Nicephoros Blemmydes. On the blank folios of the codex important historical notes were added at different times. Thus, on the f. 284v, at the end of the text, there is another historical note mentioning the death of Balsha II in 1385. On f. 113r is found an historical note from the year 1480 that mentions the spread of a plague and the difficult conditions it created not only in Berat, but also in "Illyricum and all Albania".

All the four codices considered in this paper have been used in the same geographic space and are dating, approximately, from the same period. They are evidence of the culture and book production of Berat, but also are important historical sources for the city during the 14th-15th century.

KEYWORDS: Historiography, methodological inertia, causes, consequences, methodological reformation

---



Nga fondi i dorëshkrimeve të shtuara (*Additional*) të British Library në Londër, ndodhet një numër i konsiderueshëm kodikësh të dorëshkruar (rreth 451) me prejardhje nga Epiri<sup>2</sup>. Mes tyre janë identifikuar deri më tani 4 kodikë<sup>3</sup>, të cilët janë shkruar ose janë përdorur në qytetin e Beratit. Bëhet fjalë për dorëshkrimet e Londrës: *Additional 37007* i shek. XIII-XIV dhe *Additional 37008* i vitit 1413 dhe dorëshkrimet e kolegjit të Shën Maria Magdalenës në Oksford: *Magdalen College graecus. 9*, i shek. XII dhe *Magdalen College graecus 16*, i shek. XIV.

Përtej rëndësisë së shënimeve të tyre kronike për historinë e shqiptarëve, këta kodikë së bashku me të tjerë që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit<sup>4</sup>, në Tiranë, dëshmojnë praninë, edhe në hapësirën shqiptare, të kulturës së librit të dorëshkruar, të kultivuar midis Italisë së Jugut – Epirit – Kostandinopojës gjatë shek. XIV-XV<sup>5</sup>.

---

2. Marcel Richard, *Inventaire des manuscrits grecs du British Museum : Fonds Sloane, Additional, Egerton, Cottonian et Stowe*. Paris: Publications de l'Institut de Recherche et d'Histoire des Textes, III, 1952. Shih edhe *Répertoire des bibliothèques et des catalogues de manuscrits grecs de Marcel Richard*, Troisième édition entière ment fondue par Jean-Marie Olivier, Brepols-Turnhout 1995. J.-M. Olivier, *Supplément au Répertoire des bibliothèques et des catalogues de manuscrits grecs*, Brepols 2018

3. Annaclara Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti a Londra (British Library), ed a Oxford (Magdalen College)", *Codices Manuscripti 20/21* (1997): 3-59 (3-18) [reprinted in Annaclara Cataldi Palau, *Studies in Greek Manuscripts (Testi, studi, strumenti 24)*, 2 vols, Spoleto, 2008, vol. 2: 443-521 (449-472)].

4. Mbi kodikët italo-bizantinë që ruhen sot në Arkivin Qendror Shtetëror, shih Andi Rembeci, "Kodikët mesjetarë në Shqipëri, ura kulturore midis Lindjes dhe Perëndimit: rasti i kodikëve me prejardhje italo-bizantine", në: *Shqipëria mes Lindjes dhe Perëndimit*, Studime Albanologjike, 2015, 14-33; Sokol Çunga, "Kodikët e Beratit 14 dhe 31 dhe një palimpsest i Joan Gojartit në AQSh", në: *Shqipëria mes Lindjes dhe Perëndimit*, Studime Albanologjike, 2015, 49-61; Andi Rembeci, "Italo-Greek Manuscripts from the Byzantine Collection of the Manuscripts in Albania", në: Dejan Dželebdžić, Stanoje Bojanin (eds.), *Proceeding of the 23rd International Congress of Byzantine Studies Belgrade*, 22-27 August 2016, Belgrade 2016, 123-124.

5. Mbi dorëshkrimet greke të Italisë së Jugut, shih punën bazike të Robert Devreesse, *Les Manuscrits grecs de l'Italie méridionale: histoire, classement, paléog-*

Në këtë punim do të paraqiten të dhëna lidhur me aspekte historike dhe kulturore librare të Beratit, për periudhën paraskënderbeje dhe skënderbeje, bazuar në të dhënat e përfutuara nga kodikët e lart-përmendur.

# I.

Kodiku *Magdalen College gr.* 9<sup>6</sup> është shkruar në pergamenë në gjysmën e dytë të shek. XII dhe përmban katër Ungjijtë (fl 3r-115v)<sup>7</sup>,

---

*raphie*. Citta del Vaticano: Biblioteca apostolica Vaticana, 1968. Shih gjithashtu studimet e Poul Canart dhe Julien Leroy "Les manuscrits en style de Reggio. Étude Paléographique et codicologique" në: *La Paléographie grecque et byzantine*. (Paris: 1977), 241-261; André Jacob, "Les écritures de Terra d'Otranto", në: *La Paléographie grecque et byzantine*. (Paris: 1977), 269-281; Poul Canart, Santo Lucà, *Codici greci dell' Italia meridionale, Catalogo della mostra*. Roma: 2000; Αγαμέμνων Τσελίκας, «Παρατηρήσεις σε Πελοποννησιακά χειρόγραφα του 11ου, 12ου και 13ου αιώνας», në: *Πρακτικά Γ' Διεθνούς Συνεδρίου Πελοποννησιακών Σπουδών, Καλαμάτα, 8-15 Σεπτεμβρίου 1985*, vëll. II. (Αθήνα: 1987-1988), 486-498; Për një bibliografi më shteruese shih Poul Canart, *Paleografia e codicologia greca: una rassegna bibliografica*, Littera Antiqua 7, Scuola Vaticana di Paleografia, Diplomatica e Archivistica. Città del Vaticano: 1991, 45-48.

6. Për përshkrimin e përmbajtjes, autori ka konsultuar kodikun në formën e digitalizuar në Digital Bodleian: <https://digital.bodleian.ox.ac.uk/inquire/p/4907e5b4-7b8f-40ad-9759-c417d6169afb>, konsultuar më gusht, 2019. Gjithashtu, shih Henricus O. Coxe, *Catalogus Codicum Mss. qui in Collegiis Aulisque Oxoniensibus hodie adservantur. Catalogus Codicum Mss. Collegii B. Mariae Magdalенаe*, (Oxonii: E Typographeo Academico, 1852), nr. 9, fq. 4-5. Irmgard Hutter, *Corpus der byzantinischen Miniaturenhandschriften: Oxford College Libraries*. (Stuttgart, Hiersemann 1997), Vol. V.1: fig. 252-259, 261-276, 278-289, 291, tab. 19; Vol. 5.2: nr. kat. 30, fq. 85-90. Për një përshkrim më të detajuar palaografik dhe kodikologjik, shih, Annaclara Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti a Londra (British Library), ed a Oxford (Magdalen College)", në: *Studies in Greek Manuscripts (Testi, studi, strumenti 24)*, 2 vols, (Spoleto, 2008), vol. 2: 482-485. Annaclara Cataldi Palau, "The Burdett-Coutts collection of Greek manuscripts: Manuscripts from Epirus", *Codices Manuscripti 54/55* (2006): 31-64. [Reprinted in *Studies in Greek Manuscripts (Testi, studi, strumenti 24)*, 2 vols, (Spoleto, 2008), vol. 2, 523-584]. 7. Ungjilli sipas Markut fillon me tekst të mangët, pa krye: fl 35r, Inc. ἐκ τ(ῶν) ου(ρα)νῶν· σὺ εἶ ὁ υ(ί)ός μου ὁ ἀγαπητ(ός).

Veprat e Apostujve (fl 116r-149r), Letrat e ndryshme të Apostujve (fl 149v-231r),<sup>8</sup> Psalmet e Davidit (fl 232r-284v), Ode dhe Urata (fl 285r-291v). Është produkt luksoz i punishteve kodikëshkruese të Kostandinopojës, pergamena është e bardhë dhe e pastër, dekoret janë realizuar me stilin *Blütenblattstil*,<sup>9</sup> në sfond të florinjte, me zotërimin e ngjyrës blu.<sup>10</sup>

Kodiku Magdalen College gr. 9 (fig. 1) është shkruar në pergamenë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XII dhe përmban katër Ungjijtë (f. 3r-115v), Veprat e Apostujve (f. 116r-149r), letra të ndryshme të Apostujve (f. 149v-231r), Psalmet e Davidit (fq. 232r-284v), Ode dhe lutje (fq. 285r-288r) dhe disa bekime (f. 288r-291v).

Kodikut i është bashkangjitur në fillim një dyfletësh i huaj, prej pergamene të cilësisë së dobët, me përmasa më të vogla se pjesa tjetër e kodikut. Karakteristikat e pergamenës, përmbajtja e shënimeve dhe analiza paleografike, na bëjnë të besojmë se dyfletëshi me shumë

---

8. Më konkretisht: Letrën e Përgjithshme të Apostull Jakovit (fl 149v-152v), Letrën e Parë të Apostull Pjetrit (fl 153r-156r), Letrën e Dytë të Apostull Pjetrit (fl 156v-158v), Letrën e Parë të Apostull Joanit (fl 159r-162r), Letrën e Dytë të Përgjithshme të Apostull Joanit (162v-163r), Letrën e Tretë të Përgjithshme të Apostull Joanit (163cv-164r), Letrën e Përgjithshme të Apostull Judës (fl 164v-165r), Letrën e Apostull Pavlit drejtuar Romakëve (fl 165v-177r), Letrën e Parë drejtuar Korinthianëve (fl 177v-187r), Letrën e Dytë drejtuar Korinthianëve (fl 188r-195r), Letra drejtuar Galatianëve (fl 196r-199v), Letrën drejtuar Efesianëve (fl 200r-203v), Letrën drejtuar Filipianëve (fl 204r-206v), Letrën drejtuar Kolosianëve (fl 207r-209v), Letrën e Parë drejtuar Thesalonikasve (fl 210r-212r), Letrën e Dytë drejtuar Thesalonikasve (fl 213r-214r), Letrën e Parë drejtuar Tomotheut (fl 215r-217v), Letrën e Dytë drejtuar Tomotheut (fl 218r-220r), Letrën drejtuar Titos (fl 220v-221v), Letrën drejtuar Filimonit (fl 222r-v), Letrën drejtuar Hebrenjve (223r-231r).

9. Mbi aplikimin e stilit *Blütenblattstil* në miniaturën bizantine, shih Kurt Weitzmann, *Die byzantinische Buchmalerei des IX. und X. Jahrhunderts*, Berlin 1935 [riprodhim anastatik: Wien 1996 (Österreichische Akademie der Wissenschaften. Philosophisch -historische Klasse, Denkschriften, 243; Veröffentlichungen der Kommission für Schriftund Buchwesen des Mittelalters, Reihe IV, 2/1)], 22-32.

10. Coxe, *Catalogus*, 4-5; Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 484-485.

gjasa është shkruar në Berat në shek. XIV<sup>11</sup>. Duke gjykuar nga sa më sipër, mund të pohojmë se ky kodik do të jetë sjellë në Berat nga Kostandinopoja, ndoshta rreth fundit të shek. XIV.

Dyflëtëshi *përmban disa shënime*<sup>12</sup>, ndër të cilat një është i shkruar me ngjyrë kafe të errët, me germa shumë të vogla dhe përmban të dhëna historike mbi vdekjen e Balshës II më 1385, në betejën e Savrës së Lushnjës kundra trupave osmane të Hajredin Pashës. Shënimi është botuar për herë të parë nga Henricus O. Coxe<sup>13</sup>, më pas me pasaktësi prej Spiridhon Lamprou<sup>14</sup>, prej të cilit është përdorur edhe nga studiuesit e mëvonshëm<sup>15</sup>. Për këtë arsye, po sjellim këtu transkriptimin e shënimit<sup>16</sup>, realizuar prej nesh nga origjinali, së bashku me përkthimin shqip:

«+ Εσκωτώθεν· ό πανυψελωτ(ά)του αυθ(έν)τ(ης) ήμον  
πάλασας ηπο |2 των αγαρηνων· έθνων· μην(ι) σεπ(τ)

11. Shih edhe Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 484-485.

12. I pari, në fl 1r, është shënim lutjeje i shkruar në shek. XIII-XIV: «Κ(ύρι)ε ο Θ(εό)ς μου μη άπορειψης ημας |2 από του προσοπου σου [...]» ("O Zot, *Perëndia im, mos e kthe mënjatë fytyrën tënde prej nesh*"); i dyti, i shkruar në dy kolona nga një tjetër dorë, flet për përmbajtjen në kodik të katër ungjijve, të letrave të apostujve dhe të psalmeve të Davidit; i treti, është shkruar me ngjyrë kafe të errët dhe me shkrim shumë të vogël, i cili përmban shënimin historike lidhur me Balshën që trajtojmë këtu. Për transkriptimet e shënimeve, shih Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 483.

13. Coxe, *Catalogus*, 4-5.

14. Transkriptimi i Sp. Lampros: "Εν αρχή έσκωτώθεν αυθέντης ήμέτερος Πάλασας υπό των Άγαρινών έθνών μηνός Σεπτεμβρίου ιη' ήμέρα β' έτους ,ςωδ'». Σπυρ. Π. Λάμπρος, «Ενθυμήσεων ήτοι χρονικών σημειωμάτων συλλογή πρώτη», *Νέας Έλληνομνήμων* 7 (1910): nr. 77, fq. 145.

15. Pëllumb Xhufi, *Nga Paleologët te Muzakajt. Berat dhe Vlora në shekujt XII-XV*, (Tiranë, 2009), 312-313, shën. 1. Pëllumb Xhufi, *Arbërit e Jonit. Vlora, Delvina e Janina në shekujt XV-XVII*, (Tiranë: Onufri, 2017), 218, ku përsëritet besnikërisht transkriptimi i mbishkrimit i bërë nga Lampros.

16. Për një realizim të fundit të transkriptimit, shih edhe Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 486-490.

ε(μβ)ρ(ι)ου ιη' ἡμε(ρα) β' |3"Ετους ,ζωΐδ' τις ινδη-  
κτηώνις τόσης»

"U vra zoti ynë i gjithëlartë Balsha nga kombi i agari-  
nëve në ditën e tetëmbëdhjetë të muajit shtator, dita e  
dytë, e vitit 6894 (=1385), në indiktionin aq".

## II.

Kodiku i dytë *Magdalen College gr. 16*<sup>17</sup> daton në shek. XIV, është shkruar në letër dhe përmban veprën *Hyrje në logjikë* dhe *Hyrje në fizikë* të dijetarit bizantin, Niqifor Blemidhis (1197-1272)<sup>18</sup>. Në fletët e pashkruara të kodikut, në kohë të ndryshme janë lënë disa shënime kronike me rëndësi qoftë në lidhje me prejardhjen e kodikut, qoftë për historinë lokale. Kështu, në fl. 284v, në fund të tekstit ekziston një shënim kronik<sup>19</sup>, i shkruar me germa të vogla dhe me bojë kafe në gri, që lidhet me vdekjen e Balshës II në vitin 1385. Përmbajtja, si vijon:

«ἐτελεύτησεν ο π(αν)υψηλοτ(α)τος αυθ(έν)τ(η)ς ε(μ)  
ων καὶ δοῦξ Δηραχειον Μπαλσα υπο τὸν αθε(ων) καὶ  
παρμ(ι)β(ι)β(ι) εν μηνι σεπρέμβρη των αστυι ιη' ημερα  
β' επι ετους ,ζωΐδ' (ι)νδ. θ'»<sup>20</sup>.

«Mbaroi zoti ynë i gjithëlartë dhe duka i Durrësit,  
Balsha, nga të pafetë dhe ... në ditën e tetëmbëdhjetë  
të muajit shtator, ditën e II, në vitin 6894 (=1385),  
indiktionin 9».

17. Coxe, *Catalogus* nr. 16, fq. 7. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 486-490. Cataldi Palau, "The Burdett-Coutts collection", 579.

18. Mbi Blemidhis (Nicephorus Blemmydes) dhe veprën e tij, shih Steven Runciman. *The Last Byzantine Renaissance*. (Cambridge: Cambridge University Press, 1970), 54-58.

19. Λάμπρος, «Ἐνθυμήσεων», nr. 78, fq. 145; Coxe, *Catalogus* nr. 16, fq. 7.

20. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 487.

Krahasuar me shënimin historik të kodikut *Magdalen College gr.* 9 mbi vdekjen e Balshës II, këtu vërehet, nga njëra anë, përdorimi i termave të njëjtë për Balshën (*zot, i gjithëlartë*), ndërsa, nga ana tjetër, shënimi paraqitet më i detajuar e me epitete të shtuara, si "*dukë i Durrësit*". Po ashtu, fjala "*agarinët*" është zëvendësuar me fjalën "*të pafetë*". Në fl. 113r, gjendet e shkruar një tjetër kronikë e vitit 1480, që flet për sëmundjen vdekjeprurëse të murtajës, përhapjen e saj dhe gjendjen e vështirë që kishte krijuar jo vetëm në Berat, por "*në Ilirik dhe në të gjithë Arbërinë*"<sup>21</sup>.

### III.

Kodiku *Additional 37007*<sup>22</sup> i përket shek. XIII-XIV, është shkruar në pergamenë dhe përmban katër ungjijtë me shenja muzikore (ekphonic neumes)<sup>23</sup>. Në një dyfletësh të lidhur me të, ekziston një inventar i datuar i vitit 1399<sup>24</sup>, me libra e objekte të çmuara, pronë e manastirit

21. Përmbajtja e mbishkrimit: "*Shërbëtori i Zotit, Lemirosnati, vdiq nga sëmundja në vitin 6998 (= 1480), më 14 shkurt, të hënë e lidhjes së mishit, në orën 9 të ditës. Kujtoje o Zot, tani dhe përherë, që të gjejë mëshirë në ditën e gjykimit. Pati jashtëzakonisht shumë vdekje, aq sa me të humburit nga murtaja ushqeheshin kafshët dhe zvarranikët dhe dimri në Berat (shkakton viktima) të shumta, por edhe në Licinia dhe në Ilirik dhe në të gjithë Albaninë. Po ku nuk ndodh tjetër? Kështu që njerëzit e zgjedhur janë zhdukur dhe askush nuk i përmend ato me emër*". Për transkriptimin e shënimit, shih Cataldi Palau, "*Manoscritti epiroti*", 487. Një kronikë e ngjashme ndeshet edhe në vitin 1455, shih Peter Schreiner, *Die Byzantinischen Kleinchroniken*, vol. 1: Teil Eingetung und Text, (Wien: Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 1975), 666.

22. Marcel Richard, *Inventaire*, 68-69. *Catalogue of additions to the manuscripts in the British Museum in the years 1900-1905*, (London: The Trustees, 1907), 279.

23. Këqyrja e kodikut është kryer nga autori përmes formës së digjitalizuar në Digitised Manuscripts-British Library: [http://www.bl.uk/manuscripts/FullDisplay.aspx?ref=Add\\_MS\\_37007](http://www.bl.uk/manuscripts/FullDisplay.aspx?ref=Add_MS_37007), konsultuar në gusht, 2019.

24. Inventari është botuar tre herë nga Anthim Aleksudhi: "*Ἀνθίμος Ἀλεξούδης, Ἐπιγραφαὶ τῆς ἐν Ἡπείρῳ Ἀπολλωνίας, Ὁ ἐν Κωνσταντινουπόλει Ἑλληνικὸς Φιλολογικὸς Σύλλογος, Ἀρχαιολογικὴ Ἐπιτροπὴ, Παράρτημα τοῦ ΙΖ' τόμου (1886): 182-187; Ἀνθίμος Ἀλεξούδης, «Δύο σημειώματα ἐκ χειρογράφων ὑπὸ τοῦ Ἀμασείας Ἀνθίμου Ἀλεξούδης», Δελτίον τῆς Ἱστορικῆς καὶ Ἐθνολογικῆς Εταιρίας τῆς*

të Shën Nikollës në Perondi (Pentarkondëve) pranë Beratit<sup>25</sup>. Në këtë inventar përmenden dy personazhe historike që lidhen me qytetin e Beratit, Theodhori III Muzaka, i cilësuar "*Zot i Beratit*" dhe Balsha II, i cili paraqitet si dhurues i perdes së mëndafshhtë për derën e bukur të Altarit. Po ashtu, inventari përmban edhe njoftime mbi periudhën e trazuar në Berat në shek. XIV(-XV) për shkak të inkursioneve osmane.

Nga ekzaminimi paleografik dhe kodikologjik, kodiku përmban të gjitha veçoritë që karakterizojnë kodikët epirotë. Kjo do të thotë se, me shumë gjasë, ky kodik ka qenë ruajtur gjithmonë në vendin ku ishte shkruar fillimisht. Nga inventari mësojmë se kodiku i përkiste atëkohë (v. 1399) manastirit të Shën Nikollës së Pentearhondëve (Perondisë), që gjendet rreth 12 km në veri të qytetit të Beratit. Inventari është hartuar nga Danieli<sup>26</sup>, priftmurg dhe igumen i manastirit, me

---

Ελλάδος 4 (1892): 279-281; Ἀνθίμος Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων. Κατάλογος μετὰ περιγραφῆς χειρογράφων κωδίκων ἐκκλησιαστικῆς ὕλης, εὐρισκομένων ἐν Βερατίῳ καὶ ἰδίως ἐν ταῖς ἱεραῖς ἐκκλησίαις τῆς συνοικίας Κάστρου, οἷον τῆς Μητροπόλεως Βελεγράδων τῆς ἐπ' ὀνόματι τῆς Κοιμήσεως τῆς Θεοτόκου τιμωμένης, τῆς Παναγίας Εὐαγγελιστρίας, τοῦ ἁγίου Ἰωάννου τοῦ Θεολόγου καὶ τοῦ ἁγίου Γεωργίου», *Ἐκκλησιαστικὴ Ἀλήθεια* 21 (1901): [23.02.1901] 71-72. Një botim më i vonë të këtij inventari, me disa korrigjime të tekstit dhe të datës së botimit të Aleksudhit më 1892, është kryer nga Sp. Lampros: Σπυρίδων Π. Λάμπρος, «Διορθώσεις εἰς ἔγγραφο ἐκ Βελεγράδων», *Νέος Ἑλληνομνήμων* 7 (31 Δεκεμβρίου 1910, τεύχος Δ'): 486-487. Në shqip inventari është botuar te Koço Bozhori, *Dokumente të periudhës bizantine për historinë e Shqipërisë: (shek. VII-XV)*, (Tiranë: Mihal Duri, 1978), 105. Për botime të tjera, me korrigjime pasaktësish, shih Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 443-521 (449-472). Andi Rembeci, Sokol Çunga, "Greek Manuscripts in Albania: Book Circulation and Libraries. Preliminary evaluations from a catalogue in process", paper presented in: *Le livre manuscrit grec : écritures, matériaux, histoire. IXe Colloque international de Paléographie grecque à la mémoire de Paul Canart*, (Lundi 10 septembre – Samedi 15 septembre 2018) (forthcoming).

25. Mbi kishën e Shën Kollit, shih Aleksandër Meksi, *Arkitektura e kishave të Shqipërisë (shekujt VII-XV)*, (Tiranë, Uegen, 2004), 152-155; Aleksandër Meksi, "Arkitektura dhe restaurimi i kishës së Perondisë", *Monumentet* 5-6 (1973): 19-42.

26. Erich Trapp, Walther Rainer, Hans-Veit Beyer, *Prosopographisches Lexikon der Palaiologenzeit*. Wien: Verlag der Österreichischen Akademie der Wissen-

qëllim dorëzimin e disa objekteve dhe kodikëve të çmuar të manastirit të "zoti i qytetit" Teodor Muzaka, për t'i ruajtur në kalanë e Beratit nga frika e një sulmi të osmanëve. Kur Anthim Aleksudhi botoi dy përshkrime të dorëshkrimit në vitin 1892 dhe 1900, kodiku gjendej në kishën e Shën Marisë së Vllahernës (Παναγία τῶν Βλαχερνῶν), në kalanë e Beratit, dhe mbahej nga bijtë e Joan Pavël Ikonomit, banorë të kalasë<sup>27</sup>. Më vonë, dorëshkrimi *Add. 37007* së bashku me *Add. 37008* i kalojnë në pronësi, për një kohë shumë të shkurtër (1900-1904), njëfarë Joan Eleutheriou në Korfuz<sup>28</sup>. Në vitin 1904, kodikët bëhen pjesë e koleksionit prej 12 dorëshkrimesh greke, *Add. 37001-37012*, që zotëronte Rev. John Samuel Dawes, famullitar në Korfuz gjatë fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX. Koleksioni i këtij të fundit u ble më 1904 nga biblioteka e British Museum në Londër<sup>29</sup>.

Sikundër thamë, në fl. 1r të kodikut ekziston një inventar<sup>30</sup> i pasurive të manastirit të Shën Nikollës së Pentarkondive. Përmbajtja e inventarit<sup>31</sup>, që i referohet pasurisë librore të manastirit, është si vijon:

---

schaften. 1976, nr. 5102.

27. Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων», [23.02.1901] 71-72.

28. Caspar René Gregory, *Textkritik des Neuen Testaments*, (Leipzig, J.C. Hinrichs, 1900), 428, nr. 459, 461.

29. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 446, 450.

30. Inventari është botuar tre herë nga Anthim Aleksudhi: Ἀλεξούδης, "Ἐπιγραφαι τῆς ἐν Ἡπείρῳ Ἀπολλωνίας": 182-187; Ἀλεξούδης, «Δύο σημειώματα ἐκ χειρογράφων»: 279-281; Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων»: [23.02.1901] 71-72. Një botim më i vonë të këtij inventari, me disa korrigjime të tekstit dhe të datës së botimit të Aleksudhit më 1892, është kryer nga Sp. Lampros: Λάμπρος, «Διορθώσεις εἰς ἔγγραφον ἐκ Βελαγράδων»: 486-487. Për botime të tjera, me korrigjime shtesë, shih Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 443-521 (449-472). Rembeci dhe Çunga, "Greek Manuscripts in Albania", (forthcoming).

31. Format e publikuara më parë të transkriptimit të inventarit paraqesin disa pasaktësi të lehta me transkriptimin tonë, kryesisht në analizën e shkurtesave dhe korrektimin e disa fjalëve. Brenda kllapave harkore vendosen shtjellimet e shkurtesave, ndërsa brenda kllapave katrore deklarohen germat, të cilat kanë humbur për shkak të dëmtimit të shkrimit ose të fletës.



"Εγώ Δανηήλ ιερομόναχος καὶ καθηγούμενος τῆς μονῆς τοῦ ἁγίου Νικολάου τον Πεντερχοντίον ἐξεβαίνω με τὸν αὐθ(έντην) [...] Θεόδ(ω)ρ(ον) τὸν Μουζάκ(ον)· καὶ ἐπέρνω με τὸν εμαυτὸν ι(ερο)ν ἀρχ(αῖον) εὐαγγέλιον εὐλογάδην ἐκοσμησμέ(νον) με στ(αυ)ρὸν ἀργειρόχρυσ(ον) [...] τ[έ]σ[σε]ρας ευαγγελειστας δευραν(ον)· κ(αὶ) τετραβαγγελον δευραν(ον)· ἐξαήμερος κομάτια δύο τὸ πρῶτ(ον) κ(αὶ) το δεύτερ(ον)· κατα Ματθαί(ως)· Θεολόγ(ος) δεύρανο(ς)· Θεολόγ(ος) βαβήκηνο(ς) δηερμηνευμ(έν)ος Ἀναστάσιο(ς) δεύρανο(ς)· Ζουηροῦ νόμηνον βαβήκηνο(ον) με κό[κ]ην(ον) τομάρη· Ἀντίοχο(ς) βαβήκηνο(ς)· Εὐφραίμ βαβήκηνο(ς)· Ψαλτ(ή)ρι(ον) δεύραν(ον) δηερμηνευμ(έν)ον· προφητία βαβήκηνο(η)· ἡρμολόγ(ιον) βαβήκηνο(ον) τὸνησμ(έν)ως· Κατήχησης βαβήκηνο· Τηπηκὸν δεύρανο Ἱεροσολημητ(ικόν)· Σχηματολόγ(ιον) βαβήκηνο(ον)· Μηναίων καθημερινῶν ἐξαμηναίων δεύραν(ον), ἡγουν σεπτέβριος, ὠκτόμβριος, νοέμβριος, δηκέμβριος, ιαν(ουά)ρ(ιος) καὶ [...]· Εὐχολόγ(ιον) βαβήκηνο(ον)· ὁμου κομάτια ἡκοση... καὶ παραδίδω ... εἰς τὰς χεῖρας τοῦ αὐθ(έντου) μου τοῦ Θεοδώρου τοῦ Μουζάκ(η), νὰ ἦν(εν) εἰς τὸ κελ(ά)ρ(ι) καὶ νὰ τὰ ἐπηβλέπ(ει) ὁ κελλ(α)ρ(ίτης) ὁ Θεοτόκης ἀσφαλὸς... ἐξήβαλα ἐγὼ ὁ Δανηήλ καθηγούμε(εν)ος καὶ ἁμαρτωλὸς ιερομόναχος διὰ τ(ὸν) φόβον τὸν Τουκὸν ἐκ τὴν σε(βασμίαν) μονὴν τοῦ ἁγίου Νικολάου... εγρά(φη) ἐν μη(νὶ) νοεμβρίῳ εἰς τὰς ὠκτώ... ἐπὶ ἔτους ,ςζῆη' (6908=1399)".

«Unë, Danieli, priftmurg dhe igumen i manastirit të Shën Nikollës së Pentearhondëve, shkova me zotin im Theodhor Muzakën dhe mora me vete një ungjilltar të hirshëm të lashtë, të dekoruar me kryq argjendi të pruar [...] katër ungjilltarë në pergamenë; dhe një katërungjillësh në pergamenë; heksamerë dy copë, të parin dhe të dytin; (ungjillin) sipas Mattheut; (ungjillin) sipas Joan Theologut në pergamenë; (ungjillin) sipas Joan Theologut me komente në letër; i Anastasit

në pergamenë; (nomokanoni i Joan) Zunarës në letër (i mbështjellë) me lëkurë (gëzof) të kuqe; i Antiokut në letër; i Efremi në letër; Psaltirin në pergamenë me komente; Profecitë në letër; Irmologun në letër me nota; (librin) e Katekizmit në letër; Tipikonë e Jerusalemit në pergamenë; Skimatologun në letër; Mujoret e përditshme të gjashtëmuajve në pergamenë, d.m.th. shtator, tetor, nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt; Uratoren në letër; të gjitha bashkë 20 copë. ... dhe i dorëzoi këto... në duart e zotit tim Theodhor Muzaka që të vendosen në qilar dhe të mbikëqyren të sigurta nga qilarxhiu Theotok<sup>32</sup>... i nxora prej manastirit të respektuar të Shën Nikollës, unë Danieli, igumen dhe priftmurg mëkatar, nga frika e turqve... U shkrua më tetë të muajin nëntor ... në vitin 6908 (=1399)».

Episodi i përshkruar në inventarin e mësipërm përkon, me sa njohim, me ngjarjet e kohës. Me të vërtetë Berati ishte i njohur për kalanë e tij të fortifikuar, me muret bizantine të cilat i pati rindërtuar despoti Mihal Engjëlli Komneni rreth vitit 1205, kur Berati u përfshi në territoret e Despotatit të Epirit<sup>33</sup>. Manastiri i Shën Nikollës së Pentarkondive, nga ana tjetër, gjendet i pambrojtur jashtë kalasë, "rreth një orë e gjysmë" në veri të qytetit të Beratit<sup>34</sup>. Për këtë arsye, priftmurgu Daniel kërkonte t'i shpëtonte thesaret e manastirit të tij, duke ia besuar të zotit të qytetit, për t'i mbrojtur në pjesën e fortifikuar, brenda kalasë. Shqetësimet e tij "nga frika e turqve" duket se janë plotësisht të justifikuara, për shkak se inkursionet e osmanëve në

32. Erich Trapp et al., *PLP*, nr. 7561.

33. Aleksandër Meksi, Apollon Baçe, Emin Riza, *Berati, historia dhe arkitektura*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2011), 43-81. Gjerak Karaiskaj, *5000 vjet fortifikime në Shqipëri*, (Tiranë: Pegi, 2015), 124-128.

34. Ἀλεξούδης, «Δύο σημειώματα», 279-280; Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων», 71.

ato anë u bënë më të shpeshta, duke filluar nga fundi i shek. XIV deri gjysmën e parë të shek. XV, kur edhe Berati bie në duart e osmanëve<sup>35</sup>.

Dorëshkrimet e cituara në inventarin e kodikut *Add 37007* janë të vështira të identifikohen për shkak të përshkrimit jo të qartë dhe shumë të përgjithshëm<sup>36</sup>. Sidoqoftë, mbështesim pikëpamjen e Annaclara Cataldi Palau, sipas së cilës fakti që dy kodikët *Add. 37007*, *37008* patën qëndruar në Berat deri në fillim të shek. XX, na shtyn të mendojmë se edhe kodikë të tjerë mund të kenë pasur të njëjtin fat<sup>37</sup>. Gjatë përpjekjes sonë të parë, arritëm të identifikonin 5 kodikë të inventarit *Add. 37007* me kodikët e përshkrimeve të Aleksudhit në fillim të shek. XX dhe me ato që kanë mbijetuar deri më sot dhe ruhen në AQSh<sup>38</sup>.

---

35. Aleksandër Meksi et al. *Berati*, 38. Xhufi, *Nga Paleologët*, 301-364, 349-352, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse.

36. Sikundër vëren me të drejtë edhe Annaclara Cataldi Palau, përshkrimi i kodikëve si Katërugjillësh, Mujore, Psaltir etj., pa specifikuar detaje të mëtejshme, e vështirëson identifikimin e tyre në katalogët e ndryshëm të botuar kohë pas kohe. Kodikë të këtyre tipologjive gjendeshin thuajse në të gjitha bibliotekat e kishave, manastireve dhe institucioneve të tjera kishtarë.

37. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 467.

38. Për përpjekje të mëhershme në ndërtimin e një konkordance mes të dhënave të botuara nga Anthim Aleksudhi dhe inventarit *Add. 37007*, shih Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 447, shën. 14 dhe 467-468. Për një konkordancë mes kodikëve të Fondit 488 në AQSh dhe dorëshkrimeve të Katalogut Koder-Trapp (Johannes Koder, Erich Trapp, "Katalog der griechischen handschriften im Staatsarchiv zu Tirana", *Jahrbuch der österreichischen byzantinischen Gesellschaft* 17 (1968): 197-214), shih Andi Rembeci, Sokol Çunga, "The Byzantine and Post Byzantine collection of manuscripts at the Central State Archive of Tirana and a concordance between the Koder-Trapp Catalogue of Tirana Manuscripts and their actual shelf-number" në: *Proceedings of the 22nd International Congress of Byzantine Studies*, Sofia, 22-27 August 2011, (Sofje: 2011), vol. III, 357. Shih edhe: *Greek New Testament manuscripts from Albania*, botuar në serinë: *New Testament tools, studies and documents*, v. 57, Leiden 2018, ku autorët Didier Lafleur dhe Luc Brogly kanë publikuar në faqet 58-60 dhe 523-543, në formë apendiksi, një tabelë konkordance të kodikëve të Shqipërisë, duke përfshirë edhe atë të Koder-Trapp. Për një tjetër përpjekje të pasaktë në ndërtimin e një

| Nr. | Inventari (Add 37007) 1399                                                                                       | A. Aleksudhi 1898-1900 | A. Aleksudhi 1900/1901/1902 | AQSh F. 488             |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|-----------------------------|-------------------------|
| 1   | Mujoret e përditshmeve të gjashtëmuajve në pergamenë, d.m.th. shtator, tetor, nëntor, dhjetor, janar dhe shkurt. | Kodiku nr. 28          | Kodiku nr. 13               |                         |
| 2   | Tipiko e Jerusalemit në pergamenë                                                                                | Kodiku nr. 31          | Kodiku nr. 16               | Kodiku i Beratit nr. 33 |
| 3   | Psaltirin në pergamenë me komente                                                                                | Kodiku nr. 37          | Kodiku nr. 23               |                         |
| 4   | (Ungjilli) sipas Joan Theologut me komente në letër                                                              | Kodiku nr. 39          | Kodiku nr. 25               |                         |
| 5   | Ungjilltar i hirshëm, i lashtë, i dekoruar me kryq argjendi të praruar.                                          | Kodiku nr. 4           | Kodiku nr. 32               | Kodiku i Beratit nr. 6  |

## IV.

Kodiku *Additional 37008*<sup>39</sup> është një Ungjilltar i shkruar në vitin 1413 në letër përëndimore, e prodhim italian në fund të shek. XIV,

---

konkordance të tillë, shih edhe: Sinani, *Kodikët e Shqipërisë në "Kujtesën e Botës"*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2011), 66.

39. Këqyrja e kodikut është kryer nga autori përmes formës së digjitalizuar në Digitised Manuscripts-British Library: <http://www.bl.uk/manuscripts/>

fillim të shek. XV<sup>40</sup>. Shkrimi i kodikut është i tipit barok, i shkruar me bojë të zezë dhe me germa të përmasave të mëdha. Fletët mbajnë filigrane të ndryshme, si: kampanë (fl. 1-5, 8-15, 19-28), germa kapitale B, gjysmë-njëbrirësh në dy forma, gjysmë-qen dhe gjysmë-kal.

Në fl. 397r-v të dorëshkrimit gjendet shënimi kodikografik, i cili na njofton se kodiku është shkruar në qytetin e Beratit nga kopisti Gjeorgj Sidherokastriti («Γεώργιος Σιδεροκαστρίτης»)<sup>41</sup>, me shpenzimet e "fort të respektuarit, zotit" të qytetit, Niqifor Luvri<sup>42</sup> dhe gruas së tij, Maria Qirikalena<sup>43</sup>. Të dy këta përmenden edhe si ktitorë të manastirit të Shën Marinës, së cilës me sa duket i dhuruan edhe kodikun. Si donatorët e dorëshkrimit Niqifor Luvri dhe gruaja e tij Maria Qirikalena, ashtu edhe kopisti Gjeorgj Sidherokastriti na janë bërë të njohur vetëm nga ky shënim kodikografik, por mbeten ende shumë pak të njohur nga hulumtimet e deritanishme.

Në fletën 1r të dorëshkrimit është hartuar një tjetër inventar<sup>44</sup> me 28 kodikë të dorëshkruar, pronë të kishës së Shën Marinës në

---

FullDisplay.aspx?ref=Add\_MS\_37008, konsultuar në gusht, 2019. Për më tepër, të dhënat e këqyrjes janë krahasuar edhe me bibliografinë ekzistuese: Richard, *Inventaire*, 69. Catalogue of additions, 279-280. Ἀλεξούδης, «Κατάλογος»: 352-369, 357-359. Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων»: [15.12.1900], 545, nr. 39. Gregory, *Textkritik*, 428, 1268, 1287. Ioannis Spatharakis, *Corpus of Dated Illuminated Greek Manuscripts to the Year 1453*, (Byzantina Neerlandica 8), (Leiden 1981), 68, nr. 280. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 472-482.

40. Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 476-477.

41. Marie Vogel, Viktor Gardthausen, *Die griechischen Schreiber des Mittelalters und der Renaissance*, (Leipzig O. Harrassowitz, 1900), 84; Ernst Gamillscheg, Dieter Harlfinger, Herbert Hunger, *Repertorium der griechischen Kopisten 800-1600*, Brand III/1A: Verzeichnis der Kopisten. Österreichische Akademie der Wissenschaften, Veröffentlichungen der Kommission für Byzantinistik, (Wien: Verlag der Österreichischen Akademie der Wissenschaften, 1981), 61, nr. 70.

42. Erich Trapp et al., *PLP*, nr. 15053; Vogel dhe Gardthausen, *Die griechischen Schreiber*, 84. Λάμπρος, «Ενθυμήσεων», 276-277, nr. 560.

43. Erich Trapp et al., *PLP*, nr. 14007. Vogel dhe Gardthausen, *Die griechischen Schreiber*, 84.

44. Ἀλεξούδης, «Ἐπιγραφαι», 186-187. Ἀλεξούδης, «Κατάλογος», 357-359. Ἀλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων»: [15.12.1900] 544-545. Shënimi

Berat. Inventari edhe pse është përmendur nga A. Aleksudhi në botimin e katalogut të kodikëve të Beratit, nuk u botua prej tij. Në fillim, përpara inventarit, ekziston një shënim<sup>45</sup> që bën fjalë për gjetjen (e disa kodikëve, ndoshta) në kishën e Shën Marinës dhe për dorëzimin ose ndoshta blerjen e tyre (meqenëse përmenden para). Më tej pason mallkimi i zakonshëm kundër atyre që do të dëmtojnë ose do të tjetërsojnë kodikët. Në fund është nënshkrimi i njeriut që i gjeti kodikët, «ἀναξίου Στ(α)μ(ά)του τοῦ Καλατ(ιν)ου» («*Stamati i padenjë nga Galata ose Kalata*»), zotërues i dorëshkrimeve<sup>46</sup>. Më pas vijon inventari, i shkruar nga një tjetër dorë, por bashkëkohëse, me përmbajtjen si vijon:

«Τα βηλία τῆς ἀγίας Μαρ(ι)νας· Παρακλητ(ι)κος, κο-  
μάτ(ι)α β', ἐβανγγέλ(ι)ον ἐνκόσμεσ[μένον], |2 Πεντ(η)  
κοστάριν, Τριόδην, Ἀπόστολ(ον), Μηνίο αὐγουστος καὶ  
σεπτέβρις· μηνὴ ὀκτόβρ[ιον] |3 μηνὴ νεόβριος μηνὴ  
δικέβριος καὶ γενάρης μηνὴ φευρουᾶριος καὶ μάρτιος  
|4 μηνὴ ἀπρ(ι)λίου καὶ μαΐος μηνὴ ἰούνιος καὶ ἰούλιος  
βιβλίο δέβερνο λόγ(ων) τῶν ἁγίων, |5 Πραξαππό(στ)  
ο(λος), μη(νὶ) ἰουνηος δέβαρνος βηλήο εὐλόγ(α)δη-  
βηβλίο Ἀνδρέου τοῦ σαλου· |6 Λυτουργ(ία) β', μικρὸ  
βηβλήο δεβάρ(νο), καὶ ἄλο μικρὸ βαβήκينو, Πανη-  
γυρικὸ βαβή(κينو) |7 , Ὁρολόγ(ιον), Ἀμαπασιμάρι-  
Τριαδικὸν· Ἀνθολόγι· Θεόλόγος· Ἀκουλουθία τῆς |8  
ομοῦ βηβλία κη'»<sup>47</sup>.

---

është ribotuar me korrigjime nga Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 474-475.

45. Shënimi është transkriptuar dhe botuar nga Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 474-475.

46. Transkriptimi ynë nga origjinali Additional 37008, fl 1r. Krahaso: Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 475

47. Transkriptimi te Cataldi Palau, "Manoscritti epiroti", 474-475 ka ndryshime të kufizuara me transkriptimin tonë, në lidhje me ortografinë, përdorimin e theksave, saktësinë e analizave të shkurtesave. Brenda kllapave harkore vendosen shtjellimet e shkurtesave.

Librat e Shën Marinës; Paraklitiku, copë 2; ungjill i dekoruar; Pesëdhjetorja; Triodi; Apostulli; Mujore e gushtit dhe shtatorit; Mujore e tetorit; Mujore e nëntorit; Mujore e dhjetorit dhe janarit; Mujore e shkurtit dhe marsit; Mujore e prillit dhe majit; Mujore e qershorit dhe korrikut; libër në pergamenë me fjalë të shenjtoreve; Veprat e Apostujve; Mujore e qershorit në pergamenë; libër uratore; libri i (Shën) Andreas së Marrë (më Krishtin); dy Liturgji; libër i vogël në pergamenë; dhe një tjetër i vogël në letër; Panegjirik në letër; libri i Orëve; Libri i Prehjes; Triodi; Antologji; (libri i) Theologut; libri i Shërbesave; të gjitha së bashku 28.<sup>48</sup>

Identifikimi i këtyre 28 kodikëve në këtë inventar shfaqet edhe më problematik se ata të inventarit të mëparshëm, duke pasur parasysh paqartësinë e skajshme të përshkrimit të çdo kodiku. Ajo që mund të themi me siguri është se të paktën kemi të bëjmë me dy kategori kodikësh: prej pergamene dhe prej letre.

Përveç dy inventarëve të mësipërm, njoftime për ekzistencën e librave në mjedisin arbëror na vjen edhe nga i mirënjohuri shënim i "Diptikut" të Manastirit të Shën Gjergjit në kalanë e qytetit të Beratit, shkruar më 1356<sup>49</sup>. Shënimi dhe përshkrimi i 26 kodikëve të shpëtuar paraqitet si vijon:

---

48. Përkthimi në shqip yni.

49. . Shënimi i Diptikut, apo siç quhet ndryshe edhe Kronika e Skuripeqit, është botuar për herë të parë nga Pierre Batiffol, « Les manuscrits grecs de Bérat d'Albanie et le Codex Purpureus Φ », *Archives des missions scientifiques et littéraires*, 3e série, Paris, 13 (1887), appendix 2, 437-556, 554-556. Më pas, është botuar nga Aleksudhi në dy artikuj të tij: Άλεξούδης, "Δύο σημειώματα", 275-279 dhe Άλεξούδης, «Κώδικες ἐπαρχίας Βελεγράδων»: [21.01.1901], 16. Shënimi përmendet, gjithashtu, i pjesshëm në shqip nga Sinani, *Kodikët e Shqipërisë*, 372, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse në shqip. Këtu autori herë gabimisht njëjtëson (fq. 372, shën. 280) dhe herë pasaktësisht tjetëron (fq. 130, 405) përmbajtjen e tij me të dy shënimeve të tjera që gjendet në Kodikun e Beratit nr. 27. Shih edhe Xhufi, *Nga Paleologët*, 241-242, ku përkthimi shqip vjen jo besnik ndaj origjinalit.

Πατέρες ἅγιοι, οὗτος ὁ Σκουριπέκης ἐχάρισε τῆς Μονῆς τοῦ Μεγάλου Θεολόγου καὶ τοῦ ἁγίου Γεωργίου βιβλία κς' τὰ διαλεκτὰ καὶ τὰ κριτώτερα, ὅταν ἐκούρσεψαν οἱ Σέρβοι τὰ Βελάγραδα ἠνέταξαν, ἐκρεμνοῦσαν δεξιὰ καὶ ἀριστερὰ τὰς ρύμνας ἀπέσω εἰς τὸ Κάστρον. Ὁ παπᾶς Θεόδουλος δὲ ἐκεῖνος θαρρῶντας εἰς μικρὰν ἐνόραν ἐπαρακάλεσεν τὸν τοιοῦτον καὶ ἀπῆγε τὸν ἕως τὸν Πύργον εἰς τὴν μεγάλην πόρταν τοῦ Κάστρου καὶ ἀπογλύτωσαν τὰ τοιαῦτα κς' βιβλία καὶ ἐκουβάλησάν τα ἔσω εἰς τὸν Κουλὰν εἰς δ' ὁρὰς ὁ ἱερομόναχος ἐκεῖνος εἰς τὸν ὦμον τοῦ καὶ εἰς τὰς χεῖρας τοῦ ἀπὸ β'. Οἱ σύντροφοί του δὲ ἐκούρσεβαν καὶ ἀδιαφοροῦσαν... ἐν τῷ ,ζωξδ' ἔτει (= 1356) ... .

Etër të shenjtë, ky Skuripeqi i fali manastirit të Theologut të madh dhe [manastirit] së Shën Gjergjit 26 libra, nga më të zgjedhurit dhe më të rëndësishmit. Kur serbët plaçkitën Beratin, ngrinin gjithçka përjetë; varnin majtas e djathtas rrugëve jashtë Kalasë, papa Theodhuli, që shërbente në një famulli të vogël, iu lut atij [Skuripeqit] dhe e çoi deri tek kulla [që ndodhet] tek porta e madhe e Kalasë. Dhe i shpëtuan këta 26 libra dhe i mbajtën ngarkuar në pjesën e brendshme të kullës, duke bërë 4 rrugë vetë hieromonaku edhe Skuripeqi, duke mbajtur në shpinë dhe në duar nga dy libra. Kurse shokët e tij plaçkitnin dhe rrinin indiferentë. Vëllezërit e hieromonakut u larguan, sikundër edhe gjithë banorët e Kalasë. ... [Kjo ndodhi] në vitin 6864 [1356]. [...] <sup>50</sup>

Më pas, vijon përshkrimi i 26 dorëshkrimeve:

Εἰσι δὲ τὰ βιβλία τὰ ὅποια ἀπεγλύτωσεν ὁ αὐτὸς Σκουριπέκης τὸν Ἱερομόναχον Θεόδουλον ἐν πρώτοις οἱ

50. Shënimi risillet këtu, me përmirësime në përkthimin shqip, nga Ἀλεξούδης, "Δύο σημειώματα", 275-279.



ἐξαήμεροι οἱ β' ... [μηναῖα] κομμάτια ζ'. ἦτοι Σεπτέμβριος, Ὀκτώβριος, Νοέμβριος, Δεκέμβριος, Ἰανουάριος, καὶ ἄλλον κομμάτι Ἀνουάριον καὶ τὸ Καλοκαιρινόν. Συναξάρια βιβλία γ'. Θεολόγον. Στιχηράρην τὸ διπλοτονισμένον καὶ ἄλλον ἐν παλαιόν. Απόστολος καὶ Πραξαπόστολος. Τριώδιον. Προφήτας. Ὀκτώηχος. Ἀγιογεωργικὸν τὸ Ρωμαϊκόν ... Μηναῖα κομμάτια ε'. ἦτοι Αὐγουστος Σεπτέμβριος, Ὀκτώβριος Ἀνουάριος, Φεβρουάριος τὰ καλλίτερα. Τὸ Ψαλτήριον τοῦ κτήτορος μὲ τὴν χρυσογραμμίαν. Τὸ σεντοκόπουλον μὲ τὰ δικαιώματα εὐρίσκονται ἐσήκωσεν ὁ παπ Θεόδουλος ἐπὶ τοὺς Σέρβους. Τετραευάγγελον Βουλγαρίας. Τετραευάγγελον τὸ οἰκειόχειρον τοῦ Χρυσοστόμου ἀσημόγραφον. Τὸν Πραξαπόστολον τὸν Πολίτικον. Ἀγιογεωργικόν. Ἐξαγόρασεν τὸ μέγαν Εὐαγγέλιον...

Librat, pra, që shpëtoi Skuripeqi dhe hieromonak Theodhuli ishin në fillim dy <libra të> Heksamerëve; gjashtë libra të Mujores, d.m.th. shtatorin, tetorin, nëntorin, dhjetorin, janarin dhe një libër tjetër, janarin, dhe librin e verës; tre libra Sinaksarë; libri i Theologut [ungjillit sipas Shën Joan Theologut ose Libri i Apokalipsit]; libri i Stihirarit, me dy tone dhe një tjetër i vjetër; libri i Apostullit dhe libri i Veprave të Apostujve; libri i Triodit; libri i Profetëve; libri i Tetëtingullshit; libri me Jetëshkrimin e Shën Gjergjit në latinisht; [i padeshifruar] pesë libra të Mujoreve, d.m.th. më të përzgjedhurit: gushti, shtatori, tetori, janari, shkurti; libri i Psaltirit të ktitorit me germa të arta; sënduku i vogël me të drejtat (dokumente) që gjendeshin në të, të cilin e ngriti papa Theodhuli në kohën e Serbëve; libri i Katërungjillëshit në bullgarisht; libri i Katërungjillëshit, i shkruar në argjend me dorën e Shën Joan Gojartit; libri i Veprave të Apostujve nga Kostandinopoja; libri me Jetëshkrimin e Shën Gjergjit; Bleu Ungjillin e madh... .

Konteksti historik është trajtuar disa herë në literaturë, duke nisur nga Konstantin Jirecek, i cili ishte i pari që e përdori këtë tekst për të rindërtuar ngjarjet e kohës<sup>51</sup>. Pa dashur të nënvleftësojmë rëndësinë historike, mendojmë se vlera e tekstit është edhe më e vyer për kontekstin kulturor të kohës. Në të shprehen me një gjuhë të drejt-përdrejtë shqetësimet e kohës për të mirat intelektuale dhe shpirtërore, dëshmohej angazhimi social gjatë një faze të rrezikshme dhe jepet njoftimi i parë për ekzistencën e kodikut të purpurt *Beratinus 1*, që pa kuximin e personave të përmendur në shënim, do të kishte humbur.

Nga tre inventarët e mësipërm, konstatojmë se në Berat ekzistonin të paktën 3 biblioteka, që i përkasin manastireve dhe kishave të zonës. Në këtë kontekst, natyrisht, shtrohet pyetja se deri në ç'masë numri i librave të bibliotekave të Beratit është domethënës për kohën. Po t'i hedhim një sy bibliotekave të tjera në vende dhe kohë të ndryshme do të shohim se numri i librave të tyre luhetet në varësi të numrit të anëtarëve apo të kohës së themelimit të manastireve. Kështu nga të dhënat e vëna në dispozicion nga prof. Peter Schreiner<sup>52</sup> konstatojmë se manastiri i Hyjlindës Gabaliothisa në Vodena (Edesa)<sup>53</sup> në vitin 1373 zotëronte një bibliotekë me 37 libra liturgjikë. Manastiri Panoiktirmon (Krishti i Tërëmëshirshëm), i themeluar në Kostandinopojë nga Mihal Ataliati rreth vitit 1100, dispononte rreth 50 kodikë pavarësisht numrit të kufizuar të murgjve<sup>54</sup>. Biblioteka e një tjetër manastiri, atij të Shën

---

51. Xhufi, *Nga Paleologët*, 242-246, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse.

52. Peter Schreiner, "Sorge um Handschriften. Zwei wenig bekannte Nachrichten zur serbischen Kultur im 14. Jahrhundert," *Zbornik radova Vizantološkog Instituta* 41 (2004), 353-360, ku gjendet edhe bibliografia përkatëse. Dëshiroj të falënderoj Prof. Schreiner për vënien në dispozicion të një kopjeje të artikullit të tij.

53. Në lidhje me themelimin dhe historinë e manastirit të Shën Marisë Gabaliothisa, shih Paul Lemerle et al. *Archives de l'Athos, Actes de Lavra : III. De 1329 à 1500*, (Paris, 1979), 100-104, nr. 146; 105-107, nr. 147; Ninoslava Rodoiević, Gojko Subotić, "Bogorodica Gavaliotisa u Vodenu (La Vierge Gaballiotissa a Edessa)", *Recueil des travaux de l'Institut d'Etudes Byzantine* 27-28 (1989), 217-263.

54. Paul Gautier, "La Diataxis de Michel Attaliate", *Revue des études byzantines* 39 (1981), 5-143, kryesisht 93-97. Po ashtu, Schreiner, "Sorge um Handschriften", 353-360.

Pjetrit dhe Pavlit në Pani, vendndodhja e të cilit nuk është shumë e qartë, në shek. XV numëronte 36 libra<sup>55</sup>. Manastiri i parë rus i themeluar në Malin Athos, (Manastiri Xylourgou, sot Skiti Bogorodotsa), në vitin 1142 kishte një bibliotekë me 49 libra<sup>56</sup>. Në vitin 1299/1300, në bibliotekën e mananstirit të Grottaferrata, 200 vjet pas themelimit të tij, numëroheshin 61 libra<sup>57</sup>. Manastiri i Bachkovës apo i Petritsonis në jugun e Bullgarisë, në kohën e themelimit (1083), zotëronte një bibliotekë me 31 libra<sup>58</sup>. Manastiri i Eleusës në Strumnice, në vitin 1449 dispononte një bibliotekë me 68 libra<sup>59</sup>.

Këto shifra krahasuese tregojnë se bibliotekat e tri manastireve të Beratit, me një numër në total prej 75 librash, dispononin për qytetin një nivel mbi mesatar të pasurisë librore për kohën. Sigurisht, numri prej 75 kodikësh përfaqëson vetëm librat "*më të zgjedhur dhe më të rëndësishëm*" dhe jo numrin total të librave që zotëronin bibliotekat

---

55. Thomas William Allen, "Palaeographica", *Journal of Philology* 19 (1891): 62-68, veçanërisht për listën e librave: 66-67.

56. Paul Lemerle et al. *Actes de Saint-Pantéléemôn*, Archives de l'Athos, 12. (Paris: P. Lethielleux 1982), 65-76

57. Stefano Parenti, "Manoscritti del monastero di Grottaferrata nel typikon dell'egumeno Biagio II", *Byzantinische Zeitschrift*, 95 (2008), 641-672, veçanërisht për listën e librave: 645-669; Schreiner, "Sorge um Handschriften", 353-360.

58. Ky manastir, i cili ende funksionon, ndodhet në Bullgari, pranë Baçkovës moderne në luginën e lumit Chaya i rrethuar nga malet Rodope, në jug të Plovdiv (Filipopolit bizantin). Për më tepër, shih Paul Gautier, "Le typikon de la Théotokos Évergétis", *Revue des études byzantines* 40 (1982), 5-101, për tekstin e tipikosë: 15-95. [Ribotuar "Evergetis: Typikon of Timothy for the Monastery of the Mother of God Evergetis", in: John Thomas, Angela Constantinides Hero (eds.) *Byzantine Monastic Foundation Documents*, (Washington, D.C.: Dumbarton Oaks Research Library and Collection, 2000), 454-506.]

59. Petar Miljkovic-Pepok, *Veljusa: manastir Sv. Bogorodica Milostiva vo seloto Veljusa kraj Strumica*. (Skopje: Fakultet za filozofsko-istoriski nauki na univerzitetot "Kiril i Metodij", 1981), 283-309, ribotuar me përkthimin anglisht të inventarit në: "Eleousa Inv.: Inventory of the Monastery of the Mother of God Eleousa in Stroumitza", in: John Thomas, Angela Constantinides Hero (eds.) *Byzantine Monastic Foundation Documents*, (Washington, D.C.: Dumbarton Oaks Research Library and Collection, 2000), 1667-1678.

e manastireve të Beratit. Nga ana tjetër, në bibliotekat e shqyrtuara këtu, vërehet se, midis dorëshkrimeve me përmbajtje ungjillore dhe librave fetarë, ekzistojnë edhe dy kodikë muzikorë, një legjislativ dhe një tjetër që mund të përkufizohet si filozofik, edhe pse në sferën fetare: *Hyrje në logjikë* dhe *Hyrje në fizikë* e dijetarit bizantin, Niqifor Blemidhis (1197-1272)<sup>60</sup>. Këta janë libra që i kalojnë kufijtë e librit të zakonshëm dhe dëshmojnë një prirje të veçantë intelektuale.

Zbulimi i kodikëve të rinj, me prejardhje qartësisht të deklaruar nga hapësira shqiptare, siç është rasti i kodikëve të trajtuar këtu, dhe ekzistenca, sot, në Shqipëri, e kodikëve, që janë pjesë e këtij mjedisi kulturor, çel një dritare të re njohjeje jo vetëm me krijimtarinë e së shkuarës dhe qytetërimin e trevave mesjetare shqiptare, por deponon një dëshmi të fortë mbi orientimin dhe ndikimet kulturore të shqiptarëve gjatë asaj kohe.

---

60. Shih më lart, shën 15.




Fig. 1. Magdalen College gr. 9, fl 3r. Fillimi i ungjillit sipas Mattheos.




Fig. 2. Magdalen College gr. 9, fl 1r. Shënimi mbi vrasjen e Balshës II.






Fig. 3. Magdalen College gr. 16, fl 113r. Kronika e murtajës.



*Fig. 4. British Library, Additional 37007. Kapaku i përparmë.*






Fig. 5. British Library, Additional 37007, fl 1r. Inventari i pasurive të manastirit të Shën Nikollës së Pentarkondive, Perondi, Berat.



Fig. 6. British Library, Add. 37008, fl 1v-2r. Majtas: miniatura e apostull Joan Theologut; djathtas: fillimi i leximeve ungjillore




Fig. 7. British Library, Add. 37008, fl. 397r-v. Shënimi kodikografik i kodikut






Fig. 8. British Library, Add. 37008, fl. 397r-v. Shërimi kodikografik i kodikut.




Fig. 9. British Library, Add. 37008, fl 1r. Inventari i manastirit të Shën Marinës, Berat.



*Esmeralda Kolaneci*

PRINCIPATA JETËSHKURTËR E VIDIT,  
PASOJË E FORMULËS SË DËSHTUAR LONDINEZE

---

PRINCE VIDI'S SHORT LIVED PRINCIPALITY, A CONSEQUENCE OF A FAILED  
BRITISH FORMULA OR BRITISH ATTEMPT

ABSTRACT: The Albanian principality projected by the decision of 29th July 1913, was short-lived due to a considerable number of internal and external factors. One that should be mentioned, because it is especially important is the "mortgage" burdens that were imposed by the diplomacy of the Great Powers, on the independence of Albania.

It is about the sanctioning of the status of neutrality, the guarantee of the Great Powers, the imposition of the capitulation system, sending a foreign head of state and an international structure, which would prepare the internal legal-institutional organization of the Albanian state. It is true that the Great Powers had applied interventions of this nature in other countries, but in the case of Albania their formula or experiment took extreme forms. Without going into details about the status of neutrality and the capitulation system that were fixed for Albania in the acts adopted by the Conference of Ambassadors, repeated in the Organic Statute, even bypassing them, the focus of this paper will be the imposition of the head of state and internal legal-constitutional organization of Albania.

KEYWORDS: Great Powers; internationalization; sovereignty; European diplomacy; First World War, governance, state formation

---

Areopagu i Fuqive të Mëdha, në edicionin e lamtumirës së ekzistencës së vet shekullore, përmes kompromisit londinez të datës 29 korrik 1913 shënon edhe zanafillën e historisë së ëndrrës jetëshkurtër të Wilhelm von Wied-it për të mbretëruar në vendin, i cili kishte shërbyer si

pikëprerje interesash në gjithë veprimtarinë e Konferencës së Ambasadorëve. Në shekullin XIX dhe fillimet e shekullit të XX, monarkia ishte forma mbizotëruese e qeverisjes, të cilën diplomacia evropiane e impononte për shtetet e reja të krijuara si rezultat i shkëputjes përfundimtare nga Perandoria Osmane dhe që shfaqeshin si subjekte të pavarura. Ndërkombëtarizimi i skemës organizative dhe drejtuese të shtetit shqiptar, ndryshe nga sa ndodhi në vendet e tjera ballkanike, rezultoi një formulë e pasuksesshme. Në tekstin e vendimit të fundkorrikut të vitit 1913 sanksionohej se shteti neutral shqiptar do të kryesohej nga një princ sovran, i zgjedhur nga Fuqitë e Mëdha, dhe do të kontrollohej nga një komision, në përbërjen mbizotëruese, të të cilit do të kishte përfaqësues ndërkombëtarë.<sup>1</sup>

Pas një "konkursi" ndërkombëtar diplomacia evropiane, më në fund u ndal te kandidatura e propozuar prej Fuqive të Adriatikut. Me konsensusin edhe të Fuqive të tjera, me rastin e 1 vjetorit të shpalljes së pavarësisë së shtetit shqiptar, më 28 nëntor 1913 u konfirmua si Princ i Shqipërisë i zgjedhuri i tyre, Vilhelm Vidi.<sup>2</sup> Princi protestant prusian, 38 vjeçar, u gjykua i përshtatshëm për t'i besuar mbajtjen e kursorës së Principatës shqiptare. Në korrespondencën diplomatike të përfaqësuesit francez në Bukuresht, Princ Vidi portretizohet si një individ racional "në vetëm pak çaste bashkëbisedim me të kuptohet korrektësia e pikëpamjeve të tij dhe drejtësia e gjykimit".<sup>3</sup> Përkatësia fetare e tij mendohej si një faktor që do të evitonte futjen e vendit në një orbitë armiqësore, si rezultat i pakënaqësive eventuale nga radhët e shqiptarëve, në përbërjen e të cilëve kishte të krishterë, por edhe një shumicë myslimane. Nga ana tjetër, Fuqitë e Mëdha, me sa duket nën ndikimin e politikës realiste, që karakterizonte vendimmarrjen e diplomacisë londineze, bëri këtë përzgjedhje me qëllim konservimin

1. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. 3: Periudha e Pavarësisë, 28 nëntor 1912-7 prill 1939, (Tiranë: Toena, 2009), 27-28.

2. Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë, 2007), 56.

3. DDE, 3<sup>e</sup> série, t. VIII, d. nr. 180, Bukuresht 20.10.1913. Telegram i të Ngarkuarit me Punë në Rumani Greigueuil drejtuar Ministrit të Punëve të Jashtme Pichon.



e ekuilibrit të brishtë mes forcave aleate, si dhe mbajtjen nën kontroll të synimeve hegjemoniste të aleancave të caktuara.

Pavarësisht se në narrativën apo analizën e disa autorëve dhe eksponentëve të asokohe evidentohet paaftësia administruese dhe mungesa e përvojës në lidhje me institucionalizimin e politikave efikase të Princ Vedit, fakte historike na çojnë në deduksionin se pamundësia e tij për të realizuar misionin si kryetar shteti, erdhi si pasojë e gërshetimit të disa faktorëve vendas dhe të huaj, që *ex hypothesi* kontribuan në futjen e vendit në një vorbull paqartësie lidhur me statusin ndërkombëtar të tij, situatë që do të zgjaste deri në përfundimin e Luftës së Parë Botërore. Paqartësitë e rrethit të kompetencave të tij ishin evidente përpara se ai të instalonte pushtetin në kryeqendrën e Principatës. Në rastin kur Fuqive të Mëdha u duhej të kërkonin evakuimin e Jugut të Shqipërisë, qeveria angleze vlerësonte se Epiri shqiptar është një çështje ndërkombëtare dhe jo administrative dhe si e tillë është kompetencë e KNK-së dhe jo e Princ Vedit.<sup>4</sup> Nuk ishte vetëm faji i tij që dështoi përpjekja e fundit për të atabluar në Ballkan një "monarki" gjermane trashëgimtare, por mbase edhe i tij. Ky prusian ishte gjendur në vendin e gabuar dhe kohën e gabuar dhe këtë ai e dinte më së miri.<sup>5</sup> Në kujtimet e tij, Vidi argumenton se e shihte shkakun e tronditjes së pushtetit mbretëror, të celebruar nga vetë Fuqitë, në mungesën e financave dhe mbështetjen ushtarake, duke i adresuar fajet te tendencat konfrontuese dhe dilemat e maskuara të diplomacisë së komplikuar perëndimore. Duket se logjika politike e Vedit është e saktë, sepse kur ambasadori francez në Berlin Jules Cambon analizonte intrigat dhe kundërintrigat mes Fuqive të Adriatikut për influencë në Shqipëri ngrinte pyetjen se "a nuk do të ishte me vlerë të largohemi nga Shqipëria, dhe Italia me Austrinë të zgjidhin *tête-à-tête* çështjen

4. DDF, 3<sup>e</sup> série, t. IX, d. nr. 372, tel. nr. 132, 119, 93, 112, 39, 17, Paris 27.02.1914. Telegram i Ministrit të Jashtëm Doumergue drejtuar përfaqësuesve diplomatikë francez në Shën Petersburg, Berlin, Romë, Vienë, Athinë dhe delegatit francez në KNK.

5. ÖUA, dosja nr. 9492, Durrës 20.03.1914. Telegram i Ministrit Fuqiplotë habsburgas Loëenthal drejtuar Kontit Berchtold.

e ndarjes së influencave?”. Diplomati Cambon argumentonte se ky sistem evropian mund të ekzistojë me dinjitet dhe të jetë produktiv për ata që e praktikojnë atë, vetëm nën kushte absolute, ku asnjë nga Fuqitë që e krijuan nuk do të kërkojnë një pozitë të privilegjuar në drejtimin dhe vendimmarrjen e Komisionit të Kontrollit. Në këtë rast Cambon i referohej rivalitetit austro-italian për influencë. Më tej ai konkludonte se nëse Austria dhe Italia vazhdojnë të mos pajtohen, Fuqitë e Antantës duhet të vlerësojnë me seriozitet nëse ato duhet të vazhdojnë të kontribuojnë me mbështetjen e tyre financiare dhe morale, në një realitet ku vetëm Austria dhe Italia do të përfitonin.<sup>6</sup> Edhe kryediplomati britanik kishte shfaqur të njëjtin shqetësim, kur pohonte se kishte konstatuar që “politika austriake dëshironte ta kthejë kontrollin ndërkombëtar të Shqipërisë në një kontroll austriak dhe se kjo vijë politike e ndjekur prej tyre mund të rezultojë në një bllokim absolut”.<sup>7</sup> Doemos, arsyetimi i Vidit nuk mund të konsiderohet krejt i pamotivuar edhe për faktin se, në vendet e tjera ballkanike, homologëve të tij iu garantua mbështetje e gjithanshme dhe ndihmë e pakursyer e ndërkombëtarëve, ndërsa për sovranin e shtetit më të ri në Evropë, nuk u tregua disponibiliteti i nevojshëm nga selitë qendrore evropiane për të përmbushur premtimet e bëra dhe për ta suportuar atë në qëndrueshmërinë e rendit dhe ruajtjen e integritetit territorial. Konsensusi evropian i Fuqive të Mëdha dështoi në zgjidhjen e çështjes së drejtë shqiptare, për faktin se nuk mundi të realizonte një ndër objektivat kryesorë të tij, frenimin e agresionit dhe minimizimin e ambicieve të fqinjve ballkanikë, me të cilët shqiptarët i ka lidhur destini në mënyrë të pazgjidhshme. Shumë prej hapësirave territoriale të Jugut të Shqipërisë vazhduan të ishin nën pushtimin e forcave greke dhe çdo përpasje për të zmbarsjen e tyre rezultuan të dështuara. Ajo çfarë tingëllon çuditshëm është fakti se edhe pas

6. DDE, 3<sup>e</sup> série, t. IX, d. nr. 384, dok. nr. 90, Romë 28.02.1914. Telegram i Ambasadorit Barrère drejtuar Ministrit të Jashtëm Doumergue.

7. BD, F.O. 49521/14809/13/44, d. nr. 58, tel. 660, fq 50, Foreign Office 19.10.1913. Telegram i Ministrit të Jashtëm Sir Grey drejtuar Sir Bertie.

vendimit të Konferencës së Ambasadorëve,<sup>8</sup> refuzimi i përsëritur i Athinës zyrtare për të zbatuar vendimet e Direktoratit Evropian, nuk përbënte shqetësim serioz për diplomacinë e të Mëdhenjve.

Si *argumentum a contrario* për pazotësinë e Vilhelm Vedit, mund të sjellim vendimin e tij logjik për të mos pranuar dhe materializuar brenda afateve të parashikuara vullnetin dhe kompromisin e të Gjashtëve, duke kërkuar jo vetëm plotësimin e një sërë kushtesh të vendosura prej tij, porse mbi të gjitha qetësimin, paraprak të situatës së brendshme të vendit që do të udhëhiqte, i cili ishte përfshirë nga trazirat dhe dhuna me tendencë rritjeje. Konsulenti i tij në fushën e diplomacisë dhe politikës së jashtme, Ekrem bej Vlora na kujton se në bindjen e tij askush nga kandidatët e tjerë për fronin e Princit nuk përfaqësonte vlerat dhe profilin e Vedit. Në konsideratat e tij, Princi Vilhelm përshkruhet si një personalitet i shquar dhe fisnik, si një njeri i formuar, serioz dhe i ndershëm, ndërkohë i vendosur të merrte dhe të mbante, pa asnjë iluzion, një përgjegjësi të madhe mbi vete.<sup>9</sup> Por, nga ana tjetër, ajo çfarë të bie në sy është se Qeveria e Durrësit dhe Princ Vidi nuk mundën të manovronin me angazhimet dhe interesat e fuqive evropiane në favor të një modeli të ri qeverisjeje të kujdesshme dhe stabilizuese për vendin e sapo dalë nga sundimi shekullor osman, duke limituar *in extremis* kështu shanset e mbijetesës së tyre. Qëndrime kritike ka pasur jo vetëm në adresë të kreut të shtetit, por edhe ndaj anëtarëve të kabinetit qeveritar të kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti. Sekretari i Princ Vedit në narrativën e tij arsyeton gjithashtu se që në fillim, kabineti ishte jopopullor dhe mosbesimi,

---

8. Në tekstin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (11 Gusht 1913) për kufijtë jugorë dhe juglindorë të Shqipërisë parashikohej shprehimisht largimi i trupave grekë nga territoret shqiptare brenda një afati kohor 1 muor nga përfundimi i punimeve të Komisionit Kufitar (vendimet e tij u stipuluan në Protokollin e Firences, 17 dhjetor 1913). Sipas, ÖUA, Dosja Nr. 8353

9. Eqerem bej Vlora, *Kujtime (1912-1925)*, vëll. II, (Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2001), 54-59.

i treguar nga opinioni publik, ndikoi në zbehjen e hovit të punës.<sup>10</sup> Nuk mund të mohohet se në përbërjen e qeverisë kishte njerëz me merita të padyshtimta, por mesa duket, të ndodhur në rrethana të caktuara, të painformuar në shkallën e duhur apo të paorientuar, nuk u gjendën në pozicionin e përshtatshëm në këto çaste vendimtare për çështjen shqiptare dhe fatet e Shqipërisë. Mehdi Frashëri në kujtimet e veta na sjell dhe argumenton një episod interesant, zëvendësimin e kryeministrit Përmeti me Izet Pashën, si dhe Ministrin e Luftës dhe Punëve të Brendshme Esat Pashë Toptanin me Seit Pashë Bej Tetovën. Pa mohuar aspak dhe kurrsesi vlerat dhe kontributin e Mehdi Frashërit në periudhën për të cilën po trajtojmë, mendojmë se propozimi i tij adresuar te Aqif Pasha për zëvendësimin përkatës të postit të kryeministrit në një kohë ekstremisht të jashtëzakonshme që po kalonte vendi, nuk ishte në të mirë të çështjes. Kishte fare pak kohë që Turhan Pashë Përmeti ishte në krye të qeverisë dhe nuk mund të mendohej që në një interval fare të shkurtër kohor, ai të arrinte të përballonte me sukses çdo ekces, që shfaqej në pjesë të ndryshme të vendit, si rezultat i faktorëve të ndryshëm korozivë. Referuar lidhjeve të Izet Pashës me Portën e Lartë, të cilat Mehdi Frashëri ia faturon si avantazh, ato janë po aq të vërteta dhe të besueshme edhe në rastin e kryeministrit të zgjedhur në Qeverinë e Princit, i cili gjithashtu kishte ushtruar funksione të rëndësishme politike e diplomatike në Perandorinë Osmane.<sup>11</sup> Ngjarjet e vitit 1914 në Shqipëri ishin tepër të rënda për forcat njerëzore dhe qëndronin përmbi mundësitë e vullnetit njerëzor.<sup>12</sup>

Princ Vidi, që kishte marrë bekimin zyrtar të Fuqive të Mëdha, pas disa audiencave me përfaqësuesit më të lartë të kancelarive evropiane,<sup>13</sup> u nis drejt vendit enigmatik për të, ku përjetoi ëndrrën sfiduese

10. Duncan Heaton Armstrong, *Princ Vidi - Shqipëria, gjashtë muaj mbretëri*, (Tiranë: AHS, 2008), 35-37.

11. Mehdi Frashëri, *Kujtime (Vitet 1913-1933)*, (Tiranë: OMSCA-1, 2005), 28-29.

12. Vlora, *Kujtime*, 55.

13. Përpara së Vidi të zbriste nga jahti "Taurus" më 7 Mars 1914, vënë në dispozicion nga Admiraliati austro-hungarez dhe të shkelte tokën shqiptare,

shqiptare dhe ndoshta 6 muajt më intensivë të jetës së tij.<sup>14</sup> Fillimisht u konsiderua plot shpresë dhe optimizëm nga shumë intelektualë dhe patriotë shqiptarë, madje edhe nga vetë kryeministri i qeverisë së parë të shtetit të pavarur,<sup>15</sup> si njeriu që do të shpërndante retë gri të pesimizmit, që kishin kapluar vendin pas dorëheqjes së kabinetit qeveritar të dalë nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës, si një mundësi alternative për të orientuar Shqipërinë drejt modeleve perëndimore, për të ndryshuar ritmet dhe fatet historike. Por, referuar ushtrimit efektiv të pushtetit shtetëror, deduktohet se Vidi dështoi në politikën e brendshme, pasi nuk mundi të përcaktonte rrugën që duhet të ndiqte

---

aty ku imagjinoi se do të përmbushte ëndrrën utopike të tij për të qënë sovran i një kombi sa të lashtë aq edhe të panjohur për të, pati një sërë takimesh me drejtues dhe krerë të lartë shtetesh evropiane. Ai u prit nga Perandori Franc Jozef, pati ftesë nga Pallati Buckingham ku dhe drekoi me familjen mbretërore britanike. Udhëtoi drejt Parisit, Berlinit dhe Shën Petërburg-ut si dhe nëpër kanceleri të tjera të rëndësishme të Evropës. Startin e turit të tij diplomatik dhe protokollar e shënon pritja nga mbreti në Romën zyrtare dhe Ministri i Punëve të Jashtme të saj, për të vazhduar më pas rrugëtimin përpara marrjes së kurorës, në kryeqytetin e Monarkisë Habsburgase. Gjykohet se disa prej takimeve të tij ishin thjesht dhe vetëm për të respektuar axhendën protokollare dhe disa të tjera në thelb karakterizoheshin nga direktivat herë imponuese dhe herë konstruktive lidhur me drejtimin e vendit, që, edhe pse në distancë Fuqitë e Mëdha e shikonin dhe e konsideronin doemos si një çështje të mprehtë dhe me shumë interes në përmbushjen e qëllimeve të tyre diplomatike.

14. Sekretari personal i Princ Vidi, njëkohësisht këshilltar i tij, irlandezi Duncan Heaton Armstrong në dëshminë e tij autentike, ndër të tjera artikulon se: *"Gjithëkush prej nesh pyeste veten se çfarë fshihte e ardhmja. Kishim lexuar gjithë ato libra që kishim mundur të gjenim për Shqipërinë, por nuk mund të thuhet se ne kishim ndonjë njohuri të madhe për vendin ku po shkonim dhe dukej se mbreti dhe mbretëresha dinin, më pak se sa ne, megjithëse ata kishin harxhuar muaj të tërë duke përgatitur veten për detyrat e reja".* Sipas, D. Heaton Armstrong, *Princ Vidi - Shqipëria, Gjashtë Muaj Mbretëri*. Tiranë, AIIS, 2008.

15. Ismail Qemali në kujtimet e tij do të shprehej se: *"... unë bëra çmos, me gjithë shpirt si shqiptar i vjetër, të shihja me shpresën se një epokë e re po vinte. Kishim ushqyer shpresën se takti dhe urtësia e Princit mund të baraspeshonin humbjet e territorit që patëm pësuar dhe se ardhja e tij mund t'i jepte hov të madh mbrohtësisë së vendit".* Ismail Qemali, *Kujtime*, (Tiranë: Toena, 2009), 428-429.

ai dhe oborri i tij, si dhe nuk mundi të krijonte një administratë të qëndrueshme kombëtare. Ai u tregua i pafuqishëm të përshtaste një komunikim racional me opinionin publik, madje qëndrimet e tij dëshmojnë edhe për pamundësinë për të marrë përsipër kontrollin e ngjarjeve dhe shtypjen e trazirave të brendshme. Pakujdesia e treguar për vlerësimin e drejt të situatës jo të favorshme, vërtetoi se entuziazmi i përkrahësve të tij ishte jorealit dhe konfirmoi mosbesimin e vetë atyre që e kishin pranuar atë si kandidaturë, sikundër e dëshmojnë edhe fjalët e shefit të Foreign Office-it adresuar Vidit. Sir Edward Grey theksonte se Princi në krye të shqiptarëve nuk e njihte Shqipërinë dhe zakonet e saj, madje figura e tij politike karakterizohej nga mungesa e aftësisë së duhur për të sunduar këtë vend të trazuar.

Edhe pse në aparençë të gjitha pushtetet i ishin atribuar Princit, e ashtuquajtura Principatë, kjo farsë strukturoro-politike, produkt i kompromisit londinez, *de facto* ishte nën diktatin e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, anëtarët e të cilit vepronin nën direktivat e shteteve që përfaqësonin.<sup>16</sup> Qeveria e Princit, e cila shihej si një urë për ndryshime esenciale në marrëdhëniet ndërfqinjësore, kjo për faktin se presupozohej që kishte raporte të mira me të gjitha selitë zyrtare të vendeve të tjera, qofshin ato evropiane apo ballkanike, nuk mundi të realizonte largimin e forcave greke nga territori shqiptar në jug të vendit. Vendosja e kontrollit apo shtrirja e sovranitetit territorial përbënte *conditio sine quo non* për reputacionin përballë opinionit vendas. Por, këtu ka vend të gjykojmë rimohimin e angazhimit të përbashkët të diplomacisë evropiane për të pranuar dhe trajtuar Shqipërinë si subjekt me personalitet të plotë juridiko-ndërkombëtar. Mosrealizimi i këtij imperativi kategorik dhe imediat, jo vetëm që

---

16. Kjo deduktohet nga ajo çfarë iu pohua Vidit në takimin që pati me kreun e politikës së jashtme të Ballhausplatz, Berchtold. Ky i fundit do të shprehte gjykimin e tij realist se anëtarët e KNK-së përfaqësonin dy blloqe shtetesh që vepronin njëri kundër tjetrit si dhe kishin pikëpamje diametralisht të kundërta lidhur me të ardhmen e Shqipërisë. ÖUA, D. Nr. 9399, Telegram i Berchtold-it. Cit. sipas, Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, (Tiranë, Toena: 2012) 485-486.

la një shije të hidhur në radhët e shqiptarëve, por filloi të krijonte bindjen se Princi i dërguar dhe i zgjedhur nga ata që konsideroheshin si protektorët e paqes dhe të sigurisë në mbarë rajonet e Evropës, nuk përfaqësonte dhe nuk mbronte interesat jetikë të vendit. Nëse do të duam të bëjmë një interpretim ekstensiv të kësaj ngjarjeje të paprecedentë, mund të themi se fqinjët grekë po shpërfillnin me arrogancë jo vetëm autoritetin e ligjshëm të Princit, por thelbësisht vullnetin e vetë Fuqive të Mëdha. Si mundet që një shtet relativisht i vogël të mund të cënonte në mënyrë eksplicite vendimarrjen e të Mëdhenjve dhe parimin zakonor juridiko-ndërkombëtar, që qëndron në aksin e marrëdhënieve midis shteteve, *pacta sunt servanda*<sup>17</sup>? Apo duhet të konkludojmë se diplomacia evropiane me koshiencën krijoi një Principatë jo me sovranitet të plotë, sepse jo vetëm në marrëdhëniet me jashtë ishte *quasi* inekzistente, por njëkohësisht kontrollohej edhe në punët e brendshme nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit? Si rast ilustrues na shërben vendimi i Konferencës së Ambasadorëve të Londrës (29 korrikut 1913). Nga përmbajtja e nenit të 1-rë të tij, Shqipëria sipas Fuqive të Mëdha do të ishte Principatë autonome, që nuk është e barabartë me nocionin juridik të pavarësisë, por njëkohësisht sovrane.<sup>18</sup> Drejtuesi i Principatës nuk gëzon një hapësirë pavarësie të plotë politike, veçanërisht në disa aspekte të caktuara. Në të vërtetë në vlerësimin e evropianëve cilësohej si i tepërt atribuimi i emërtimeve më të konsiderueshme ndaj një sovraniteti ende të pasigurt.<sup>19</sup> Edhe pse, nga burimet diplomatike franceze rezulton se Vjena ka pasur tendencë që Shqipërinë autonome ta përfshinte në grupin e shteteve të organizuara si mbretëri, duke sjellë si rast ilustrues,

---

17. Një ndër parimet themelore dhe universale të së drejtës ndërkombëtare është parimi *pacta sunt servanda*, sipas të cilit, traktatet janë të detyrueshme dhe duhet të respektohen.

18. Autonomia, duke qenë pjesë e pavarësisë është më pak se ajo. Në raste të caktuara është fazë paraprake drejt pavarësisë, drejt shfaqjes së një shteti me cilësinë e subjektit të së drejtës ndërkombëtare.

19. DDF, 3<sup>e</sup> série, t. IX, dosja nr. 343, dok. nr. 44, Vjenë 22.02.1914. Raport i Ambasadorit francez Dumaine drejtuar Ministrit të Jashtëm Doumergue.

Malin e Zi, i cili edhe pse shtet më i vogël, ishte përfshirë në grupin e shteteve të organizuar në formën e monarkisë.<sup>20</sup> Ky përcaktim i megjulluar i statusit të saj, u shoqërua edhe me veprime konkludente nga struktura që Fuqitë e Mëdha e prezantuan *prima facie* si organ konsultativ. Kompetencat vendimmarrëse të Komisionit të Kontrollit, i cili *de facto* krijonte një autoritet paralel me atributet shtetërore, lexohet qartë në nënshkrimin e "Protokollit të Korfuzit" në muajin maj të vitit 1914 prej tij dhe jo nga funksionarë të autorizuar prej drejtuesit të Principatës. Princi, nga ana e vet, përmes të ngarkuarit të tij, oficerit hollandez Thomson, hyri në negociata me përfaqësuesit e të ashtuquajturve vorioepirotë, madje ai avancoi në kompromise të pathemelta juridikisht duke iu premtuar këtyre të fundit bërjen realitet të disa të drejtave që ata kërkonin. Qeveria shqiptare e gjykoi ngushtësisht çështjen dhe ndërmori një hap të pamenduar. E ndodhur përpara presioneve dhe veprimeve eksplicite agresive të Athinës zyrtare, ajo ra në kurthin e një skenari, që synonte shpëputjen e Jugut të Shqipërisë. Autoritetet greke e njihnin shumë mirë situatën në këtë rajon të vendit dhe e përpunonin atë intesivisht në favorin e tyre. Pjesë e këtyre veprimeve ishte edhe shpallja e Qeverisë vorioepirote me në krye Kristaq Zografon. Vidi duke mos e njohur thellësisht realitetin politik vendas e duke rënë pre e një fryme paniku, të shkaktuar nga njerëz përreth tij, pranoi nënshkrimin e të ashtuquajturit "Protokoll i Korfuzit", që në vetvete përbënte një cënim të ndjeshëm të vendimit të Asamblesë së Vlorës, por edhe të vetë vendimeve të Konferencës së Londrës.<sup>21</sup> Princ Vidi në vend që të mobilizonte vendin dhe forcat progresiste për mbrojtjen e integritetit territorial, hyri në kompromise të panevojshme, që çonin në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë drejt cedimesh territoriale të pajustificueshme. Protokollin e ratifikuar prej tij, përmes të cilit u njoh autonomia e "Epirit filohelenik", një

20. DDE, 3<sup>e</sup> série, t. IX, dosja nr. 343, dok. nr. 44, Vjenë 22.02.1914. Raport i Ambasadorit francez Dumaine drejtuar Ministrit të Jashtëm Doumergue.

21. Vendimet e 22 Marsit 1913, lidhur me kufijtë jugor dhe jug-lindor të Shqipërisë, si dhe atë të 29 korrikut 1913 që konsistonte në përcaktimin e statusit politik të vendit.



fantazmë politike, shtojcë e kamufluar keqazi, e ideuar nga qarqe zyrtare greke, u zhbë nga shqiptarët, të cilët e kishin manifestuar prej shekujsh vendosmërinë për mbrojtjen e tokave të tyre autoktone dhe dëshirën për t'u vetëqeverisur.

Historiani dhe diplomati iltalian, Ferdinando Salleo, përfundimin e mbretërimit të Vidit, ia faturon antagonizmit dhe intrigave të pashembëllta të Fuqive të Mëdha dhe kryesisht atyre të Adriatikut, të cilat në krye të herës kishin si prioritet përmbushjen e qëllimeve dhe strategjive të tyre në hapësirat shqiptare dhe jo stabilitetin shtetëror të saj.<sup>22</sup> Krisja e solidaritetit mes Konsultës dhe Ballhausplatz, në rivalitet permanent për supremaci, të cilin Fan Noli e gjykonte si "ndeshje mes gjelash", po ndikonte negativisht në të ardhmen politike të Shqipërisë, për konsolidimin e saj si shtet i pavarur, por edhe në vetë suksesin e qeverisjes së Vidit. Austro-Hungaria dhe Italia, që ishin treguar më të gatshme se fuqitë e tjera të kohës, të njihnin pavarësinë dhe të pranonin ngritjen e shtetit shqiptar, u shndërruan shpejt në varrmihësit kryesorë të stabilizimit të tij.<sup>23</sup> Divergjencat e para mes dy Fuqive ishin kristalizuar që me ardhjen e Vidit në krye të Principatës, duke qenë se Italia nga ana e saj, Vidin gjerman e konsideronte më pranë interesave austriake dhe nën këtë pandehmë, ajo kërkoi zgjidhje në makinacione politike, duke mbështetur elementë destabilizues në vijimësinë e Qeverisë Kombëtare të Durrësit.

Nuk mund të shpërfillen edhe intrigat e Esat Pashë Toptanit, personazhit më të përfolur nga bashkëkohësit e tij, që shërbyen për rrëzimin e Principatës dhe largimin e Vidit nga fronin shqiptar. Ai u shndërrua në një instrument të politikës italiane, që kërkonte me doemos të minonte influencën austro-hungareze. Në historiografinë shqiptare është folur gjatë për rolin e kësaj figure politike, e cila fatkeqësisht nuk ka qenë i vetmi në këtë mjedis tribal ballkanik. Krerë me mentalitete mesjetare, të udhëhequr nga ndjenja të një fodullëku

22. Shih për më gjerë, Ferdinando Salleo, *Shqipëria: Gjashtë Muaj Mbretëri*. Tiranë: Shtëpia e Librit & Komunikimit, 2000.

23. Muin Çami, *Shqipëria në Rrjedhat e Historisë, Përmbledhje Studimesh 1912-1924*, (Tiranë: Onufri, 2007), 31.

inJORANT, në këtë moment domethënës për Shqipërinë dhe shqiptarët, mendonin vetëm për veten e tyre dhe dëshironin ta shfrytëzonin situatën delikate për interesa vetjake. Komploti i pandëshkuar i Esat Pashë Toptanit u perceptua me të drejtë nga shqiptarët si një paaftësi për të paralizuar kundështarët e tij dhe jo seriozitet në ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë në vend. Situata po përkeqësohej dhe sytë e Vidit u drejtuan nga Fuqitë e Mëdha, të cilat nuk u treguan të gatshme për vënien nën kontroll të incidentit, i cili sa vinte e po merrte trajtën e një mosbindjeje civile ndaj autoritetit të Princit. E gjithë kjo atmosferë e nderë, e provokuar ose jo, solli edhe ripozicionim e Italisë ndaj Vidit, i cili shihej si një figurë, qëndrimi i të cilit në fron nuk përcillte shpresë e besim. Komisioni Ndërkombëtar duhej të merrte në dorë frenat e qeverisjes së vendit.

Në fillim të Luftës së Parë Botërore pozita e Princ Vidit dhe vetë Komisionit Ndërkombëtar u venit, deri në braktisjen e shtetit. Fuqitë e Mëdha nuk u angazhuan maksimalisht të instalonin një makineri shtetërore më të mirë nga Qeveria e Vlorës, që me profesionalizëm ndoqi një politikë prestigji, meritat e së cilës koha i vërtetoi se ishin pakrahësimisht shumë të vyera. Ndërkombëtarët, për fat të keq, hezituan ta pranonin dhe ta mbështesnin.

Pavarësisht se copëtimin e Shqipërisë dhe formën e shtetit shqiptar, të reduktuar në gjysmën e trojeve të saj, Fuqitë e Mëdha e trajtuan nën sloganin e ruajtjes së "paqes së përgjithshme" apo "ekuilibrit politik", nuk mundën të evitonin shpërthimin e Luftës së Parë Botërore. Uillson-i konfliktin ndërkombëtar e përcaktonte si rezultat të mendimeve të turbullta dhe nuk e identifikonte atë me prirjen e përplasjes së interesave dhe këtu mund të themi se formula e sistemit të aleancës evropiane, pati si konsekuencë eksplicite jetëshkurtësinë e planit të tyre për ndërkombëtarizimin e drejtimit, kontrollit dhe organizimit të brendshëm të Shqipërisë.

Konferenca e Londrës, u konceptua si zgjidhje, por realisht ofroi zgjidhje jo në konkordancë me moralin e primeve juridiko-ndërkombëtare. Vendimet e saj të karakterizuara nga arbitrariteti ishin një goditje e fortë dhe me pasoja për paqen në Ballkan dhe sigurinë

evropiane, duke na kujtuar Kantin, i cili shprehej se çdo e mirë që nuk është e shartuar me idealin moralisht të mirë, nuk është asgjë tjetër veçse llustër dhe mjerim që vezullon dobët. Ajo që ndodhi me Vidin dhe strukturat e tij juridiko-institucionale qeverisëse vërteton pohimin e Tuqididit qysh në antikitetin e hershëm, kur shprehte bindjen se imponimi është një bazë influence joefikase dhe përfundimisht vetëshkatërruese.<sup>24</sup> Duket se mjetet dhe modalitetet e përdorura nga Kuvendi i Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha, nënshkruan koston e lartë, që fshihej në politikën dhe vendimarrjen e tyre dritëshkurtër për Shqipërinë. Ata sikundër do të argumentonte gati një çerek shekulli më vonë, profesori francez i së drejtës ndërkombëtare, Redslob, projektuan një vepër të pathemeltë, që u krijua veçse në tryezat dhe imagjinatën e diplomacisë evropiane dhe nuk hodhi kurrë rrënjë në popullin shqiptar.<sup>25</sup> Fillim shtatori shënon edhe përfundimin e pushtetit të Princ Vedit të zgjedhur për të mbretëruar shqiptarët, "monarkinë" ndoshta më jetëshkurtër në historinë politike të Evropës, për t'u zëvendësuar në mënyrë të natyrshme nga struktura qeverisëse dhe drejtues të zgjedhur nga vullneti i tyre kombëtar. Por, megjithatë, pavarësisht nga inkonvencencat dhe inkonsekuencat, nga mangësitë dhe kostot me të cilat u shoqërua, Principata e Vedit, produkt i konjunkturave të diplomacisë evropiane, konsiderohet dhe vlerësohet pa mëdyshje si një etapë në historinë e Shqipërisë, sepse krijimi i saj shërbeu si certifikimi i njohjes *de jure* në komunitetin ndërkombëtar të pavarësisë së Shqipërisë, të shpallur nga Kuvendi Kombëtar i Vlorës.

---

24. Shih për më gjerë, Tim Dunne, Milja Kurki, Steve Smith, *Teori të Marrëdhënieve Ndërkombëtare - Disiplina dhe shumëllojshmëria*, (Tiranë: UET PRESS, 2010), 91.

25. Kur Fuqitë e Mëdha pretenduan të ngrinin Shqipërinë si principatë më vete me Princ Vidin në krye dhe i dhanë edhe një Statut, kjo ishte nga ana e tyre një vepër e pa themel. Monarkia e re nuk u krijua veçse në letër dhe në imagjinatën e diplomatëve. Ajo nuk jetoi kurrë për arsien e thjeshtë se ajo nuk hodhi kurrë rrënjë në popull. Robert Redslob, *Les Principes du droit des gens moderne*, Paris, 1937, f. 63, cituar sipas Puto, *Pavarësia Shqiptare*, 522.

Paqja dhe ekuilibri evropian, drita udhërrëfyese e pretenduar e Koncertit Evropian, duket se u tronditën nga makinacionet diplomatike, të cilat gjeneruan një luftë bipolare në Evropë, ku si fitil ndezës shërbeu kryesisht rajoni i Ballkanit. Ndërkombëtarizimi i organizimit dhe i drejtimit të shtetit shqiptar rezultoi një eksperiment i pasuksesshëm, jo vetëm sepse Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, në përbërjen e të cilit dominonte prania e përfaqësuesve ndërkombëtarë, eliminoi plotësisht elementin vendas, porse e la vendin në një vakum juridiko-institucional dhe Shqipëria u përball me furinë e Luftës së Parë Botërore si një vend që s'kishte as kryetar vendi, as qeveri, as ushtri dhe as organe të tjera, që të merrnin përsipër përballimin e përgjegjësive eventuale.

Është e rëndësishme të ndalemi dhe të theksojmë se kjo datë me gjithë rëndësinë e vet historike që mbart, nuk duhet kurrsesi të barazohet me momentin e themelimit të shtetit shqiptar. Kjo datë shënon njohjen *de jure* të pavarësisë së shtetit shqiptar, porse një pavarësi të kufizuar gjeografikisht, duke i shkëputur asaj hapësira territoriale të mëdha në favor të pretendimeve të ballkanasve fqinj. Duket se në historinë politike të Evropës, Principata Shqiptare rezulton të jetë më jetëshkurtra dhe shërben si një rast ilustrues *par excellence* i një akti juridiko-ndërkombëtar *non sens* dhe të marrë në kapërcimin të parimit *ex aequo et bono*.<sup>26</sup>

---

26. Shprehje latine: *në pajtim me të drejtën dhe të mirën*.

*Eva Hyskaj*

## LIDHJA E KOMBEVE DHE "PROBLEME SHQIPTARE" TË MEHDI FRASHËRIT

---

THE LEAGUE OF NATIONS  
AND MEHDI FRASHËRI'S "ALBANIAN PROBLEMS."

**ABSTRACT:** The year 1920 was apparently a year full of events and political developments for the Albanians and their new state. It started with the Congress of Lushnja, convened from January 28 to 31, which at the same time marked the beginning of a new era in Albanian politics. That year was also successful internationally, because it coincided with the creation on January 10 of an interstate organization, namely the League of Nations, conceived by the President of the United States, Woodrow Wilson, which had as its main objective the maintenance of peace, as well as the guarantee of the territorial integrity and independence of the member states.

The country's membership in the League of Nations was extremely important for the political future, not only because it affirmed the international recognition of Albania as an independent and sovereign state, but, at the same time, it was an act of collective recognition of the ruling government, which gave the country the opportunity to copy the best practices of civilized nations as Albania established diplomatic relations with them. The first parliamentary elections took place when Albanian State was already recognized by the League of Nations. It was the period following these elections that also revealed the importance of the figure of Mehdi Frashëri who was already known in political circles.

In this sense, firstly, it should be said that starting from the state tasks he performed, which were very important, as well as in delicate situations for the consolidation and development of the Albanian state, it became possible for his figure to be central in the first parliamentary elections in Albania. Secondly, his ideas and his long stay for a period of 15 years (from 1923, until 1939) as a member of the Assembly and as a representative of

the Albanian State in the League of Nations, he was rightly ranked among the representatives of political thought in Albania.

KEYWORDS: Albanian State, League of Nations, international relations, elections

---

Viti 1920 mesa duket ishte një vit plot ngjarje e zhvillime politike për shqiptarët dhe shtetin e ri. Ai kishte filluar me Kongresin e Lushnjës, të mbledhur në datat 28-31 Janar, duke hapur njëkohësisht siparin e një ere të re në politikën shqiptare. Me të u ngritën dhe u formësuan tiparet e para të mirëfillta të shtetit shqiptar. Sigurisht procesi i formimit të shtetit modern shqiptar kishte nisur qysh në vitin 1912 me shpalljen e Pavarësisë në Vlorë, por ngritja e strukturave shtetërore dhe bashkimi i tërësisë tokësore që iu la Shqipërisë prej Konferencës së Ambasadoreve në Londër (1913), u bë vetëm pas Kongresit të Lushnjës, të fillimvitit 1920. Ky fillimviti ishte i mbarë edhe në një aspekt ndërkombëtar, sepse përkonte me krijimin e një organizate ndërshtetërore më 10 janar, me Lidhjen e Kombeve, e ideuar nga Presidenti amerikan Vudrou Uilson, me qëllimin kryesor ruajtjen e paqes, garantimin e integritetit territorial dhe të pavarësisë politike të shteteve anëtare.

Mbështetur në misionin thuajse hyjnor të kësaj organizate, qeveria shqiptare e dalë nga Kongresi i Lushnjës e fokusoi gjithë vëmendjen tek ripohimi i vendimeve të 1913-ës, mbi njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, duke i vënë vetes si detyrë veprimtarinë në politikën e jashtme. Për rrjedhojë, në vjeshtë të vitit 1920 ajo e zhvendosi vëmendjen e saj nga Konferenca e Paqes, te Lidhja e Kombeve, duke e vlerësuar atë si selinë kryesore ku mund të zgjidheshin çështjet e vendit. Anëtarësimi i vendit në Lidhjen e Kombeve kishte rëndësi të jashtëzakonshme për të ardhmen politike, jo vetëm sepse pohonte njohjen ndërkombëtare të Shqipërisë si shtet i pavarur dhe sovran, por gjithashtu ishte një akt njohje kolektive i qeverisë në pushtet, që i jepte mundësinë vendit të kopjonte përvojat më të mira të shteteve të qytetëruara, përmes vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.

Kësisoj, në shtetin tashmë të njohur nga Lidhja e Kombeve do të zhvilloheshin zgjedhjet e para parlamentare. Këtu do ta nisja edhe unë trajtimin e figurës së Mehdi Frashërit. Arsyeja pse e nis me këto zgjedhje nuk është rastësore. Mehdi Frashëri nuk ishte një personazh i panjohur në qarqet politike. Ai kishte pasur fatin, por edhe përgjegjësinë e madhe të ishte përfaqësuesi shqiptar në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit, të cilin Konferenca e Ambasadorëve e kishte dërguar në Shqipëri, për të ngritur strukturat shtetërore.

Vitet e Luftës së Parë Botërore i kishte ndjekur me dhimbje nga Italia. Përgjatë viteve të luftës ai qëndroi në fshatin arbëresh San Demetrio-Korona, ku italianët e lejuan të jepte mësim në kolegjin e fshatit. Në qeverinë e Durrësit Mehdi Frashërit iu caktua detyra e Ministrit të Brendshëm, por në kushtet që ishte Shqipëria, kishte pak mundësi për ta ushtruar atë. Meqenëse problemi më i madh në këtë kohë ishte situata ndërkombëtare, ai ishte pjesë e delegacionit që mbronte çështjen kombëtare në Konferencën e Paqes në Paris, duke shkëmbyer postet me Mehmet Konicën, i cili ishte ministër i Jashtëm. Qëndrimet e tij në Paris e ngarkuan me akuzën "italofil", gjë të cilën ai nuk e pranoi në asnjë moment. Një rol të jashtëzakonshëm zënë përpjekjet e Mehdi Frashërit për t'i bashkuar delegatët e delegacioneve shqiptare në Paris. "Të gjithë kombet e tjerë kanë ardhur me nga një dërgatë kurse ne kemi katër", - do ta përshkruante ai paraqitjen e shqiptarëve në këtë konferencë. Detyra e tij përfundoi në fillim të vitit 1920, me rrëzimin e qeverisë dhe shkarkimin e delegacionit të Durrësit, nga Kongresi i Lushnjës.

I zgjedhur në detyrën e ministrit të Brendshëm, në qeverinë e Iliaz Vrionit, emri i tij lidhet ngushtë me ngjarjet më të rëndësishme të kohës, siç ishin zgjedhjet e para parlamentare apo destabiliteti politik, që çoi në ardhjen e Komisionit Hetues të Lidhjes së Kombeve. Në kushtet në të cilat ishte Shqipëria, zgjedhjet parlamentare ishin një sukses. Ato prodhuan parlamentin e parë shqiptar, që u dallua për debate të ashpra, mosmarrëveshje të mëdha, madje edhe për grusht shteti. Me gjithë pengesat që nxirrte autoriteti dhe ndikimi individual,

dukuri kjo e zakonshme në shoqërinë e prapambetur shqiptare, në parlament u krijuan partitë e para politike.

"Parlamenti i parë i vitit 1921 fuqinë e tepërt e tregonte kundër çdo qeverie që zgjidhte vetë, si dhe me formimin e partive që s'kishin rrënjë në popull dhe asnjë qëllim të mirë veç lakmisë për të zbritur tjetrin e për të hipur vetë", - shkruan Frashëri te "*Probleme shqiptare*".<sup>1</sup> Mehdi Frashëri ishte kryetar i Partisë Përparimtare, që kishte dhe shumicën parlamentare, por nuk do të qëndronte gjatë në drejtim, për shkak të perceptimit të ndryshëm, për çështje të ndryshme. Ai do t'i bashkohej grupit të "të papartive", por duke qenë gjithnjë një zë i fortë në parlament. Diskutimet e tij lidheshin me çështje jetike për vendin, siç ishte krijimi i Bankës Kombëtare, i ndërtimit të infrastrukturës së vendit apo të masave ekonomike që duhet të merrnin qeveritë.

Kështu, duke folur për idenë e një banke kombëtare, ai i referohet shumës prej 75 milionë franga ari që Konferenca e Londrës kishte akorduar për një bankë shteti dhe që gjate ikjes së Princ Vedit, - siç thotë Frashëri, - ishin zhdukur. "Pas luftës së përgjithshme të Konferencës së Paqes së Parisit dhe pas njohjes së shtetit shqiptar nga Lidhja e Kombeve, - vazhdon ai, - i parashtrova parlamentit formimin e një banke kombëtare, që të ishte e vetme në të drejtën e saj për të nxjerrë kartëmonedha ose bankënota të shtetit".<sup>2</sup>

Një detyrë e rëndësishme që Mehdi Frashëri mori në sesionin e parë parlamentar ishte caktimi në Komisionin për Zgjerimin e Statutit të Lushnjës së bashku me Fan Nolin, Ndre Mjedën, Koço Tasin, Stavro Vinjaun, Ali Këlcyrën, etj.<sup>3</sup> Lidhur me statutin, ai do të shprehej se "zgjerimi nuk bënte fjalë për formën e prerë të shtetit, caktimi i së cilës i lihej asamblesë kushtetuese, por bënte fjalë vetëm për të drejtat e njeriut, për lirinë e shtypit e për disa dispozita të tjera".<sup>4</sup>

Pas detyrës së ministrit të Punëve Botore, në qeverinë e dytë të Iliaz Vrionit, funksionet shtetërore të Mehdi Frashërit lidhen me

---

1. Mehdi Frashëri, *Probleme shqiptare*, (Tiranë: Plejad, 2006), 91..

2. Frashëri, *Probleme*, 161.

3. AQSH, F. 146, D. 81, fl. 195. Mbledhja e 40-të e Kuvendit Kombëtar, 1 gusht 1921.

4. Frashëri, *Probleme*, 89.



përfaqësimin e Shqipërisë në institucionet dhe konferencat ndërkombëtare. Ai do të mbronte interesat e Shqipërisë në Konferencën e Lozanës, që u mbajt në vitin 1923, ku diskutoheshin problemet e dala pas Luftës Turko-Greke.

Më 27 gusht të vitit 1923, me vrasjen e Telinit, kryetarit të Komisionit të Caktimit të Kufijve, Shqipërisë i duhej të provonte pafajësinë e saj përpara Komisionit që Lidhja e Kombeve e solli për të hetuar. Pas shoqërimit të Komisionit Hetues, Mehdi Frashëri emërohet si përfaqësues shqiptar në Komisionin e Caktimit të Kufijve. Çështja më e nxehtë këtu është ajo e Shën Naumit dhe e Vermoshit, zgjidhja e të cilave u pleks edhe me zhvillimet e brendshme politike dhe do të përfundonte vetëm në vitin 1926. Mehdi Frashëri, si delegat i Shqipërisë në Konferencën e Lozanës, kishte kërkuar që shkëmbimi i popullsisë të mos përfshinte popullsinë shqiptare.

Qeveria shqiptare iu drejtua Lidhjes së Kombeve në vitet 1924 dhe 1925, përmes Mehdi Frashërit, për të mbrojtur interesat e popullsisë shqiptare në Greqi, në sesionin e dhjetorit të vitit 1924 e më pas edhe në sesionin e dhjetorit të vitit 1925. Ai deklaroi në Lidhjen e Kombeve se qeveria shqiptare do t'i strehonte çamët e larguar nga dhuna greke, në pronat e minoritetit grek në Shqipëri. Deklaratat e forta të tij u drejtoheshin jo vetëm përfaqësuesve grekë, por edhe Komisionit të Përzier të Lidhjes së Kombeve. Falë vullnetit dhe insistimit të qeverisë shqiptare dhe Mehdi Frashërit, u ndalua shpërngulja e mëtejshme me dhunë e çamëve.

"Nisur nga gjendja e mjeruar e Shqipërisë në vitin 1930, ai flet për nevojën e një industrie kombëtare, duke theksuar se një popull që nuk ka një industri kombëtare, nuk mund të ketë pavarësi ekonomike. Ai deklaroi se "në vitin 1930, kur isha ministër i ekonomisë kombëtare, hartova një projektligj të posaçëm për t'i dhënë forcë krijimit të industrive në Shqipëri."<sup>5</sup>

Duke iu referuar arsimit, ai i mëshonte nevojës së krijimit të një universiteti dhe përgatitjes së elitave prej tij. Krahasonte në mënyrë

---

5. Frashëri, *Probleme*, 191.

shumë interesante përthithjen e popullsisë, pas krijimit të universitetit të Athinës, më 1834, duke theksuar se greket e kishin nisur kombin e lirë e të pavarur më 1830, me 570 mijë frymë dhe në 100-vjetorin e universitetit, më 1934, ata ishin shndërruar në 7 milionë, si rezultat i fryteve të mëdha të sjella nga arsimimi dhe universiteti.<sup>6</sup>

Një nga periudhat më të rëndësishme të karrierës së tij është ajo si kryeministër. Pasi përmbylli çështjen e kufijve, jeta e Mehdi Frashërit ishte mes Tiranës dhe Gjenevës. Përveç përfaqësimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, ai ushtroi funksione të rëndësishme shtetërore. Mehdi Frashëri u vu në krye të komisioneve ligjhartuese dhe Këshillit të Lartë të Shtetit. Emri i tij lidhet me miratimin e ligjeve të rëndësishme, si Kodi Penal dhe Kodi Civil.

Qeveria e Mehdi Frashërit, e zgjedhur në tetor të vitit 1935, u mirëprit nga mbarë populli, i cili ishte lodhur nga metodat e ashpra të qeverive të mëparshme. Një valë optimizmi e dashamirësie shpërtheu ndaj qeverisë së re. Ajo u konsiderua si qeveri "liberale", qeveria e "të rinjve", emra të cilët, më shumë sesa qeverinë, përkufizonin shpresat që kishte populli për të.

Gjatë kësaj kohe u organizua xhandarmëria në nivele lokale dhe qendrore. Ajo varej nga Ministria e Brendshme, për ruajtjen e qetësisë dhe nga Ministria e Drejtësisë, për zbatimin e vendimeve të gjykatave e, sakaq, në nivel vendor varej nga Prefekti<sup>7</sup>. Vetë Frashëri në "Probleme shqiptare" flet për hyrjen në fuqi të Kodit Civil, më 1929 dhe zëvendësimin e krahinave me komuna. "Më 1935, kur mora në dorë kryesinë e qeverisë, hartova dhe një projektligj për administratën civile, - thotë ai, - ku nënprefekturat pushojnë së qeni të tilla, pasi formojnë një barrë për buxhetin e shtetit".<sup>8</sup> Në një klimë entuziazmi, me një program ambicioz dhe me një kabinet të përbërë nga njerëz të papërlyer politikisht e filloi punën qeveria e re. I bindur se kishte

---

6. Frashëri, *Probleme*, 202.

7. Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005: organizimi shtetëror, jeta politike, ngjarjet kryesore, të gjithë ligjvënësit, ministrat dhe kryetarët e shtetit shqiptar në historinë 93-vjeçare të tij*, (Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2006), 125.

8. Frashëri, *Probleme*, 95.

ardhur në pushtet për të qeverisur ndryshe, Mehdi Frashëri solli një sërë risish.

Me rëndësi janë projektligjet mbi bujqësinë, mbi sindikatat, monopolet, transformimi i të dhjetave në tatime, rëndësia e shfrytëzimit të naftës, monopoli i kripës etj.

Duke ndjerë nevojën e popullit, për të luajtur rol në qeverisje, ai theksoi transparencën që do ta karakterizonte qeverinë e tij. Për këtë ai zhvilloi takimin me popullin në kinemanë "Nacional" dhe shpalli krijimin e Zyrës së Ankesave, ku populli mund të shkruante problemet e tij. Frashëri deklaroi se do t'i jepej fund nepotizmit, përmes konkurrimit të drejtë, ku femrat, gjithashtu, do kishin të drejta të barabarta. Në programin e qeverisë theksohej forcimi i administratës, shëndetësisë dhe xhandarmërisë, pavarësia e gjyqësorit dhe një arsim cilësor. Ndërsa në fushën ekonomike, programi synonte balancimin e të ardhurave, me shpenzimet, në mënyrë që të ulej deficitin. Gjithashtu, Mehdi Frashëri premtojte se nuk do kishte rritje taksash në atë moment të vështirë për popullin. Problemet mund të zgjidheshin, duke rritur prodhimin, duke përmirësuar cilësinë e tij dhe duke shtuar eksportin.

Mehdi Frashëri besonte se programi i qeverisë së tij, ishte i realizueshëm, vetëm nëse kishte mbështetjen e popullit. Gjithashtu, ai theksonte nevojën e bashkëpunimit me parlamentin. Ky mesa duket ishte edhe problemi më i madh i qeverisë, sepse, duke analizuar shtypin dhe dokumentet e kohës, kuptonte që i vetmi mirëkuptim mes qeverisë dhe parlamentit ishte nënshkrimi i marrëveshjes me Italinë, e cila u mirëprit nga të gjitha palët. Për gjithçka tjetër qeveria u kritikua rëndë dhe projektet e saj më të rëndësishme, kryesisht ato ekonomike, u hodhën poshtë nga parlamenti, duke e vënë qeverinë në pozitë të vështirë përpara popullit. Problemet ekonomike u thelluan më tej, ndërkohë që politika liberale e qeverisë nxiti protestat dhe grevat në vend. Pas një viti qeverisjeje konfliktuale me parlamentin dhe me shtypin e kohës, duke e kuptuar shumë mirë që pas tyre qëndronte vetë mbreti, Mehdi Frashëri jep dorëheqjen më 7 nëntor 1936.

Lidhur me marrëdhëniet e Mehdi Frashërit me pushtuesin italian dhe atë gjerman në vitet 1939-1944, sado që ishte quajtur shpesh edhe nga koleget si italoofil, Frashëri kërkonte të mos ndiqej shembulli i Tunizisë, por të bëhej rezistencë, pasi, sado modeste të ishte rezistenca e shtetit shqiptar, ajo do t'i bënte të qartë opinionit ndërkombëtar se nuk ishte bashkim i vullnetshëm, por pushtim i mirëfilltë dhe si i tillë duhej trajtuar në konferencat që do të pasonin luftën. Ishte kjo bindje e tij që e nxiti t'i drejtohej Radio-Tiranës, në një kohë kur qeveria dhe mbreti zgjodhën të largoheshin nga vendi. Përmes një deklarate të përkthyer në shumë gjuhë, Frashëri i tregoi botës se ishte shkelur pavarësia dhe sovraniteti i shtetit shqiptar. Si rezultat u internua në Itali, ku do të qëndronte deri në shtator të vitit 1943.

Kapitullimi i Italisë bëri që ai të përzgjidhet nga gjermanët si njeriu më i respektuar dhe më me influencë në Shqipëri. Qëndrimi që mbajti ndaj pushtuesit italian e kishte rritur vlerësimin dhe besimin e popullit ndaj figurës së tij. Gjermanët e zgjodhën Mehdi Frashërin në krye të Regjencës Shqiptare, së bashku me Lef Nosin, Fuat Dibrën dhe Anton Harapin. Frashëri e pranoi këtë detyrë, por jo pa kushte. Nga bisedimet me të dërguarin gjerman, Nojbaher, ai arriti të siguronte "neutralitetin relativ", sipas të cilit Gjermania ishte një shtet mik që gjendej në Shqipëri nga domosdoshmëria, por kjo nuk duhej të cenonte neutralitetin e shtetit shqiptar ndaj fuqive të tjera ndërluftuese. Gjermania i pranoi kushtet e Frashërit, nga nevoja që kishte për të siguruar qeverisje vendase bashkëpunuese dhe me reputacion në popull. Ndërsa Mehdi Frashëri e pranoi detyrën, me shpresën se ishte zgjidhja më e mirë për shtetin e tij, tashmë të lodhur dhe të shkatërruar nga lufta. Ai mendonte se mund të lehtësonte vuajtjet e popullit nga pushtimi italian, ta mbronte atë nga kaosi dhe dhuna e panevojshme dhe, mbi të gjitha, shpresonte të bashkonte forcat nacionaliste në luftë kundër komunizmit, i cili ishte përhapur shumë, duke u bërë dhe forca kryesore e rezistencës kundër pushtimit italian. Frashëri e konsideronte komunizmin si "kuçedër gjakpirëse", që mbillte urrejtje e ndasi në popull, por që, për fat të keq, kishte hedhur rrënjë të thella në djalërinë shqiptare. Prandaj detyra e tij dhe e popullit ishte ta

shkatërronin atë, si e vetmja mënyrë për t'u bashkuar dhe për të ecur përpara. Ky do të ishte dhe objektivi i tij kryesor përgjatë muajve në vijim. Rrethanat bëjnë që ai ta drejtojë Regjencën deri në fund, edhe pse më herët ishte vendosur drejtimi me rotacion. Në politikën e brendshme, Frashëri do të kishte rolin kryesor, ndjekur nga ministri i Brendshëm, Xhafer Deva, njëkohësisht edhe mbështetësi e besniku më i madh i gjermanëve. Ky rivalitet dëshmonte faktin që Mehdi Frashëri nuk iu nënshtrua asnjëherë plotësisht gjermanëve. Ai ishte i bindur në fitoren e forcave aleate dhe, si shumë nacionalistë të tjerë, priste me padurim zbarkimin e tyre në territorin shqiptar. Në kushtet kur kjo nuk po ndodhte, ai bëri çmos për të krijuar një front kundër komunizmit. Por kjo rezultoi shumë e vështirë. Megjithatë arriti të bindte fillimisht ballistët e më pas legalistët që të bashkëpunonin me forcat ushtarake gjermane, u bë e qartë se ishte shumë vonë për t'u përballur me forcat komuniste, që fuqizoheshin gjithnjë e më shumë. Po kështu bashkëpunimi me gjermanët kishte problematikat e veta. Me largimin e gjermanëve, largohet edhe ai nga Shqipëria. Funksionet shtetërore që mbarti ishin të rëndësishme dhe në situata delikate për konsolidimin dhe zhvillimin e shtetit shqiptar. Fakti që më ka detyruar të merrem me çfarë ai përshkruan në kujtimet e veta dhe në librin "Probleme shqiptare" është pikërisht qëndrimi i tij i gjatë për një periudhë 15-vjeçare, nga 1923-1939 si deputet i kuvendit dhe si përfaqësues i shtetit shqiptar në Lidhjen e Kombeve, por dhe idetë të cilat e rendisin ndër përfaqësuesit e mendimit politik shqiptar e, po ashtu, e rendisin edhe ndër përfaqësuesit e determinizmit në Shqipëri.

Shqipëria do mbante zgjedhjet në pranverën e vitit 1921.

Reforma e parë zgjedhore e miratuar në Shqipëri ishte nga më të përparuarat e kohës. Vendi do të kishte 78 deputetë, nga të cilët 77 zgjidheshin drejtpërdrejt nga populli, ndërsa një deputet i rezervohet diasporës shqiptare, në rastin konkret caktohej nga shoqëria Vatra në SHBA, si grupimi më i rëndësishëm i shqiptarëve jashtë vendit.

Vatra emëroi Fan Nolin, i cili hyri në parlamentin shqiptar si i zgjedhuri i parë i diasporës. Votimi në pjesën tjetër të Shqipërisë kryhej në bazë prefekturash, ku çdo prefekturë kishte një numër të caktuar deputetësh.

Kandidat për deputet mund të ishte çdo shtetas shqiptar, burrë ose grua, mbi 30 vjeç, i shkolluar dhe person i lirë.

Të drejtën e zgjedhjes, pra të votës, e kishin meshkujt mbi 20 vjeç.

Votimi bëhej në dy nivele, përmes një "sistemi të tërthortë". Fillimisht, meshkujt e një fshati, lagjeje, qyteti apo komuniteti zgjidhnin një përfaqësues të tyre, i cili duhej të ishte mbi 25 vjeç dhe i shkolluar.

Në fazën e dytë përfaqësuesit e zgjedhur nga komunitetet brenda prefekturës votonin për të zgjedhur deputetët e prefekturës, me anë të votimit të fshehtë. Nga shtypi i kohës mësohet, për shembull, se zgjedhjet në prefekturën e Elbasanit u zhvilluan në hotelin më të njohur të qytetit, ku përfaqësuesit e zonave dhe komuniteteve të ndryshme të prefekturës votuan në mënyrë të fshehtë për 8 deputetët e prefekturës. Votimi u monitorua nga trupi gjyqësor i prefekturës, media dhe madje vullnetarët amerikanë të Kryqit të Kuq.

I gjithë ky proces votimi zgjati përreth një muaj, për zgjedhjen e 77 deputetëve të parë shqiptarë, pasi çdo prefekturë shpallte datën e vet për kryerjen e votimit.

Ligji zgjedhor vendosi disa standarde që ishin tejet përparimtare për kohën. Dekriminalizimi ishte një nga standardet bazë: ndalohej kandidimi për individët e dënuar për krime. U ndalohej votimi forcave ushtarake, të cilat duhet të ishin të pavarura, si dhe të burgosurve.

Gjithashtu, nëpunësve të shtetit u ndalohej kandidimi nëse më parë nuk jepnin dorëheqjen, ndërkohë që u ndalohej me ligj ndërhyrja në proces zgjedhor.

Ministri i Brendshëm Mehdi Frashëri, një nga më të respektuarit e kohës së tij për përvojën administrative, hartoi disa urdhra të cilat i shërbyen rregullsisë së procesit. Ai themeloi traditën e parë të mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Zyrat e prefekturave u kthyen në zyra informacioni që kishin detyrë të raportonin për çdo incident apo paqartësi.

Gjithashtu, forcat e xhandarmërisë u urdhëruan nga ministri të qëndrojnë larg procesit zgjedhor dhe të përgjigjeshin për sigurinë vetëm nëse Prefekti kërkonte ndërhyrjen e tyre.

Frashëri u dha zgjidhje praktike disa shqetësimeve reale, siç ishte lista e zgjedhësve. Ai sanksionoi një rregull që ka mbijetuar deri në ditët e sotme, sipas të cilit zgjedhësit votojnë aty ku banojnë "më së paku për 6 muaj". Për të garantuar zbatimin e këtyre urdhrave, Ministri Frashëri themeloi Inspektoratin e Zgjedhjeve, që monitoronte prefektët, ndërsa urdhëroi forcat e armatosura, të cilave me ligj u ndalohej të votonin, të monitoronin nëpunësit "për të mos lejuar ndërhyrje". Një lloj mekanizmi "hajduti ruan hajdutin".

Zgjedhjet përfunduan në prill 1921, pas rreth 1 muaji procesi zgjedhor. U raportuan disa incidente që vinin kryesisht nga përplasjet në zona të caktuara, për shkak të influencës mes individëve të ndryshëm.

Nëse në Elbasan votimet shkuan normalisht, për shkak se Prefektura dominohej nga influenza e një individi si Shefqet Vërlaci, s'mund të thuhet e njëjta gjë në Korçë, ku përplasjet ishin të përditshme. Sërish nuk munguan denoncimet për blerje votash, kërcënimet me armë ndaj zgjedhësve, apo ndikimi i administratës dhe i forcave të xhandarmërisë. Në fund zgjedhjet u dominuan nga krahu konservator ose siç njihej ndryshe "krahu kombëtar" dhe nuk pati kundërshtim për rezultatin e zgjedhjeve.

Me hapjen e punimeve të Parlamentit të parë të zgjedhur, ende nuk ishte kristalizuar një shumicë solide dhe kjo u manifestua me kërkesën e rizgjedhjes së Iljaz Vrionit kryeministër. Parlamenti i parë shqiptar ia doli më tej të kryente një tranzicion që çoi në zgjerimin e Statutit të Lushnjës, një formë kushtetute të plotë, të hartonte ligje të nevojshme për mbarëvajtjen e administratës, të kristalizonte dy grupet e para politike dhe, mbi të gjitha, të themelonte një elitë të re politike.

Sot, 100 vite më pas, trashëgojmë probleme të vjetra, por jo zgjidhje të reja. Disa beteja të rëndësishme për votën e lirë vendi i ka fituar prej 1 shekulli, por disa ende nuk po i zbaton dot. Çfarë të bën të reflektosh, është fakti se pikërisht 100 vite më parë, kur besohej se mbi 80 për qind nuk dinin shkrim e këndim, shqiptarët votonin me votë përfaqësuesit e tyre të drejtpërdrejtë në parlament.





KRISTO DAKO, UDROU UILLSON  
DHE "ÇËSHTJA E ADRIATIKUT"

---

CHRISTO DAKO, WOODROW WILSON AND THE "ADRIATIC QUESTION"

ABSTRACT: This paper is dedicated to the efforts of the Albanian patriot, politician and intellectual, Christo Anastas Dako (1876 - 1941), at the Paris Peace Conference (1919 - 1920) against the partition of Albania. Albania was not torn apart by the combination of the intervention of Albanian patriots and the creation of an international conjuncture, which favored a positive solution to the Albanian issue. Christo Dako tried to influence the position of US President Woodrow Wilson regarding the "Adriatic Question", which included the solution of the problem of Albania's borders and its existence as an independent national state. At the end of January 1920, Christo Dako managed to meet the American president in person at the house of the American billionaire industrialist from Chicago, Charles Richard Crane, where he presented the whole complexity of the Albanian issue.

KEYWORDS: Triple Entente, Central Powers, League of Nations, Fourteen Points of Wilson, Adriatic Question

---

Në një prej artikujve të botuar te gazeta "Dielli" në vitin 1924, Faik Konica është shprehur se, nëse një ditë Shqipëria do të zhdukej nga harta, si epitaf për të do të shkruanin: "*u ngjall nga idealistët, u ruajt nga rastet, u vra nga politikanët*".<sup>1</sup> Ndërsa nuk është qëllimi im të vërtetoj vlefshmërinë e postulatit të Konicës në 108 vjetët e shtetit shqiptar, në këtë artikull, duke marrë si shembull përpjek-

---

1. Faik Konica, *Vepra*, vëll. 3, përgatiti për botim Nasho Jorgaqi (Tiranë: Dudaj, 2001), 333.

jen e atdhetarit, politikanit dhe intelektualit korçar, Kristo Dakos (1876 – 1941), në Konferencën e Paqes së Parisit kundër copëtimit të Shqipërisë, do të analizoj sesi në vitin 1920, Shqipëria nuk u copëtua nga ndërthurja sa e ndërhyrjes së patriotëve shqiptarë, aq edhe e krijimit të një koniunkture ndërkombëtare, e cila favorizoi zgjidhjen pozitive të çështjes shqiptare.

Në prill të vitit 1915, fuqitë e Antantës, të dëshpëruara të zgjerimin frontin kundër Bllokut Qendror, hodhën në krahun e tyre Italinë dhe Greqinë, duke u dhënë si shpërblim, përpos të tjerash, edhe pjesë nga Shqipëria (Traktati i Fshehtë i Londrës 26 prill 1915).<sup>2</sup> Në listën e përfituesve të territoreve shqiptare nuk mund të mungonin edhe Serbia dhe Mali i Zi, të cilat kishin qenë deri në atë moment në ballin e luftës kundër ushtrive habsburgase. Kështu, Shqipëria, krijesë e këmbënguljes dhe presioneve të Austro-Hungarisë<sup>3</sup> u themeloi sapo kjo e fundit nisi luftën kundër fuqive të Antantës. Sipas këtij traktati, Italia do të integronte brenda sovranitetit të saj Vlorën dhe hinterlandin e saj, si dhe do të vendoste protektoratin mbi Shqipërinë Qendrore. Krahina e Gjirokastrës dhe Korçës do t'i kalonin Greqisë, Shkodra Malit të Zi, kurse krahinat shqiptare mbi Drin do të aneksoheshin nga Serbia.<sup>4</sup> Pas fitores së Antantës, zhbërja e Shqipërisë u bë një fakt real dhe zhvillimet në konferencën e Paqes në Paris, të cilët u mbajtën nga fitimtarët për të ndërtuar rendin e ri botëror në përputhje me interesat e tyre, do të rezervonte mjaft surpriza, ku falë këmbënguljes së rrethëve shqiptare dhe përplasjeve midis qeverive të shteteve, që deri atëherë kishin luftuar përkrah njëri-tjetrit, mundësuan anulimin e zbatimit të Traktatit të Fshehtë të Londrës.

Emblematike në shndërrimin e aleatëve të luftës në rivalë, ishte përplasia e Italisë me Mbretërinë Serbo-Kroate-Slllovene për kontrollin

2. Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (Tiranë: Toena, 2013), 316.

3. Arben Puto, *Pavarësia Shqiptare dhe Diplomacia e Fuqive të Mëdha* (Tiranë: 8 Nëntori, 1978), 162-180.

4. Për më shumë mbi Traktatin e Fshehtë të Londrës dhe zhvillimet ushtarake në territorin e Shqipërisë shih: Muin Çami, *Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare: 1914-1918*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1987.

e Gadishullit të Istrias (përfshi këtu krahinën dhe qytetin e Fiumes).<sup>5</sup> Roma, e cila këmbëngulte të kontrollonte siujdhesën, ku banonin një numër i rëndësishëm bashkësish italiane, u mundua të përdorë Shqipërinë si monedhë shkëmbimi. Gjithsesi, ndeshi në kundërshtimin e vendosur të Beogradit, i cili jo vetëm që donte të ruante kontrollin mbi Istriën, por gjithashtu, duke mos dashur të shihte praninë italiane në Ballkan, parapëlqente të shmangte vendosjen e Italisë në Shqipëri. Ngërçi diplomatik i krijuar ndërmjet Beogradit dhe Romës, të cilët luftuan përkrah njëri-tjetrit kundër forcave ushtarake habsburgase, u emërtua në zhargonin e pjesëmarrësve në Konferencën e Paqes në Paris, si "Çështja e Adriatikut".<sup>6</sup> Të dyja palët rreshtonin sakrificat e jashtëzakonshme dhe qindra mijëra të vdekurit nga lufta, uria dhe sëmundjet, për të legjitimuar kërkesat e tyre. Kjo përplasje krijoi një situatë mjaft të vështirë për Francën dhe Anglinë, të cilat, të përqendruara te organizimi i Evropës së pasluftës, kërkonin të ruanin ekuilibrat midis aleatëve të tyre. Në ndihmë të palës serbo-kroate vajti, përfaqësuesi i fuqisë më pak të përfshirë dhe më pak të interesuar nga pikëpamja gjeostrategjike në Evropë: Presidenti amerikan Udrou Uillson.<sup>7</sup>

Promotori i idesë së Lidhjes së Kombeve dhe autor i programit prej katërmbëdhjetë pikash, Uillsoni synonte të rivalizonte apelin që ushtronte Bashkimi Sovjetik dhe Lenini mbi kombet e reja të Evropës. Projekti uillsonian premtonte një rend të ri botëror të mbështetur mbi parime morale dhe jo mbi raportet e forcës dhe pragmatizmin e realpolitikës. Si pjesë e kësaj pakete, presidenti amerikan, mbështetur edhe në parimet e demokracisë së vendit që përfaqësonte, shpalli të drejtën e popujve për vetëvendosje, si një nga shtyllat kryesore të botës, që pasoi fundin e Luftës së Madhe. Për rrjedhim, ai doli hapur edhe

5. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III (Periudha e Pavarësisë 28 nëntor 1912 – 7 prill 1939), (Tiranë: Akademia e Shkencave të Historisë: 2007), 130.

6. Joseph Swire, *Shqipëria: Ngritja e një mbretërie*, përktheu nga anglishtja në shqip Kujtim Ymeri, (Tiranë: Dituria, 2005), 231-264.

7. Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912 - 2000* (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2007), 103–104.

ishite kundër traktateve të fshehta të fuqive ndërluftuese, përfshi këtu edhe ato të Antantës, të cilat, të udhëhequra nga lakmitë territoriale apo nevojat gjeostrategjike, e ndanin hapësirën mbi parime imperialiste të diktuar nga raportet e forcës. Sipas Uillsonit, në botën e re që do të ngjallej nga hiri i luftës, dielli do të ndrinte jo vetëm për të fuqishmit, por edhe për të dobëtit. Të paktën kjo ishte çfarë shkruhej në letër.<sup>8</sup>

Sapo idetë prekin truallin e realitetit ato shndërrohen, shpesh edhe rrënjësisht. Kjo ndodhi edhe me Uillsonin dhe programin e tij. Me të ardhur në Evropë, atij iu desh të bënte një varg kompromisesh me realitetin evropian, si dhe me kërkesat e fuqive aleate të ShBA-së. Kjo nënkuptonte edhe pranimin prej tij të zbatimit të pjesshëm të Traktatit të Fshehtë të Londrës. Gjithsesi, në përplasjen dhe mundjen e krahut midis Romës dhe Beogradit, presidenti amerikan mbajti hapur anën e këtij të fundit. Humbjet kolosale të Serbisë dhe qëndresa heroike e ushtrive serbe kundrejt ushtrive austro-hungareze, e kishin shndërruar vendin ballkanik në një ikonë të luftës, së asaj që në Perëndim, quhej imperializmi militarist teutonik i fuqive të Evropës Qendrore. Por, nga ana tjetër, ai nuk mund të shpërfillte Italinë, e cila ishte anëtare e klubit të fuqive të mëdha – edhe pse ishte më e dobëta ndër to. Kështu, ndërsa refuzoi aneksimin e Istrias dhe shkëmbimin e saj me Shqipërinë e Veriut, më 9 dhjetor të vitit 1919, Uillsoni ra dakord me Klemansonë e Francës dhe Llojd Xhorxhin e Anglisë, që Italia të ruante sovranitetin mbi Vlorën.<sup>9</sup> Zbatimi i pjesshëm i Traktatit të Fshehtë të Londrës, nënkuptonte se, potencialisht si Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene ashtu edhe Greqia ruanin të drejtën të kërkonin pjesën që ky traktat u jepte nga territori i Shqipërisë.

Pikërisht, në kryqëzimin e këtyre përplasjeve dhe kompromiseve u vendos edhe e ardhmja e Shqipërisë. Dhe në këtë pikë, u munduan të ndërhyjnë nacionalistët shqiptarë, të cilët u përpoqën të shfrytëzojnë

---

8. Për një shtjellim më të hollësishëm mbi vizionin e Uillsonit dhe programin e tij në Konferencën e Versajës, shih: Margaret Macmillan, *Paris 1919: gjashtë muajt që ndryshuan botën*, përktheu nga anglishtja në shqip Fatmir Xharri & Myrteza Shini. Tiranë: Plejad, 2006.

9. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, 135.

sa parimin e vetëvendosjes aq edhe koniunkturën ndërkombëtare në shërbim të çështjes kombëtare. Kristo Dako, marrëdhëniet e të cilit me rrethet e ndryshme politike shqiptare ishin shpesh mjaft të vështira, ishte një ndër figurat që u angazhuan më shumë për ta nxjerrë Shqipërinë nga ekuacionet diplomatike të epokës së imperializmit, të cilat synonin zgjidhjen e fërkimeve ndërkombëtare përmes shkëmbimesh territoriale. E thënë ndryshe, qëllimi i Dakos dhe i nacionalistëve të tjerë shqiptarë ishte, që Shqipëria të mos konsiderohej si kolonitë afrikane dhe aziatike të Fuqive të Mëdha të Evropës. Shqiptarët ishin njerëz që kishin zë, pra ishin një popull, me të drejtat e sovranitetit dhe të vetëvendosjes, të cilat rridhnin prej këtij përkufizimi.

Interesant në rastin e Kristo Dakos është rruga që ai ndoqi për të bërë të mundur të dëgjohej zëri i shqiptarëve në majat e Olimp të diplomacisë së kohës. Delegacionet shqiptare që morën pjesë në Konferencën e Paqes së Parisit dhe politikanët shqiptarë të kohës përdorën si një nga mjetet kryesore të tyre, telegramet dhe notat e protestave, të cilat ua dërgonin organizatorëve të rendit të ri botëror, që të mos cenonin Shqipërinë e dalë nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër dhe kufijtë e saj të përcaktuar në 29 korrik të vitit 1913.<sup>10</sup> Këto telegrame shpesh shpërfilleshin. Mbi të gjitha, edhe fqinjët që kërkonin rishikimin e kufijve të shtetit shqiptar përdornin gjerësisht telegramet për të arritur qëllimet e tyre. Kjo ishte sidomos e vërtetë për Greqinë, e cila nuk kursehej të dërgonte telegrame, që në emër të së drejtës së vetëvendosjes, të manipulonin katërshen e Antantës dhe të realizonin aneksimin e Gjirokastrës dhe Korçës brenda kufijve të shtetit helenik.

Ndikimi i vendimmarrjes ishte një nga mjetet e tjera që përdorën nacionalistët shqiptarë për të influencuar vendimmarrjen e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të mbledhura në Paris. E tillë është edhe përçapja që bëri Fan Noli, kur kërkoi të siguronte mbështetjen e presidentit amerikan gjatë një takimi që pati në jahtin Mayflower, që Uillsoni dha për përfaqësuesit diplomatikë të delegacioneve, të cilët

---

10. Duka, *Histori e Shqipërisë*, 62.

merrnin pjesë në Konferencën e Pages.<sup>11</sup> Aty, Noli u përpoq të ndikonte tek presidenti amerikan nëpërmjet gruas së këtij të fundit, Edith Uillon, duke u munduar të sensibilizojë zonjën e parë të gjigandit të Amerikës së Veriut mbi çështjen shqiptare.<sup>12</sup> Kristo Dako ishte një tjetër aktor që u përpoq të influenconte qëndrimin e Uillonit lidhur me "Çështjen e Adriatikut", brenda së cilës ishte futur edhe zgjidhja e problemit të kufijve të Shqipërisë dhe ekzistencës së saj, si një shtet kombëtar i pavarur.

Janari i vitit 1920, ishte koha kur arriti edhe kulmi i mosmarrëveshjeve lidhur me refuzimin e Beogradit për të lëshuar Istriën në favor të Italisë. Gjatë kësaj kohe, autoritetet jugosllave refuzonin edhe zbatimin e memorandumit të 9 dhjetorit të vitit 1919, i cili i njihte Italisë të drejtën e sovranitetit mbi Vlorën.<sup>13</sup> Pikërisht, në fund të këtij muaji (janarit), Kristo Dako arriti të takonte personalisht presidentin amerikan në shtëpinë e industrialistit miliarder amerikan nga Çikago, Çarls Krejn (Charles Richard Crane 1858 – 1939). Ky i fundit kishte qenë një financues i rëndësishëm i fushatës së zgjedhjeve të Uillonit dhe ishte mik personal i Kristo Dakos dhe i bashkëshortes së tij, Sevasti Qiriazit. Përpos Dakos, Krejn i kishte mundësuar edhe Tomas Masarikut, themeluesit të Çekosllovakisë, që të takonte Udrou Uillonin dhe t'i kërkonte këtij të fundit të mbështeste krijimin e shtetit të ri dykombësh, pas shpërbërjes së zotërimeve habsburgase. Dako dhe familja Qiriazit, ishin të mirëintegruar në cirkujt e misionarëve protestantë amerikanë, që depërtuan në vilajetet evropiane osmane në gjysmën e parë të shekullit XIX.<sup>14</sup>

Të arsimuar në shkollat amerikane në Perandorinë Osmane dhe më pas edhe në universitetet në SHBA, Kristo Dako dhe Qiriazët, përmes

11. Valentina Duka, *Çështje të Historisë Bashkëkohore të Shqiptarëve*, (Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2008), 101, 127.

12. Duka, *Histori e Shqipërisë*, 123-124.

13. Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare*, (Tiranë: Albin, 2003), 317-321.

14. David Hosaflook, "Lëvizja Protestante ndër shqiptarë, 1816 – 1908" (disertacion në kërkim të gradës shkencore "Doktor", Universiteti i Tiranës, 2017), 42.

edhe mbështetjes së fondacioneve ungjillore, arritën të kishin akses edhe në radhët e elitës ekonomike amerikane.<sup>15</sup> Ndër ta, më i spikatur i ishte industrialisti Çarls Krejn. Njeri shumëplanësh, sipërmarrjet e të cilit e bënë atë një personazh të njohur jo vetëm në jetën ekonomike, por edhe atë politike amerikane dhe ndërkombëtare, Krejn u njoh me Kristo Dakon dhe Sevasti Qiriazin në vitin 1911 gjatë një vizite turistike që ai bëri në Shqipëri. Çifti shqiptar, për shkak të njohjes së gjuhës angleze, e shëtiti miliarderin amerikan nëpër viset shqiptare dhe që prej atij momenti ata farkëtuan një marrëdhënie të tillë, sa që Sevastia dhe Parashqevia e thërrisnin Krejnin me njëra-tjetrën me emrin "babai". Kjo miqësi u mbajt gjallë dhe u përforcua edhe më tej gjatë kohës, kur, Kristo dhe Sevasti studionin në universitet në ShBA. Krejn, si lobist dhe financues i Partisë Demokratike, kishte mbështetur fushatën elektorale të Udrou Uillsonit, të cilin manjati amerikan e njihte personalisht.

Dako do të shfrytëzonte miqësinë e madhe me Krejnin dhe njohjen dhe ndikimin që ky i fundit kishte deri në majat e politikës amerikane, për të siguruar një takim me presidentin Uillson. Në fund të janarit të vitit 1920, në shtëpinë e Çarls Krejnit, Kristo Dako takoi presidentin amerikan, ku i parashtrroi gjithë kompleksitetin e çështjes shqiptare. Dako, si edhe nacionalistët e tjerë shqiptarë, e dinte se, aneksimi i Vlorës prej Italisë, i hapte rrugën zbatimit, sikur edhe të pjesshëm të Traktatit të Fshehtë të Londrës. Në çastin që italianët vendosnin portin që mbyllte ngushticën e Otrantos nën kontrollin e tyre, atëherë Athina do kërkonte medoemos aneksimin e krahinave jugore të Shqipërisë, gjë që do të shtynte edhe Beogradin të kërkonte të njëjtën gjë, në mënyrë që, të përdorte malësitë e Veriut për të krijuar një zonë jastëk kundër italianëve.

Qëllimi i Dakos ishte të bindte Uillsonin që të hiqte dorë nga memorandum i 9 dhjetorit të vitit 1919, i cili i njihte Italisë sovranitetin mbi Vlorën. Dako i argumentoi Uillsonit se, kontrolli mbi Vlorën

---

15. Për më tepër, shih Dhimitër Dishnica, *Motrat Qiriazit*. Tiranë: Botime Enciklopedike, 1997.

nuk kishte më rëndësi strategjike për Italinë, pasi në vitin 1915, fuqia apenine synonte të mbyllte Otranton, në mënyrë që të mos linte flotën habsburgase të kontrollonte Adriatikun, që italianët, njëlloj si venecianët në Mesjetë, e quanin një liqen të tyrin.

Uillsoni, edhe pse e dëgjoi me vëmendje Dakon, i bëri këtij të ditur se ai nuk mund të tërhiqej nga një vendim, ku kishte vendosur firmën. Kuptohet se për presidentin amerikan më shumë rëndësi kishte respektimi i procedurave diplomatike, sesa zbatimi i parimeve të shpallura prej tij. E megjithatë, edhe pse ndërhyrja e Dakos nuk pati ndonjë efekt të drejtpërdrejtë në qëndrimin e Uillsonit, përpjekja e tij përfaqëson një nga tentativat e shumta për t'i lënë të kuptohej presidentit amerikan se, shqiptarët kishin një zë.<sup>16</sup> Ndërkaq, po në fund të janarit në Shqipëri u mbledh Kongresi i Lushnjës, ku përfaqësues nga e gjithë Shqipëria u shprehën se do të luftonin kundër copëtimit të Shqipërisë, si dhe kujtdo protektorati mbi vendin. Paralelisht, të dërguarit e Departamentit të Shtetit në Shqipëri konfirmonin mëtimet e Dakos dhe të tjerëve nacionalistë shqiptarë mbi përbërjen etnike dhe vetëdijen kombëtare të shqiptarëve.

Në 6 mars të vitit 1920, Uillsoni do të deklaronte se Shqipëria ishte jashtë "Çështjes së Adriatikut" dhe se zgjidhja e problemit të sovranitetit mbi Istriën (mbi krahinën dhe qytetin e Fiumes), nuk do të bëhej duke përfshirë trevat shqiptare. Këto nuk do të ishin një monedhë shkëmbimi.<sup>17</sup> Ky ishte momenti i parë, kur u ndërmor një hap nga Fuqitë e Mëdha që fituan luftën për të zhbërë zbatimin e Traktatit të Fshehtë të Londrës. Viti 1920 do të ishte një vit me rëndësi të jashtëzakonshme për Shqipërinë. Në janar të atij viti u mbledh Kongresi i Lushnjës, i cili hodhi poshtë zbatimin e vendimeve të Traktatit të Fshehtë të Londrës;<sup>18</sup> kurse në verë, u zhvillua Lufta e

16. Dhimitër Dishnica, *Përballë të vërtetës: Kristo Dako (jeta dhe vepra)*, (Tiranë: Erik, 2004), 266-269.

17. Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, (Tiranë: 55, 2006), 105-106.

18. Edwin Jacques, *Shqiptarët: historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*, shqipëroi nga anglishtja Edi Seferi, (Tiranë: Kartë dhe Pendë, 1995), 405-406.



Vlorës, që u mbyll me sukses për forcat shqiptare, kjo falë edhe faktit se, Italia ishte në zgrip të luftës civile, si pasojë e thuarje revolucionit socialist që po përjetonte. Tërheqja italiane nga Vlora ishte pjesë e një manovre më të gjerë diplomatike, ku Roma hiqte dorë prej shumë angazhimeve që kishte marrë përsipër gjatë kohës së Luftës së Madhe.

Ndërkaq, Greqia që po bëhej gati të niste aventurën e Azisë së Vogël. Edhe pse qeveria e Athinës mbajti nën kontrollin e saj 27 fshatra në zonën e Korçës, Azia e vogël përbënte për të një arritje shumë më të rëndësishme se sa ai i Shqipërisë së Jugut. Për të mos hapur dy fronte, autoritetet greke nënshkruan në maj të vitit 1920 marrëveshjen e Kapshticës, ku autoritetet helenike njihnin, sikur edhe përkohësisht vijën kufitare të vitit 1920. Katastrofa ushtarake greke nga forcat turke të drejtuara nga Qemal Atatürk dhe Ismet İnönü shënuan fundin e ambicieve greke për të realizuar Megali İdenë dhe përmbushjes së objektivit të saj për të aneksuar Shqipërinë e Jugut.<sup>19</sup>

Pretendimet greke i varrosën përfundimisht anglezët. Për fatin e Shqipërisë, në vitin 1918 në zonën e Vlorës, dy inxhinierë italianë zbuluan naftë. Legjendat e paverifikuara, por gjerësisht të besuara, se Shqipëria ishte një Persi e vogël ndikuan në qëndrimin britanik. Londra po kërkonte me ngulm të fuste nën kontroll sa më shumë burime të arit të zi. Diplomacia angleze u angazhua seriozisht dhe, në shkëmbim të futjes së Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe njohjes së saj kërkoi koncesionin e naftës – koncesion ky që iu dha menjëherë.<sup>20</sup> E kështu, si pasojë e kësaj koniunkture, ajo që dukej e pamundur u bë e mundur. Gjithsesi, njerëz si Kristo Dako, që thjesht për rastësi fatlume të jetës, patën akses në qarqet më të larta të politikës amerikane, dhanë një kontribut jo të vogël për të bërë zërin e shqiptarëve të dëgjohej. Si thoshte edhe Konica, Shqipëria shpëtoi nga fati dhe u ngjall nga idealistët.

19. Nina Smirnova, *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, përktheu nga rusishtja në shqip Korab Hoxha dhe Fatmir Mborja, (Tiranë: Ideart, 2004), 101-102

20. Iljaz Fishta dhe Veniamin Toçi, *Gjendja ekonomike e Shqipërisë në vitet 1912 – 1944, prapambetja e saj, shkaqet dhe pasojat*, (Tiranë: 8 Nëntori, 1983), 40.



PROBLEMI I STATUSIT NDËRKOMBËTAR TË SHQIPËRISË  
RRETH KUFIJVE TË SAJ (1920-1926)

---

THE PROBLEM OF ALBANIA'S INTERNATIONAL STATUS  
AND THE DEBATES CONCERNING ITS BORDERS (1920-1926)

ABSTRACT: The legal and diplomatic aspect of Albania's international status was one of the main issues faced by the Albanian political elite after the First World War. In these circumstances a principled question arose: could it be accepted that Albania was a fully independent and freely governed state within the framework envisaged by Article 1 of the League of Nations Covenant? Fan Noli, the Albanian representative to the League of Nations, after long and strong debates managed to win the sympathy of the delegates. Albania was admitted to the League of Nations on December 17, 1920.

Albania's accession served as a collective recognition of the Albanian government, but no country had established normal diplomatic relations with it yet. The solution to the Albanian issue was not yet considered final. Albania's status in terms of borders was still questioned. The decisions of the Conference of Ambassadors, already known as the competent body to decide on the Albanian borders, confirmed the trace of the southern (Greek-Albanian) borders of Albania determined by the border demarcation commission which drafted the protocol of its work on December 17 1913 in Florence.

As for the Northeast (Yugoslavia-Albania) Boundary Commission, Belgrade kept open some complex border issues, of which the most controversial one was the well-known issue of the Monastery of St. Naum, which was highly debated between 1922-1924 in high international forums. Based on the ethnic and economic arguments formulated by the members of the Border Commission, the Conference of Ambassadors, decided on December 6, 1922 on the reunification of the monastery of St. Naum with Albania. This decision was confirmed by the Court of Justice of The Hague, on September 4, 1924. On these institutional and legal grounds, the text of the Final Act

of Defining the Borders of Albania, was finally signed in Paris on July 30, 1926, by the representatives of all the interested states.

**KEYWORDS:** International Status, League of Nations, Diplomatic Relations, Conference of Ambassadors, Border Demarcation Commission, Issue of the Monastery of St. Naum, Court of Justice of The Hague, Final Act of Defining the Borders of Albania

---

Shqipëria doli nga Lufta e Parë Botërore e shkatërruar dhe kaotike. Ishte e nevojshme të ndërtohej shteti i krijuar në letër në 1913-1914. Një qeveri e re që doli nga Kongresi i Lushnjës në janar 1920 i kryesuar nga S. Delvina, u krijua në Tiranë, e cila u bë kështu kryeqyteti i Shqipërisë. Tani ajo kishte një qeveri me autoritet efektiv në pjesën më të madhe të territorit të përcaktuar nga Konferenca e Londrës e vitit 1913. Ky ishte kushti i domosdoshëm për njohjen sipas ligjit ndërkombëtar dhe për ta fituar atë, qeveria e Tiranës bëri kërkesë për pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve.

### **Aspekti juridik e diplomatik i Statusit ndërkombëtar të Shqipërisë**

Një çështje parimore ngrihej në këto rrethana: ajo e pozitës ndërkombëtare të Shqipërisë. A mund të pranohej që Shqipëria ishte një shtet plotësisht i pavarur dhe i qeverisur lirisht brenda kuptimit të Nenit 1 të Paktit të Lidhjes së Kombeve? Shqipëria kishte qenë e pavarur që nga viti 1912; pavarësia e saj ishte njohur në 1913; aktet e luftës nuk kishin ndryshuar asgjë nga statusin e saj ndërkombëtar; "Sapo kaloi stuhia, Shqipëria u rimëkëmbë, u riorganizua dhe u formua një qeveri kombëtare." Ky ishte qëndrimi i qeverisë së Tiranës shprehur në memorandum<sup>1</sup> e 22 nëntorit 1920, i cili përbënte dhe platformën politike të zhvilluar për çështjen shqiptare.

---

1. Le Mémorandum du GVT albanais soumis au Secrétaire général de la SDN, Eric Drummond, cituar nga Arben Puto, "La question du statut international de l'Albanie devant la SDN et la Conférence des ambassadeurs", *Studia Albanica* 2 (1965): 20-21.

Me mbështetjen e Britanisë së Madhe, përfaqësuesi shqiptar në Lidhjen e Kombeve Imz. Fan Noli arriti ta fitonte çështjen duke dalë në kundër politikës së Francës dhe *protégé-në* e saj Jugosllavinë, Greqisë dhe Italisë. Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve në 17 dhjetor 1920 pas debateve të gjata dhe të forta, si përpara Komisionit Ligjor përgjegjës për paraqitjen e një raporti në Asamblenë e Përgjithshme mbi kandidaturën shqiptare, ashtu edhe përpara vetë kësaj Asambleje. Ai mori miratim gati unanim nga Asambleja e Përgjithshme. Pranimi i saj në Lidhjen e Kombeve ishte i tillë që shuante të gjitha dyshimet për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë, pasi shërbente si konfirmim i saktë dhe formal i akteve juridike dhe politike ndërkombëtare të viteve 1913-1914.

Kjo arritje në politikën e jashtme shqiptare nuk do të thoshte se të gjitha vështirësitë u kapërcyen. Në veçanti kriza serioze u shfaqën në marrëdhëniet me vendet fqinje. Megjithëse pranimi i Shqipërisë shërbente si një njohje kolektive e qeverisë shqiptare nga ana e vendeve që votuan pro, asnjë nga këto vende nuk bëri ndonjë përpjekje konkrete për të vendosur marrëdhënie normale diplomatike me të.

Qeveria shqiptare nuk mund të kishte kontakte të përhershme dhe të rregullta me qeveritë e vendeve fqinje për të zgjidhur një çështje kaq urgjente siç është ajo e caktimit të kufijve. Ajo nuk mund të negocionte me autoritetet e vendeve të tjera ose me kompani të huaja për të ngritur ekonominë e vendit, pasi ato hezitnin të hynin në marrëveshje ose në kontrata me një qeveri të panjohur. Qeveria e Tiranës nuk ishte pranuar ende në Unionin Postar Botëror, i cili pengonte komunikimet me jashtë vendit. Edhe udhëtimi jashtë për shqiptarët ishte i vështirë, pasi konsujt nuk jepnin viza për shtetasit shqiptarë. Edhe kontaktet dhe marrëveshjet e që qeveria shqiptare kishte arritur të realizonte veçanërisht me qeverinë Romës dhe të Athinës nuk konsideroheshin njohje nga ana e tyre. Mbizotëronte kështu gjykimi i shprehur gjatë debatit në Asamblenë e Lidhjes se qeveria shqiptare nuk ishte as *de jure* as *de facto*<sup>2</sup>.

---

2. Artan Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, (Tiranë: Duda, 2010), 323.

Dy janë faktorët që pengonin njohjen e qeverisë shqiptare sipas mendimit të profesor Arben Puto, 1 - veprimet e vendeve fqinje që synonin shkëputjen e pjesëve të caktuara të territorit shqiptar; 2 - këmbëngulja e Italisë për të garantuar me çdo kusht një vendim ndërkombëtar për njohje të interesave të veçanta italiane në Shqipëri<sup>3</sup>. Këto synime, në aspektin ligjor, morën formën e pretendimeve të mëposhtme: pranimi në Lidhjen e Kombeve nuk shton ndonjë element të ri në statusin ndërkombëtar të Shqipërisë pas luftës; aktet e viteve 1913-1914 kanë humbur vlerën e tyre; duhet të hartohen instrumente të reja ndërkombëtare që të mund të jepnin zgjidhje për çështjen shqiptare. Kjo është arsyeja se përse, shumë muaj pas pranimi të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, çështja shqiptare nuk u konsiderua e zgjidhur përfundimisht. Nëse do të prananim vlerën e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të 17 dhjetorit 1920 në lidhje me statusin ndërkombëtar të Shqipërisë si një vend i pavarur, vlera e tij për sa i përket kufijve ishte e dyshimtë. Çështja ishte se a mund të konsiderohej Shqipëria si një shtet me kufij të mirëpërcaktuar? Delegati jugosllav në Gjenevë madje theksonte përpara Lidhjes së Kombeve si një argument kundër njohjes së qeverisë në Tiranë se ajo mbështetej te "xhonturqit dhe bolshevikët për të luftuar popullsinë e krishterë"<sup>4</sup>.

Në Lidhjen e Kombeve filloi një debat mbi problemin nëse ajo ishte apo jo kompetente për të zgjidhur çështjen e kufijve shqiptarë ose nëse ky problem ishte kompetencë e Konferencës së Ambasadorëve. Në të vërtetë, sipas mendimit të qeverive të vendeve fqinje dhe të fuqive të tjera, pranimi në Lidhjen e Kombeve nuk parakuptonte edhe njohjen e kufijve të shtetit të ri. Greqia të paktën e kishte pohuar këtë publikisht po ashtu si dhe Mbretëria Serbe, Kroate e Sllovene, që mbante ende pretendime territoriale mbi Shqipërinë. Fqinjët lakmitarë pohonin se kufijtë e Shqipërisë së vitit 1913 nuk ishin më të vlefshme për shkak të

3. Puto, "La question", 36.

4. Arkivi Qëndror i Shtetit, F. 25, D. 35, viti 1921; AMAE, Série: Europe 1944-1960, sous-série Albanie 1944-1949, vol. 10.

dështimit të ushtrimit të pushtetit politik dhe se të gjitha marrëveshjet për Shqipërinë duhet të rishikohen<sup>5</sup>.

Teza e mbrojtur nga pala shqiptare në Gjenevë i jepte të drejtën Lidhjes së Kombeve, si mishërimi i ri i koncertit të fuqive, për të vendosur mbi çdo çështje të rëndësishme të lidhur me Shqipërinë. Ndërsa përfaqësuesit e Greqisë dhe Jugosllavisë theksonin se caktimi i kufijve ishte përgjegjësi ekskluzive e Konferencës së Paqes dhe organit të saj, Këshillit Suprem të Aleatëve dhe për pasojë Konferencës së Ambasadorëve. Delegati shqiptar peshkopi Fan Noli hodhi poshtë këtë sugjerim dhe këmbënguli se Konferenca e Ambasadorëve kishte si detyrë të vetme të merrej me zgjidhjen e problemeve mes fitimtarëve dhe të mundurve, probleme që dilnin nga traktatet e paqes të përcaktuara pas luftës<sup>6</sup>.

Ndërsa Shqipëria nuk ishte një vend pjesëmarrës në luftë, por një vend neutral. Prandaj, ajo nuk mund të njihte kompetencat e Konferencës së Ambasadorëve për çështjen e kufijve të saj që tashmë ishin përcaktuar para luftës<sup>7</sup>. Qeveria e Tiranës duke ditur kundërshtimin e Francës dhe Italisë, u përpoq t'i shmangej vendimeve të fuqive dhe që me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve, përfaqësuesi i saj Fan Noli e ftoi këtë institucion për të vendosur për kufijtë shqiptarë.

### **Problemi i kufijve dhe debatet rreth tyre**

Këshilli i Lidhjes së Kombeve vlerësoi tezën greko-jugosllave, dhe më 25 qershor 1921 e referoi problemin në Konferencën e Ambasadorëve të Anglisë, Francës, Italisë dhe të Japonisë. Ky institucion, me anë të Rezolutës së Lidhjes së Kombeve të 2 tetorit 1921, formuluar mbi bazën e raportit të Lord Balfour-it, u njoh tashmë si organi kompetent për të vendosur mbi kufijtë shqiptarë. Ky raport i paraqitur në Këshillin

5. Robert Clegg Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit: Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924*, (Tiranë: Albin, 2000), 45-46.

6. Puto, *Historia diplomatike*, 325-326.

7. André Simonard, *Essai sur l'indépendance albanaise*, (Paris: M. Lavergne, 1942), 379; shiko dhe Joseph Swire, *Albania: the rise of a kingdom*, (New York: Arno Press, New York Times, 1971), 349.

e Lidhjes së Kombeve më 2 shtator 1921 "sugjeroi që aktet e 1913-1914 janë në fuqi në lidhje me pavarësinë e Shqipërisë, por ato nuk janë në fuqi për çështjen e kufijve"<sup>8</sup>.

Më në fund, konferenca e mbledhur në Paris më 9 nëntor 1921 deklaroi se ishte në favor të akteve kryesore ndërkombëtare në lidhje me statusin e Shqipërisë, si dhe për një kthim në kufijtë e vendosur në Konferencën e Londrës të 1913. Në të vërtetë, më 9 nëntor, Konferenca e Ambasadorëve mori dy vendime: 1 - mbi "korrigjimet" e kufijve veriorë dhe njohjen e qeverisë shqiptare; 2 - mbi njohjen e interesave të veçantë strategjike të Italisë në Shqipëri<sup>9</sup>.

E vetmja rëndësi pozitive e vendimeve të 9 nëntorit 1921 qëndron në ripohimin e njohjes së Shtetit Shqiptar, të bërë nga pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920. Përshtypja është se "vendimet e 9 nëntorit 1921 janë ambivalente"<sup>10</sup>, pra me një dykuptimësi kontraktore. Nga njëra anë, ato konfirmuan pavarësinë e Shqipërisë dhe njohën qeverinë shqiptare të formuar në baza kombëtare, duke i dhënë fund izolimit diplomatik të saj. Por konferenca e vuri Shqipërinë nën një lloj tutelë italiane. Nga ana tjetër, ato përfshijnë dhe rregullime të caktuara të kufijve për të marrë parasysh pretendimet jugosllave.

Me gjithë vendimet e Konferencës së Ambasadorëve, Athina dhe Beogradi nuk pranuan të njohin vendimet e arbitrave që ata vetë i kishin zgjedhur. Gjatë debatit shumë të ashpër, i cili u zhvillua në Asamblenë e Lidhjes së Kombeve, delegati grek u ankua për simpatinë e treguar ndaj Shqipërisë si pasojë e mbrojtjes dhe simpatisë që kishte ngjallur fjala e Fan Nolit. Ai mori përgjigjen e mëposhtme nga delegati i Afrikës së Jugut, Lord Robert Cecil-i: "është e saktë, siç u tha, se i

---

8. Puto, "La question", 41.

9. Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperIALIZMIT: përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik*, vëll. III (1919-1926), (Tirane: Albin, 2001), 73-74.

10. Stafanaq Pollo, Arben Puto, Stafanaq Pollo, Kristo Frasheri, Skënder Anamali, dhe Maurice Beaumont, *Histoire de l'Albanie des origines à nos jours*; sous la direction de Stafanaq Pollo et Arben Puto, avec la collaboration de Kristo Frasheri et Skënder Anamali; préface de Maurice Beaumont, (Roanne: Horvath, 1974), 216



deleguari i Shqipërisë ka ngjallur shumë simpati në këtë Asamble. Nëse i nderuari z. Frangulis dëshiron të dijë se përse, më lejoni t'i them se kjo është për shkak se i deleguari shqiptar ka treguar një frymë të madhe moderimi dhe drejtësie, e cila vlerësohet shumë nga kjo Asamble; delegacioni grek do të bënte mirë të paktën të përpiqet të imitonte fqinjët e tij në këtë fushë"<sup>11</sup>.

Vendimet e Konferencës së Ambasadorëve konfirmuan gjurmën e kufijve jugorë (greko-shqiptar) të Shqipërisë të fiksuar në tokë nga komisioni i caktimit të kufijve, i cili hartoi Protokollin e punimeve të tij më 17 dhjetor 1913 në Firence. Në të vërtetë, caktimi i kufijve të vitit 1913 në Jug u konsiderua në parim përfundimtar, i cili e detyroi Greqinë të kthente 14 fshatra, të okupuara që nga fundi i Luftërave Ballkanike. Qeveria Greke protestoi kundër vendimit të 9 nëntorit 1921, i cili përcaktoi kufijtë e Shqipërisë. Ajo nuk pranoi të merrte pjesë në punën e Komisionit të Kufijve shqiptare, derisa ky Komision të kishte njohur zyrtarisht vlefshmërinë e Protokollit të Korfuzit të 17 majit 1914, që shkëputte territoret e pretenduara si Epir i Veriut nga grekët<sup>12</sup>.

Konferenca e Ambasadorëve, përmes një rezolute të datës 24 gusht 1922, informoi qeverinë greke se "Protokollin e Korfuzit nuk mund të konsiderohej më si një instrument diplomatik në fuqi, pasi ky Protokoll është shkelur nga epirotët në korrik të 1914, kur ata pushtuan Korçën dhe ky protokoll u anulua nga aktet e mëvonshme, veçanërisht me vendimin e 9 nëntorit 1921"<sup>13</sup>. Ky hap i ndërmarrë në Paris u shoqërua me një hap tjetër të përbashkët dhe energjik i ndërmarrë nga Përfaqësuesit Aleatë në Athinë, sugjeruar nga Presidenti i Konferencës, *Poincare*, më 2 shtator 1922, "për t'i bërë thirrje vendosmërisht Qeverisë greke të ndërpresë pengesat e saj për punën e Komisionit të Caktimit të Kufijve"<sup>14</sup>.

11. AQSh, F. 25, D. 35, viti 1921, si dhe AMAE, vëll. 10.

12. AMAE, Correspondance Politique et Commerciale 1914-19140, Albanie 1918-1929, vëll. 68, Délimitation de l'Albanie, III.

13. *Ibid.* Shih Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, 132.

14. AMAE, Correspondance Politique et Commerciale 1914-19140, Albanie 1918-1929, vëll. 68, Délimitation de l'Albanie, III.

Greqia më në fund u tërhoq më 25 tetor 1924 të lëshonte 14 fshatrat nga 26 gjithsej që ajo mbante që prej vitit 1914 në rajonin e Korçës të pretenduar e të pushtuar prej saj. Komisioni Ndërkombëtar për Përcaktimin e Kufijve të Shqipërisë përfundoi hartimin e protokollit për kufijtë greko-shqiptar, i cili u nënshkrua në 27 Janar 1925 në Firence<sup>15</sup>. Ky protokoll përfundimtar u miratua më 5 gusht 1925 në Paris nga Konferenca e Ambasadorëve. Delegati helen, duke e konsideruar të tepërt këtë vendim, me vështirësi u pajtua me vendimet e marra nga Konferenca, veçanërisht në lidhje me kufirin greko-shqiptar.

Për Komisionin për Përcaktimin e Kufijve Veri-Lindor (Jugosllavi-Shqipëri) i cili u desh të ndërpresë punën e tij në 1914, vendimet përcaktonte që një komision do të ishte përgjegjës për caktimin e gjurmës së këtij kufiri në përputhje me direktivat e përgjithshme të cilat tregohen në vetë tekstin e vendimit. Beogradi, duke pranuar me keqardhje<sup>16</sup> vendimet e 9 nëntorit 1921, mbajti të hapura disa çështje kufitare, më të ndërlikuara se ato midis Greqisë dhe Shqipërisë. Më e diskutueshmja nga këto çështje ishte ajo e njohur e Manastirit të Shën Naumit, e cila u debatua gjatë midis viteve 1922-1924 në forume të larta ndërkombëtare<sup>17</sup>.

Një Komision Hetimor i dërguar nga Lidhja e Kombeve në Shqipëri raportoi më 18 janar 1922 për vështirësitë që kishin lindur në lidhje me vijën e kufirit shqiptar, ndër të tjera në zonën e Manastirit të Shën Naumit, ku gjendet një manastir historik në jug të liqenit të Ohrit. Më vonë, kur Komisioni i Kufirit iu desh të merrej me caktimin e kufirit në rajonin e Shën Naumit, në mendjet e disa komisionarëve lindi një dyshim për interpretimin që do t'u bëhej termave të Protokollit të Londrës: "deri në Shën Naum"<sup>18</sup>; A ishte qëllimi i autorëve të Protokollit të vitit 1913 për t'ia atribuuar Shën Naumin Shqipërisë apo Serbisë?

15. AMAE, Correspondance Politique et Commerciale 1914-19140, Albanie 1918-1929, vëll 73, Délimitation de l'Albanie, VIII. Shih edhe Puto, *Çështja shqiptare*, dok. 48, 352-361.

16. Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, (Tiranë: "Tirana", 1992), 207-208.

17. Puto, *Historia diplomatike*, 336.

18. *Idem*.

Çështja ishte e rëndësishme sepse, Manastiri i Shën Naumit, është i lidhur me një trashëgimi fetare që e bën atë një vend pelegrinazhi për të gjithë rajonin, si për shqiptarët dhe për sllavët e jugut; por manastiri në vetvete është shumë modest me gjithë vjetërsinë e tij: në atë kohë shërbesat fetare aty bëheshin vetëm nga dy murgj, njëri në gjuhën shqipe tjetri në gjuhën serbe, të cilët për më tepër ishin dërguar aty nga vetë autoritetet jugosllave.

Qeveria britanike e shtroi këtë çështje të vështirë<sup>19</sup> në Konferencën e Ambasadorëve. Anëtarët e Komisionit të Kufijve ia përcollën kësaj konference mendimet e tyre të arsyetuara. Komisioneri britanik interpretoi, me disa hezitime, Protokollin e Londrës si një dhënie e Shën Naumit Serbisë, por etnikisht, gjeografikisht dhe strategjikisht ai mendoi që Shën Naumi duhet t'i lihej Shqipërisë. Komisioneri francez dhe komisioneri italian ndanin të njëjtën ndjenjë si kolegu i tyre britanik dhe ishin në favor të dhënies së Manastirit Shqipërisë<sup>20</sup>. Komisionerët e Fuqive të interesuara (Jugosllavia dhe Shqipëria) kishin, sigurisht, secili prej tyre një mendim të ndryshëm; Me përjashtim të mendimit të komisionarit shqiptar, asnjë nga dokumentet e paraqitura në Konferencë nuk insistonte për interesat morale dhe fetare që viheshin në pikëpyetje nga vendimi që do të merrej.

Ishte e vështirë të përcaktoheshin qëllimet e autorëve të Protokollit të Londrës të vitit 1913, sepse ata nuk kishin lënë procesverbale të rregullt, as një hartë zyrtare që tregonte trasenë që kishin zgjedhur. Në këto kushte, Konferenca e Ambasadorëve duhej të vendoste. Duke marrë parasysh sidomos argumentet etnike dhe ekonomike të formuluar nga anëtarët e Komisionit të Kufijve, ajo vendosi më 6 dhjetor 1922 për ribashkimin e manastirit të Shën-Naumit me Shqipërinë<sup>21</sup>.

19. AMAE, Corresp. Pol. Com. 1914-1940, Albanie 1918-1929, vëll. 71, V, Société des Nations, Frontière albanaise dans la région de Saint-Naoum; Note sur les délibérations de la Conférence des ambassadeurs au sujet de l'attribution du monastère de St-Naoum, c. 293. M. 94. 1924. VII, note du 27 septembre 1922.

20. *Ibid.*, Lettre du 5 novembre 1922.

21. AMAE, Corresp. Pol. Com. 1914-1940, Albanie 1918-1929, vëll. 71, 72.

Qeveria jugosllave nuk reagoi dhe protestoi vetëm 5 muaj më vonë, 27 Mars 1923, sepse po kalonte një nga krizat e saj të shpeshta të brendshme dhe ishte e nevojshme të kërkonin nëpër arkiva për të paraqitur kundër argumente për vendimin e lartpërmendur. E mbështetur nga përfaqësuesi francez në Konferencën e Ambasadorëve, ajo bëri thirrje për një rishikim të vendimit të 6 dhjetorit. Debatet u për-collën nga instanca në instancë deri në Gjykatën e Drejtësisë të Hagës, e cila më në fund vendosi në favor të shqiptarëve, më 4 shtator 1924<sup>22</sup>.

Sidoqoftë, qeveria e Beogradit hodhi poshtë këto gjykime dhe i kërkoj qeverisë së Tiranës të lëshonte territoret e caktuara tashmë si shqiptare nga autoritetet e larta ndërkombëtare. Ky ishte një parakusht për pjesëmarrjen e Jugosllavisë në ndërhyrjen e dhjetorit 1924, e cila ishte për të përmbysur situatën politike në Shqipëri duke sjellë A. Zogun në pushtet në Tiranë. Ishte kthimi në legalitet në lidhje me ndryshimet e dhunshme politike që ndodhën në qershor 1924, të cilat sollën në pushtet një qeveri të udhëhequr nga një demokrat i arsimuar në Harvard, Peshkopi Fan Noli, "zëdhënësi për një Shqipëri republikane, moderne dhe demokratike"<sup>23</sup>.

Një figurë tjetër e rëndësishme e Shqipërisë moderne, konservatori Ahmet Zogu, i përshkruar si autoritar, shumë ambicioz dhe i palodhur, duke dashur me çdo kusht të mbante pushtetin<sup>24</sup>, u zgjodh president i republikës në janar 1925. Ai ndryshoi menjëherë kushtetutën dhe në shkurt 1925 hapi negociatat me përfaqësuesin jugosllav në Tiranë. Pas vonesave të ndryshme, u arrit një marrëveshje në 6 gusht 1925 për korrigjimin e kufijve, e lidhur kjo me një propozim të Konferencës së Ambasadorëve, duke lënë manastirin e Shën-Naumit përfundimisht në anën jugosllave. Ky propozim u miratua nga Parlamenti Shqiptar në 14 tetor 1925.

22. AMAE, Corresp. Pol. Com. 1914-1940, Albanie 1918-29, vëll. 72, VI, Publications de la Cour Permanente de Justice Internationale, Série B – N° 9, Affaire du Monastère de Saint Naoum.

23. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, 7-12.

24. Albert Mousset, *L'Albanie Devant L'Europe (1912-1929)*, (Paris: Delagrave, 1930), 48.

Ekziston një debat midis historianëve në lidhje me marrëveshjen e arritur midis kryeministrit serb Pasiç dhe Zogut, kur ky i fundit ishte një refugjat në Beograd. Opinionet janë të ndryshme, por në një pikë ato përputhen: të dy udhëheqësit kanë arritur një marrëveshje gojore<sup>25</sup>, një lloj "*gentlemen's agreement*" mbi mosmarrëveshjet territoriale midis serbëve dhe shqiptarëve. Marrëveshja u paraqit nga Zogu jo si një akt lëshimi, por si një shkëmbim territorial me qeverinë jugosllave. Ishte një lloj koncesioni i njohur si një borxh<sup>26</sup> ose shpërblim<sup>27</sup> nga ana e presidentit të ri shqiptar ndaj kujdestarëve të tij të fuqishëm në Beograd. Marrëveshja u konceptua në formën e shkëmbimit të territoreve, të cilat kishin të bënin me Vermoshin (kullota alpine në veri të Shqipërisë) dhe Shën Naumin, dy çështje të mprehta mosmarrëveshjesh midis dy vendeve.

Konferenca e Ambasadorëve, Lidhja e Kombeve dhe Gjykata e Përhershme Ndërkombëtare e Drejtësisë e kishin trajtuar nga ana e tyre çështjen e kufijve deri në korrik 1926. Ata interpretuan të gjitha aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje në një kuptim të favorshëm për Shqipërinë. U vendos që të miratohet teksti i Aktit Përfundimtar të Përcaktimit të Kufijve të Shqipërisë pas nënshkrimit në Firence të dokumentacionit përfundimtar të kufirit Serbo-Shqiptar në 26 Korrik 1926<sup>28</sup>. Nënshkrimi përfundimtar do të bëhej në Paris më 30 korrik 1926 nga përfaqësuesit e të gjitha shteteve të interesuara, Franca, Britania e Madhe, Italia, Japonia dhe përfaqësuesit e Shqipërisë, Greqisë dhe Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve, për të gjithë dokumentacionin përfundimtar të kufijve të Shqipërisë<sup>29</sup>. Këto dokumente ende sot përbëjnë dokumentet themelore ndërkombëtare në lidhje me kufijtë e Shqipërisë.

25. Austin, *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit*, 125.

26. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia*, 362.

27. Pietro Quaroni, *Valigia diplomatica*, (Milano: Garzanti, 1956), 87-88.

28. Puto, *Çështja shqiptare*, dok. 49, 361-383.

29. AMAE, Albanie 1918-1929, vëll. 74, IX. Shih, po ashtu, Roberto Almagià, *L'Albania*, (Roma: Paolo Cremonese, 1930), 164.



*Migena Leskoviku, Evgjeni Bashari*

## MINORITETET DHE MBROJTJA E TYRE NË VEPRIMTARINË E LIDHJES SË KOMBEVE

---

### MINORITIES AND THEIR PROTECTION IN THE ACTIVITY OF THE LEAGUE OF NATIONS

**ABSTRACT:** Special attention has been paid and continues to be paid to the protection of minorities, both domestically and internationally. The growing interest in the position of minorities has come as a result of their growing in numbers, nationalism, strengthening the idea of the need to protect human rights, and appreciating the fact that the protection of minorities is an important factor for the stability and unity of Europe. The issue of ensuring an effective protection of minorities became the subject of a wider international discussion after the First World War. Recognition and protection of minority rights under international law began with the League of Nations through the adoption of several "minority treaties".

The League of Nations was the first international body to establish a mechanism for the protection of minorities in the event of a conflict, in order to preserve the internal stability of states and international peace. The League of Nations exercised its function of guarantor and protection of minorities, through a procedure of reviewing petitions that could be submitted to the League Council by various minorities. But over time, it became clear that the mechanism set up by the League of Nations to respect and protect the rights of national minorities failed. This failure was evident as during this period national minorities were subjected to oppression, assimilation and expulsion. The League of Nations did not achieve its mission and failed to produce an international treaty for the protection of minorities. Experience has shown that it proved powerless even in the protection of the rights of national minorities; however, it formed the basis on which the UN and other international organizations would further operate after World War II. There is no internationally accepted definition of minorities; however, there are plenty of definitions that vary. Any definition should include objective

factors (such as the existence of a common ethnicity, language or religion) and subjective factors (including that individuals should identify themselves as members of a minority group). Some minorities have a strong sense of collective identity and recorded history; others retain only a fragmented notion of their common heritage. Likewise, this can be explained by a lack of political will as a number of states have been declared as homogeneous and unitary states, and thus fear to incite territorial claims and separatist tendencies. Minorities can serve as bridges in improving the relations between neighboring states. Albania is a country where national minorities have been recognized and enjoyed the proper legal status, as well as have been protected and respected in contrast to some other countries.

The problem of national minorities in Europe and the Balkans has been evident for a long time. The Balkan countries being part of the former multi-ethnic, multi-lingual, multi-religious and multi-cultural empires have inherited many of these common features and their traces are present even today, so this diversity makes it quite a complex environment.

Today, the question of minorities is seen as closely linked to the approach of human rights, regional and international cooperation and stability. At the heart of minority rights is the promotion and protection of their identity. Promoting and protecting their identity prevents forced assimilation and the loss of national values as part of world heritage. Therefore, positive actions are required from states to respect cultural, religious and linguistic diversity, and to recognize that minorities contribute to social cohesion of our society and its diversity, as well as friendly-neighborhood relations.

KEYWORDS: minority, League of Nations, human rights, protection of minority rights, regional and international cooperation, international treaties

---

Mbrojtjes së minoriteteve i është kushtuar dhe vijon t'i kushtohet një vëmendje e veçantë, si në nivel të brendshëm shtetëror ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Ekzistenca e pakicave etnike ndikon fuqishën në marrëdhëniet midis shteteve të rajonit. Përpjekjet e grupeve jo dominuese për të ruajtur dallimet e tyre kulturore, fetare apo etnike u shfaqën me krijimin e shteteve kombëtare në shekujt XVIII dhe XIX. Deri në shek. XIX bëhej fjalë për pakicat fetare dhe vetëm në fillim të shekullit XX u shtrua problemi i pakicave kombëtare, për të cilat



ka pasur dhe vijon të ketë debate të shumta. Njohja dhe mbrojtja e të drejtave të pakicave sipas të drejtës ndërkombëtare filloi me Lidhjen e Kombeve nëpërmjet miratimit të disa "traktateve të pakicave"<sup>1</sup>.

Gjatë krijimit të shteteve kombëtare, shpesh pakicat kombëtare ishin "pengesë" dhe për pasojë pësuan vuajtje, shpërngulje, e deri asimilim në disa vende. Kjo sjellje ndaj tyre nuk ka qenë e njëjtë në të gjitha vendet ku ka pasur pakica kombëtare. Shqipëria ka qenë vendi ku pakicat kombëtare janë njohur dhe kanë gëzuar statusin ligjor përkatës, si dhe janë mbrojtur e respektuar në dallim nga shtete të tjera.

Interesimi në rritje për pozitën e minoriteteve ka ardhur si pasojë e rritjes së numrit të tyre, e rritjes së nacionalizmit, e forcimit të idesë për nevojën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, dhe vlerësimit të faktit se mbrojtja e minoriteteve është një faktor i rëndësishëm për stabilitetin dhe unitetin e Evropës. Çështja e sigurimit të një mbrojtjeje efektive të minoriteteve u bë objekt diskutimi ndërkombëtar më të gjerë pas Luftës së Parë Botërore.

Nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht se cilat grupe përbëjnë minoritete. Shpesh theksohet se ekzistenca e një pakice është një çështje fakti dhe se çdo përkufizim duhet të përfshijë faktorë objektivë (siç është ekzistenca e një etnie, gjuhe ose feje të përbashkët) dhe faktorë subjektivë (duke përfshirë që individët duhet të identifikojnë veten si anëtarë të një pakice). Vështirësia për të arritur në një përkufizim gjerësisht të pranueshëm qëndron në shumëllojshmërinë e situatave në të cilat jetojnë minoritetet. Disa pakica kanë një ndjenjë të fortë të identitetit kolektiv dhe historisë së regjistruar; të tjerët ruajnë

---

1. Këto ishin një tërësi traktatesh që u nënshkruan me përfundimin e Konferencës së Paqes në Paris (1919) me përfundimin e Luftës I Botërore dhe humbjen e Gjermanisë në këtë luftë, e që solli shpërbërjen e perandorisë Austro-Hungareze dhe krijimin e disa shteteve të reja në Evropë, përcaktimin e kufijve territorialë të këtyre shteteve; traktati mes Aleatëve dhe Perandorisë Osmane e cila me shpërbërjen e saj po ashtu krijoi ndryshime në hartën politike të Evropës dhe njohjes së shtetit të ri të Republikës së Turqisë që u përmyll me Traktatin e Lozanës (1923). Për më gjerë, shih Zejnulla Gruda, *Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut I*, (Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, 2000), 134-135.

vetëm një nocion të fragmentuar të trashëgimisë së tyre të përbashkët<sup>2</sup>. Po ashtu, kjo mund të shpjegohet edhe me mungesën e vullnetit politik pasi një numër shtetesh janë deklaruar shtete homogjene dhe unitare, dhe i druhen faktit se mos definicioni i termit pakicë mund të nxisë pretendime territoriale dhe tendenca separatiste.

Pavarësisht mungesës së një përkufizimi të qartë përpjekjet nuk kanë reshtur dhe përkufizimet për termin pakicë (minoritet) janë të shumta dhe variojnë. Minoritetet mund të shërbejnë si ura lidhëse në marrëdhëniet ndërmjet shteteve fqinjë ose shkak mosmarrëveshesh e konfliktesh ndërmjet shtetit ku jetojnë dhe shtetit amë.

### **Lidhja e Kombeve, parimi i vetvendosjes dhe minoritetet**

Presidenti amerikan Wilson në mesazhin me 14 pika drejtuar Kongresit amerikan, në fillim të muajit janar 1918, i referohej dhe evokonte parimin e kombësisë si baza për rregullimin paqësor të marrëdhënieve, pasi të përfundonte Lufta I Botërore. Në Konferencën e Paqes në Paris (1919) ai do ta ripohonte këtë qëndrim, duke përvijuar kështu një platformë që do të përbënte linjën kryesore të politikës së jashtme të SHBA-së në këtë periudhë. Ndaj, ajo solli një qasje të re në diplomacinë e kohës, duke iu referuar kështu parimit të së drejtës së popujve për vetvendosje si parim bazë<sup>3</sup>.

Vetëvendosja u konsiderua një nga parimet e suksesshme në mënyrën dhe legjitimitetin e formimit të shteteve në Evropë pas shpërbërjes së perandorive të kohës. Ky parim rezultoi i suksesshëm për shtete të tilla, si: Çekosllovakia, Finlanda apo Polonia. Por, gjithashtu, duhet theksuar se shpërbërja e këtyre perandorive la më tepër se 30 milionë njerëz pa një shtet të tyre, dhe ishin këta që do të formonin pakicat e reja<sup>4</sup>. Kështu, traktatet e paqes së pas Luftës I Botërore duket se nuk e zgjidhën problemin etnik/kombëtar, por i përfshinë këto

---

2. *Minority Rights: International Standards and Guidance for Implementation*, HR/PUB/10/3, (Geneva: United Nations, 2010), 2.

3. Artan Puto, *Historia diplomatike e çështjes Shqiptare 1878-1926*, (Tiranë: Dudaj, 2010), 286.

4. Kalevi J. Holsti, *Shteti, lufta dhe gjendja e luftës*, (Tiranë: AIIS, 2008), 59.

pakica në shtetet e reja që u formuan. Këto shtete tashmë vendosën autoritetin mbi pakica etnike që karakterizoheshin nga larmia etnike, gjuhësore, kulturore dhe fetare<sup>5</sup>.

Pakti i Lidhjes së Kombeve që u negociua dhe u miratua në Konferencën e Paqes në Paris (1919), shihej si një pjesë integrale e Traktatit të Paqes të Versajës<sup>6</sup> dhe krijimi i një organizate që ishte shtylla kryesore e strukturës së paqes. Sipas preambulës së Paktit, qëllimi i organizatës së re ishte "të promovonte bashkëpunimin ndërkombëtar dhe të arrinte paqen dhe sigurinë ndërkombëtare".

Lufta e Parë Botërore çoi në ndryshime të gjera kufijsh në Evropë. Si pasojë, u krijuan një sërë pakicash të reja. Për t'u siguruar që këto minoritete të trajtoheshin siç duhet dhe për të shmangur krijimin e konflikteve të reja, disa shtete duhej të merrnin detyrime për mbrojtjen e këtyre pakicave. I gjithë sistemi u vu nën garancinë e Lidhjes së Kombeve<sup>7</sup>. U krijua kështu baza për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që më pas do të konturohej plotësisht pas Luftës së Dytë Botërore. Me dështimin e këtij sistemi, interesi për rregullat e mbrojtjes së pakicave të Lidhjes sikur u venit përkohësisht. Kur filloi sërish interesimi për mbrojtjen e minoriteteve, kësaj radhe në nivel të OKB-së, dukej se ishte gjetur një bazë krejtësisht e re dhe mbi disa parime dhe garanci në një kontekst të ri ndërkombëtar.

Megjithatë, gjatë negociatave të paqes të pasluftës u bë e qartë se një rivizitim i kufijve evropianë sipas parimit të kombësisë nuk ishte i realizueshëm. Jo vetëm që kombësitë e ndryshme ishin shumë të përziera sa që nuk mund të gjendeshin elemente objektive për vija të qarta kufitare, por koncepti i përkatësisë kombëtare u pa se ndikohej shumë nga konsideratat subjektive dhe ishte i hapur ndaj përkufizimeve kontradiktore. Për më tepër, negociatat e paqes u karakterizuan shumë

---

5. Holsti, *Shteti, lufta*, 59.

6. Peter Hilpold, "The League of Nations and the Protection of Minorities – Rediscovering a Great Experiment", në: *Max Planck Yearbook of United Nations Law Online*, 17/1 (2013): 87-124. doi: <https://doi.org/10.1163/18757413-90000081>

7. *Idem*.

më tepër nga parimi tradicional "*vae victis*" - sesa nga ndjekja për të sjellë në jetë një parim të ri të vetëvendosjes objektivisht të drejtë<sup>8</sup>.

Lidhja e Kombeve ishte organizmi i parë në rrafshin ndërkombëtar, që krijoi një mekanizëm për mbrojtjen e minoriteteve. Qëllimi i sistemit të krijuar nga Lidhja e Kombeve nuk pretendonte t'i zgjidhte përfundimisht problemet që mund të lindnin në marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe minoriteteve. Qëllimi ishte të krijoheshin mekanizma për të mbrojtur këto minoritete në rast konflikti, në mënyrë që të ruhej stabiliteti i brendshëm i shteteve dhe paqja ndërkombëtare.

Baza formale e sistemit të Lidhjes për mbrojtjen ndërkombëtare të pakicave kombëtare përbëhej nga një tërësi instrumentesh me anë të të cilave shtete të veçanta pranonin dispozitat në lidhje me trajtimin e grupeve minoritare dhe njohjen e Lidhjes së Kombeve si garantues. Këto instrumente morën formë të ndryshme. Një numër marrëveshesh dypalëshe për pakicat u lidhën menjëherë pas Konferencës së Paqes, por ato ishin të jashtme për sistemin e pakicave të Lidhjes<sup>9</sup>.

Kështu, që nga maji 1919 filloi përgatitja e dispozitave për pakicat që do të përfshiheshin në traktatet e paqes. Detyrime në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve iu ngarkuan shteteve humbëse në Luftën I Botërore, si: Austria, Hungaria, Bullgaria dhe Turqia; disa shteteve të sapokrijuara si Polonia, Çekosllovakia, apo shteteve që kishin marrë dhe zgjeruar territoret e tyre, si: Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Greqia, Rumania, si dhe shtetet që shfaqnin interes të pranoheshin në Lidhjen e Kombeve, siç ishte rasti i Shqipërisë, Lituanisë, Estonisë, Letonisë që u detyruan të bëjnë deklarata në lidhje me trajtimin e pakicave të tyre respektive<sup>10</sup>. Pas luftës, shtetet e reja evropiane si: Austria, Bullgaria, Çekosllovakia, Greqia, Hungaria, Polonia, Rumania dhe Jugosllavia u detyruan të nënshkruanin marrëveshje që u jepnin barazi fetare, sociale dhe politike pakicave të tyre, pavarësisht nëse

8. Hilpold, "The League of Nations", 87-124.

9. Claude, Jr., Inis L.. *National Minorities: An International Problem*, vol 6 in the series Harvard Political Studies, (Cambridge, MA and London, England: Harvard University Press, 2013). <https://doi.org/10.4159/harvard.9780674494275>

10. Holsti, *Shteti, lufta*, 61.

ato ishin mundur në Luftën I Botërore ose jo. Për të mbikëqyrur këto marrëveshje, Lidhja e Kombeve ngriti Seksionin e Pakicave, një gjetje unike në atë kohë. Përgjegjësitë e tij përfshinin shqyrtimin e peticioneve të ardhura, kërkimin e përgjigjeve nga shtetet e akuzuara, përcjelljen e rasteve të "Komiteti i të Treve" një komitet ad-hoc, dhe/ose hetimin e çështjeve<sup>11</sup>.

Ndërmjet viteve 1920 dhe 1939, 883 peticione iu dorëzuan Seksionit të Minoriteteve. Vetëm 16 nga 395 peticionet e konsideruara si të pranueshme arritën të Këshilli dhe nga këto 16, Këshilli me shumë ngurrim dënoi shtetin e akuzuar për keqtrajtim të minoritetit vetëm në katër raste<sup>12</sup>.

Si në shumë fusha të tjera, Lidhja e Kombeve nuk e arriti misionin e saj dhe eksperiencia tregoi se u tregua e pafuqishme edhe në mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare dhe ajo dështoi, por krijoi bazën mbi të cilën do të vepronte më tej OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare pas Luftës II Botërore.

### **Anëtarësimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe politika e shtetit shqiptar ndaj pakicave kombëtare. Rasti i shkollave të minoritetit grek**

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore, çështja shqiptare u trajtua në Konferencën e Paqes në Paris në 1919, ku vlen të përmendet angazhimi diplomatik shqiptar për rimëkëmbjen e shtetit shqiptar dhe shpëtimin e saj nga copëtimi me përfundimin e kësaj lufte. Në seancat e ndryshme të zhvilluara për këtë qëllim, vlen të përmendet p.sh. ndërhyrja e përfaqësuesve të delegacionit shqiptar Mihal Turtulli dhe Mehmet Konica, të cilët në përgjigje të pyetjes së bërë se cilat do të ishin garancitë për popullsitë joshqiptare të Epirit të Veriut apo të Shqipërisë së Jugut, duke iu referuar kështu popullsisë së minoriteteve që mbeteshin brenda kufijve të shtetit shqiptar, u përgjigjën se ‘do të

11. United Nations Geneva - The League Of Nations, konsultuar në muajin prill 2022, <https://www.ungeneva.org/en/history/league-of-nations>.

12. *Idem*.

*jepeshin të gjitha garancitë që vendet e qytetëruara u japin minoriteteve të tyre*<sup>13</sup>. Kjo tregonte angazhimin e shtetit shqiptar për të njohur dhe respektuar minoritetet në territorin e shtetit shqiptar, gjë që tregonte një qëndrim pozitiv në respekt të parimeve dhe garancive të njohura në atë kohë për minoritetet. Kështu, kjo deklaratë mund të konsiderohet si akti i parë i angazhimit të shtetit shqiptar në respektimin e minoriteteve në periudhën e pas Luftës së Parë Botërore<sup>14</sup>.

Në planin juridik, angazhimi i Shqipërisë në lidhje me regjimin e minoriteteve dhe mbrojtjen e tyre, lidhet me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920. Në 2 tetor 1921, Shqipëria bëri një deklaratë të posaçme para Këshillit të Lidhjes, me anë të së cilës mori përsipër të respektonte të drejtat e pakicave kombëtare brenda territorit të saj në përputhje me dispozitat e traktateve të paqes të lidhura pas Luftës I Botërore. Vendimet e 9 nëntor 2021 të marra nga Konferenca e Ambasadorëve, përbënin zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare, pas vështirësive dhe përpjekjeve të mëdha të më shumë se dy vjetëve pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Përmes këtyre vendimeve u sqarua përfundimisht pozita dhe statusi i Shqipërisë dhe qeverisë së saj, duke i dhënë kështu mundësinë që të diltë dhe vepronte si subjekt në marrëdhëniet ndërkombëtare<sup>15</sup>.

Kërkesa për anëtarësim në Lidhjen e Kombeve shqyrtohej edhe nga pikëpamja e garancive të shteteve kërkuese për mënyrën se si trajtonin minoritetet brenda kufijve territorialë të tyre. Në dukje, kjo ishte një kërkesë pozitive e që ofronte garanci në parim për respektimin e minoriteteve, por gjithsesi nuk rezultoi plotësisht e suksesshme. Paqja shpejt u prish dhe konfliktet do të rishfaqeshin, fillimisht me intensitet më të ulët dhe më pas do të shpërthenin fuqishëm e do të çonin në shkelje flagrante të të drejtave të pakicave nga disa shtete, si dhe shkelje të parimit të vetvendosjes<sup>16</sup>, aq shumë i popullarizuar nga presidenti Wilson dhe Lidhja e Kombeve.

---

13. Puto, *Historia diplomatike*, 274.

14. *Idem*.

15. Puto, *Historia diplomatike*, 330-333.

16. Holsti, *Shteti, lufta*, 64.

Lidhja e Kombeve, megjithë përpjekjet dhe propozime të parashtruara nga shtete të caktuara, nuk arriti të prodhonte një traktat ndërkombëtar për mbrojtjen e minoriteteve. Ajo e ushtronte funksionin e saj të garantit dhe mbrojtjes së minoriteteve, përmes një procedure të shqyrtimit të peticioneve që mund të paraqiteshin pranë Këshillit të Lidhjes nga minoritete të ndryshme. Brenda Këshillit të Lidhjes ishte ngritur një komitet i posaçëm për shqyrtimin e tyre. Në disa raste edhe Gjykata Permanente e Drejtësisë Ndërkombëtare mund të jepte mendime konsultative për çështje juridike që lidheshin me minoritetet<sup>17</sup>. Një rast i tillë i parashtruar pranë Gjykatës Permanente i paraqitur në 1935, lidhej me çështjen e shkollave minoritare në Shqipëri<sup>18</sup>. Ky minoritet, i përkrahur edhe nga qeveria greke, iu drejtua Gjykatës Permanente të Drejtësisë Ndërkombëtare për shkelje të të drejtave të tyre të arsimimit në gjuhën greke si rezultat i akteve të nxjerra nga qeveria shqiptare, duke i kujtuar kështu shtetit shqiptar detyrimin për respektimin e angazhimeve të marra në 1921 përpara Lidhjes së Kombeve, në lidhje me respektimin e pakicave në territorin e tij.

Më 15 dhjetor 1920, Asambleja e Lidhjes së Kombeve u kërkoj disa shteteve, përfshirë Shqipërinë, që në rast të pranimit të tyre në Lidhjen e Kombeve, të merrnin masat e nevojshme për të zbatuar parimet e të ashtuquajturave 'traktate të pakicave', prototipi i të cilit ishte ai i përfunduar më 28 qershor 1919, midis Fuqive Aleate dhe të Asociuara dhe Polonisë; këto shtete u ftuan në të njëjtën kohë të rregullonin me Këshillin detajet e nevojshme për zbatimin e këtij detyrimi që buronte nga këto dispozita traktati<sup>19</sup>.

Në vitin 1930 u ndërmorën hapa për sekularizimin e arsimit në Shqipëri dhe në vitin 1933 shfuqizimi i shkollave private u plotësua me anë të një amendamenti të Kushtetutës së vitit 1928, i cili më tej

---

17. Arben Puto, *E drejta ndërkombëtare publike*, (Tiranë: Albin, 2008), 235-236.

18. *Idem*.

19. "Minority Schools in Albania, Advisory Opinion of 6 April 1935 (Series A/B, No. 64)", në: *Summaries of Judgments, Advisory opinions and orders of the Permanent Court of international Justice*, ST/LEG/SER.F/1/Add.4, United Nations Publications Sales No. E.12.V.18, (United Nations, New York, 2012), 348-360.

përmbante klauzolën e mëposhtme: "Mësimi dhe arsimimi i lëndëve shqipe i rezervohet shtetit dhe ato do të jepen në shkollat shtetërore. Arsimi fillor është i detyrueshëm për të gjithë shtetasit shqiptarë dhe do të jepet pa pagesë. Shkollat private të të gjitha kategorive që aktualisht janë në funksion do të mbyllen." Kjo bëri që minoriteti grek të reagoonte dhe rasti të paraqitej para Gjykatës Permanente.

Në *Opinionin e saj konsultativ*, kjo Gjykatë ndër të tjera theksonte se deklarata e bërë nga Shqipëria (në 1921) ndiqte nga afër klauzolat përkatëse të të ashtuquajturve 'traktateve të pakicave', veçanërisht të Traktatit me Poloninë, por ndryshonte prej tyre në disa aspekte. Kështu, në veçanti, neni 1 i Deklaratës, përveç dispozitës së zakonshme për epërsinë e dispozitave të pakicës, parashikonte se asnjë akt shtetëror nuk do të mbizotërojë mbi to "tani apo në të ardhmen". Po ashtu, paragrafi 2 i nenit 5 të Deklaratës, sipas të cilit Shqipëria duhet t'i paraqesë Këshillit brenda gjashtë muajve informacion të detajuar në lidhje me statusin ligjor të pakicave në territorin e saj, nuk gjendej në Traktatin me Poloninë, dhe paragrafi 1 i të njëjtit nen fliste për "të drejtën e barabartë" të pakicës për të "mbajtur/ruajtur, menaxhuar dhe kontrolluar" institucione të caktuara ose për t'i "themeluar" ato në të ardhmen; ndërsa Traktati polak përmendte vetëm të drejtën për të "themeluar, menaxhuar dhe kontrolluar"<sup>20</sup>.

Në përputhje me angazhimin për të paraqitur informacionin e dhënë në paragrafin 2 të nenit 5 të Deklaratës, Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më 7 korrik 1922, i dërgoi Sekretarit të Përgjithshëm një letër ku ndër të tjera thuhej se komunitetet shqiptare, përfshirë këtu edhe komunitetin ortodoks kishte "të drejta të plota për të themeluar shkolla të kategorive të ndryshme që mësonin në gjuhën e njerëzve mbi të cilët krerët e tyre fetarë kanë të drejta juridiksioni". Këshilli i vuri në dukje këto deklarata. Nga të dhënat e dorëzuara në Gjykatë rezultonte gjithashtu se para 2 tetorit 1921 ekzistonte liri e

---

20. "Minority Schools in Albania", 348-360.



plotë për ngritjen me iniciativë private të institucioneve arsimore që përdornin gjuhën greke<sup>21</sup>.

Gjykata vlerësoi se paragrafi 1 i nenit 5 të Deklaratës së 2 tetorit 1921, u siguronte shtetasve shqiptarë të pakicave racore, fetare ose gjuhësore të drejtën për të mbajtur, menaxhuar dhe kontrolluar me shpenzimet e tyre, ose për të krijuar në të ardhmen, institucione bamirëse, fetare e shoqërore, shkolla dhe institucione të tjera arsimore, me të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre dhe për të ushtruar lirisht fenë e tyre në të, dhe për rrjedhojë, hodhi poshtë pretendimet e Qeverisë Shqiptare<sup>22</sup>.

Në këto kushte dhe nën presionin e Lidhjes së Kombeve, qeveria shqiptare do të raportonte në Këshillin e Lidhjes se ajo kishte bërë ndryshime në legjislacionin e saj dhe pikërisht në dekretligjin mbi shkollat, të aprovuar në 1936. Qeveria Mbretërore shpalli një ligj, sipas të cilit çdo shtetas shqiptar, qoftë fizik apo juridik, ka të drejtë të hapë dhe të mbajë shkolla. Kjo kategori përfshinte edhe bashkësitë fetare.

Pas kësaj përgjigje, Këshilli e shpalli të mbyllur shqyrtimin e çështjes dhe i përcolli Qeverisë Shqiptare vlerësimin e saj për vullnetin e mirë që ajo kishte shfaqur<sup>23</sup>.

## Përfundime

Mund të themi se problemi i pakicave kombëtare në Evropë dhe në Ballkan ka qenë evident për një kohë të gjatë. Vendet e Ballkanit duke qenë pjesë e perandorive të dikurshme multi-etnike, multi-gjuhësore, multi-fetare dhe multi-kulturore kanë trashëguar shumë nga këto tipare të përbashkëta madje gjurmët e tyre janë të pranishme edhe në ditët tona, prandaj kjo shumëllojshmëri e bën këtë ambient mjaft kompleks. Në vitet e pas Luftës së Parë Botërore, iu kushtua vëmendje më e madhe zgjidhjes së problemit të pakicave kombëtare, si faktor që do të shmangte rrezikun e luftës në të ardhmen. Po ashtu, që me

---

21. "Minority Schools in Albania", 348-360.

22. *Idem*.

23. *Idem*.

planin Wilson, doli në pah parimi i vetvendosjes së popujve, gjë që u pasqyrua edhe në qasjen e adoptuar nga Lidhja e Kombeve. Problemit të pakicave kombëtare i duhej dhënë një zgjidhje e tillë që në të ardhmen të shmangej si keqtrajtimi i këtyre pakicave, ashtu edhe përdorimi i të drejtave të pakicave për t'u përdorur si burim konflikti mes shteteve dhe pretekst për luftëra.

Në këtë frymë, edhe Shqipëria me rastin e kërkesës për anëtarësim, mori angazhime pranë Lidhjes së Kombeve për të mbrojtur të drejtat e pakicave kombëtare që gjendeshin brenda territorit të saj.

Nga njëra anë, me sistemin e krijuar nga Lidhja e Kombeve, u rrit mundësia e mbrojtjes së pakicave, ndërsa në anën tjetër Lidhja e Kombeve doli si garantuese për palët pjesëmarrëse për mbrojtjen e pakicave. Por me kalimin e kohës, qartazi u bë evidente se mekanizmi i ngritur nga Lidhja e Kombeve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, dështoi. Ky dështim ishte evident pasi gjatë kësaj periudhe pakicat kombëtare iu nënshtruan, shtypjes, asimilimit dhe dëbimit.

Sot kërkohet që pakicave t'u jepen mundësi të tilla që të afirmohen e të luajnë rol në jetën shoqërore e politike të vendit. Problemi i pakicave kombëtare shihet i lidhur ngushtë me problemin e të drejtave të njeriut dhe me problemin e bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal e ndërkombëtar.

Në qendër të të drejtave të minoriteteve janë promovimi dhe mbrojtja e identitetit të tyre. Promovimi dhe mbrojtja e identitetit të tyre parandalon asimilimin e detyruar dhe humbjen e vlerave kombëtare si pjesë e trashëgimisë botërore. Të drejtat e pakicave kanë të bëjnë me sigurimin e respektimit të identiteteve të veçanta, ndërkohë që garantojnë që çdo trajtim i ndryshëm ndaj grupeve ose personave që u përkasin grupeve të tilla nuk maskon praktikën dhe politikat diskriminuese. Prandaj, kërkohet veprim pozitiv nga shtetet për të respektuar diversitetin kulturor, fetar dhe gjuhësor, dhe të pranohet se pakicat pasurojnë shoqërinë përmes këtij diversiteti.

*Enriketa Pandelejmoni (Papa)*

JANUSI ROMAK NË POLITIKAT KOLONIALISTE DHE  
MODERNISTE TË ITALISË NDAJ SHTETIT TË RI SHQIPTAR  
(1914-1943)<sup>1</sup>

---

ROMAN JANUS IN THE MODERNIST AND COLONIAL POLICIES OF ITALY  
TOWARDS THE NEW ALBANIAN STATE 1914-1943

**ABSTRACT:** This paper focuses on the main features of Italian policy in Albania during 1914-1943. My aim is to investigate the Italian interventionist policies in Albania, specifically in the context of modernization and colonial approaches related to the concepts of emancipation, development, military control that Italy aimed in Albania. My interest lays in analysing how Italian interventionism in the Albania was shaped by a civilisation and modernization mission. Following the self-proclaimed Independence of Albania (1912) Italy had helped the process of secession of the Albanian territories of the Ottoman Empire from the High Porte, and together with Austria-Hungary helped in the Conference of London (1913-1914) the process of the international recognition of the new Albanian state internationally. Pragmatism in Italian foreign policy in the Mediterranean, as well as efforts to compete with the other Great Powers in the Balkans, were among the main goals of Italian expansionist policy until Benito Mussolini's March on Rome in 1922. Italy's colonialist policy in Albania, corresponds to the so-called liberal period of Italian colonialism, where the first Italian investments in the newly formed Albanian state begin (1912). The second phase corresponds to Mussolini's rule in Italy till 1943, where Italian expansionist policy would already be characterized by fascist vision of the world, fascist imperial space and its use

---

1. Ky artikull, në një pjesë të tij, përmban materiale të trajtuar në kumtesën time, të mbajtur në 18 dhjetor 2020, gjatë konferencës "Shqipëria: Marrëdhëniet e saj me Lidhjen e Kombeve dhe OKB-në", organizuar nga Departamenti i Historisë, i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, i Universitetit të Tiranës.

in the interest of reviving the former glory and the economic valorisation of its imperial communities that fascist Rome embodied.

KEYWORDS: Albania, Italy, Fascism, Colonialism, Italy, Modernization

---

Në mitologjinë romake, Janusi ishte perëndia me dy fytyra, të pozicionuara me drejtime të kundërta, që simbolizonte të kaluarën dhe të ardhmen. Janusi konsiderohej si perëndia e fillimit, e vendimarrjeve dhe e zgjedhjeve. Duke marrë simbolikën e tij të kontradiktave, në këtë artikull do të shtjelloj politikën e shtetit italian përkundrejt shtetit të sapoformuar shqiptar deri më 1943. Simbolika e Janusit përceptohet si kontraste të politikës kolonialiste të Italisë në fillim të shek. XX dhe diskursit të modernitetit, e inkadruar në qasjet kolonialiste dhe postkolonialiste të marrëdhënieve midis qendrës dhe periferisë, gjysëmperiferisë, si dhe qëndrimeve eurocentrike mbi Evropën e zhvilluar dhe rajoneve të saj të prapambetura.<sup>2</sup> Një vëmendje e veçantë do t'i dedikohet edhe qasjes moderniste nga kritikët e kolonializmit të vonë italian,<sup>3</sup> që shoqërojnë debatet mbi modernitetin si një fenomen eurocentrist, tërësisht evropian, i lidhur ngushtësisht me konceptet e

---

2. Immanuel Wallerstein, *Historical Capitalism*, (London: Verso, 1984); Hans-Heinrich Nolte, "The Position of Eastern Europe in the International System in Early Modern Times", *Review* 6/1 (1982): 25-84; Larry Wolff, *Inventing Eastern Europe: The Map of Civilization on the Mind of the Enlightenment*. Stanford: Stanford University Press, 1995; Maria N. Todorova, *Imagining the Balkans*, New York: Oxford University Press, 1997; Anibal Quijano dhe Michael Ennis, "Coloniality of Power, Eurocentrism, and Latin America", *Nepantla: Views from South* 1, no. 3 (2000): 533-580; Edward W. Said, *Orientalism: Western Conceptions of the Orient*. London: Penguin. 2003; Gayatri Spivak, Chakravorty, "Can the Subaltern Speak?" në Cary Nelson dhe Lawrence Grossberg (eds), *Marxism and the Interpretation of Culture*, (Urbana: University of Illinois Press, 1988), 271-313; Bhabha, Homi. *The Location of Culture*, London and New York: Routledge, 2004.

3. Angelo Del Boca, ed., *Le guerre coloniali del fascismo*, Roma & Bari: Laterza, 1991; Richard J. B. Bosworth, *Italy, the Least of the Great Powers: Italian Foreign Policy Before the First World War*, Cambridge: Cambridge University Press, 1979; Ruth Ben-Ghiat, *Fascist Modernities. Italy, 1922-1945*. Berkley, Los Angeles,

emancipimit, zhvillimit, formimit të kombshetit, kontrollit ushtarak, apo obligimit për të "emancipuar të tjerët (botën joevropiane).

Qasja ime ndaj politikës së Italisë do të analizohet edhe nga retorika moderniste e sqaruar më së miri edhe nga teoria mbi modernitetin e Anthony Giddens, sipas të cilit moderniteti është një model i organizimit social dhe i jetesës që lindi në Evropë në shek XVII, por që u përhap pak a shumë në të gjithë botën, duke u bërë një model universal.<sup>4</sup> Pikërisht nën petkun e këtij universaliteti fuqitë koloniste evropiane ndërmorrën politikën e tyre "shpëtimtare" ndaj vendeve të pazhvilluara me qëllim imponimin e civilizimit, modernizimit, zhvillimit, progresit. Në rastin e Italisë dhe politikave të saj kolonialiste në Shqipëri, ajo ndahet në dy periudha. Periudha liberale e kolonializmit italian, kur fillojnë dhe investimet e para italiane në shtetin e sapoformuar shqiptar (1912). Italia kishte ndihmuar procesin e shpëputjes së territoreve shqiptare të Perandorisë Osmane nga Porta e Lartë, si dhe ishte ndër Fuqitë e Mëdha që për arsye pragmatiste, bashkë me Austro-Hungarinë ndihmuan në përshpejtimin e njohjes ndërkombëtare të shtetit të ri shqiptar në arenën ndërkombëtare. Pragmaticiteti në politikën e jashtme italiane në Mesdhe, si dhe përpjekjet për të konkurruar Fuqitë e tjera të Mëdha në Ballkan, ishin ndër synimet kryesore të politikës ekspansioniste italiane deri në Marshimin mbi Romë të Benito Musolinit, më 1922.

Prej 1922-1943 Italia hyn në periudhën fashiste të regjimit, ku politika ekspansioniste italiane do të karakterizohej tashmë edhe nga vizioni fashist mbi botën, hapësirën imperiale fashiste dhe shfrytëzimin e saj në interes të ringjalljes së lavdisë së dikurshme, që Roma fashiste mishëronte. Kësaj periudhe do t'i kushtohet një analizë e veçantë për të hedhur dritë mbi të ashtuquajturin kolonializëm fashist dhe interesat e tij mbi Shqipërinë.

---

London: University of California Press, 2004, Ruth Ben-Ghiat & Mia Fuller eds. Italian Colonialism, New York: Palgrave Macmillan, 2015.

4. Anthony Giddens, *The Consequences of Modernity*, (Cambridge: Polity Press, 1990).

## **Periudha liberale dhe politika ekspansioniste të Italisë deri në Luftën e Parë Botërore**

Shteti italian qysh me bashkimin e tij në 1870 shfaq politikë ekspansioniste, duke arritur protektorate jashtë Gadishullit Apenin, si në rastin e protektoratit mbi Eritrenë (Assab dhe Massawa 1890), luftën italo-turke mbi Libinë (1911-1912), pushtimet në Afrikë apo edhe në ndërhyrjen italiane dhe pushtimet e saj në Mesdhe gjatë Luftës së Parë Botërore. Ambiciet koloniale të Italisë mbi territoret shqiptare e kanë zanafillën, që gjatë periudhës, kur këto ishin pjesë e provincave evropiane të Perandorisë Osmane. Një ndër promovuesit e politikave ekspansioniste dhe kolonialiste të Italisë në kapërcyell të shek XX ishte Baroni Antonino San Giuliani<sup>5</sup>, i cili në Letrat e tij mbi Shqipërinë (*Lettere sul l'Albania 1903*), të shkruara mbi përshtypjet e tij përgjatë udhëtimit në provincën shqiptare të Perandorisë Osmane, shpaloste rëndësinë e politikës italiane përgjatë Adriatikut. Edhe kur u bë Ministër i Jashtëm (1910-1914) më pas, San Giuliani punoi fuqishëm në dobi të interesave italiane në Shqipëri. I ndikuar disi nga teoritë mbi darvinizmin social të fundshekullit të XIX-të, ai besonte se Italia duhet të ishte e denjë të garonte me fuqitë e tjera të mëdha ekonomike të Evropës, dhe të mos rrinte në vendin e fundit, përsa i përket zhvillimit ekonomik, fuqisë financiare dhe garës për pushtet në kontinent. Prandaj për të, përpjekja për prosperitet duhet të ishte në plan të parë ndër prioritetet e politikës së jashtme italiane, e cila konkurronte për pushtime koloniale në këto kohë.<sup>6</sup>

Nga kjo perspektivë duhen parë edhe ndërhyrjet italiane, në kuadër edhe të rivalitetit me Austro-Hungarinë në tokat shqiptare. Që kur këto toka ishin në Perandorinë Osmane, shteti italian u aktivizua fuqishëm në projektimin e disa ndërhyrjeve dhe investimeve për të

---

5. Politikan italian, i cili ka pasur disa poste ministrish në qeveritë italiane të fillimshekullit XX.

6. Richard J. B. Bosworth, "The Albanian Forests of Signor Giacomo Vismara: A Case Study of Italian Economic Imperialism During the Foreign Ministry of Antonino di San Giuliano", *The Historical Journal* 18/3 (1975): 571-586.

shfrytëzuar pyjet shqiptare, si në Mirditë, bonifikimin e tokave, ndërtime e rrugëve dhe të urave me synime rregullimin e rrjetit rrugor drejt lidhjes së territoreve të brendshme me portin e Shën Gjinit, Durrësit e Vlorës, projekte këto që u lanë përgjysmë nga shpërthimi i Luftës italo-turke në Libi.<sup>7</sup>

Menjëherë pas Pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjes së saj ndërkombëtarisht në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Italia ishte e etur në sfidën e saj për dominim në Mesdhe dhe Ballkan, ku konkurrentët kryesorë ishin Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe. Italia synonte, njësoj si aleatët e saj, të zgjerohej dhe të dilte nga guaska e një shteti të vogël, dhe të kthehej në një fuqi hegjemoniste në Mesdhe. Në Shqipëri kjo kërkonte dominimin dhe shfrytëzimin e burimeve të vajgurit, naftës, burimeve minerale, ujore dhe pyjore. Sipas Ministrit të Jashtëm italian, në këtë garë për dominim, Italia duhet të përballej me ambiciet dhe politikat shumëvjeçare të Perandorisë Austro-Hungareze, si dhe pozicionet favorizuese që kjo perandori kishte tradicionalisht në Shqipëri. Ndaj konfrontimi me Perandorinë Austro-Hungareze do të kthehej në një supremaci ekonomike, politike, morale.<sup>8</sup> Prandaj San Giuliani i komunikoi kryeministrit Giolitti (1913) se "në Shqipëri ia vlen të luhej për çdo gjë, ndaj duhet të vëmë në dispozicion të forcimit të ndikimit tonë [italian – EP] të gjitha institucionet civile dhe tregtare, të bëjmë për vete individët më me influencë që do të ndikojnë në realizimin e supremacisë sonë politike dhe ekonomike aty.<sup>9</sup> Sipas San Giuliano-s, Italia duhet të arrinte të merrte nga qeveria shqiptare koncesione ekonomike mbi portet, rrugët, sektorin e ndërtimeve publike, komunikacionit, sektorin bankar, shfrytëzimin e minierave si dhe mbi ndërtimin e rrugëve automobilistike dhe hekurudhore. E gjithë kjo politikë do të realizohej përmes politikave italiane në Shqipëri që do të synonin "të nxisnin te shqiptarët idenë se Italia nuk

---

7. John R. Lampe & Marvin R. Jackson, *Balkan Economic History, 1550–1950: From Imperial Borderlands to Developing Nations*, (Bloomington: Indiana University Press, 1982), 208.

8. Bosworth, "The Albanian Forests", 583.

9. *Ibid.*, 573.

kishte ambicie territoriale, por do të synonte forcimin e pavarësisë së Shqipërisë, dhe zhvillimin e saj dhe prosperitetin ekonomik. Kjo do të arrihej, përfundonte San Giuliani, përmes prezencës italiane ekonomike dhe tregtare, si dhe përmes investimeve dhe punës italiane për të civilizuar, sjellë progres dhe paqe në Shqipëri".<sup>10</sup>

Italia në krahasim me politikën ekspansioniste të Perandorisë austro-hungareze, dukej më aktive dhe dinamike. Teksa bankat vjeneze nguronin të zgjeronin investimet e tyre, investimet italiane filluan të shtohen. Megjithatë pati momente, kur të dy shtetet edhe i mpleksën bashkë interesat e tyre gjeostrategjike mbi Shqipërinë. Si Italia dhe Austro-Hungaria u interesuan të themelonin Bankën Kombëtare shqiptare, dhe ta paraqisnin si projekt të Qeverisë së Ismail Qemalit, me kapitale nga *Wienerbankverein* dhe *Banca Commerciale Italiana*. Projekt, në fakt u kundërshtua nga pala shqiptare, pasi kjo Bankë me kapitale italo-austriake kishte si synim dhe të operonte në sektorin e kredisë në pasuri të paluajtshme në Shqipëri. Kjo gjë shkaktoi shqetësim nga pala shqiptare, për shkak të hipotekimit të sipërfaqeve të mëdha të territorit vendas me kapital të huaj. Kundërshtim të fortë ndaj projektit për formimin e Bankës Kombëtare Shqiptare u has dhe nga Rusia, mbrapa së cilës qëndronin dhe dy fuqitë e tjera evropiane, Franca dhe Britania, për të cilat, institucioni i ri i kreditit duhet të kishte një bazë më të gjerë ndërkombëtare. Si rrjedhojë, krijimi i bankës qendrore nuk vazhdoi.<sup>11</sup>

Italia dhe Austro-Hungaria bashkëpunuan në drejtim të forcimit të një shteti të pavarur shqiptar edhe në rastin e caktimit të Princ Wied-it, si princ i Shqipërisë, teksa i premtuan atij një bazë financiare prej 10 milion frangash direkt, si pjesë e një huaje prej afro 75 milionë frangash, me të cilat ai do të niste qeverisjen e vendit, pas të cilit premtim, ai pranoi kurorën e Principatës shqiptare.<sup>12</sup>

10. Bosworth, "The Albanian Forests", 584.

11. Alessandro Roselli, *Italy and Albania: Financial Relations in the Fascist Period*, (London, New York: I.B.Tauris, 2006), 9.

12. Joseph Swire, *Albania: The Rise of a Kingdom*, (London: Williams & Norgate: London, 1929) (reprint by Arno Press and New York Times, 1971), 194, 229.



Në vitet 1914-1920 politika italiane përkundrejt Shqipërisë mund të konsiderohet si një politikë që kishte ulje-ngritjet e saj, duke synuar mbështetjen politike dhe pavarësinë e shtetit të ri ballkanik, për ta shfrytëzuar më pas edhe në dobi të interesave ekonomike italiane, siç bënë qeveritë e Sonnino-s, Giolitti-it, apo edhe për ta pushtuar, copëtuar mes fqinjve ballkanikë më të fuqishëm, dhe në dobi të interesave ballkano-strategjike të Italisë, si në rastin e San Giuliano-s, Tittoni-t, Nitti-t dhe Scialoja-s.<sup>13</sup> Interesat gjeopolitike të Italisë në Ballkan dhe në Mesdhe mplekseshin edhe me pozicionet strategjike që pika të rëndësishme në territorin shqiptar, si ishulli i Sazanit dhe Vlora, shumë afër Gadishullit Apenin, do të shërbenin si baza të rëndësishme për ankorimin e anijeve luftarake italiane përgjatë konfliktit të madh botëror. Gjithashtu Shqipëria mund të kthehej në një të ardhme të afërt në një hapësirë, ku mund të jetonin italianë. Po ashtu burimet natyrore si nafta dhe kromi, ishin një tjetër arsye e rritjes së interesit italian mbi Shqipërinë.<sup>14</sup>

Lufta e Parë Botërore e gjente Shqipërinë një shtet të varfër, me afro 800.000 mijë banorë, territoret e së cilës ishin pushtuar nga trupat e ushtrive ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha. Ndër këto të fundit, Italia dukej më ambiciozia në synimet e saj koloniale për të mos lëshuar Ishullin e Sazanit dhe territoret e administruara prej saj në kuadër të Paktit të Fshehtë të Londrës. Sipas della Rocca-s, në shtypin italian të kohës shprehej habia, se "si popullata e pakët dhe primitive në doke dhe zakone, siç ishte ajo shqiptare, kundërshtonte mbajtjen e Vlorës prej ushtrisë italiane".<sup>15</sup>

Politika ekspansioniste italiane në Mesdhe dhe në Detin Adriatik konsiderohej nga ky shtet si përmbushje e misionit të Romës pera-

---

13. Roselli, *Italy and Albania*, 8.

14. Nicola Mai, "The cultural construction of Italy in Albania and vice versa: Migration dynamics, strategies of resistance and politics of mutual self-definition across colonialism and post-colonialism", *Modern Italy* 8:1 (2003): 81. Doi: 10.1080/1353294032000074098

15. Roberto Morozzo della Rocca, "Roma e Tirana, le "convergenze parallele", *Limes* 2 (2001): 213.

ndorake, e shtrirë në kufijtë natyralë të saj. Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore (1918-1920) ambicjet e Italisë u shfaqën në qytetin e Vlorës si qendra e protektoratit italian mbi Shqipërinë. Në shtypin italian shqiptarët përshkruheshin si "njerëz primitivë", të cilët do të përfitonin nga ndihma dhe mbrojtja e Italisë në ndërtimin e shtetit të tyre modern.<sup>16</sup> Nga këndvështrimi i Italisë përpjekjet e modernizimit kolonial lidheshin me qasjen civilizuese, që ky shtet i zhvilluar dhe i qytetëruar, synonte të sillte në Shqipëri. Italia do t'u tregonte shqiptarëve standardet e vlerave evropiane edhe nëpërmjet veprave të frytshme civilizuese dhe investimeve në ekonominë shqiptare, ajo do të zhvillonte tregtinë, do të ndërtonte rrugë dhe hekurudha.

Pavarësisht këtyre synimeve, shqiptarët e konsideronin praninë e ushtrisë italiane si pushtim. Qeveria shqiptare e Sulejman Delvinës, që ishte formuar prej Kongresit të Lushnjës, u konfrontua me Italinë në ambicjet e saj koloniale për të mbajtur Vlorën. Qeveria shqiptare mbështeti luftimet lokale të 5 qershorit 1920 kundër ushtrisë pushtuese italiane. Italianët prej luftimeve të ashpra po zbrapseshin. Në tërheqjen e tyre prej Vlorës ndikoi edhe kriza e brendshme politike në Romë, ku kryeministri Nitti u zëvendësua nga Giovanni Giolitti. Dështimi italian u shfrytëzua nga qarqet nacionaliste në Itali. Në shtypin nationalist italian shkruhej, se dominimi italian në Shqipëri dhe investimet italiane atje justifikonin të drejtën që Italia kishte për të mos ikur nga Vlora, por për të qëndruar në Shqipëri. Në fletët e *Il Popolo d'Italia*, Benito Mussolini përmendte se investimet italiane në Vlorë, si "rrugët, urat, shtëpitë dhe spitalet" që italianët ndërtuan atje gjatë "pushtimit të tyre paqësor" u braktisën.<sup>17</sup> Në Itali përpjekjet për modernizimin kolonial ishin të lidhura me "civilizimin" që Italia e "zhvilluar dhe e civilizuar" i kishte sjellë Shqipërisë "të prapambetur

---

16. Fabio Bego, "The Vlora conflict from a Trans-Adriatic Perspective: History, Myth and Ideology", në Claudia Lichnofsky, Enriketa Pandelejmoni, Stojanov Darko (eds.) *Myths and Mythical Space. Conditions and Challenges for History Textbooks in Albania and South-Eastern Europe*, Eckert. Die Schrifteihe vol. 147, (Gottingen: V&R Unipress, 2018), 108.

17. Bego, "The Vlora conflict", 108.

dhe primitive" që në fillimet e pavarësisë së shtetit shqiptar. Gjatë viteve 1920-të Shqipëria përshkruhej si një tokë djerrë, sterile nga natyra, që në historinë e saj nuk kishte përjetuar asnjë periudhë të vetme lulëzimi.<sup>18</sup>

Gjithsesi, pavarësisht harxhimit të miliona lirave në shtator 1920, italianët do të largoheshin. Protokolli dypalësh i 2 gushtit 1920 shpalli pushimin e të gjitha pretendimeve italiane ndaj Shqipërisë, me përjashtim të ishullit të Sazanit. Kështu italianët u detyruan të linin Vlorën në 3 shtator 1920, pas luftimeve të ashpra me luftëtarët shqiptarë.

Ndërsa pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në dhjetor 1920, Italia mori njohjen nga Lidhja për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë, duke i dhënë asaj *de facto* të drejtën strategjike të protektoratit mbi Shqipërinë. Pas ardhjes në pushtet të Musolinit, Italia e pa praninë e saj politike, ekonomike dhe financiare në Shqipëri si vendimtare për zgjerimin e saj strategjik në Ballkan, përkundrajt shteteve të tjera, si Britania, Franca, SHBA, të cilat kishin filluar të interesoheshin pas shfrytëzimit të burimeve të naftës në Shqipëri.<sup>19 20</sup>

### **Periudha fashiste dhe ambicia kolonialiste mbi Shqipërinë**

Në vitet në vijim, Italia lëvizi me shpejtësi në arritjen e marrëveshjeve për tregtinë e naftës dhe të burimeve minerale dhe koncesionet e sektorit bankar shtetëror, punëve publike dhe pyjeve me Qeverinë e Presidentit Ahmet Zogu (1925), i cili u bë Mbreti Zogu I në 1928.<sup>21</sup> Në përgjithësi gjatë kësaj kohe politika koloniale e Musolinit ndaj

---

18. Bego, "The Vlora conflict", 109.

19. Roselli, *Italy and Albania*, 12; Arben Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, (Tiranë: Afërdita, 2002): 75.

20. Roselli, *Italy and Albania*, 30-34. Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane*, 75. Iljaz Fishta, *Sistemi monetar dhe i kreditit në Shqipëri (1924-1944)*, (Tiranë: Mihal Duri, 1971), 43.

21. Pietro, Pastorelli, "La penetrazione italiana in Albania. Gli accordi economici italo-albanesi del marzo 1925", *Rivista di Studi Politici Internazionali* 33/1 (1966): 52.

Shqipërisë ishte një politikë me në qendër shtetin, e mbështetur nga fondet e qeverisë italiane. Duke paguar miliona për nevojat financiare të Zogut, Italia zgjeroi në vitet 1924-1925 depërtimin e saj financiar në Shqipëri, duke marrë koncesionin e naftës në favor të Ferrovie dello Stato në krahinat e Vlorës dhe Beratit; nënshkroi marrëveshjen për themelimin e një banke kombëtare me një pjesë kapitali prej 51 për qind në favor të grupeve financiare italiane dhe 49 për qind të shqiptarëve, si dhe një kredi financiare prej 15 milionë lireta nga Italia për Shqipërinë. Kështu varësia ekonomike e Shqipërisë tek Italia u thellua edhe nga inkorporimi në Romë i Bankës së re Kombëtare të Shqipërisë, në shtator 1925, dhe krijimi i Società per lo Sviluppo Economico dell'Albania (SVEA) dhe huasë së lëshuar prej saj, që ishte rrjedhojë e lidhjes së SVEA-s edhe me bankat italiane dhe me "Institutin Kombëtar Italian për Shkëmbimet me Jashtë/Istituto Nazionale per i Cambi con l'Estero – INCE".<sup>22</sup>

Pas kësaj kredie fluksi i kapitalit italian u rrit jashtëzakonisht në Shqipëri dhe u dhanë koncesione në të gjithë sektorët e ekonomisë në kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, minierave dhe bujqësisë.<sup>23</sup> Kreditë e SVEA-s u përdorën për investime të rëndësishme publike midis viteve 1927 dhe 1939. Prioritet iu dha zhvillimit të sistemit hekurudhor, ndërtimit të urave dhe porteve, rrjeteve hidraulike, bonifikimit të tokës dhe kullimit të kënetave. U bënë plane për ndërtimin e rrugëve dhe të urave të reja përgjatë linjave Tiranë-Durrës, Shkodër-Elbasan dhe Durrës-Vlorë. Me rëndësi të veçantë ishte ndërtimi i godinave publike dhe ushtarake, vilave, pallatit mbretëror dhe godinave ministrore në Tiranë, në përputhje me planin rregullator urbanistik, të hartuar nga Armando Brasini.<sup>24</sup> Ndërsa inxhinieri italian Luigi Luiggi ishte përgjegjës për projektin e Portit të Durrësit

22. Roselli, *Italy and Albania*, 34-35. Cici, *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane*, 75. Fishta, *Sistemi monetar*, 4.

23. Alketa Marku, *La Relazioni bilaterali tra Albania e Italia: 1939-1957*, (Tiranë: Albanian University Press, 2012), 22.

24. Anna Bruna Menghini, "La presenza italiana attraverso gli istituti e gli enti per le opera pubbliche", në Francesca Calace, *Restituiamo la storia. Dagli archivi*

dhe hartimin e planit të bonifikimit të kënetës në një sipërfaqe prej afro 3 km<sup>2</sup>, që do të ndihmonte edhe në zhdukjen e malaries. Ky plan synonte transformimin e "kënetës së vdekur në një lagunë të gjallë", duke ndërtuar një sistem kanalesh të përbërë nga një kanal kryesor i lidhur me kanale dytësore, për të lejuar hyrjen e ujit të kripur të detit në lagunë, duke parandaluar kështu riprodhimin e mushkonjave, si dhe për të mbushur një pjesë të kënetave me materiale të nxjerra nga përrenjtë dhe thellimin e portit të Durrësit. Ky plan do t'i shndërronte tokat kënetore në "toka të rikuperuara dhe të kultivueshme në mënyrë të përsosur që do të nxirrnin të ardhura të mëdha bujqësore dhe do të bëheshin burim pasurie për fermerët dhe vendin".<sup>25</sup>

Përgjatë viteve 1930-të punimet për bonifikimin e tokës dhe kullimin e kënetave ishin pjesë e përpjekjeve të Italisë për të mundur vendosjen e qytetarëve italianë dhe ngritjen e disa fermave bujqësore eksperimentale përgjatë Ultësirës Perëndimore të Durrësit, Shijakut, Kavajës dhe Vlorës.<sup>26</sup> Investimet në peizazhin natyror, investimet agrare dhe bonifikimi i tokës në Shqipëri u kryen nga "Ente Italiano Attività Agraria" (EIAA-Agencia Italiane për Veprimtaritë Bujqësore), e cila ishte kompania më e madhe që operonte në sektorin agrar, me qëllim zhvillimin e fermave eksperimentale dhe vendosjen e kolonëve italianë. Ajo mori një koncesion prej 3000 hektarësh tokë në fushën e Shijakut në vitin 1926 dhe asaj iu dha e drejta për të blerë dhe eksportuar produkte agrare drejtpërdrejt nga prodhuesit dhe kooperativat shqiptare.<sup>27</sup>

---

*ai territori. Architettura e modelli urbani nel Mediterraneo orientale*, (Roma: Gangemi Editore, 2013), 43.

25. Ezio Godoli, "Progetti per la SVEA (società per Lo Sviluppo Economico dell'Albania): documenti dagli archivi di Luigi Luiggi e Guido Fiorini", në Godoli, Ezio, Tramonti Ulisse (eds.), *Architetti e ingegneri italiani in Albania*, (Edifir: Firenze, 2012), 56.

26. Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, (Tiranë: Çabej, 1994), 246.

27. Silvia Trani, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia: censimento delle fonti (1939-1945) conservate negli archivi pubblici e privati di Roma*, (Roma: Ministero per i beni e le attività culturali. Direzione generale per gli archivi, 2007), 30.

Sipas Bernd Fischer, paratë e SVEA-s jepnin përshtypjen se italianët po i përdornin për të kryer një sërë punimesh në interes të shqiptarëve, por prioritetet e këtyre të fundit rrallë merreshin parasysh. U ndërtuan më shumë rrugë dhe ura për qëllime ushtarake italiane, si ato drejt kufijve me Greqinë dhe Jugosllavinë. Porti i Durrësit u zgjerua deri në atë masë, aq sa me përfundimin e tij mund të ankoroheshin anije tregtare më të mëdha se zakonisht.<sup>28</sup> Ndërsa kanalizimi i parashikuar i fushës së Myzeqesë, fushës së Vlorës, fushës së Matit, si dhe tharja e kënetës së Shëngjinit, liqenit të Vivarit, kënetës së Durrësit dhe ndërtime të tjera të planifikuara as që filluan.<sup>29</sup>

Pas gati një dekade nga fillimi i veprimtarisë së EIAA, në maj 1935 ministri italian në Tiranë Mario Indelli i propozoi qeverisë shqiptare një tjetër marrëveshje kreditore, si dhe vendosjen e kolonëve italianë në Shijak dhe Durrës, ku EIAA kishte koncesionin e saj.<sup>30</sup> Pas presionit të vazhdueshëm mbi qeverinë shqiptare për të pranuar zgjerimin e ndikimit të kapitalit dhe prezencës italiane në vend, më 19 mars 1936 u nënshkruan në Tiranë Marrëveshja Berati-Indelli, e cila parashikonte: pagesat e qeverisë italiane për Shqipërinë në likuidimin e huasë 10-vjeçare të vitit 1931 për një periudhë dyvjeçare; financimin e deficitit të buxhetit të shtetit shqiptar; rifinancimin e kapitalit të Bankës Bujqësore Shqiptare nëpërmjet një kredie bujqësore për një periudhë trivjeçare; u ra dakord për një kredi për monopolin e duhanit për një periudhë dyvjeçare dhe dy kredi për portin e Durrësit.<sup>31</sup> Jason Tomes vëren se me këto marrëveshje «Shqipëria kapitulloi ndaj fashizmit italian. Shqipëria u bë një koloni italiane. Porti kryesor i saj Durrësi do të kthehej në një Massawa tjetër, vendi i ankorimit

---

28. Fischer, *Mbreti Zog*, 104.

29. Fishta, *Sistemi monetar*, 74.

30. Owen Pearson, *Albania and King Zog: Independence, Republic and Monarchy, 1908-1939*, (London: IB Tauris. Pearson 2004), 370.

31. Roselli, *Italy and Albania*, 61. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme, D. 13, viti 1936.

për aventurën tjetër perandorake italiane".<sup>32</sup> Pas marrëveshjes, Italia njoftoi në prill 1936 se "300.000 kolonistë italianë do të vendoseshin së shpejti në Shqipëri", ndërsa mohoi që të jepeshin koncesione për kolonizimin italian.<sup>33</sup>

Kësisoj gjatë viteve '20-të dhe '30-të, kreditë e SVEA-s u përdorën për të krijuar një varësi politike dhe ekonomike të Shqipërisë ndaj Italisë, e cila u bë jashtëzakonisht e ndjeshme ndaj presionit politik italian. Këshilltarët italianë u punësuan në administratën publike shqiptare, si në sektorin ushtarak, arsim, ekonomik.<sup>34</sup> Sipas Besnik Pula-s, në këto vite Italia depërtoi fuqishëm në jetën sociale dhe politike shqiptare. Përdorimi i aparatit shtetëror shqiptar nga Italia, për të futur format fashiste të organizimit shoqëror, nënkuptonte se deri në aneksimin e vitit 1939, Shqipëria ishte gati për fashistizimin e plotë.<sup>35</sup> Ky fakt ishte paralajmëruar në gusht 1937 nga vetë Konti Ciano, i cili në Ditarin e tij, parashtronte vizionin e tij kolonial për Shqipërinë: "E kam bindur Duçen që në katër vitet e ardhshme t'i japë Shqipërisë 60 milionë për vepra të llojeve të ndryshme... Duhet të krijojmë qendra të qëndrueshme të influencës italiane atje. Kush e di se çfarë mund të na sjellë e ardhmja! Duhet të jemi gati të shfrytëzojmë mundësitë që do të dalin. Ne nuk do të tërhiqemi këtë herë si në vitin 1920. Në Jugun tonë kemi disa qindra mijëra shqiptarë. Pse të mos ndodhë e njëjta gjë nga ana tjetër e Adriatikut?"<sup>36</sup>

### **Pushtimi dhe politikat koloniale-moderniste**

Të Premten e Zezë, të 7 prill 1939, trupat italiane zbarkuan në bregdetin shqiptar pa asnjë shpallje zyrtare lufte. Bombarduesit italianë

32. Jason Tomes *King Zog self-made monarch of Albania*, (Thrupp – Stroud: Sutton Publishing, 2003), 180.

33. Pearson, *Albania and King Zog*, 379.

34. Elidor Mëhilli, *From Mao to Stalin. Albania and the Socialist World*, (London: Cornell University Press, 2017), 24. Besnik Pula, "Becoming Citizens of Empire: Albanian Nationalism and Fascist Empire, 1939-1943." *Theory and Society* 37, nr. 6 (2008): 575. <http://www.jstor.org/stable/40345603>.

35. Pula, "Becoming Citizens of Empire", 575.

36. Galeazzo Ciano, *Diario 1937-1943*, (Roma: Rizzoli, <sup>10</sup>2006), 28.

mbi qiellin shqiptar shpërndanë fletëpalosje në shqip me mesazhe miqësore ndaj popullit shqiptar. Pushtimi u bë brenda dy ditësh, ndërsa Mbreti Zog, gruaja e tij dhe foshnja e tyre 2 ditëshe ikën në Greqi.<sup>37</sup> Më 12 prill 1939, Asambleja Kushtetuese Kombëtare shpalli shfuqizimin e regjimit politik në fuqi, si dhe shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1928; krijoi një qeveri kukull dhe shprehu dëshirën për krijimin e një bashkimi midis Italisë dhe Shqipërisë, duke i ofruar kurorën e Shqipërisë Mbretit të Italisë në formën e një bashkimi personal. Dekreti mbretëror i 18 prillit 1939 themeloi një Nënsekretariat për Çështjet Shqiptare në Ministrinë e Punëve të Jashtme italiane të kryesuar nga Zenone Benini.<sup>38</sup> Ndërsa më 3 qershor u suprimua Ministria e Jashtme shqiptare, dhe tashmë Italia do të menaxhonte punët e jashtme të Shqipërisë dhe do ta përfaqësonte atë jashtë. Ky bashkim hibrid do të drejtohej nga zyra e sapokrijuar e Mëkëmbësit të Mbretit në Shqipëri, nga Partia Fashiste Shqiptare, si dhe nga këshilltarët e përhershëm italianë në ministrinë shqiptare. Mëkëmbësi, i cili përfaqësonte Mbretin e mërguar, kishte të drejtën e sovranitetit. Ndërkohë që Italia kontrollonte qeverinë shqiptare nëpërmjet kompetencave të saj emëruese, qeveria kontrollohej nga brenda nga këshilltarët e përhershëm italianë, të cilët ishin aktivë në çdo ministri.<sup>39</sup>

Musolini i premtoi popullit shqiptar, se ai dhe Italia fashiste do t'i sillnin Shqipërisë drejtësi, rend dhe prosperitet, pasi ai njihej se e mbante fjalën!<sup>40</sup> Më parë ishte arritur një marrëveshje për shkrirjen e dy ushtrive, organizatave fashiste dhe bashkimit doganor, si dhe barazimin e lekut shqiptar me lirën italiane. Bashkimi me Italinë në

---

37. Pearson, *Albania and King Zog*, 443.

38. Roselli, *Italy and Albania*, 99.

39. Enriketa Papa-Pandelejmoni, "Il rimpatrio degli italiani e lo stallo nelle relazioni Albania-Italia (1945-1957)", në Paolo Rago (ed.) *Una pace necessaria. I rapporti italiano-albanesi nella prima fase della guerra fredda*, 127-172, (Bari: Editori Laterza, 2017), 435.

40. Carlo Alberto Straneo, "L'Albania nel Impero", *Rivista d'Albania* 1 (1940): 7. Romeo Gurakuqi, *Shqipëria dhe tokat e lirueme 1939-1946*, (Tiranë: Botimet Jozef, 2018), 82.



realitet ishte një varësi koloniale brenda shoqërisë perandorake romane, pasi të dy vendet ndanin kreun e shtetit, regjimin politik fashist dhe përfaqësimin diplomatik dhe kishin bashkuar doganat dhe ushtritë e tyre.<sup>41</sup> Shtetasit shqiptarë në Itali dhe shtetasit italianë në Shqipëri gëzonin të gjitha të drejtat civile dhe politike.<sup>42</sup> Shqipëria renditej si një koloni e privilegjuar italiane në krahasim me kolonitë afrikane në varësi të Romës, megjithëse nga pikëpamja formale, juridike, bashkimi i Italisë dhe Shqipërisë ishte i bazuar në të drejtën ndërkombëtare dhe ishte një marrëveshje ndërmjet dy vendeve sovrane. Shqipëria ruante formalisht territorin, popullin dhe sovranitetin, por në thelb ishte në varësi të Italisë.<sup>43</sup>

Musolini bëri përpjekje për të mos e identifikuar Shqipërinë si një koloni dhe këmbënguli, se pavarësia e Shqipërisë po ruhej, megjithëse do të fashistizohej dhe italianizohej.<sup>44</sup> Ekspansioni në Mesdhe i Italisë u portretizua si vazhdimi natyror i "misionit civilizues" të Romës.<sup>45</sup> Lidhja dypalëshe mes Italisë dhe Shqipërisë justifikohet brenda "hapësirës jetike" (spazio vitale) italo-mesdhetare, e ngjashme me *Lebensraum*-in gjerman. Hapësira jetike, sipas Davide Rodogno-s, ishte e organizuar në mënyrë hierarkike mbi parimet racore, në nivelin më të ulët përbëhej nga popujt autoktonë të Afrikës dhe në kulm qëndronte raca perandorake italiane.<sup>46</sup> Brenda hapësirës jetike Roma do të impononte "rendin e ri" (ordine nuovo) dhe do të organizonte një komunitet si

---

41. Nicola Mai, "The cultural construction of Italy in Albania and vice versa: Migration dynamics, strategies of resistance and politics of mutual self-definition across colonialism and post-colonialism", *Modern Italy* 8:1 (2003): 84, 77-93, DOI: 10.1080/1353294032000074098.

42. Gaspari Ambrosini, "L'Albania nella Comunità Imperiale di Roma", *Quaderni dell'Istituto Nazionale di Cultura Fascista* 5 (1940): 64.

43. Giovanni Villari, "A Failed Experiment: The Exportation of Fascism to Albania", *Modern Italy* 2 (2007): 160, 157-171.

44. Pula, "Becoming Citizens of Empire", 576.

45. Ruth Ben-Ghiat dhe Mia Fuller (eds.), *Italian Colonialism*, (New York: Palgrave Macmillan, 2005), 2.

46. Davide Rodogno, "Progetti e finalità delle politiche fasciste d'occupazione", *Contemporanea*, 8/2 (2005): 322. Davide Rodogno, *Fascism's European Empire*:

për popujt prej së cilëve përbëhej, ashtu edhe për popujt e tjerë, që megjithëse ishin më pak të qytetëruar, megjithatë do të shtoheshin dhe do të zhvilloheshin njësoj si ata që i përkisnin më parë Perandorisë Romake.<sup>47</sup> Brenda komunitetit perandorak, revolucion i fashist do të krijonte Njeriun e Ri që do të përmbushte përpyekjet revolucionare të Musolinit për të krijuar një botë të re. Njerëzit e rinj italianë do ta ndriçonin botën me artin e tyre, do ta edukonin atë me njohuritë e tyre dhe do të forconin strukturën e territoreve të reja me teknikat dhe aftësitë e tyre administrative, me sipërmarrjen dhe organizimin e tyre të tregtisë.<sup>48</sup> Prandaj, retorika fashiste kishte propaganduar se qeveria italiane shpenzoi miliona lireta gjatë viteve të fundit për të ndihmuar Shqipërinë në çdo mënyrë. Vendi ishte paraqitur si ekzotik dhe tërheqës, si "*Oriente sotto casa*", një vend magjepsës oriental, si një pazar, por që në të njëjtën kohë nuk kishte shfrytëzuar burimet e veta të konsiderueshme natyrore, përkundrazi kishte pritur që vëllai i tij i madh, Italia, të vinte për t'i përdorur ato.<sup>49</sup> Rikthimi i i lavdisë së Romës nëpërmjet pushtimit perandorak dhe "përjetësimit dhe përhapjes së italianitetit [në botë]" nëpërmjet edhe një pune paralele të "depërtimit shpirtëror" përbën një element qendror të ideologjisë fashiste.<sup>50</sup> Kjo është arsyeja pse për të legjitimuar këtë projekt imperialist, akademikët dhe politikanët italianë nënvlerësuan unitetin kulturor, social dhe politik të Shqipërisë dhe qëndrueshmërinë e saj si një entitet kombëtar autonom, duke legjitimuar kështu të drejtën e Italisë si mbrojtëse natyrore e Shqipërisë. zbuluar burimet e saj.<sup>51</sup> Aksioma fashiste ishte përparimi përmes fashistizimit.

---

*Italian Occupation during the Second World War*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2006), 48-52.

47. Rodogno, "Progetti e finalità", 48.

48. *Ibid.*, 321-323.

49. Della Rocca, "Roma e Tirana", 215.

50. Ruth Ben-Ghiat, *Fascist Modernities. Italy, 1922-1945*, (Berkley, Los Angeles, London: University of California Press, 2006), 385.

51. Mai, "The cultural construction of Italy in Albania", 83.

Muharrem Dëzhgiu thekson rëndësinë e hapësirës jetike strategjike fashiste në Ballkan, ku sipas tij, Italia kërkonte të krijonte një "autarki kontinentale" duke kontrolluar pasuritë natyrore të rajonit. Nëpërmjet narrativës së hapësirës jetike, Italia u përpoq të kontrollonte pasurinë e Ballkanit për ekonominë e saj të luftës dhe për krijimin e "komunitetit perandorak". Shqipëria me burimet e saj të pasura natyrore do të ishte e dobishme për ekonominë autarkike italiane. Ishte një vend me shumë mundësi të mëdha ekonomike dhe zonat e saj bujqësore konsideroheshin me një potencial të madh zhvillimi. Në të njëjtën kohë, Shqipëria ishte e rëndësishme për Italinë për shkak edhe të pozicionit të saj gjeografik, duke shërbyer si një urë ekonomike për në Ballkanin Lindor.<sup>52</sup> Ndërsa Besnik Pula e konsideron sundimin italian në Shqipëri gjatë viteve 1939-1943, si një formë dominimi kolonial. Zgjerimi i Italisë në Shqipëri ishte tipar i kolonializmit, pasi u shoqërua edhe me vendosjen e kolonëve në territoret e fituara. Italia e konsideronte Shqipërinë si një territor të hapur ndaj vendbanimeve italiane. Më tej, Italia dominoi kontrollin e Shqipërisë edhe me praninë e saj të madhe ushtarake; në sferën politike, duke krijuar një strukturë institucionale që i dha pushtetin përfundimtar politik Romës; në ekonomi nëpërmjet kontrollit të financave shtetërore, fluksit të kapitalit dhe shfrytëzimit të punës dhe burimeve natyrore.<sup>53</sup>

Në thelb të imperializmit fashist qëndronte ideja e përmisimit (valorizzazione), me të cilën nënkuptohej një mision ekonomik për të qytetëruar ekonominë e vendeve që do t'i përkisnin Romës. Përpjekja e përmisimit të vitit 1939 në Shqipëri u shoqërua me një politikë të gjerë si të punëve publike, ashtu edhe me bonifikimin integral.<sup>54</sup> Ndaj u hartuan programe ekonomike, urbane, industriale dhe bujqësore që synonin qytetërimin dhe modernizimin e Shqipërisë. Në maj të vitit 1939, Mëkëmbësi i Mbretit, Francesco Jacomoni u takua në Romë me Beninin dhe zyrtarë të tjerë të lartë për të diskutuar plane konkrete

52. Muharrem Dëzhgiu, *Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Historisë, 2005), 146.

53. Pula, "Becoming Citizens of Empire", 577.

54. Rodogno, "Progetti e finalità", 319.

ekonomike dhe teknike për Shqipërinë.<sup>55</sup> Në një raport studimor dërguar Musolinit në Tetor 1939, Benini raportonte mbi burimet natyrore dhe ekonomike të Shqipërisë, duke nënvizuar rëndësinë e kryerjes së punimeve të mëdha të bonifikimit të tokës në Durrës, Shijak, Tiranë, Vlorë dhe Fier deri në fund të vitit 1941.<sup>56</sup> Ndërkohë që ishte në proces bonifikimi i kënetës së Durrësit, përfundimi i të cilit ishte planifikuar në vitin 1941. Në Myzeqe ishin kryer punime bonifikuese dhe në Kavajë filloi një eksperiment i madh për bonifikimin e tokës. Pritej që rrjetësimi i plotë i peizazhit rural të shtrihej në mbi 200,000 hektarë tokë.<sup>57</sup> Në Raportin optimist të Beninit shkruhej se investimi i gjerë në Shqipëri do të sillte përfitime ekonomike dhe politike për 10 vitet e ardhshme.

Bonifikimi fashist i natyrës, njeriut dhe shoqërisë ishte thelbi i bonifikimit dhe përmisimit që italianët synonin të realizonin në Shqipëri. Skema e bonifikimit agrar-njerëzor-kulturor u shpreh në përpjekjet shpëtuese të peizazhit natyror dhe të njerëzve. Bonifikimi ishte thelbësor në përmirësimin e gjendjes fizike, ekonomike dhe kulturore të vendit duke transformuar peizazhin dhe njerëzit në të njëjtën kohë. Shteti i ri fashist në Shqipëri do të merrte një rol inxhinierik për t'u imponuar njerëzve dhe peizazhit vizionin e tij ripërtëritës për një vend të qytetëruar dhe të zhvilluar.<sup>58</sup> Ky vizion transformues u pasqyrua në shumë artikuj të botuar në gazetën "Fashizmi" apo tek "Ekonomia Kombtare". Në artikullin e vitit 1940 të "Ekonomisë Kombtare" me titull "Regjimi fashist dhe fkatundari

---

55. Gurakuqi, *Shqipëria dhe tokat e lirueme*, 100.

56. Antonio Amendola, *Assimilazione economica dell'Albania*, (Napoli: Edizioni Porti d'Italia, 1939), 23. Rovena Sakja, "Così vicina, così lontana: visioni fasciste dello sviluppo dell' Albania negli anni quaranta", *Nuovi annali della scuola speciale per archivisti e bibliotecari* 3 (2016): 174. Paskal Milo, *Shqiptarët në Luftën e Dytë Botërore*, vëll. 1, (Tiranë: Toena, 2014), 63. Enriketa Pandelejmoni, "Italian Fascist Modernisation and Colonial Landscape in Albania 1925-1943", *Perspectivas - Journal of Political Science* 25 (2021): 48. <https://doi.org/10.21814/perspectivas.3243>.

57. Sakja, "Così vicina, così lontana", 176.

58. Pandelejmoni, "Italian fascist modernisation", 49.

shqipëtar" fokusi vihej në synimin për të përmirësuar mjedisin rural dhe racën shqiptare:

"Është një punë e madhe çështja e bonifikimeve në Shqipëri, por është një punë gjith' aq ' e madhe sistemimi, zhvillimi i katundit dhe një punë shumë m' e madhe heqja e katundarit nga mizerja në të cilën e ka hedhur mos-kokëçarja kriminale e njerzve të së djeshmës. Katundari, bujku shqipëtar duhet të shpëtojnë nga sëmundjet, e të hyjë në jetën njerëzore, të çlirohet nga agallarët, të fitojë ndërgjegjen e rolit dhe të misjonit të tij në shoqëri por sidomos duhet të dashurojë katundin dhe tokën e tij, me të cilën të ndjehet i lidhur në mënyrë të pa-zgjidhur. Është një kryqëzatë nga më të mbëdhatë këjo që po merr përsipër të kryejë në tokat shqipëtare Fashizmi, kryqëzatë që sidomos për pjesën e saj humanitare është nga ato që historia do t'i përmendë në mënyrë sa më të dukëshme. Nuk është vetëm puna, se do të përmisohet gjëndja ekonomike e vëndit, por më shumë ka rëndësi se do të shpëtojë një popull, një rac' e tërë, që jo njëherë e ka okupuar historin' e përbotëshme me trimëritë dhe therorit' e saj në favor të qytetimit europjan të kërcënuar seriozisht prej oridve aziatike. Nuk do bisedim, se Fashizmi me besnikët e tij, dhe përpjekësit më trima në këtë ndërmarrje të tij, do t'i gjejë pikërisht në burrat e kësaj toke."<sup>59</sup>

Shndërrimi i natyrës në një peizazh modern dhe i fshatarit në një "njeri të ri" fashist ishin qëllimet e politikës së bonifikimit të mjedisit. Fashizmi ndërtoi narrativën e vet të gjakut dhe tokës, në të cilën cilësia racore e njerëzve ishte e ngulitur në peizazhin kombëtar, si

---

59. Ekonomia Kombtare, 1940, nr. 35. Regjimi fashist dhe katundari shqipëtar.

rezultat i forcave natyrore, racore dhe historike.<sup>60</sup> Bonifikimi integral fashist ishte rruga për të dalë nga mjerimi dhe korrupsioni siç kishte ndodhur në tokën italiane.

"Katundarët besojnë në Fashizëm dhe në DUÇEN e Fashizmit si në Shpëtimtarin e tyre. Shumë kujt do t'i duket si çudi, por është e vërtetë se në katundet t'onë dëgjon sot njeriu të flasin për Agro Pontino, për Reformë Siciliane e tjera, me bindje se shumë shpejt këto vepra madhështore të Fashizmit n'Itali, do t'i shofim shumë shpejt edhe në Shqipërinë t'onë, për të cilën me aqë dashuri rreh Zemëra e Madhe e DUÇES."<sup>61</sup>

Për historianët shqiptarë Italia me politikën e saj ekonomike dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore të vendit, praktikisht e ktheu Shqipërinë nga mesi i viteve 20-të në koloni të saj. Strategjia fashiste e Romës në thelbin e saj nuk ishte vetëm krijimi i një baze ushtarake në Shqipëri për zgjerim të mëtejshëm në Ballkan, por edhe përdorimi i burimeve natyrore dhe potencialeve ekonomike të Shqipërisë.<sup>62</sup> Zrytarët italianë planifikonin të shfrytëzonin potencialet e peizazhit rural shqiptar për të sjellë kolonë të zgjedhur italianë që do të kontribonin në kapërcimin e prapambetjen agrare shekullore të vendit.<sup>63</sup> Nevoja për të rritur kapacitetin prodhues në Shqipëri bëri që autoritetet italiane të pushtimit të kërkonin më shumë punëtorë italianë në Shqipëri. Kjo ishte arsyeja që italianët kërkuan që sipërfaqet e mëdha të tokave të kompanive italiane t'u jepeshin shtetasve italianë. Kjo do të siguronte strehimin e kolonëve italianë në Shqipëri, të cilët do të sillnin prishjen e status quo-së politike të interesave vendase shqiptare në

---

60. Marco Armiero, *A Ruined Nation: Mountains and the Making of Modern Italy*, (Cambridge: The White Horse Press, 2011), 14.

61. Ekonomia Kombtare 1940, 22.

62. Milo, *Shqiptarët*, 61.

63. Dëzhgiu, *Shqipëria*, 148-49.

favor të interesave italiane.<sup>64</sup> Kështu në Shqipëri u ndërtua një sistem dominimi kolonial italian. Italia mbajti një prani të madhe ushtarake, krijoi një strukturë institucionale që i dha pushtetin përfundimtar politik Romës, mbajti dominimin mbi sferën ekonomike dhe e hapi vendin ndaj kolonëve italianë.<sup>65</sup> Roma vendosi në Shqipëri një lloj rendi protektorati të bazuar në përhapjen kulturore dhe jo në rendin racor nazist që gjermanët vendosën në Evropë. Rrethet kulturore propaganduan lidhjet e lashta shqiptaro-italiane. Prania e Italisë në Shqipëri, në kuadër të projektit kolonial, u karakterizua nga një integrim më i thellë ekonomik dhe një sistem i ndërlikuar institucionesh që synonin lidhjen me Romën.<sup>66</sup>

Duhet theksuar, se projekti i kolonizimit italian në Shqipëri duhet parë më gjerë nga këndvështrimi i politikës demografike të Musolinit. Musolini e përkufizoi problemin demografik si "një aspekt të shëndetit publik", duke besuar se fuqia e popullsisë ishte baza e fuqisë politike, ekonomike dhe morale të shtetit.<sup>67</sup> Bonifikimi i tokës dhe ripopullimi i zonave fshatare në Itali dhe në kolonitë e saj nga fshatarë, të paprekur nga hedonizmi urban, do të ruante karakteristikat e forcës, vitalitetit dhe maturisë, që përfaqësonin vlerat e Italisë fashiste. Kolonizimi demografik do ta parandalonte Italinë nga pasojat e degjenerimit borgjez të urbanizmit: hedonizmi, konsumizmi, fertiliteti i dobët dhe pacifizmi.<sup>68</sup> Familjet koloniale fshatare do të vendoseshin në fshatra të rinj të krijuar në Afrikë dhe Shqipëri, ku do të formonin feramat, do të kishin mjetet dhe furnizimet e tyre autonome. Kjo është arsyeja pse njësia organike e familjes duhet të ishte baza për migrimin në koloni,

---

64. Gurakuqi, *Shqipëria dhe tokat e lirueme*, 147.

65. Pula, "Becoming Citizens of Empire", 577-578.

66. Mëhilli, *From Mao to Stalin*, 24.

67. Gian Luca Podestà, "I censimenti nei domini coloniali come fonte per la storia sociale", në Guido Alfani et al. (eds.) *I censimenti nell'Italia unita. Le fonti di stato della popolazione tra il XIX e il XXI secolo*. In *Annali di statistica*, Anno 142, Serie XII - Vol. 2, (Roma: Istituto nazionale di statistica, 2012), 255.

68. *Ibid.*, 256.

pasi vetëm ashtu do të ruanin dhe do të zgjerohnin racën, kulturën dhe stilin e jetesës italiane.<sup>69</sup>

Megjithëse italianët nuk kishin ide të qarta për ofrimin e territoreve nga Shqipëria për kolonët, një projekt për kolonizimin demografik të Shqipërisë, i hartuar nga specialistë italianë, iu dorëzua Jacomonit më 1 gusht 1939, për të sjellë deri në 2 milionë kolonë italianë që do të tejkalonin popullsinë vendase.<sup>70</sup> Për administrimin e këtyre vendbanimeve u krijua dhe një shoqëri italo-shqiptare, e njohur si Littorio, ajo ishte përgjegjëse për vlerësimin agrar të 10,000 hektarëve tokë në zonën e Kavajës.<sup>71</sup> Ky program kolonial parashikonte strehimin e kolonëve italianë krahas zhvillimit të programeve kulturore dhe arsimore. Vetëm nëpërmjet një skeme të tillë, të ashtuquajtur "bonifikim i trefishtë", siç e quan Ruth Ben Ghiat, përkatësisht të bonifikimit bujqësor, të bonifikimit njerëzor dhe të bonifikimit kulturor, Italia mund të synonte ribërjen e natyrës sipas një ideali optimal, të pastronte kulturën mbi baza nacionaliste dhe krijimin e "njeriut të ri italian".<sup>72</sup>

Bonifikimi kulturor imponoi ngritjen e programeve arsimore si për italianët ashtu edhe për shqiptarët. U ndërmorën gërmime arkeologjike për të gjetur 'romanitetin' e territoreve shqiptare. Disa shoqërive kulturore dhe kinematografike italiane iu dha ekskluziviteti si për krijimin dhe menaxhimin e kinemave, ashtu edhe për shpërndarjen e filmave gazetareskë dhe dokumentarë të prodhuar nga Instituti LUCE.<sup>73</sup> Mënyra e jetesës fashiste u propogandua në gazeta dhe revista; ndërsa institucionet kulturore të llojeve të ndryshme të formuara gjatë atyre viteve, si Shoqëria Dante Alighieri, "Fondacioni Skënderbej" përhapën gjuhën, kulturën dhe jetën akademike italiane. Po ashtu, *Società geografica italiana* promovoi një mision studimor për të zgjeruar njohuritë mbi territorin dhe popullsinë shqiptare.

69. Podestà, "I censimenti nei domini coloniali", 255.

70. Ivan T. Berend, *An Economic History of Twentieth-Century Europe*, (Cambridge: Cambridge University Press, 2006), 126.

71. Gazzetta Ufficiale Albanese, 14 tetor 1939.

72. Ben-Ghiat dhe Fuller (eds.), *Italian Colonialism*, 4.

73. Trani, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia*, 69–70.



Akademia Mbretërore e Italisë u përdor si një mjet propagande për pranimin në të të disa personaliteteve shqiptare si anëtarë të saj dhe krijimin e një Qendre Studimi për Shqipërinë. Bursat për studiuesit dhe studentët shqiptarë për të studiuar dhe studiuar në universitetet italiane ishin një mjet tjetër në rritjen e ndikimit italian.<sup>74</sup>

Përveç transformimit urban të qendrës së kryeqytetit, italianët ndërtuan në Tiranë po ashtu dhe një lagje të tipit "Pater", sipas emrit të kompanisë milaneze të inxhinierit zviceran Dario Pater që prodhonte ndërtesa parafabrikate, me 500 apartamente për familjet italiane. Këto pallate formonin nga pamja ajrore nga lart shenjwn e DUX.<sup>75</sup> Po ashtu italianët filluan dhe një program për përmirësimin e bujqësisë, dhe organizimin e fermave sipas projektit të bonifikimit integral. Pranë Tiranës u zgjodh një zonë e sheshtë me tokë pjellore, e cila u nda në dy zona, ku do të vendoseshin 900 familje italiane dhe 2000 familje shqiptare. Shtëpitë, të renditura në grupe, ishin vendosur në qendër të fermave dhe formonin 6 fshatra, me një popullsi prej 8,000 njësisish shtëpiake të shpërndara në rreth 36,000 hektarë të punueshme.<sup>76</sup>

## Përfundime

Megjithëse kolonializmi italian ishte më i vonë se sa ai i fuqive të tjera evropiane, politikat kolonialiste italiane në Shqipëri u vunë re që me krijimin e shtetit shqiptar, përmes kompanive italiane dhe pranisë sporadike të ushtrisë italiane në territorin shqiptar deri në 1920. Ndërsa prej mesit të viteve '20-të dhe deri me pushtimin e Shqipërisë prej Italisë fashiste, politika ekspansioniste e Musolinit u qendërzua edhe në ideologjinë fashiste dhe botëkuptimin kolonial të zgjerimit të hapësirës jetike italiane në Mesdhe. Kësisoj Roma do të shërbente si një fuqi civilizuese dhe transformuese për territoret e reja të saj. Italia do të kontribonte në zhvillimin dhe transformimin e peizazhit dhe

74. Trani, *L'Unione fra l'Albania e l'Italia*, 70–72.

75. Vittorio Santoanni Vittorio, "Il Razionalismo nelle colonie italiane 1928-1943. La "nuova architettura" delle Terre d'Oltremare", Tezë doktorature në Universita degli Studi di Napoli "Federico II", 2008, 80.

76. *Idem*.

shoqërisë shqiptare. Para pushtimit italian të vitit 1939, Musolini e detyroi shtetin shqiptar të bënte gjithnjë e më shumë lëshime ekonomike dhe të lejonte ndërhyrjen e kapitalit dhe kompanive italiane, si dhe vendosjen e kolonistëve italianë në territorin shqiptar. Pas vitit 1939 Shqipëria u bë një satelit i Romës, i integruar në komunitetin perandorak romak. Musolini imponoi aplikimin e modelit fashist si në politikë dhe në ekonomi. Sistemi i përmisimit social-ekonomik synonte fashistizimin e shoqërisë dhe stilit të jetesës. Modeli integral i bonifikimit të njerëzve, kulturës dhe ekonomisë ishte thelbi i politikës fashiste, përmes së cilit synohej civilizimi i shoqërisë shqiptare sipas modelit që impononte Roma. Pikërisht përmisimi dhe ripërtëritja ekonomike u tentua të aplikohesh në peizazhin shqiptar. Politikat fashiste të modernizimit rural dhe bonifikimit u panë si një shpëtim i natyrës dhe i njerëzve. Peizazhi natyror shqiptar duhej shpëtuar, ripërtëritja e natyrës dhe e njerëzve duhej të realizohej nëpërmjet teknologjisë së re dhe modernizimit të fshatarëve shqiptarë, si dhe të vendosjes së kolonistëve italianë.

Përkatësia në komunitetin perandorak, autarkia ekonomike, retorikat mbi misionin civilizues dhe shpëtues më anë të programit të kolonizimit dhe rehabilitimit, prania e ushtrisë italiane, të gjithë këto karakteristika, janë tregues të ndërtimit në Shqipëri të një modeli hibrid të sundimit kolonial italian. Dëshira për të transformuar natyrën shqiptare sipas modelit fashist të bonifikimit, krijoi një lloj mjedisi hibrid, ku italianët ishin në rolin e kolonizatorëve civilizues, që u përpoqën të modernizonin peizazhin shqiptar dhe njerëzit e pacivilizuar në Shqipëri.

*Valentina Duka*

## 28 APO 29 NËNTOR: NJË SHQYRTIM KRITIK I DOKUMENTEVE ARKIVORE SHQIPTARE

---

NOVEMBER 28TH OF 29TH.  
A CRITICAL REVIEW OF ALBANIAN ARCHIVAL SOURCES

**ABSTRACT:** One of the most polarized and controverse issues among historians in post-communist Albania has been the date of Albania's liberation from the Nazi Germans. The number of discourses and debates on this topic has engaged historians, politicians and even media. The liberation day is a "par excellence" case when today's Albanian politics has tried and tries to use history to its benefits in strengthening its influence and position upon various groups in the society.

The historiographical and political debates on liberation's day demonstrates at its best how difficult is to reach accurate and consistent conclusions when the parties strive to create different, even contradictory, perceptions and opinions about historical phenomena and events, as well as the motives and actions of their protagonists, based on interpretations, assumptions, conceptions, and prejudices often far from the historical reality of the time. Seeing the confusion and misunderstandings that this issue has caused and is causing in the public opinion; I will focus mostly on archival sources to approach this topic in understanding the stance of decision-makers in setting the liberation date during communism on November 29<sup>th</sup>, 1944. Only in this way we can understand their political and ideological in setting a special date to commemorate and celebrate the liberation of Albania from foreign occupiers.

**KEYWORDS:** liberation 28<sup>th</sup> November, 29<sup>th</sup> November, Albania, historiography

---

Një nga çështjet më të debatuar në këto dekada të postkomunizmit ka qenë data e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazistë gjermanë. Diskutimet pa fund rreth kësaj teme kanë okupuar jo vetëm segmente të caktuara nga sfera e historiografisë, por edhe skenën politike dhe mediatike. Madje ky është një nga rastet "par excellence" kur politika e sotme shqiptare është përpjekur e përpiket ta përdorë historinë në dobi të interesit për fuqizim të ndikimit dhe pozicionit të saj në shtresat e ndryshme të shoqërisë.

Madje sa herë vijnë festat e nëntorit më shumë flitet për datën e çlirimit se sa për vetë ngjarjet e rëndësishme historike që përkujtohen në këtë muaj. Ky debat sa historiografik aq dhe politik demonstroi më së miri se sa e vështirë është që të arrihen përfundime të sakta e të qëndrueshme kur palët rreken të krijojnë perceptime e opinione të ndryshme, madje kontradikore, në lidhje me dukuritë dhe ngjarjet historike, si dhe motivet e veprimet e protagonistëve të tyre, duke u bazuar në interpretime, supozime, konceptime dhe paragjykitime shpesh larg realitetit historik të kohës.

Duke parë konfuzionin dhe keqkuptimet që ka shkaktuar dhe shkakton kjo çështje në opinionin publik, si dhe duke konstatuar aty këtu edhe gabime të natyrës metodologjike, sikurse janë rastet e sforcuara për të provuar të vërtetën e një date çlirimi me kohën kur është larguar ushtari i fundit nga Shkodra,<sup>1</sup> menduam t'i qasemi kësaj teme duke bërë objekt të kumtesës shqyrtimin e dokumenteve autentike të vendimmarrësve të atëherëshëm që caktuan datën e çlirimit. Vetëm kështu mund të qartësohen më mirë sipas perspektivës sonë, motivet e vërteta që i shtynë drejtuesit kryesorë të pushtetit të ri komunist për vendosjen e një date të posaçme për të përkujtuar e festuar çlirimin e Shqipërisë nga okupatorët e huaj.

Më 28 nëntor 1944, Enver Hoxha, i shoqëruar nga pothuajse e gjithë udhëheqja komuniste, hyri në Tiranë triumfalisht si kryeministër i Qeverisë së Shqipërisë të zgjedhur në mbledhjen e Beratit, ku mbajti

---

1. Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, (Tiranë: Toena, 2014), 271-336.

edhe fjalimin e çlirimit në një tribunë të vendosur përpara hotel Dajtit. Në mënyrë solemne udhëheqësi komunist do të deklaronte:

"Në një ditë të shënuar si kjo, më 1912, pas aq kohe robërie, lindi Shqipëria indipendente. Kur vendi ynë kërcënohej nga të katër anët nga armiqtë e jashtëm, kur për popullin tonë po farkëtoheshin zinxhirë të rinj robërie, plaku Ismail Qemali, me një grusht trima patriotë, e ngriti lart flamurin e lirisë në Vlorë, dhe populli shqiptar mori frymë... Dita e flamurit u bë dita dy herë e shënjtë, dita e çlirimit (nënvizimi ynë-V.D.) dhe e bashkimit të popullit shqiptar."<sup>2</sup>

Nga fjalimi original i Hoxhës dhe jo ai ndryshuar më vonë, duket qartë se udhëheqësi komunist kishte pritur ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, 28 Nëntorin, për të mbajtur fjalimin e çlirimit të vendit nga nazifashistët, Edhe po të shohim faqen e parë të *Buletinit të Luftës Nacionalçlirimtare*, 30 Nëntor 1944, i cili botonte të gjithë veprimtaritë festive të 28 nëndorit 1944, ishte vendosur në faqen e parë të tij një poster, ku fotografia e Enver Hoxhës si kryeministër i Shqipërisë qëndronte në krah të fotografisë së Ismail Qemalit dhe mbi kokën e tyre ishte vendosur një flamur i madh kuq e zi.<sup>3</sup> Mesazhi i posterit ishte i qartë: 28 nëndori dy herë i shënjtë, dita e pavarësisë dhe e çlirimit të vendit.

Pas këtyre festimeve triditore dedikuar çlirimit të vendit, për më shumë se 11 muaj në organin shtetëror më të lartë shqiptar të kohës, në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, nuk ishte vënë asnjëherë në diskutim 28 nëntori si ditë e çlirimit të Shqipërisë. Mendojmë se kjo ishte një taktikë politike e rafinuar e kreut të komunistëve shqiptarë. Me domethënien e veçantë që kishte në historinë kombëtare të shqiptarëve, në momentet e para 28 nëntori i leverdiste

---

2. Buletini i Luftës Nacionalçlirimtare, viti i I, Tiranë, 30 Nëntor 1944.

3. *Idem*.

udhëheqjes komuniste për të fituar mbështetje e simpati në popull si çlirimtarë dhe si vazhdues të veprës së madhe të Ismail Qemalit.

Mirëpo për më tej, strehimi brenda 28 nëntorit edhe i ditës së çlirimit, nuk do të nxirrte sa e si duhet në reliev as Luftën e cila ishte kapitali i vetëm politik me të cilin komunistët erdhën në pushtet, as edhe figurën e liderit komunist shqiptar, të cilit rrezikonte t'i bënte hije figura e arkitektit të pavarësisë shqiptare. Prandaj pas një qetësie të përkohshme filluan manovrat për të gjetur një datë të posaçme për çlirimin. Sinjalet e para në këtë drejtim i dha mbledhja e Kryesisë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar më 5 nëntor 1945. Në këtë mbledhje ku merrnin pjesë të gjithë anëtarët e këtij forumi, duke përfshirë edhe Enver Hoxhën, do të diskutohej përveç të tjerash edhe një projektligj që kishte të bënte me amnistinë dhe faljen e të gjithë atyre personave që kishin kryer faje ordinere deri ditën e çlirimit.<sup>4</sup>

Projektligjin e mësipërm e kishte hartuar Manol Konomi, anëtar i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe jurist në profesion. Në dispozitën e parë të këtij ligji ai kishte vendosur datën 17 nëntor si ditë të çlirimit të Shqipërisë, ditë kjo e cila do të mbyllte kohën e amnistisë për njerëzit që kishin kryer faje ordinere gjatë luftës.<sup>5</sup> Ai sqaroi në mbledhje se kishte vendosur 17 nëntorin si ditë të çlirimit të Shqipërisë, sepse në këtë datë ishte çliruar Tirana dhe sipas tij çlirimi i kryeqytetit në të gjitha vendet shënon edhe çlirimin e vendit në tërësi.

Mirëpo ky propozim nuk gjeti mbështetjen e pjesëmarrësve të tjerë. Qirjako Harito, anëtar i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar dhe pas tij Tuk Jakova, komunist i vjetër i Shkodrës dhe komisar i Brigadës së Parë Sulmuese, propozuan që si ditë e çlirimit të Shqipërisë, në shërbim të ligjit të amnistisë, të konsiderohej 28 Nëntori i vitit 1944. Sipas Tuk Jakovës, *kur iku okupatori prej Shkodre, (28 nëntor) nuk ngeli ndonjë ushtri e huaj në ndonjë vend tjerër të Shqipërisë*.<sup>6</sup> Kjo e vërtetë e shqiptuar nga një prej përfaqësuesve më në zë

4. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 2.

5. *Idem*.

6. *Idem*.

të shkodranëve në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar pranohet nga të gjithë, sepse kështu shkruhet edhe në procesverbalin e mbledhjes. Më 5 nëntor 1945, e gjithë udhëheqja komuniste e mbledhur në Kryesinë e Këshillit Antifashist përfshi edhe Enver Hoxhën pranuan të vërtetën e Qirjako Haritos dhe Tuk Jakovës për 28 Nëntorin si ditë të çlirimit të Shkodrës dhe njëkohësisht të çlirimit të Shqipërisë. Kjo frymë e diskutimit në mbledhje u reflektua edhe në ligjin e amnistisë që u aprovua po këtë datë me votim unanim.

Në nenin 1 të ligjit thuhet: *Amnistohen të gjitha fajet ordinere të kryera edhe ditën 28 nëntor 1944.*<sup>7</sup>, datë kjo e nënvizuar në dokumentin original pa e përcaktuar si ditë çlirimi, por e nënkupuar nga diskutimet e anëtarëve të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, që si ditë fundore për amnistinë do të konsiderohej çlirimi i Shkodrës, si çlirim i gjithë Shqipërisë.

Më 9 nëntor 1945, Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar do të mbledhë përsëri, për të diskutuar për herë të parë ditën e çlirimit të Shqipërisë si festë kombëtare, në kuadër të projektligjit për festat zyrtare.<sup>8</sup> Dëshiroj të nënvizoj faktin se në projektligjin e festave zyrtare që iu vendos në tavolinë anëtarëve të Kryesinë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, qëllimisht nuk ishte shënuar dita e çlirimit të Shqipërisë si festë zyrtare, por vetëm 28 nëntori festa e pavarësisë së Shqipërisë, 9 maji dita e fitores ndaj fashizmit,<sup>9</sup> 24 maji dita

7. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 3.

8. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 37. Sipas procesverbalit, në mbledhje merrnin pjesë: Kolonel Baba Mustafa Xhani (Nënkryetar), Koço Tashko (Sekretar), Sami Baholli (Sekretar), Gjeneral-Major Bedri Spahiu, Gjeneral-Major Dali Ndreu, Gjeneral-Kolonel Enver Hoxha, Gogo Nushi, Prof. Gjergj Kokoshi, Kolonel Haxhi Lleshi, Kolonel Islam Radovicka, Kolonel Kristo Themelko, Manol Konomi, Dr. Medar Shtylla, Gjeneral-Major Myslim Peza, Nako Spiru, Olga Plumbi, Qiriako Harito, Kolonel Ramadan Çitaku, Ingj. Spiro Koleka, Gjeneral-Major Spiro Moisiu, Kolonel Tuk Jakova; edhe mungojnë vetëm: Gjeneral-Leint. Koçi Xoxe (Nënkryetar), Dr. Ingj. Gaqo Tashko, (Ministër i Bujqësisë dhe Pyjeve), Kolonel Hysni Kapo, Liri Gega, Prof. Sejfullah Malëshova, Prof. Siri Shaplllo e Dr. Ymer Dishnica.

9. *Idem.* Ky vendim ishte marrë që më 9 maj 1945.

e Kongresit të Përmetit, 10 korriku festa e ushtrisë dhe 16 shtatori, dita e Konferencës së Pezës. Mungesa e festës së çlirimit në këtë projektligj tregon se jo vetëm Manol Konomi si hartues dhe relator i tij, por edhe anëtarët e tjerë të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar madje vetë Enver Hoxha, ishin akoma në mëdyshje për ditën e cila do të konsiderohej prej tyre si festa zyrtare e çlirimit të Shqipërisë.

I pari që e mori fjalën dhe propozoi vendosjen në projektligj të datës së çlirimit të Shqipërisë ishte Bedri Spahiu, një komunist nga Gjirokastra, i cili propozoi që meqenëse 28 Nëntori kishte koïnciduar me çlirimin e Shqipërisë, d.m.th. me çlirimin e Shkodrës, emërtimi i festës së 28 Nëntorit të bëhej: Dita e Indipendencës dhe e çlirimit të Shqipërisë. Në fakt propozimi i Bedri Spahiut ishte në logjikën e zhvillimit të ngjarjeve në Shqipëri nga 28 nëndori i 1944, pra, hyrjes triumfuese në Tiranë të Enver Hoxhës dhe të Qeverisë së re të Shqipërisë, por edhe të frymës së diskutimeve për ligjin e amnistisë, 4 ditë më parë, ku 28 nëndori ishte pranuar nga të gjithë si dita e çlirimit të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë.

Mirëpo edhe propozimi i Bedri Spahiut nuk gjeti përkrahje të gjërë.<sup>10</sup> Kur ky i fundit kërkoi të votohet propozimi i tij, në fakt u mbështet vetëm nga 5 anëtarë të Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar. Në procesverbalin e mbledhjes nuk jepen emrat e anëtarëve të Kryesisë që mbështetën Bedri Spahiun.

Pas propozimit të Bedri Spahiut, mbledhja e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar për çudi vazhdoi me propozime vetëm për festa fetare siç ishte ajo e Novruzit që u përfshi në projektligj dhe ajo e Shengjergjit e cila nuk u pranua<sup>11</sup> dhe askush nuk kërkoi t'i qaset ditës së çlirimit të Shqipërisë si festë zyrtare deri sa u bënë 5 minuta pushim, që në procesverbalin e mbledhjes nuk thuhet pse u bë ky pushim dhe nga kush u kërkua.<sup>12</sup> Pas këtij pushimi e gjithë mbledhja u fokusua te dita e çlirimit të Shqipërisë, caktimi i të cilës u shoqërua me shumë diskutime.

10. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 2.

11. *Ibid.*, fl. 2.

12. *Ibid.*, fl. 1.



I pari që mori fjalën pas pushimit ishte Ramadan Çitaku i cili si për t'i zënë në faj të gjithë pjesëmarrësit kërkon të vendoset në projektligj si festë zyrtare dita e çlirimit që, sipas habitës së tij, mungonte. Kemi bindjen se Çitaku në këtë rast bënte edhe zëdhënësin e Hoxhës: Ai midis të tjerash tha:

Është harruar të vihet dita e Çlirimit të Shqipërisë. Është venë dita e Konferencës së Pezës që mori formën Lufta Nacional-Çlirimtare, është venë dita e Kongresit të Përmetit ku lufta merr formë më të gjërë, edhe ish e drejtë të viheshin dhe të festoheshin këto ditë, por është haruar, si thashë, dita e çlirimit, dita e përfundimit të Luftës së Madhe që bëri populli shqiptar. Këtë ditë duhet t'a kujtojë populli dhe t'a festojë brez pas brezi, të mbetet si një ditë historike. Dita e 28 Nëntorit 1912 është e drejtë të festohet, por edhe kjo e Luftës së Dytë, e Luftës së madhe duhet të shtohet. Vetëm është çështja e datës. Me sa di unë, pas mesnatës së 28 Nëntorit 1944, armiku që zhdukur nga e gjithë Shqipëria, d.m.th., dita e 29 Nëntorit u gdhi duke qenë Shqipëria e çliruar. Prandaj propozoj që dita e 29 nëntorit të shtohet në ditët e festave kombëtare. Ne kemi venë ditën e mbarimit të luftës së përbotëshme, e të mos vemë ditën e çlirimit të Shqipërisë, me duket do të ishte gabim.<sup>13</sup>

Ndërhyrja e Çitakut do të ndryshonte rrjedhën e diskutimeve në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar. Ajo që bie në sy është fakti se të gjithë diskutantët që morën fjalën në mbledhje pas Ramadan Çitakut, e pranuan 29 nëntorin si festë të çlirimit, megjithatë, asnjëri prej tyre nuk e asocioi atë datë me çlirimin e Shkodrës. Kjo gjë e detyroi Ramadan Çitakun të rimerrte fjalën disa herë në mbledhje duke këmbëngulur të bindte pjesëmarrësit që të

---

13. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 2.

pranonin si të vërtetë alibinë e çlirimit të Shkodrës për të justifikuar 29 nëntorin si festë kombëtare të çlirimit.

Diskutantët e tjerë që morën fjalën nuk sollën fakte se kur ishte çliruar Shkodra apo dhe Shqipëria, por këmbëngulnin tek ideja e të pasurit të një date çlirimi për Shqipërinë e ndryshme kjo nga ajo e 9 majit, sepse sipas tyre edhe Jugosllavia kishte datën e vet të çlirimit, që ishte çlirimi i Beogradit 20 tetori, edhe Bullgaria kishte ditën e saj të çlirimit,<sup>14</sup> pavarësisht se bullgarët nuk kishin luftuar sa shqiptarët.

Në mbledhje nuk diskutoi Enver Hoxha, por për të kuptuar edhe më mirë vendosjen e 29 nëntorit si ditë feste të çlirimit është e nevojshme të përmendin fjalën e Tuk Jakovës në mbledhje, ideatori i vendosjes së 28 nëntorit si ditë e çlirimit të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë në dispozitën e parë të ligjit të amnistisë. Ai nuk e përmendi asnjëherë 29 Nëntorin si ditë të çlirimit të Shkodrës, por këmbënguli në pranimin e kësaj date si festë kombëtare duke renditur edhe arsyet kryesore:

Dita e 29 Nëntorit është një datë historike e shquar dhe do të luajë një rol të rëndësishëm në ndërgjegjën e popullit shqiptar. Në këtë ditë do të mbahen fjalime dhe të kujtohen sakrificat e mëdha që ka bërë populli; me këtë datë është lidhur secili, kush ka dhënë djalën, kush atin, vëllanë etj. Data e 28 Nëntorit 1912, është një etapë tjetër, pas, pesëqind vjet robërije është fituar vetë-qeverimi dhe është e drejtë të festohet. Po edhe 29 Nëntori, duhet të festohet se dhe për këtë janë bërë sakrifica dhe punë e madhe. Kjo gjë përkrahet, thuhet në prosesverbalin e mbledhjes<sup>15</sup>.

Omer Nishani, drejtuesi i mbledhjes dhe njëkohësisht kryetari i Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, duke mbështetur 29 nëntorin si festë kombëtare, kërkon të votohet dhe pasi propozimi

---

14. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 2.

15. *Ibid.*, fl. 4.

mbështetet me shumicë votash<sup>16</sup>, 29 Nëntori si ditë feste kombëtare për çlirimin e vendit zuri vend në nenin 2 të ligjit për festat kombëtare të aprovuar po më 9 nëntor 1945.

Për këtë datë politika shqiptare ka votuar në këto 75 vjet tri herë. Për herë të parë ka votuar Kryesia e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, në mbledhjen e saj të 9 Nëntorit 1945, ku fituesit e luftës caktuan si festë kombëtare të çlirimit 29 Nëntorin, me argumentin se Shkodra dhe e gjithë Shqipëria u çliruan në këtë datë,<sup>17</sup> herën e dytë ka votuar Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në seancën plenare të 22 nëntorit 1993 duke caktur festën e çlirimit më 28 Nëntor mbi bazën e të njëjtit argument historik siç ishte çlirimi i Shkodrës<sup>18</sup>, dhe përsëri Kuvendi i Republikës së Shqipërisë mbështetur tek i njëjti argument historik, çlirimi i Shkodrës, votoi në seancën plenare të 30 nëntorit 1997<sup>19</sup> si datë feste për çlirimin e Shqipërisë, përsëri 29 Nëntorin.

Po kështu aparati propagandistik i Partisë së Punës së Shqipërisë për të mos kompromentuar datën e re të çlirimit, 14 vite më vonë ka modifikuar tekstin e fjalimit të 28 nëntorit 1944 në vëllimin e dytë të veprave të Enver Hoxhës botuar më 1968.<sup>20</sup> Pavarësisht se në veprën nr. 2, ribotimi i fjalimit bëhet duke iu referuar *Buletinit të Luftës Nacionalçlirimtare*, togfjalëshi *dita e çlirimit* që ndodhet në *Buletin*, është zëvendësuar me togfjalëshin *dita e pavarësisë*.

Në përfundim të këtij artikulli dëshiroj të theksoj se ndryshe nga diskutimet sot për largimin e ushtarit të fundit nga Shkodra, protagonistëve vendimmarrës në Kryesinë e Këshillit Antifashist Nacional-Çlirimtar, fituesve të luftës ndaj fashizmit dhe nazizmit nuk u duhej asnjë dokument për këtë gjë. Enver Hoxha pas 11 muajve, kërkonte një ditë feste për vete dhe luftën, fabula e posterit të 30 nëntorit të Buletinit të Luftës Nacionalçlirimtare ku dita e pavarësisë dhe ajo e çlirimit të festoheshin në një ditë tashmë ishte rrëzuar.

16. AQSh, F. 489, D. 108, viti 1945, fl. 4.

17. *Ibid.*, fl. 6.

18. Ligji nr. 7770, datë 22.11.1993, *Fletore Zyrtare*, nr. 14, 1993, fl. 865.

19. Kuvendi i Shqipërisë: Tiranë, 2001, F.198, 30.10.1997.

20. Enver Hoxha, *Vepra 2*, (Tiranë: Naim Frashëri, 1968), 426.

Prandaj kemi ndërhyrje dhe ndryshime edhe te fjalimi i tij i 28 nëntorit i ribotuar më 1958. Pas 9 nëntorit të vitit 1945, në posterin e 28 nëntorit do të qëndronte vetëm fotografia e Ismail Qemalit. Duke gjetur një alibi historike të menduar mirë nga Enver Hoxha, fotoja e këtij të fundit do të ishte pompoze dhe e madhe tek posteri i 29 nëntorit, ngjitur por më vete nga plaku i Vlorës, duke mos lejuar në asnjë rast që babai i pavarësisë t'i bënte hije udhëheqësit komunist. Por, pavarësisht motiveve politike dhe mënyrës së caktimit të datës së çlirimit, mendojmë se shqiptarët e rënë për atdheun, e meritonin atë datë përkujtimi. Tentativat e mëvonshme për ta ndryshuar atë përsëri rezultuan të padobishme, madje të dëmshme për kohezionin e shoqërisë shqiptare.

PROPAGANDA NË FAZËN TË LUFTËS PËR ELEMENIMIN E  
INSTITUCIONEVE FETARE NË SHQIPËRI 1966-1967

---

PROPAGANDA IN THE FINAL STAGE OF THE WAR FOR THE ELIMINATION OF THE RELIGIOUS INSTITUTIONS IN ALBANIA (1966-1967)

---

ABSTRACT: Albanian communist regime outlawed religion and waged a long campaign of repression against religious ideology, and that surely marks a dark spot on its history. In the long process of creating the "new man", the regime has changed its approach towards the ideological pluralism and freedom of faith in Albania. With this act the state not only spiritually perpetuated the population, but also severely damaged the cultural tradition of Albanian identity.

For the implementation of this process, the communist regime focused on a criminally well-structured anti-religious strategy. Religious ideology was declared hostile ideology, while institutions of faith was destroyed by the so-called "universal" methods of class warfare. Through a well-organized system of propaganda, we can see the state's commitment to the destruction of religion by all means which have left traces in collective memory. The use of anti-religious propaganda hinted in various forms, but the most popular was the "dazibao", a kind of wallposter full of political slogans and names of public enemies, which also constitutes the object of this study.

The dazibao, appeared in the Albanian everyday life, at the peak of the anti-religious campaign that waged during the hot spot of the revolutionary period : 1966-1967. It also coincides with the time when Albanian society began to be infected with elements borrowed from the Chinese cultural revolution. Precisely, as a result of these unusual "models", some new unusual practices of anti-religious war, were born. Even the dazibao, seems to have reflected a cause of dual revolutionary inspiration, so it was well-known for the classes. As a new form of public speeches, it attracted people making them abnormally sensitive to it. Its aim was to protect (legitimize) the party line, destroying ideological opponents. These particular features of the

Albanian dazibao, encouraged lot of scholars in studying it, not only out of curiosity, but mostly out of their values within the transitional justice process that Albanian society is undertaking recently.

KEYWORDS: Albania, religion, dazibao, fletë-rrufe, communism

---

Në fillim të viteve '60, politika e shtetit komunist mori karakter represiv, çka u reflektua qartë edhe në jetën shoqërore të vendit. Nën moton: "*socializmi në shtetrrëthim*", ai hartoi një program qeverisës me objektiv zhdukjen e pluralizmit ideologjik në Shqipëri. Synimi i tij ishte të mbahej pastër politika e partisë, me qëllim që të evitohej çdo mundësi për "degjenerimin revizionist" të saj, siç ndodhi me partitë simotra të Lindjes komuniste. Ndërsa këto të fundit ndërmorën nisma për liberalizimin e sistemit, Partia e Punës (PPSH) shpalli pamundësinë e bashkëjetesës paqësore të ideologjisë marksiste me ideologji alternative, kurse luftën kundër tyre e bëri objekt të luftës së klasave<sup>1</sup>.

Precedenti i luftës së klasave në ideologji, përbën, aktin më të rëndë, në shkellje të lirive dhe të të drejtave të njeriut, në përgjithësi, dhe të lirisë së besimit, në veçanti. Në zbatim të tij, u përdorën forma e metoda diktati të panjohura, gjurmët e të cilave shfaqen (tek-tuk) ende në Marrëdhënien Publike të shoqërisë shqiptare. Praktikrat komunikuese me efekt detyrues ndikuan jo pak, në indoktrinimin komunist të njerëzve dhe në vendosjen e sundimit ideologjik të PPSH-së. Një prej këtyre modeleve më tipike, deri-diku edhe më autentike të saj, e përbën komunikimi publik me fletërrufe. Ai u përdor si mjet efikas, në dobi të propagandës komuniste, për instrumentalizimin politik të luftës së klasave në frontin ideologjik. Roli i tij u bë gati përcaktues në momentin kur, procesi i luftës për eliminimin e besimit fetar, hyri në fazën finale<sup>2</sup>.

---

1. *Historia e Shqipërisë*, vëll. IV, (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1983), 320.

2. *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV, (Tiranë: Toena, 2007), 287.

Si gjithmonë, frymëzimi në të tilla raste, dmth për praktikën e reja të komunikimit publik buronte nga lart, (udhëheqja) që nënkuptonte me patjetër, udhëheqësin. Më 6 shkurt të vitit 1967, Enver Hoxha mbajti një fjalim me disa organizata partie në Tiranë, drejtuar "masave punëtore" dhe sidomos intelektualëve. Në këtë fjalim, ndër të tjera ai artikuloi dhe një "porosi", që shërbeu edhe si zanafillë e fletërrufesë. Ai bëri thirrje që: "*Cilido, pa frikë dhe me shkronja të mëdha, të shkruajë se çfarë mendon për punën dhe për njerëzit*",<sup>3</sup>.

Kjo shprehje shkaktoi reagim të menjëhershëm qytetar, dhe në përmbajtje mori kuptimin e të vërtetës absolute. Ajo filloi të qarkullojë gojë më gojë, në formën e një citati maoist, që interpretohej si konkretizim i parimeve demokratike të partisë, në mbrojtje të lirisë së fjalës e të mendimit qytetar. Për reklamimin e këtij citati u ngrit një infrastrukturë propagandistike gjigande, që shërbente për të shenjuar e autorizuar hapësirat e afishimit të fletërrufeve.

Fletërrufeja lindi si një formë specifike e adresimit të kritikës dhe e autokritikës komuniste, në mbrojtje të vijës ideo-politike të partisë. Kjo lloj kritike dallonte sepse shkruhej me shkronja të mëdha, në një letër jashtë formatit normal. Që të tërhiqte vëmendje e të nxiste reagim qytetar, ajo afishohej në mjedise publike të dukshme. Për këtë arsye, fletërrufeja u bë praktikë e detyrueshme drejtimi e komunikimi. Për afishimin e saj u ndërtuan (kënde) stenda të posaçme, në çdo fshat, lagje, ose qytet, në institucione administrative e social-arsimore, në qendrat e punës e të prodhimit, etj. Brenda një kohe të shkurtër ajo mori statusin e një lëvizjeje që përfshiu të gjithë vendin.

Fletërrufeja bënte objekt kritike këdo, që "*cenonte*", apo "*shkelte*" vijën e ideologjinë e partisë. Në kuptimin formal ajo kishte dy anë; të kritikonte të metat e dobësitë në punë dhe të vinte në dukje arritjet e rëndësishme. Por, në realitet shërbeu si një praktikë diktatoriale e ushtrimit të luftës së klasës. Sepse tashmë e kritikës e përqëndroi sidomos, te personat: që shfaqnin sjellje a qëndrime të dyshimta; që

---

3. Enver Hoxha, "Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe i pushtetit", *Zëri i Popullit* nr. 32 (5757), Tiranë, 7 shkurt 1967.

shprehnin ide, mendime, a pikëpamje të huaja, të vjetra, a konservatore; që kryenin veprime që binin ndesh me nderin e moralin komunist, etj. Më të ekspozuar ndaj saj ishin qytetarët, që predikonin dhe aplikonin procesionet fetare, apo propagandonin dogmën fetare, etj. Por, statusin e "*shkelësit të rrezikshëm*" (armikut) e gëzonin klerikët doktrinarë, të njohur si bartës e përpunues të liturgjisë fetare. Kjo e fundit goditej hapur si, ideologji reaksionare e regresive, deri dhe antikombëtare.

Komunikimi me fletërrufe ishte një format domethënës për ushtrimin e diktatit ideologjik të PPSH-së. Kjo sepse, "shkelësin" e vijës së partisë e ndante vetëm një hap nga akuza e armikut të partisë. Kaq mjaftonte për të diskredituar personin, pasi vetvetiu, implikimet e atributive të tij ishin shumë serioze; armik i popullit, i pushtetit, i socializmit, ...etj. Ndaj, fletërrufeja krijonte një situatë terrori e frike në publik. Aq më tepër që, rrallë ajo shndërrohej në kritikë-akuzë që merrte vlerën e provës së dokumentuar, në dënimin e kundërshtarëve ideologjikë. Mjafton të përmendim burgimin, në fillim të vitit 1967, të dy klerikëve të lartë katolik, Shtjefën Kurti dhe Zef Bici. Për ta, u organizuan gjyqe popullore, që siç pohon politika zyrtare, "*...vetë masa e njerëzve dhe organet e hetimit hodhën dritë mbi aktivitetin armiqësor të këtyre grupeve*".<sup>4</sup>

Të dy klerikët u dënuan si "shërbëtorë të Vatikanit", për "propagandë" kundër regjimit komunist për shërbimin e fshehtë italian dhe kundër nismave revolucionare për çrrënjosjen e fesë. Në fak, ata patën guximin të kundërshtonin me forcë mbylljen e disa kishave të njohura dhe shndërrimin e tyre në zona ushtarake ose poligone qitjeje si Shenjtorja e Zojës në Shkodër, Kisha e Shënanoi në Laç<sup>5</sup>. Madje, në mbrojtje të tyre pati dhe një reagim masiv antikomunist. Mbi 10.000 besimtarë katolikë nënshkruan një petition, drejtuar udhëheqjes së lartë komuniste. Në emër të tyre, petitionin e bëri të njohur një i ri nga Kruja, Pashko Leka. Gjatë dorëzimit të tij në Komitetin Qëndror të PPSH-së, ai bëri një prezantim tejet ironik dhe sfidues, duke u

4. Dilaver Sadikaj, "Lëvizja rrevolucinare kundër fesë në vitet gjashtëdhjetë", *Studime Historike* 4 (1981): 128

5. AQSh, F. 490, D. 470, viti 1966, fl. 6.



shprehur; "...jam njeri i edukuar, respektoj çdo njeri që nuk më bën keq, qoftë ky italian, amerikan gjerman, apo ndonjë tjetër."

Në mendimin e sotëm shkencor, qarkullojnë pikëpamje e debate rreth karakterit dhe antivlerave, që prodhoi fenomeni fletërrufe në Shqipëri në dy dekadat e ekzistencës së tij. Më dominuese është pikëpamja që e vë në dyshim, autenticitetin e kësaj praktike diktatoriale komunikimi<sup>6</sup>. Sipas saj, fletërrufeja duhet parë, jo si produkt (vepër) autokton i PP-së, por si një kopje e ngjashme, pak a shumë, me modelin revolucionar kinez "*dazibao*" (e drejta për të shkruar). Kjo pikëpamje arsyetohet e mbrohet, si me paraqitjen formale, ashtu dhe me kohën e njëjtë të praktikimit të tyre, në Shqipëri dhe në Kinë. Një pikëpamje e tillë mbështetet kryesisht, nga studiues të rinj të fjalorit të shqipes totalitare. Bazuar mbi një qasje krahasuese mbi afritë etimologjike e semiotike midis dy fjalëve, ata dalin në përfundimin se, fletërrufeja në Shqipëri u modelua sipas *dazibao*-s kineze. Ky është një term, që sipas tyre, "...fjalë për fjalë do të përkthehet; "raport me shkronja të mëdha", dhe që i referohet një forme të komunikimit publik e cila erdhi dhe u bë përfaqësuese e revolucionit kulturor"<sup>7</sup>. Por, veç kësaj, revolucioni kulturor kinez promovoi edhe tri forma të tjera të *dazibaos*; *da ming* (të flasësh në publik me zë të lartë), *da fang* (të shprehësh pikëpamjet e tua haptazi) dhe *da bianlun* (të hapësh debate të gjëra)". Të gjitha këto "të drejta", në vitin 1975, kushtetuta kineze i sanksionoi me emrin, "*katër të drejtat e mëdha*".

Ndoshta, nuk është vendi, por sidoqoftë, debati shkencor nuk e përjashton faktin që, përshtatja e fletërrufesë në realitetin shqiptar i dha asaj specifika thelbësore autenticiteti. E para, sepse ndryshe nga *dazibao* kineze, që formalisht konsiderohej e drejtë, në kuptimin e shprehjes me shkrim të fenomenit, fletërrufeja përkundrazi, ishte imponim mendimi me forcë. Në këtë kuptim ajo e mohonte lirinë e shprehjes, dhe më shumë se sa denoncim i së "keqes", ishte ndërhyrje në jetën private të njeriut. Së dyti, nuk ishte hera e parë që komunistët

6. Ardian Vebiu, *Shqipja totalitare*, (Tiranë: Çabej, 2007), 137.

7. *Idem*.

shqiptarë kopjonin modele drejtimi e komunikimi të huaja. Dhe, në përpjekje për t'u dhënë atyre ngjyrimë kombëtare, gjatë përshtatjes ata i deformonin me sigla besueshmerie si: "*socializmi i vërtetë*", "*socializmi krijues*" "*socializmit real*", "*socializmi në bllokadë*, etj. Kështu, vepruan psh kur huazuan nga jugosllavët *kooperativizmin popullor*, apo nga sovjetikët, *lëvizjen stahanoviste*. Ndaj, dhe këto huazime, edhe pse e infektuan qytetërimin shqiptar, asnjëherë nuk u bënë pjesë domethënëse e tij.

Fletërrufeja u bë pjesë e luftës ideologjike së PPSH-së, si domosdoshmëri për zgjerimin e bazës sociale të luftës kundër fesë. Në përballjen 20 vjeçare me fenë, propaganda komuniste, në këtë kohë, përgjithësonte një bilanc të pasur arritjesh. Sipas saj, ishte ngritur një infrastrukturë e plotë ligjore antifetare. Fuqia ekonomike, administrative e organizative e institucioneve fetare ishte dobësuar së tepërmi. Goditjen më të rëndë, theksonite ajo, e kishte marrë personeli klerik, qoftë me pakësimin e numrit, qoftë me mbylljen e shkollave fetare. Thua jse e gjithë elita klerikale e doktrinare ishte eliminuar, ose vuante dënimet dhe persekutimet e regjimit. Shteti e kishte çrregulluar regjimin e shërbesave dhetë kremteve fetare. Plus, që ishin mbyllur, ose shkatërruar qindra objekte të shenjta.

Gjithsesi, si ideologji me rrënjë të thella, pjesë botëkuptimore e njerëzve, feja ushtronte ende ndikim të madh në popull. Ndaj, nuk mund të çrrënjosej kurrsesi, me masa represive nga lart. Përkundrazi, ideologjia fetare zotëronte pozita monopoli në shoqëri e në familje<sup>8</sup>. Ritet, procesionet e ceremonitë fetare, pavarësisht goditjeve dominonin tërësisht jetën private e shpirtërore, por dhe atë ekonomike e shoqërore të vendit.

Në këto kushte, suksemi i luftës kundër ideologjisë fetare qe vështirësuar së tepërmi. Pushteti i saj, mbetej një sfidë që mund të "*kompromentonte*" vijën e partisë. Mesa duket, situata kërkonte mënyra e forma të reja diktati, që të rritej e garantohej efektiviteti i kësaj lufte. Vërehej

---

8. Ajet Shahu, "Shteti Komunist dhe Kisha Katolike 1945-1967", në Romeo Gurakuqi (ed.) *Krishterimi ndër Shqiptarë*, simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, (Shkodër: Toena, 2000), 362.

qartë se, pa tërheqjen e besimtarëve, lufta kundër fesë rrezikonte dështimin. Pikërisht në ndihmë të saj erdhi komunikimi me fletërrufe.

Në praktikimin e kësaj forme, propaganda zyrtare abuzoi shumë me opinionin publik. Fletërrufeja hartohej thuajse, në fshehtësi e në mungesë të plotë transparence. Po ashtu, ajo nuk bazohej në kritere të përcaktuara, që "identifikonin shkelësin" e vijës së partisë, apo "bartësit" e ideve të huaja, çka do të thoshte se, kushdo mund të bëhej viktimë e saj.

Për këtë arsye, si formë e re e ligjërimit publik, fletërrufeja tërhiqte vëmendje e krijonte sensibilitete të larta. E keqja ishte se, reagimi publik në vetvete, qoftë edhe pa vetëdije, shërbente si mjet presioni mbi individin, për imponimin e vijës së partisë. Veç kësaj, fletërrufeja adresonte kritikë të shpejtë, të atypëratyshme, d.m.th. kritikë rrufe, siç mori emrin. Në sy të publikut, qytetari i prekur, ndjehej në pamundësi reagimi, por dhe i pafuqishëm për të mbrojtur ose kontestuar të drejtën. Në këtë mënyrë, ky lloj ligjërimi për individin, shndërrohej në terror ideologjik publik.

Përveçse mjet imponimi ideologjik, fletërrufeja, shërbente edhe si mjet demaskimi publik për qytetarin e prekur. Ajo shoqërohej me një kërkesë për reflektim dhe për autokritikë të partishëm, në një afat të caktuar. Reflektimi autokritik hamendësonte që qytetari të tjetërsonte idetë, pikëpamjet apo mendimet e tij. Nga ana tjetër, duke qenë se ekspozonte jetën private, autokritika e detyruar, shfaqej si vetëdemaskim ose, më saktë, si depersonalizim i individit.

Një spekulim tjetër i propagandës komuniste lidhej me autorësinë e fletërrufesë. Zakonisht, fletërrufeja i adresohet personit ose personave, nga autorë të fshehtë, anonimë. Anonimati për regjimin komunist përbente një fenomen tipik. Më së shumti, autori personifikonte një personazh hipotetik, që shpesh identifikohet me interesin e përgjithshëm. Në këtë mënyrë, fletërrufeja merrte karakterin e një kritike kolektive, në emër të anonimit. Në pamje të parë, dukej sikur fletërrufeja nuk prekte lirinë e individit, për sa kohë, interesi i përgjithshëm qëndronte mbi atë personal dhe trumbetohej; parim themelor

i socializmit. Ndaj, kundërvënia ndaj interesit kolektiv lexohej edhe si kundërvënie ndaj vijës së partisë.

Por, ajo që theksonte më tepër karakterin antidemokratik të kritikës fletërrufe, në raport më liritë dhe të drejtat e njeriut ishte se, kjo praktikë nuk ishte e barabartë për të gjithë qytetarët. Prej saj ishin të përjashtuar, për të mos thënë të imunizuar, titullarët e lartë të partisë dhe të pushtetit, të çdo niveli. Kjo sepse, hamendësohej që, ata ishin përfaqësuesit simbol të zbatimit të direktivës së partisë. Do të thoshte që, kritika ndaj tyre cenonte drejtpërsëdrejti integritetin e vijës së partisë.

Nismëtarë, nxitës dhe ideatorë të "kritikës kolektive" me fletërrufe ishin komunistët, militantët, drejtuesit e organeve vendore të partisë e të organizatave të masave. Pikërisht, ky fakt përbën dhe një nga antivlerat e fletërrufesë, sepse, askush nuk mbante përgjegjësi, as për vërtetësinë e kritikës, as për abuzimin me liritë e të drejtat e qytetarit. Ajo hartohej e vendosej kryesisht në emër të një grupimi social, organizimi politik, organizate profesionale, kolektivi punonjës, komuniteti të lagjes apo fshatit etj. Fletërrufetë me autorë realë ishin më të rralla, pasi nuk ekzistonin grupe interesi, përveç interesit të partisë. Fletërrufe të tilla i përdornin më tepër, në funksion të zgjidhjes së konflikteve personale ose të ambicieve për pushtet.

Fletërrufeja e parë, e vlerësuar nga politika zyrtare, si "*ngjarje e shënuar*", doli nga organizata e rinisë së shkollës "Naim Frashëri" në Durrës.<sup>9</sup> Si burim "frymëzimi rrevolucionar" për të, shërbeu fjalimi i 6 shkurtit 1967, ndaj ajo u përgjithësua menjëherë në shtypin e ditës. Nëpërmjet saj, të rinjtë shprehnin shqetësim për disa fenomene që ndeshnin në shkollë: Për shembull: nxënësit hynin në klasë me këmbën e djathtë, ose për festa fetare ata ndanin karamеле, vezë, vishnin rroba të reja, etj. Sipas të rinjve, ky fenomen kishte "infektuar" të gjithë shoqërinë. Për këtë, ata tipizonin një punëtor të dalluar në Portin e Durrësit, i cili, sipas tyre, "...ditën e luftonte fenë, kurse natën vizatonte ikona", më pas i shiste tek besimtarët.

---

9. AQSh, F. 490, D. 470, viti 1967, fl. 24.

Të "*revoltuar*" nga këto fenomene, sidomos nga "*indiferentizmi i partisë*" e i "*opinionit*", të rinjtë deklarorin se nuk do ta pranorin më ideologjinë fetare. Për t'i bërë ballë presionit fetar, ata afishuan një fletërrufe në muret e shkollës, ku zotoheshin: -Të nxisnin përgatitjen intensive ideologjike të mësuesve e të nxënësve; - Të forconin agjitacionin e propagandën ateiste brenda e jashtë shkollës me parulla, fletërrufe, etj. - Të organizonin mbledhje me rininë, intelektualë e shtresa të tjera sociale, me pyetje e debate të zjarrta antifetare; - Të zhvillonin kritikë të hapur ndaj opinionit e organeve drejtuese për lëshimet ndaj fesë e klerit. Nisma e adoleshentëve parashtronte edhe disa "*kërkesa ultimative*" për organet qeverisëse; a) - fshirjen e përkatësive fetare në varre e në pasaporta, b) - ndalimin e përshëndetjeve fetare, c) - dënimin e "*parazitizmit të klerit*". Në respekt të kësaj nisme, të rinjtë shkuan në Shën Vlash, ku mbështetën rininë e fshatit, për kthimin e kishës atje, në vatër kulture<sup>10</sup>.

Fletërrufeja e tronditi si rrallë herë opinionin dhe prodhoi efektin zinxhir, duke u shtrirë në të gjithë vendin. Shtypi dhe media zyrtare shpejtuan të shpjegonin përmbajtjen revolucionare të nismës dhe të përgjithësonin përvojën e saj në rrethe të tjera. Mbi të gjitha, ato u kujdesën të krijonin përshtypjen se, tashmë lufta kundër fesë kishte fituar bazë të gjerë sociale dhe paraqitej, si kërkesë nga poshtë. Si provë besueshmërie përdorej edhe fakti që, nisma erdhi nga një institucion i dijes dhe i brumosjes me botëkuptim ateist, siç ishte shkolla socialiste.

Këto janë dy nga spekulimete mëdha të propagandës komuniste që shfaqen edhe si shtrembërim flagrant i së vërtetës historike. Sepse, nisma e mësipërme, shërbeu thjesht si alibi, për të kaluar në fazën finale të luftës kundër fesë. Si e tillë, siç e thekson edhe shtypi, ajo lindi nga "*frymëzimi revolucionar*", i "*vijës marksiste-leniniste të partisë*", etj., që dihet se nga buronte. Madje, procedura e kësaj "nisme" provon qartë shpërdorimin politik të rinisë. Këtë e pohon vetë E. Hoxha, kur thekson se, shkëndija e nxënësve revolucionarë të Durrësit, e

---

10. "Me shpatën e mprehtë të ideologjisë së partisë, kundër ideologjisë fetare, paragjytimeve, bestitnyve e zakoneve prapanike.", *Zëri i Popullit*, nr. 33, Tiranë, 8 shkurt 1967.

frymëzuar nga partia ndezi një zjarr, "...që fshiu nga faqja e dheut, vatrat e obskurantizimit fetar"<sup>11</sup>.

Pas kësaj, nisma të tilla u nxitën në të gjithë vendin. Kleriku At. Zef Pllumi përshkruan me hollësi situatën e terrorit që krijuan fletërrufetë kundër fesë, në qytetin e Shkodrës. Më 15 shkurt 1967, ai kujton se dyert e institucioneve fetare u gdhinë të mbushura me fletërrufe. Kryesore ishte se, fletërrufetë i vendosnin në mënyrë të tillë që nuk lejonin hapjen e dyerve. Në rast të kundërt, "kritikët" (autorët) kërcënonin se heqja konsiderohej vepër përgjegjësie.<sup>12</sup> Kurse një tjetër klerik katolik, Zef Simoni, kujton: grupe të rinjsh adoleshentë, shpërndanë fletërrufe në të gjitha dyert e objekteve të kultit, drejtuar klerikëve e personelit fetar. Në to shkruhej: "*Klerikë, mjaftë keni gënjyer*", "*Fitoni bukën me djersë*", "*Populli e rinia nuk ju do*". "*Feja është qendra e obskurantizimit*", etj"<sup>13</sup>.

Kudo në vend shpërtheu një duf i papërmbajtur kundër institucioneve të fesë. Turma të irrituara të rinjsh, të drejtuar nga militantë partiakë, shembën dhe shkatërruan vlera të shumta kulturore. Kjo luftë u mbyll me një bilanc tragjik dëmsh, si në burime njerëzore e ekonomike, por sidomos në vlera të trashëgimisë kulturore. Edhe pse ende nuk ka një evidencë të saktë, mund të themi se përmasat e dëmeve tejkalojnë çdo kufi të imagjinatës njerëzore. Deri tani është përlogaritur vetëm një pjesë e vogël e dëmeve që lidhen kryesisht me shkatërrimet fizike të objekteve të kultit dhe me pasuri të tjera materiale të enteve fetare. Nga këto të dhëna del se, gjatë këtij procesi u mbyllën, u shkatërruan dhe u tjetërsuan 2035 objekte kulti; të ndara sipas përkatësive fetare; 740 xhami, 608 kisha ortodokse e manastire, 157 kisha katolike dhe

11. Enver Hoxha, *Rapporte e fjalime*, 1967-1968, (Tiranë: Shtëpia Botuese, "Naim Frashëri", 1969), 206.

12. At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, (Tiranë: Hylli i Dritës, 1997), 250-252.

13. Imzot Zef Simoni, "Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri, 1944-1990", në në Romeo Gurakuqi (ed.), *Krishterimi ndër Shqiptarë*, simpozium ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, (Shkodër: Toena, 2000), 380.

503 teqe, tyrbe e mekame.<sup>14</sup> Këtu bëjnë përjashtim dhe një numër i vogël objekteve kulturi që u konsideruan si monumente kulturore.

Si praktikë e re komunikimi me publikun, fletërrufeja luajti rol të madh edhe në lëvizjen e ashtuquajtur për emancipimin e gruas. Sikundër u tha, si tregues për këtë lëvizje shërbeu fjalimi i liderit E. Hoxha, më 6 shkurt të vitit 1967. Në këtë fjalim, ai trajtoi edhe pozitën social-ekonomike diskriminuese të gruas, në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Kjo situatë, theksoi ai, kushtëzohej nga ekzistenca e zakoneve të vjetra (prapanike), në mënyrën e jetesës dhe nga zbatimi i normave të së drejtës kanunore. Për të dalë nga kjo gjendje, Enver Hoxha bëri thirrje që, paria e popullit të ngrihen në këmbë dhe "*...të dëgjin me zjarr dhe t'i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe vajzave*".<sup>15</sup>

Kështu, ideologjia fetare u konsiderua pengesë kryesore për emancipimin e gruas. Sipas udhëheqjes së PP-së, ishin pikërisht zakonet dhe paragjykimet fetare ato që mbanin peng të drejtat e grave, dhe i bënë sfidë të drejtës socialiste. Për këtë arsye, shtypi dhe media çdo ditë denonconin shembuj të shumtë mbi karakterin maskilist e patriarkal të familjes shqiptare, sidomos në fshat. Theksi vihej në mbingarkesën e gruas me punë shtëpiake, në nëpërkëmbjen e të drejtave të saj në shoqëri e familje, në drejtim, në administratë. Këto dukuri negative, që sipas propagandës i mbanin gjallë normat e vjetra të së drejtës zakonore, mbronin privilegjet e klerikëve dhe të fesë dhe i kundërviheshin hapur mënyrës së re të jetesës socialiste.

Prandaj, për ta gërrshetur lëvizjen kundër fesë, me atë për emancipimin e gruas, u ndërmorën disa masa të shpejta organizative e ligjore. Në mesin e shkurtit 1967, u krijua shtabi i përgjithshëm për drejtimin e luftës kundër zakoneve prapanike dhe bestytnive fetare, me në krye Ramiz Alinë. Enver Hoxha, tashmë i konsoliduar si një lider politik absolut, me një letër të posaçme (27 shkurt 1967), urdhëroi organet

14. Kastriot Dervishi, *Histori e shtetit shqiptar, 1912 – 2005*, (Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2006), 706.

15. AQSh, F. 14 / AP S.T.R. viti 1967, D. 202, fl. 52: Raport mbi gjendjen e gruas dhe rritjen e personalitetit të saj.

vendore partiake, të bindnin çdo njeri se, "*feja ishte opium për popullin*". Me këtë letër, ai shfaqti hapur ambicien për t'u shndërruar edhe në një lider shpirtëror i shqiptarëve.<sup>16</sup>

Letra, si rrallë herë, i motivoi organet partiake që, në bashkëpunim me organizatat e masave, të stimulonin situata terrori mbi institucionet e veprimtaritë fetare dhe të minimizonin çdo rezistencë antiqeveritare. Nga ana tjetër, propaganda ateiste, nëpërmjet fletërrufeve, shpalljeve, posterave, medias etj. krijonte opinione sikur procesi i deideologjizmit fetar, më shumë se detyrë partiake, ishte çështje emancipimi e progresi qytetar. Madje, për t'i dhënë besueshmëri procesit, u mobilizua edhe "Kuvendi i Pleqve", një institucion tradicional, i anatemuar jo pak gjatë regjimit. Mbi bazën e një grafiku të përcaktuar, këto organe thërrisnin mbledhje ose kuvendet, ku deklarorin nisma kundër rriteve fetare, në funksion të përqafimit të vijës së partisë. Më pas, shtypi zyrtar i prezantonte këto si shprehje të presonit revolucionar nga poshtë, për të mposhtur fenë.

Në fakt, kjo ishte përpjekje për ta klasifikuar procesin e emancipimit të gruas, vepër të partisë. Sepse, ç'është e vërteta, në ecurinë e këtij procesi, prapambetjes ekonomike e varfërisë ekstreme të vendit, vepronin shumë faktorë të tjerë socialë, kulturorë, arsimorë etj. Jo pak rol luanin faktorët tradicionalë. Qytetërimi shqiptar barte ende një frymë të theksuar konservatorizmi e patriarkalizmi. Shpesh, tek burri ngrinte krye, për të mos thënë se mbizotëronte egoizmi mashkullor dhe ndjenja e të qenit pronar mbi gruan. Për të, funksioni i gruas shtrihej brenda kuadrit të familjes dhe kujdesit për ekonominë shtëpiake. Më e keqja ishte se dhe vetë gratë e pranorin këtë ndjenjë të theksuar inferioriteti.

Në vitet '60, PPSH-ja publikoi një program qeverisës i cili e konsideroi të pamundur bashkëjetesën paqësore të ideologjisë marksiste me ideologji alternative, kurse luftën kundër tyre e bëri objekt të luftës së klasave. Precedenti i luftës së klasave në ideologji, përbën aktin më të rëndë, në shkelje të lirive dhe të të drejtave të njeriut,

---

16. PPSH, *Dokumente Kryesore*, vëll. IV, (Tiranë: 8 Nëntori, 1974), 240.



në përgjithësi, dhe të lirisë së besimit, në veçanti. Në zbatim të tij, u përdorën forma e metoda diktati të panjohura. Një prej këtyre modeleve më tipike, deri-diku edhe më autentike, e përbën komunikimi publik me fletërrufe.

Fletërrufeja u bë pjesë e luftës ideologjike së PPSH-së, si domosdoshmëri për zgjerimin e bazës sociale të luftës kundër fesë. Në mendimin e sotëm shkencor, qarkullojnë debate rreth origjinës dhe antivlerave, që prodhoi fenomeni fletërrufe në Shqipëri. Komunikimi me fletërrufe ishte një format domethënës për ushtrimin e diktatit ideologjik të PP-së. Në thelb të tij, qëndronte kritika dhe autokritika publike (komuniste). Ajo bënte objekt kritike cilindo individ, (me emër konkret) që shfaqte kundërshti ideologjike apo kryente veprime që binin ndesh me vijën e partisë. U quajtën fletërrufe sepse, kjo lloj kritike ishte e shpejtë, e papritur dhe me efekt të menjëhershëm d.m.th., binte mbi kokën e njerëzve, tamam "si rrufe në qiell të pastër".

Fletërrufeja e parë, e vlerësuar nga politika zyrtare, si "*ngjarje e shënuar*", doli nga organizata e rinisë së shkollës "Naim Frashëri" në Durrës. Ajo e tronditi si rrallë herë opinionin dhe prodhoi efekt zinxhir, duke u shtrirë në të gjithë vendin. Kudo në vend shpërtheu një duf i papërmbajtur kundër objekteve të kultit, të cilët brenda vitit 1967 dolën tërësisht jashtë funksionit si institucione të ushtrimit të lirisë së besimit. Turma të irrituara të rinjsh, të drejtuar nga militantë partiakë, shembën dhe shkatërrojnë vlera të shumta kulturore.



*Pranvera Teli (Dibra)*

## PROCESI I ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË KONFERENCËN PËR BASHKËPUNIMIN NË EVROPË (OSBE)

---

ALBANIA'S MEMBERSHIP PROCESS IN THE CONFERENCE ON SECURITY AND  
CO-OPERATION IN EUROPE, (OSCE)

**ABSTRACT:** The easing of tensions between East and West, the political changes in Eastern Europe, the economic crisis in the country, the growing dissatisfaction of the Albanian society with the communist leadership and the denial of basic human rights, urgently required a reflection on the political attitudes held towards the international factor and European processes, starting with the Helsinki process which included within it East and West. This new position appeared in the 9th Plenum of the Central Committee of the former ALP on January 22, 1990. In this Plenum it was decided that Albania should participate with full rights in the next meeting of the CSCE in Paris, in November 1990, a meeting that was considered Helsinki-2 where the CSCE would define its new role in a new order of international relations after the end of the Cold War. This ambitious claim of the Albanian communist leadership would go a long way between the need to carry out fundamental political and economic reforms, international pressure to do so, the fear of the communist leadership that this would pave the way for the overthrow of its political power, as well as the unwillingness of the internationals to support a government that did not guarantee the full success of the required reforms.

Based mainly on diplomatic archival sources, the article undertakes to analyze the path described by the emergence of the desire to be a full member of the CSCE, January 1990, until the realization of this ambition in June 1991. This political journey of Albania in external relations were accompanied by major political reforms, such as the establishment of political pluralism in the country, the legal improvement of human rights in Albania, the establishment of diplomatic relations with major Western countries, but also with the institutionalization of the CSCE itself. As such, the road to it

would pass through some political filters and objective assessments. In June 1991, Albania had entered the path of democratic transformations, but still unfinished. Its admission to the CSCE was the first international support for Albanians on the difficult path of their efforts to make Albania like Europe.

KEYWORDS: Helsinki Process, CSCE, reform, observers, rights, Paris, membership

---

Konferenca për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (KSBE) që u mbajt në Helsinki në korrik të vitit 1975, ishte një ngjarje historike që identifikoi qëndrime të përbashkëta dhe vullnetin për të bashkëpunuar në shuarjen e konflikteve, të vatrave të krizës, për ruajtjen e paqes e të sigurisë. Akti Final i kësaj Konference u pranua dhe u nënshkrua në Helsinki me 1 gusht 1975 nga 34 shtete, ku bënë pjesë të gjitha vendet evropiane me përjashtim të Shqipërisë, SHBA-së, dhe të Kanadasë. Ky Akt dhe parimet e tij nuk përshtateshin në shumë drejtime me filozofinë politike komuniste të udhëheqjes shqiptare të atyre viteve, dhe regjimin totalitar të instaluar në Shqipëri, veçanërisht kur bëhej fjalë për respektimin e të drejtave të njeriut. Shqipëria socialiste kishte humbur rastin e madh duke mos pranuar ofertën diplomatike të Perëndimit, duke bojkotuar në këtë mënyrë debatin e vazhdueshëm shumëpalësh mbi të ardhmen e Evropës që kishte filluar në Helsinki 1975.<sup>1</sup> Akti Final i Helsinkit hodhi themelet e atij procesi që ndihmoi në transformimet e mëdha në kontinentin tonë 15 vite më pas. Duke mos qenë pjesë e këtij procesi që në gjenezën e tij, këto transformime do të vonoheshin në Shqipëri, por nuk do të ndaleshin dot.

### **Qëndrimet e reja politike dhe zhvillimet në kuadër të procesit "Helsinki 2", Paris nëntor 1990**

Në fund të viteve '80-të, kur klima e marrëdhënieve politike Lindje-Perëndim sa vinte e zbutej nga tensioni i vazhdueshëm, dhe Evropa

---

1. Elez Biberaj, *Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë*, (Tiranë: Botimet Ora, 2000), 74.

Lindore komuniste kishte hyrë në vrullin e revolucioneve demokratike dhe zhvillimeve shumë të shpejta politike, KSBE-ja e gjeti të nevojshme të ripozicionohej në rolin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare. E filluar si një forum që synonte të zhdukte gradualisht barrierat artificiale, të ngritura midis Lindjes dhe Perëndimit, tani do të ishte e nevojshme që të merrte tiparet e një organizmi ndërkombëtar, i cili duhej të ishte një instrument që të shërbente për parandalimin e konflikteve të mundshme mes shteteve anëtare që mund të pasonin shkrirjen e akujve të Luftës së Ftohtë.<sup>2</sup> KSBE-ja duhej të përgatitej për të ecur para drejt një Evrope të re dhe drejt marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Kishte ardhur koha për një Helsinki 2. Presidenti francez Miteran ofroi Parisin si vend mikpritës.<sup>3</sup> Kjo mbledhje do të shënonte pikënisjen e një etape të re më të avancuar të procesit të KSBE-së, do t'i jepte atij drejtime të reja, dhe do ta institucionalizonte këtë proces.

Udhëheqja komuniste shqiptare mbajti një qëndrim politik ndaj këtyre zhvillimeve. Në fakt, në kujtimet e tij, ish-presidenti Alia shprehet se menjëherë pas vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me RFGJ, shtator 1987, Tiranën e vizitoi ministri i jashtëm gjerman, Hans-Dietrich Genscher, i cili në takimet me drejtues të shtetit shqiptar kishte shtruar çështjen që Shqipëria duhej të inkuadrohej në inisiativat politike evropiane, duke nënkuptuar këtu mospjesëmarrjen e vonuar të saj në procesin e Helsinkit, KSBE.<sup>4</sup> Kriza e thellë ekonomike në vend për shkak të vetëizolimit të vendit dhe pasiguria në një botë që po ndryshonte në kushtet e fundit të Luftës së Ftohtë, kërcënonin pushtetin politik, siç po ndodhte në vendet e tjera të Evropës Lindore. Në Plenumin e 9-të të Komitetit Qendror të ish-PPSh-së, në 22 janar 1990, Ramiz

2. Arben Puto (ed.), *KSBE, Njohuri të Pergjithshme*, (Tiranë: botim i Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 1993), 50

3. Arkivi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më tej AMEPJ), Fondi MPJ, viti 1990, D. 1263, fl.1: "Analizë e Drejtorisë së Organizatave Ndërkombëtare në MPJ", 6.1.1990.

4. Ramiz Alia, Blerim Shala, Llukman Halili. *Unë, Ramiz Alia: dëshmoj për historinë*, (Tiranë: Shtëpia Botuese "Dituria", 1993), 143.

Alia, Sekretari i Parë i KQ të PPSH-së, duke shprehur shqetësimin për ngjarjet e vrullshme që po ndodhnin në vendet e Evropës Lindore, ku po avancohej me rrëzimin e sistemit komunist, pranoi disa lëshime në drejtim të sistemit ekonomik dhe politik në Shqipëri, por vazhdoi të shprehej kundër pluralizmit politik në vend. Ai propozoi rishikimin e legjislacionit dhe konkretisht ngritjen e institucionit të mbrojtjes juridike dhe të Ministrisë së Drejtësisë, rishikimin e luftës së klasave, një ndër tiparet thelbësore të sistemit komunist totalitar në Shqipëri.<sup>5</sup> Në cilësinë e drejtuesit kryesor të partisë-shtet, duke argumentuar politikën e jashtme të deriatëhershme të Shqipërisë, Alia u përpoq të argumentonte vonesën e hyrjes së Shqipërisë në Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin Evropian. Ai deklaronte se Shqipëria edhe pse nuk kishte marrë pjesë në Helsinki 1, ajo nuk kishte qenë as kundër e as e painteresuar për sigurimin evropian. Sipas Alisë, Shqipëria nuk kishte marrë pjesë në Helsinki 1, pasi aty shtetet ishin të grupuar në blloqe rreth dy superfuqive, dhe Shqipëria nuk bënte pjesë në to, dhe jo për t'iu shmangur akuzave për shkelje të të drejtave të njeriut, lirinë e besimit apo të lëvizjes së njerëzve, siç akuzohej nga faktori ndërkombëtar.<sup>6</sup> Ky qëndrim ishte përmbledhur në tezën politike të deklaruar të Alisë "*Shqipëria as Lindje e as Perëndim*".<sup>7</sup>

Alia u përpoq të argumentonte se tani rrethanat politike ndërkombëtare ishin krejt të ndryshme, pa blloqe e luftë mes superfuqive në kuadër të zbutjes së marrëdhënies Lindje – Perëndim. Tani secili vend do të mbronte interesat e veta e jo të bllokut ku bënte pjesë. Alia paralajmëroi në Plenum se Shqipëria do të synonte të merrte pjesë në Konferencën "Helsinki 2" që do të mbahej në Paris me statusin e anëtarit të plotë, por si hap i parë mund të pretendonte të merrte pjesë

5. Luljeta Progni, *Trashëgimtarët. Partia Socialiste midis transformimeve dhe vazhdimësisë*, (Tiranë: UETPress 2010), 50-51.

6. AMEPJ, Fondi MPJ, viti 1990, D. 8, fl. 65-67: "Tezat në Plenumin e 9-te të KQ të PPSH për pjesëmarrjen në "Helsinki-2".

7. Servet Pëllumbi, *Përmbysja e "Komunizmit"*, (Tiranë: UETPress, 2015), 123.

edhe si vëzhguese duke ua kërkuar këtë organizatorëve.<sup>8</sup> Plenum IX i KQ të PPSH-së preku për herë të parë thelbin e sistemit komunist në Shqipëri.<sup>9</sup>

Një muaj më pas, në 20 shkurt 1990, në Misionin e Përherëshëm të Shqipërisë pranë OKB-së, në New York, mbërriti një kërkesë për vizë, por edhe për ndihmë në organizimin e vizitës në Shqipëri nga Kryetari dhe bashkëkryetari i Komisionit për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë, pranë Kongresit Amerikan, i njohur edhe si Komiteti i Helsinkit i SHBA, Dennis De Concini dhe Steny H. Hoyer. Qëllimi i vizitës do të ishte diskutimi me autoritetet shqiptare lidhur me situatën e tensionuar në Kosovë, pretendimet jugosllave se Shqipëria ishte burimi i turbullirave atje, si dhe të diskutonin çdo problem tjetër që do të sugjeronin autoritetet shqiptare, edhe pse Shqipëria nuk ishte pjesë e procesit të KSBE-së. Kjo kërkesë ishte testi i parë i qëndrueshmërisë së angazhimeve të reja të udhëheqjes shqiptare për hapje në politikën e jashtme. Ajo u refuzua nga autoritetet shqiptare, pasi u mendua se mos përkthehej si njohje i Aktit të Helsinkit apo hap drejt vendosjes së marrëdhënieve me SHBA-në.<sup>10</sup>

Para vizitës në Shqipëri të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB Javier Pérez de Cuéllar, ishin bërë publike qëndrimet e qeverisë shqiptare se Shqipëria dëshironte t'i jepte fund izolimit dhe të bashkohej në procesin multilateral të Helsinkit. Duke shfrytëzuar këtë situatë, bashkëkryetarët e Komitetit të Helsinkit të SHBA-së në *U.S CSCE News Relase* e asaj dite deklarorin që:

"Si pjesëmarrëse në procesin e Helsinkit, Shqipëria duhet të angazhohet të respektojë të drejtat e qytetarëve të vet për lirinë e shprehjes, të mbledhjes dhe të bashkimit në shoqata, si edhe lirinë e lëvizjes... . Ajo

8. AMEPJ, Fondi MPJ, viti 1990, D. 8, fl. 65-67: "Tezat në Plenumin e 9-te të KQ të PPSH për pjesëmarrjen në "Helsinki-2".

9. Progni, *Trashëgimtarët*, 51.

10. AMEPJ, Viti 1990, D. 1265, fl.1-8: "Kërkesa e Komisionit dhe përgjigja e MPJ", 20.2.1990.

duhet të pranojë konceptet e pluralizmit politik dhe të shtetit ligjor, dhe për këtë qëllim duhet të shkojë drejt zgjedhjeve të lira dhe të ndërmarrë reforma ligjore të domosdoshme".<sup>11</sup>

Me 17 maj 1990 ky Komitet, pasi përshëndeti deklaratën e Çarçanit, përsëriti kërkesën për vizë për të vizituar Shqipërinë. Këtë radhë kërkesa u miratua nga udhëheqja shqiptare dhe vizita propozohej të zhvillohej në fund të qershorit ose në fillim të korrikut 1990.<sup>12</sup> Ngjarjet e 2 korrikut e shtynë këtë vizitë me 19-22 gusht 1990.<sup>13</sup>

Pas dakordësisë së arritur gjatë vizitës së Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së në Tiranë, 6 anëtarët e familjes Popaj, u larguan nga Shqipëria, të pajisur me pasaportë shqiptare dhe pa pasoja në maj 1990, pas më shume së 4 vite qëndrimi në ambasadën italiane në Tiranë. Kjo dha një sinjal pozitiv për faktorin ndërkombëtar.<sup>14</sup>

Nga 5 deri më 29 qershor 1990 u zhvilluan në Kopenhagë mbledhja e KSBE-së për çështjet humanitare, ku morën pjesë ministrat e jashtëm të të gjitha vendeve anëtare ose zëvendësit e tyre. Për herë të parë Shqipëria kërkoi të merrte pjesë në këtë takim me statusin e vëzhguesit. Kërkesa e saj u miratua nga organizatorët, duke dhënë në këtë mënyrë mesazhin se mirëprishnin dhe nxisnin hapat e Shqipërisë për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut. Pjesëmarrja e Shqipërisë u përshëndet nga shumë ministra të jashtëm kryesisht nga Evropa Lindore, pjesëmarrës në takimin e Kopenhagës. Diplomatët e huaj deklaruan se "*tani procesi evropian mori pamjen e tij të plotë*

---

11. Biberaj, *Shqipëria në tranzicion*, 75. AMEPJ, viti 1990, D. 1265, fl.12: "Press Release e Komitetit te Helsinkit SHBA", 10.05.1990.

12. AMEPJ, viti 1990, D.1265 fl.13,14, 21.

13. Ibid., fl. 32-34, 117: "Letër e Komisionit, 9 gusht 1990".

14. Pranvera Teli-Dibra, "Il contributo dell'Italia all'apertura dell'Albania comunista nella seconda meta degli anni Ottanta del Ventesimo secolo", në Paolo Rago (ed.) *Prima della fine. Le relazioni italiano-albanesi nella fase conclusive della Guerra Fredda*, (Roma-Bari, Laterza, 2021), 224.



*evropiane*".<sup>15</sup> Nga ana tjetër, nisur nga fakti që delegacioni shqiptar atje ripohoi qëndrimin e Alisë që Shqipëria nuk kishte ndërmend të lejonte krijimin e partive opozitare, disa vende perëndimore megjithëse përshëndetën pjesëmarrjen e vendit tonë në takim, por shprehën një farë hezitimi dhe sugjerimi që pjesëmarrja e plotë e Shqipërisë kërkonte angazhimin e saj për zbatimin e të gjitha dokumenteve të Konferencës dhe aktet e miratuara deri atëherë, ku dimensionin human konsiderohej vital për gjithë procesin e KSBE-së. Sipas studiuesit Biberaj, përfundimi i tha hapur qeverisë shqiptare se ajo kishte për të bërë një rrugë të gjatë para se Shqipëria të pranohej si anëtare me të drejta të plota e bashkësisë ndërkombëtare.<sup>16</sup>

Po në qershor 1990, një delegacion i Ministrisë së Punëve të Jashtme i kryesuar nga zv/ministri i Jashtëm Muhamet Kapllani zhvilloi në Paris e Bon konsultime politike bilaterale mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në KSBE. Përfaqësuesit e dy vendeve përshëndetën dëshirën e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e KSBE-së dhe reformat që kishin filluar brenda vendit. Ata theksuan se reformat duhej të thelloheshin në frymën e Aktit të Helsinkit e të arritjeve të deriatëhershme të procesit evropian. "*Shqipëria e ka vendin e vet në Evropë, por varet shumë prej saj si dhe kur do të bashkohet me të*" - u shprehën diplomatët e huaj.<sup>17</sup> Ata e konsideronin të përshtatshme për Shqipërinë statusin e vëzhguesit, të paktën deri në mars 1992 me qëllim që gjatë kësaj periudhe tranzitore të bëheshin adoptimet e nevojshme në legjislacionin e brendshëm të vendit e të konkretizoheshin ato në realitetin e prekshëm.<sup>18</sup>

Konsultimet vazhduan në Vjenë, Gjenevë e Stokholm. Delegacionit shqiptar iu kërkua nga bashkëbiseduesit që qeveria shqiptare në fillim duhej të bënte një deklaratë të qartë zyrtare ku të theksohej pranimi nga Shqipëria i dokumenteve të KSBE-së.<sup>19</sup> Ministri i Jashtëm Malile

15. AMEPJ, viti 1990, D.1264, fl.107: "Info e ambasador P. Bushati për MPJ", 6.6.1990.

16. Biberaj, *Shqipëria në tranzicion*, 75.

17. AMEPJ, viti 1990, D.1276, fl.29: "Informacion mbi takimet ne Bon e Paris".

18. *Idem*.

19. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl. 1, 5: "Komunikim i Reis Maliles, 12.7.1990".

i propozoi udhëheqjes politike shqiptare të kohës që një deklaratë e tillë të bëhej sa më shpejt, para mbylljes së takimeve përgatitore të Mbledhjes së Parisit, por ngjarjet e korrikut devijuan vëmendjen e udhëheqjes politike. Ato patën jo pak kosto për regjimin në përkeqësimin e imazhit për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Komisioni i Helsinkit i SHBA-së vizitoi Shqipërinë në 19-22 gusht 1990. Vizita u shoqërua me mungesë dakordësie për shumë çështje, veçanërisht lidhur me situatën e trajtimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, konkretisht për parime të tilla, si pluralizmi politik, ekonomia e tregut dhe ushtrimi i pakufizuar i fesë etj. Gjithsesi nga pala amerikane kjo vizitë u konsiderua si fillimi i një dialogu të sinqertë me palën shqiptare. Ata ranë dakord të mbështesnin statusin e vëzhguesit për Shqipërinë edhe në takimet e tjera të KSBE-së dhe i deklaruan udhëheqjes shqiptare të kohës se procesi do të monitorohej. Vetëm kur Shqipëria të tregonte seriozitet në realizimin e synimeve të saj nëpërmjet afrimit të politikave dhe të praktikave të saj me ato të KSBE-së, do të kishte një qëndrim tjetër.<sup>20</sup>

Pas largimit të tyre nga Shqipëria, me 23 gusht 1990 u zhvillua mbledhja e Byrosë Politike. Në raportin e paraqitur, ministri i jashtëm Malile argumentonte se zgjatja e mbajtjes së statusit të vëzhguesit dhe mbetja e Shqipërisë jashtë zhvillimeve të reja evropiane, nuk ishte në interesin e saj. Vonesa do të çonte në përjashtimin e mundësive për t'u përfshirë në strukturat që po kristalizoheshin në Evropë, do të vështirësonte zhvillimin e një politike aktive dhe zgjerimin e marrëdhënieve të Shqipërisë me vendet evropiane. Ky izolim do të krijonte terrenin e përshtatshëm për fillimin e tensioneve brenda vendit. Ai propozonte takimin e nivelit të lartë në Paris si stacionin e parë të pjesëmarrjes së Shqipërisë në KSBE me të drejta të plota.<sup>21</sup> Siç kishin sugjeruar disa shtete në konsultime politike, Malile i propozoi udhëheqjes politike formulimin e një deklaratë në emër të qeverisë

---

20. AMEPJ, viti 1990, D.1265, fl. 117-120: "Raport i Komisionit amerikan të Helsinkit, 23 gusht 1990".

21. AMEPJ, Fondi Organet e Larta të PPSH, viti 1990, D. 6, fl. 6: "Fjala e Reis Maliles".

shqiptare mbi njohjen dhe pranimin nga ana e Shqipërisë të parimeve që përmbanin dokumentet kryesore të KSBE-së dhe menjëherë të njoftoheshin të gjithë vendet anëtare për kërkesën e Shqipërisë për pjesëmarrjen e saj me të drejta të plota në takimin e Parisit.<sup>22</sup> Raporti nuk u prit pa kundërshtime brenda Byrosë Politike. Një pjesë e anëtarëve nuk e shihnin me sy të mirë hapjen e Shqipërisë drejt Perëndimit, pasi e shihnin si kërcënim për pushtetin e tyre politik.<sup>23</sup>

Ndërkohë diplomacia shqiptare filloi punën që Shqipëria të merrte pjesë në statusin e vëzhguesit në mbledhjen e Ministrave të Jashtëm të KSBE-së në New York, 1-2 tetor 1990, si mbledhje përgatitore për takimin e Nivelit të Lartë në Paris 19-21 nëntor 1990. Në përmbushje të këtij synimi, më 12 shtator 1990 Malile dërgoi letërën e parë në emër të qeverisë shqiptare për Sekretarin e Shtetit Xhejms Bejker në cilësinë e përfaqësuesit të vendit pritës të takimit, Ministrit të Jashtëm të Francës, Roland Dymas, në cilësinë e përfaqësuesit të vendit pritës ku do të mbahej Mbledhja e Nivelit të Lartë të KSBE, si dhe Ministrit të Jashtëm të Finlandës, z.Partti Passio, në cilësinë e shtetit ku ishte depozituar Akti i Helsinkit. Në letër Malile theksonte se ky moment vlerësohej nga qeveria shqiptare si më i përshtatshmi për t'u bashkuar me të drejta të plota në procesin e Helsinkit, duke marrë përsipër zbatimin e të gjitha vendimeve që do të merreshin në mbledhjen e Parisit.<sup>24</sup>

Në mbështetje të kësaj kërke, me 15 shtator 1990 qeveria shqiptare, pas miratimit të dhënë nga Byroja Politike, dëgjoi raportin e ministrit të jashtëm Malile mbi pjesëmarrjen e Shqipërisë në procesin e KSBE-së dhe hapat që ishin ndërmarrë deri në atë kohë. Në përfundim qeveria shqiptare bëri këtë deklaratë, e cila, në fakt, ishte sugjeruar nga faktori ndërkombëtar:

22. AMEPJ, Fondi Organet e Larta të PPSH, viti 1990, D. 6, fl. 7: "Fjala e Reis Maliles".

23. Bashkim Pitaraka, "Pse u sulmua raporti i Reis Maliles, ku kërkohet futja në KSBE", *Telegraf*, 13.09.2018.

24. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl.14-15: "Letër e Maliles për Xhejms Beiker."

"...Duke u nisur nga dëshira për t'u bashkuar me procesin e bashkëpunimit dhe të sigurimit evropian si dhe nga fakti që ndryshimet që janë bërë e po bëhen aktualisht në legjislacionin shqiptar lejojnë zbatimin e parimeve të Kartës së Helsinkit e të vendimeve të KSBE, qeveria shqiptare shpreh gadishmërinë e angazhimit e saj për pranimin e këtyre parimeve e vendimeve që janë marrë." Qeveria shqiptare ngarkonte ministrin e saj të jashtëm që këtë deklaratë t'ua bënte të njohur të gjithë shteteve pjesëmarrëse të KSBE-së dhe të kërkonte miratimin e tyre për pjesëmarrjen me të drejta të plota të Shqipërisë në konferencat e mbledhjet e ardhshme të KSBE-së duke filluar me mbledhjen e Ministrave të Punëve të Jashtme në Nju Jork."<sup>25</sup>

Këtë qëndrim Presidenti Alia e vuri në dukje edhe në Sesionin e 45-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në New York, 30 shtator 1990.<sup>26</sup> Ndër të tjera Alia tha:

"Shqipëria dëshiron të jetë anëtare me të drejta të plota në mbledhjen e ardhshme të KSBE në Paris dhe do të punojë me frymën e detyrimeve që rrjedhin prej saj. Të gjitha ato përpjekje, inisiativa ose ide, që synojnë likuidimin e ndarjes dhe përçarjes së Evropës në blloqe e në zona influence, ose në forma të tjera, që i kanë trashiguar nga e kaluara, që synojnë respektimin e lirië, pavarësisë dhe sovranitetit të secilit shtet, kane mbështetjen pa rezerva të vendit tonë."<sup>27</sup>

---

25. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl.34/1: "Deklaratë e qeverisë shqiptare, 15 shtator 1990."

26. AMEPJ, viti 1990, D.1271, fl.10-11: "Letër e Maliles për Liederman, Sekretar Ekzekutiv i Komitetit Pergatitor."

27. Progni, *Trashëgimtarët*, 67-68.

Mbledhja e KSBE-së mbi Mesdheun në Palma de Majorka, 24 shtator – 19 tetor 1990, ishte pjesëmarrja e parë e Shqipërisë si vëzhguese pas deklaratës zyrtare të qeverisë shqiptare të 15 shtatorit.<sup>28</sup> Delegacioni shqiptar shfrytëzoi mundësinë për të riadresuar kërkesën për pranimin e plotë të Shqipërisë në KSBE-së në takimin e Parisit 1990, duke e argumentuar atë me proceset e nisura demokratizuese të jetës politike e shoqërore në vend, në përgjigje të interesave kombëtare, por edhe në harmoni me tërë procesin e Sigurimit dhe Bashkëpunimit në Evropë.<sup>29</sup>

Gjatë këtij takimi, delegacioni shqiptar në statusin e vëzhguesit mori takime me delegacione të ndryshme pjesëmarrëse në procesin e KSBE-së. Kundërshtimi kryesor vinte nga delegacioni amerikan, anglez e ai francez. Mesazhi i dhënë ndër rreshta ishte:

"... është akoma shpejt që t'ju japim mikrofonin ju në KSBE. Është e nevojshme të vazhdoni ndryshimet që të fitoni besimin e anëtarëve të KSBE. Ju duhet të jepni prova, të vazhdoni rrugën e nisur duke ndërmarrë njëkohësisht hapa konkrete në fushën e legjislacionit, të ekonomisë dhe të drejtave të njeriut. Ndaj është e domosdoshme ky status i vëzhguesit për ju."<sup>30</sup>

Në takimin e Ministrave të Jashtëm të vendeve pjesëmarrëse në KSBE që u zhvillua në Nju Jork 1-2 tetor 1990, Shqipëria u ftua të merrte pjesë me statusin e vëzhguesit.<sup>31</sup> Në diskutimet e tyre shumë ministra të jashtëm iu referuan çështjes së pjesëmarrjes së Shqipërisë në KSBE. Në përgjithësi ato mbështetën interesimin e Shqipërisë për

---

28. Puto, *KSBE*, 45.

29. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl. 39: "Fjalim i delegacionit shqiptar në mbledhjen e KSBE për Mesdheun."

30. AMEPJ, viti 1990, D.1282, fl. 75-78. D. 1281, fl. 40-41, 28.09.1990: "Info për MPJ nga delegacioni shqiptar në Palma de Majorka, 4.10.1990"

31. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl. 44: "Informacion i MPJ për zhvillimet në takimin përgjithor të New Yorku-t, 1-2 tetor 1990."

t'u bashkuar plotësisht me procesin e KSBE-së, por kjo kushtëzohej me thellimin e masave dhe ndërmarrjen e hapave të reja për demokratizimin e plotë të saj. Mbledhja e New Yorkut nuk pati dakordësi të plotë për Shqipërinë dhe vendosi pjesëmarrjen e saj vetëm si vëzhguese në Takimin e Nivelit të Lartë në Paris, i cili do të mbahej në Paris me 19-21 nëntor 1990.<sup>32</sup>

Kërkesën e qeverisë shqiptare për antarësim të plotë të Shqipërisë në KSBE gjatë takimit të Parisit e mbështeti edhe takimi i Ministrave të Punëve të Jashtme të shteteve të Ballkanit që u organizua në Tiranë me 24-25 tetor, nëpërmjet një mesazhi drejtuar shteteve anëtare të KSBE-së. *"Ministrat përshëndeten- thuhej në mesazh- kërkesën e Shqipërisë për pjesëmarrje të plotë në KSBE dhe shprehën dëshirën e tyre që kjo kërkesë të realizohet"*.<sup>33</sup>

Qeveria shqiptare vazhdoi përpjekjet e saj diplomatike pranë Komitetit Përgatitor në Vjenë për të marrë pjesë me të drejta të plota në takimin e Parisit në nëntor.<sup>34</sup> Pavarësisht përpjekjeve, Komiteti Përgatitor me qendër në Vjenë, duke gjykuar ecurinë e reformave politike të kryera në vend, me vendimin e tij të 14 nëntorit i njohu Shqipërisë vetëm statusin e vëzhguesit në Samitin e Parisit.<sup>35</sup> Shqipëria mbeti i vetmi vend në Evropë që nuk mori pjesë me status të plotë në Samitin e Parisit, por vetëm me status vëzhguesi.

Me 19 deri në 21 nëntor të vitit 1990 në Paris u zhvillua takimi i dytë në nivel të lartë i KSBE-së, i njohur si Helsinki 2. Në të morën pjesë kryetarë shtetesh e kryeministra të vendeve anëtare të KSBE-së. Shqipëria merrte pjesë me cilësinë e vëzhguesit. Delegacioni përbëhej nga 5 diplomatë dhe kryesohej nga Ministri i Punëve të Jashtme Reis Malile. Delegacioni në deklaratën e tij për median, me 20 nëntor, shprehu habinë dhe keqardhjen e tij për konsensusin e munguar për

---

32. *Ibid.*, fl. 80: "Informacion mbi zhvillimin e takimit të New Yorkut."

33. AMEPJ, viti 1990, D.1272, fl. 31: "Mesazh i MPJ te Ballkanit, 24-25 tetor 1990."

34. AMEPJ, viti 1990, D.1262, fl. 85: "Letër e DBSH për Komitetin Përgatitor në Vjenë."

35. *Ibid.*, fl. 87: "Letër e përfaqësishë shqiptare në Paris me Komitetin Përgatitor."

Shqipërinë që të ishte pjesëmarrëse e plotë në këtë takim të nivelit të lartë të KSBE-së. Deklarata përfundonte me nota optimiste:

"... Megjithatë delegacioni shqiptar është i bindur se fryma demokratike dhe konsensusi që karakterizon sot marrëdhëniet ndërevropiane dhe realiteti i Shqipërisë përbëjnë premisë objektive që Shqipëria të përfshihet si të gjitha shtetet e rajonit në këtë proces mbarëevropian."<sup>36</sup>

Partia-shtet në optikën e saj politike e përktheu këtë mungesë konsensusi si një presion që disa qarqe e qeveri të caktuara po e përdornin për t'i diktuar Shqipërisë receta e kushte të ndryshme politike. Në forumet partiake deklarohet se asgjë nuk do të ndodhte nën diktatin e ndokujt dhe se ndryshimet në politikën e jashtme i përgjigjeshin vetëm ndryshimeve në politikën e brendshme.<sup>37</sup> Në fakt, mungesa e konsensusit ishte presioni i radhës nga faktori ndërkombëtar për kryerjen e reformave demokratizuese në vend.

Në Paris, kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të KSBE-së miratuan një dokument prej 19 faqesh të titulluar "Karta e Parisit për një Evropë të re". Në këtë Kartë shtetet nënshkruese shpallnin fundin e periudhës së Luftës së Ftohtë dhe të ndarjes së Evropës dhe njihnin vlerat e përbashkëta demokratike.<sup>38</sup> Ajo ishte një tërësi parimesh se mbi çfarë bazash duheshin ndërtuar këtej e tutje marrëdhëniet mes vendeve evropiane, çfarë vlerash duheshin ruajtur në këtë periudhë tranzicioni nga komunizmi në demokraci, dhe çfarë fenomenesh negative duheshin luftuar bashkërisht. Karta institucionalizoi KSBE-në duke ngritur struktura të reja të saj siç ishin Këshilli i Ministrave të Jashtëm, i cili do të mblidhej të paktën një herë

36. AMEPJ, viti 1990, D. 1262, fl. 94: "Deklaratë delegacionit shqiptar në Paris, 20 nëntor 1990."

37. AMEPJ, Fondi i Organet e Larta të PPSH, viti 1990, D. 4, fl.1: "Fjala e Ramiz Alias në Plenumin e 12-të të KQPPSH, 6-7 nëntor 1990."

38. Puto, *KSBE*, 50.

në vit. Mbledhjet e këtij Këshilli do t'i përgatiste Komiteti i Zyrtarëve të Lartë të vendeve anëtare. U vendos të krijohej edhe një Sekretariat me qendër në Pragë, i cili do t'i jepte mbështetje administrative bisedimeve mes palëve.<sup>39</sup> Kjo strukturë e bënte procesin e antarësimit më burokratik dhe e detyronte të kalonte në disa filtra para se të arrihej në vendimarrje. Tashmë nuk mjaftonte të shprehje vetëm dëshirën e të pranoje parimet themelore si në 1975, por duheshin plotësuar disa kushte të cilat bënin të pakthyeshme reformat demokratizuese, të nisura në vend.

### **Anëtarësimi i Shqipërisë me të drejta të plota në KSBE, Berlin 19 qershor 1991**

Pas institucionalizimit të procesit të Helsinkit dhe ndërtimit të strukturave përkatëse, në Paris u vendos që në 19-21 qershor 1991 në Berlin të mbahej takimi i parë i Këshillit të Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të KSBE-së. Nga takimet bilaterale që delegacioni shqiptar kishte pasur në Paris me përfaqësues të vendeve anëtare, qeveria shqiptare mori mesazhin që çështja e antarësisë së plotë të Shqipërisë në KSBE mund të shqyrtohej në takimin e qershorit 1991, në varësi të zhvillimeve konkrete të Shqipërisë në planin e brendshëm e atë të jashtëm. Malile në raportimin e tij pas kthimit nga takimi i Parisit (Helsinki 2), në 23 nëntor 1990, udhëzonte shtimin e veprimtarive dhe kontakteve të dendura politike e diplomatike me shtetet anëtare që të bëheshin të njohura sa më shumë të ishte e mundur masat dhe reformat që ishin ndërmarrë në vend në fusha të ndryshme e të kërkohej mbështetja e tyre në këtë proces.

Ministria e Punëve të Jashtme në kuadër të përgatitjes së vendit për t'u antarësuar në KSBE, i sugjeronte qeverisë së fundit komuniste në vend disa hapa avancues në ndryshimet politike në vend, mes te cilave: t'i pergjigjeshin pozitivisht kërkesës së Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për një vizitë njëjavore në Shqipëri në fillim të vitit 1991, të pranoheshin më shumë gazetarë perëndimorë në vend, të përcaktohej

---

39. Puto, *KSBE*, 51.



në ligj statusi i gazetarit të huaj në Shqipëri, dhënia e informacionit të nevojshëm për ta, sipas dispozitave kryesore të dokumenteve të KSBE-së.<sup>40</sup> Po kështu u cilësua tepër e rëndësishme të intensifikohej puna për përfshirjen e vendit në inisiativat politike evropiane, kryesisht për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me TPE, të fitohej statusi i "*të ftuarit të veçantë*" për Shqipërinë në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të rritej angazhimi në bashkëpunimin ballkanik, të normalizoheshin sa më parë marrëdhëniet me SHBA dhe Anglinë, të mundësohej normalizimi i punës të ambasadës franceze e asaj gjermane pas ngjarjeve të korrikut '90.

Në planin e brendshëm, në këtë raportim të fundit të nëntorit 1990 kërkohej rritja e rolit të Kuvendit Popullor dhe Komisioneve të tij në marrëdhëniet me jashtë duke dobësuar rolin e organeve parti-shtet, përshtatja e legjislacionit shqiptar me atë ndërkombëtar, duke mbajtur parasysh kushtet specifike të Shqipërisë, krijimi i një Komiteti Kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, krijimi i një komisioni parlamentar për zbatimin e normave dhe kërkesave të KSBE-së, brenda e jashtë vendit, krijimi i një grupi parlamentar për bashkëpunimin ballkanik, botimi i dokumenteve kryesore të KSBE-së etj.<sup>41</sup>

Ndërkohë dy javë më pas, në dhjetor 1990, në Shqipëri u zyrtarizua formimi i partive opozitare në vend dhe vendosja e pluralizmit politik. Vendi hyri në rrugën e përgatitjes së zgjedhjeve të para pluraliste që paraqisnin interes të madh për faktorin ndërkombëtar. Më 21 janar 1991 ministri i jashtëm Malile i dërgoi një letër zyrtare Sekretares së Përgjithshme të Këshillit të Evropës, Catherine Lalumiere, dhe Presidentit të Komisionit Ekzekutiv të Komunitetit Evropian në Bruksel, Jacques Delors. Që në fillim Malile theksonte faktin që Shqipëria kishte shprehur interesin e vullnetin e saj për t'u bashkuar me KSBE dhe me proceset e tjera aktuale evropiane. Në këtë frymë ai kërkonte të vendoseshin sa më shpejt që të ishte e mundur kontaktet e njohjes dhe të bashkëpunimit me Këshillin e Evropës, duke marrë

40. AMEPJ, viti 1990. D. 1266, fl. 104-107: "Raportimi Maliles për qeverinë shqiptare".

41. *Idem*.

pjesë që në Konferencën e Vienës mbi problemet e migrimit në 24-25 janar 1991 që do të organizohej me inisiativën e KiE-së. Kërkesa mori përgjigje pozitive. Ndërsa në raport me Komunitetin Evropian qeveria shqiptare njoftoi Brukselin se kishte vendosur të dërgonte një mision të vogël me dy ose tre persona për të hyrë në kontakt me shërbimet eksperte të këtij organizmi, për t'u njohur me aktivitetin, mekanizmat e format e mundshme të bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian.<sup>42</sup>

Në takimin e Vjenës të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë të KSBE-së, ku do shqyrtoheshin zhvillimet aktuale dhe përgatitjet për mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Ministrave të Punëve të Jashtme që do të mbahej në Berlin në qershor 1991, Shqipëria mori pjesë si vëzhguese. Përfaqësuesi i ambasadës shqiptare në Vjenë që ndoqi takimin njoftoi MPJ për një deklaratë mjaft të rëndësishme, të bërë nga përfaqësuesi i Luksemburgut në 28 janar 1991:

"...Qeveria e Tiranës tashmë ka caktuar zgjedhjet e para të lira, të fshehta e pluraliste për në 31 mars. Për më tepër, një kushtetutë e re është në hartim e sipër, e cila duhet të përfshijë dispozita lidhur me liberalizimin e ekonomisë dhe sidomos të fiksojë në tekstin e saj liri që duhet të jenë kredoja e përbashkët e të gjitha vendeve pjesëmarrëse në KSBE, të cilat janë liria e bashkimit dhe e shprehjes, liria fetare, e drejta për grevë, që përbëjnë veçse disa prej lirive themelore.

Të 12 shtetet e Komunitetit do të ndjekin me interesin më të madh zhvillimet politike, shoqërore dhe ekonomike në këtë vend. Në mënyrë të veçantë, ata do të japin gjykimin e tyre në bazë të përfundimeve të nxjerra nga autoritetet përkatëse mbi rezultatet përfundimtare të votimit, si dhe mbi zbatimin konkret të teksteve të reja legislative. Që nga momenti në të cilin Shqipëria do të jetë e gatshme të pranojë plotësisht trashigimin e

---

42. AMEPJ, viti 1991, D. 1701, fl. 2, 4, 7, 9: "Korrespondencë e MPJ-së me KE-në dhe Komunitetin Evropian."

vlerave tona, ne do të mirëpresim me kënaqësi të madhe këtë vend në familjen tone të popujve."<sup>43</sup>

Kjo i dha nota optimiste përpjekjeve të qeverisë shqiptare e cila përherë e më tepër e ndjente se zhvillimet e brendshme demokratike ishin përcaktuese dhe çelësi që mund të hapte dyert e institucioneve evropiane. Promotorët që nxitën procesin e tërheqjes së vëmendjes së faktorit ndërkombëtar për një përgjigje pozitive për Shqipërinë, do të ishin lëvizja demokratike e dhjetorit 1990, zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri mars 1991, dhe miratimi i Dispozitave Kryesore, më 29 prill 1991. Kjo e fundit e shpallte Shqipërinë Republikë parlamentare, bënte të qartë ndarjen e pushteteve, reduktonte mandatin e presidentit në 5 vjet, dhe i jepte peshë kryesore parlamentit pluralist në çështjet e brendshme dhe në politikën e jashtme.<sup>44</sup> Çdo arritje në politikën e jashtme dhe përfshirje në organizmat ndërkombëtare, qeveria shqiptare do të përpiqej t'i përdorte edhe për forcimin e pozitave të saj të brendshme në një shoqëri shqiptare, të dramatizuar nga kriza ekonomike e politike në vend dhe e frymëzuar nga zhvillimet në Evropën Lindore.

Me 21 maj 1991, një muaj para takimit të Berlinit, ministri i jashtëm Muhamet Kapllani iu drejtua me një letër të posaçme të gjithë ministrave të punëve të jashtme të shteteve pjesëmarrëse në KSBE nëpërmjet të cilës kërkohej pjesëmarrja e Shqipërisë me status të plotë në KSBE në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Berlin 19-20 qershor. Kapllani i siguroi ministrat se Shqipëria e kishte pranuar plotësisht trashëgiminë e vlerave të përbashkëta evropiane dhe e kishte angazhuar veten të ruante e të nxiste demokracinë pluraliste parlamentare, respektimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e

43. AMEPJ, viti 1991, D.1701, fl.11-12: "Korrespondencë e ambasadës shqiptare në Vjenë me MEPJ, 28 janar 1991."

44. Nesti Gjeluçi, "Albania: A history of isolation", në: Teresa Rakowska-Harmstone, Teresa Rakowska-Harmstone, Piotr Dutkiewicz, Agnieszka Orzelska (eds.), *New Europe. The Impact of the First Decade*, (Warszawa: Institute of Political Studies, Polish Academy of Sciences, Collegium Civitas Press, 2006), vol. 2, 29.

ligjit. Kërkesa shoqërohej me listën e plotë të ndryshimeve ligjore që kishin ndodhur brenda vendit, si liria e manifestimeve paqësore, liria e besimit dhe e vendosjes së institucioneve fetare, lëvizja e lirë e qytetarëve, lehtësimi i procedurave për marrje vize, vendosja e pluralizmit politik, mbajtja e zgjedhjeve të 31 marsit, zgjedhjet e para pluraliste pas luftës që prodhuan parlamentin e parë pluralist, dhe hapja e politikës së jashtme shqiptare, si dhe kontakti me proceset e organizmat evropiane. Kërkesës i bashkangjitej gjithashtu edhe kopja e përkthyer e Ligjit mbi Dispozitat Kryesore Kushtetuese, të miratuara në prill 1991.<sup>45</sup>

Shqipëria kërkoi të merrte pjesë si vëzhguese edhe në takimin e Pragës të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë të KSBE-së, 23-24 maj 1991, i cili ishte vazhdim i takimit të Vjenës.<sup>46</sup> Kërkesa e Shqipërisë u miratua. Në këtë takim u diskutua edhe dëshira e shprehur e qeverisë shqiptare për të anëtarësuar Shqipërinë në KSBE. Vendet pjesëmarrëse i vlerësonin ndryshimet demokratike në Shqipëri, por akoma nuk ishte arritur një konsensus për pranimin e saj me të drejta të plota në KSBE.<sup>47</sup> Anëtarësimi i saj i plotë u propozua të diskutohej pas mbledhjes së Berlinit. Meqë Shqipëria nuk i kishte pranuar dhe i kishte hedhur poshtë dokumentet e Helsinkit për vite, disa vende kërkonin që Shqipëria t'i aplikonte më parë këto dokumente e pastaj të pranohej si anëtare me të drejta të plota. SHBA, Anglia dhe Gjermania kishin hedhur idenë që para pranimin të Shqipërisë në KSBE të dërgohej një delegacion i KSBE, një "Fact Finding Mission" për vëzhgimin e gjendjes dhe ecurisë të reformave në Shqipëri. Gjetjet e tij do të diskutoheshin në mbledhjen e dytë të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të KSBE-së në Pragë në vitin 1992. I takonte Shqipërisë ta pranonte ose jo këtë delegacion.<sup>48</sup>

45. AMEPJ, viti 1991, D.1701, fl. 67-69: "Leter e Kapllanit për MPJ e vendeve anëtare ne KSBE, 20 maj 1991."

46. AMEPJ, viti 1991, D. 1701, fl.37: "Letër e Kapllanit 11 maj 1991."

47. *Ibid.*, fl. 76: "Korrespondencë e MPJ me Komitetit Përgatitor."

48. *Ibid.*, fl. 93-94: "Letër e delegacionit shqiptar në Pragë per MPJ, 22 maj 1991."

Delegacioni shqiptar i bëri të njohur kryetarit të takimit të Komitetit të Zyrtarëve të Lartë të KSBE-së, ambasadorit Pavicevic, se Shqipëria nuk ishte kundër dërgimit të një delegacioni të tillë, por ishte tepër e interesuar të veprohej sa më shpejt, ndaj kërkonin të gjendej një formulë kompromisi dhe një rrugë veprimi më e shpejtë. Pas mbledhjes delegacioni shqiptar u takua përsëri me Pavicevic dhe përfaqësuesin amerikan Mareska dhe ranë dakord që delegacioni të mos quhej "Fact Finding Mission" i cili kishte një protokoll të gjatë veprimi e raportimi, por të dërgohej një raportues dhe disa ndihmesa të cilët do t'i raportonin KSBE-së në një kohë sa më të afërt dhe në rastin më të përshtatshëm. Sipas tyre, kjo do të ishte e mjaftueshme për të arritur konsensusin.

MPJ këtë qëndrim ia bëri të ditur më 26 maj kryetarit të radhës së Këshillit të Ministrave të vendeve anëtare të KSBE-së, Ministrit federal të Puneve të Jashtme Gensher, meqë Gjermania merrte kryesinë e KSBE-së. Në këtë komunikim Gensher dhe nëpërmjet tij Këshilli i Ministrave viheshin në dijeni se Shqipëria ishte dakord të priste një "CSCE fact-finding" ose "mission raportues" para mbledhjes së Berlinit. Qeveria shqiptare kërkonte që ky ekip raportues të jepte raportin e tij në mbledhjen e radhës të zyrtarëve të lartë, që do të zhvillohej në Berlin, 17-18 qershor, dy ditë para takimit të Këshillit të Ministrave. Edhe pse mundësitë për pranimin e Shqipërisë në mbledhjen e Berlinit ishin ngushtuar shumë, pala shqiptare mbetej me shpresë se çështja ishte e hapur ndaj duhej intensifikuar puna diplomatike.<sup>49</sup> Trysnia e saj u zhvendos në Bon për të shtuar kontaktet me diplomatë e zyrtarë të lartë gjermanë.

Ndërkohë po në maj 1991 në Londër po vazhdonin bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve me Britaninë e Madhe, një ndër shtetet që shprehte rezerva për anëtarësimin e Shqipërisë në KSBE me të drejta të plota. Kjo u realizua nëpërmjet një komunikate të përbashkët, të publikuar me 29 maj 1991. Atë ditë në Vjenë u mblodh

---

49. AMEPJ, viti 1991, D. 1701, fl. 102: "Komunikim i delegacionit shqiptar në Pragë me MPJ, 24 maj 1991"; fl.105/1: "Letër e Kapllanit për Gensher, 25 maj 1991."

grupi perëndimor i KSBE-së për të diskutuar për pranimin e Shqipërisë me të drejta të plota në organizatë. Mendimet brenda anëtarëve ishin të ndryshme. Në fund të takimit u propozua që Shqipërisë t'i jepej statusi i vëzhguesit në takimin e Berlinit.<sup>50</sup>

Ndërkohë një zhvillim i ri pozitiv në qëndrimin amerikan i dha një shtysë të fuqishme procesit. Misioni shqiptar pranë OKB-së në New York informonte Tiranën zyrtare në 15 maj se Komisioni për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (Komisioni i Helsinkit) i SHBA në një njoftim për shtyp kishte njoftuar se ky Komision do të bënte shqyrtimin e zhvillimeve të fundit në Shqipëri, perspektivën për zhvillimin e mëtejshëm të demokracisë në vend, dhe mënyrat me të cilat SHBA mund të inkurajonte këtë zhvillim tani që ishin vendosur marrëdhëniet diplomatike me SHBA, 15 mars 1991, dhe pas zgjedhjeve pluraliste të 31 marsit të cilat i kishte ndjekur nga afër një delegacioni i atij Komiteti. Diskutimi do të përfshinte edhe situatën e të drejtave të njeriut në frymën e kërkesës që kishte bërë qeveria shqiptare për anëtarësi të plotë në KSBE. Ishin ftuar në këtë rast edhe përfaqësues të opozitës shqiptare dhe një përfaqësues nga Misioni shqiptar në New York.<sup>51</sup> Arsye e qenësishme për të rishqyrtuar qëndrimin e tyre ishte edhe tensionimi i situatës politike e nacionale në shtetin fqinj, në ish-Jugosllavi, ku shpërthimi i nacionalizmit mund të rrezikonte shpërbërjen e saj. Pasojat do të ishin kërcënuese për stabilitetin dhe sigurinë në rajonin e Ballkanit.

Më 10 qershor 1991, Komisioni mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (Komisioni i Helsinkit) me qendër në Uashington, publikoi qëndrimin e tij në News Release në favor të kërkesës së Shqipërisë për anëtarësi të plotë në KSBE në takimin e qershorit në Berlin.

"Vitin e kaluar – shprehej Komisioni- i vetmi vend evropian që zgjodhi që në fillim të mos marrë pjesë në Konferencën për Sigurimin dhe Bashkëpunimin

---

50. AMEPJ, viti 1991, D. 1701, fl. 59: "Njoftime të përfaqësive tona me MPJ."

51. AMEPJ, viti 1991, D. 1705, fl.1: "Korrespondencë e Misionit të RSH në New York me MPJ, 15.5 1991."

Evropian-kërkoi për herë të parë dhe iu dha statusi i vëzhguesit në takimet e KSBE. Ne e përshëndetëm këtë shprehje të interesit të Shqipërisë për procesin e KSBE, dhe kemi përkrahur dhënien e statusit të vëzhguesit Shqipërisë në çdo mbledhje të radhës të KSBE-së. Ne gjithashtu përkrahëm rivendosjen e marrëdhënieve dypalëshe midis Shqipërisë dhe SHBA-së. Ne besojmë se tashmë ka ardhur koha të përkrahim kërkesën e Shqipërisë për tu bërë anëtare me të drejta të plota në KSBE, duke e angazhuar atë në mënyrë të barabartë në ndertimin e së ardhmes së Evropës në tërësi, dhe në respektimin e standarteve të sigurimit, ekonomisë së tregut, mjedisit dhe të drejtave të njeriut që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve të KSBE-së. Përmirësimet të mëdha janë bërë që prej gushtit 1990 kur një delegacion i Komisionit të Helsinikut gjatë vizitës në Shqipëri konstatoi se të drejtat e njeriut dhe të tjera ishin shumë larg parimeve dhe normave të Helsinikut, që garantojnë anëtarësinë me të drejta të plota në KSBE. Krijimi i qeverisë së re në Shqipëri premtonte se progresi do të vazhdojë. Sigurisht që ka probleme, por ato mund të rregullohen-ndoshta mund të zgjidhen, në përputhje me procesin e Helsinikut. Sipas pikëpamjes tonë, pjesëmarrja e Shqipërisë dhe marrja përsipër e një sërë angazhimesh që përputhen me të do të jenë në të mirë të saj.

Ne kërkojmë me këmbëngulje nga Mbledhja e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të KSBE, e cila do të zhvillohet në Berlin nga fundi i këtij muaji, që të pranojë anëtarësinë e plotë të Shqipërisë në KSBE nëpërmjet përfaqësimit të saj duke deklaruar se është dakord të zbatojë të gjitha marrëveshjet e KSBE-së dhe të nënshkruaje, në nivelin e kryetarit të shtetit ose të qeverisë, Aktin Fianl të Helsinikut dhe Kartën e Parisit,

ashtu siç kanë vepruar edhe udhëheqësit e shteteve pjesëmarrëse të KSBE-se."<sup>52</sup>

Kjo deklaratë u shpërnda te të gjitha vendet anëtare të KSBE-së. Duke ditur kredibilitetin e Komisionit dhe rëndësinë e opinionit të tij te vendet anëtare, delegacioni shqiptar e shfrytëzoi këtë opinion në konsultimet dypalëshe në funksion të mbledhjes së Berlinit.

Me 11 qershor 1991 u formua Qeveria e Stabilitetit me kryeministër Ylli Bufi, qeveria e parë me përfaqësues nga forca të ndryshme politike në vend. Me 14 qershor, 5 ditë para takimit të Berlinit, Ylli Bufi iu drejtua zyrtarisht përsëri të gjithë kryetarëve të qeverive të 34 shteteve anëtare të KSBE-së. Pasi i vuri në dijeni për krijimin e qeverisë së re pluraliste ku merrnin pjesë edhe partitë opozitare, Bufi deklaronte se ajo ishte qeveria e parë përfaqësuese e të gjitha forcave politike e ndërtuar mbi bazën e konsensusit, dhe kjo dëshmonte angazhimin e plotë të Shqipërisë ndaj vlerave demokratike dhe pluraliste evropiane. *"Kjo ishte dëshmi se Shqipëria –sipas Bufit- kishte pranuar përfundimisht trashëgiminë e vlerave të përbashkëta evropiane"*. Bufi u kërkoi homologëve të tij që të mbështesin kërkesën e Shqipërisë për t'u pranuar si anëtare e plotë e KSBE-së në takimin e Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Berlin.

Pikë tjetër e fortë, ishte se kryeministri i ri shprehu gadishmërinë e qeverisë së tij pluraliste për të mirëpritur kurdo çdo ekip fakt-mbledhës apo raportues për të dëshmuar ndryshimet që kishin ndodhur në Shqipëri.<sup>53</sup>

Në takimin e 17-18 qershorit në Berlin delegacioni shqiptar, i kryesuar nga ministri i jashtëm, Muhamet Kapllani, me statusin e vendit vëzhgues, deklaroi se:

---

52. AMEPJ, viti 1991, D.1705, fl. 6-7: "Deklaratë Publike e Komisionit te Helsinkit 10.6.1991."

53. AMEPJ, viti 1991, D. 1706, fl. 59-60: "Letër e Ylli Bufit për homologët e 34 vendeve anëtare, 15 qershor 1991."



- "1. Qeveria shqiptare do të dërgonte në takimin e Këshillit të Ministrave të Jashtëm në Berlin një delegacion përfaqësues të përbërë nga të gjitha forcat politike që bënin pjesë në qeverinë pluraliste në detyrë.
2. Qeveria shqiptare do ishte e kënaqur të ftonte shtetet e interesuara për të dërguar në çdo kohë delegacione apo përfaqësues në Shqipëri për të parë e dëshmuar për ndryshimet që kishin ndodhur në vend."<sup>54</sup>

Sipas dakordësisë të arritur në takimin e 17-18 qershorit, me 18 qershor ministri Kapllani i dërgoi një letër të dytë Kryetarit në detyrë të Këshillit të Ministrave të Jashtëm të KSBE, Ministrit të Jashtëm federal H.E.Hans-Dietrich Genscher ku ripërsëriti të gjitha angazhimet e qeverisë shqiptare:

- "1. Shqipëria pranonte aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit për Evropën e Re.
2. Qeveria shqiptare mirëpriste vizitën e një Misioni raportues të ngarkuar nga Këshilli i Ministrave i KSBE.
3. Qeveria shqiptare ishte e gatshme të firmoste Aktin Final të Helsinkit dhe Kartën e Parisit nga kryetari i Shtetit ose i Qeverisë në mundësinë më të afërt."<sup>55</sup>

Me 19-20 qershor 1991, në ndërtesën e Raishtagut në Berlin, u hap mbledhja e parë e Këshillit të Ministrave të Jashtëm të vendeve pjesëmarrëse në KSBE, që nga krijimi i kësaj strukture në Paris, nëntor 1990. Takimi kryesohej nga zv. kancelari dhe Ministri i Jashtëm i Republikës Federale të Gjermanisë Hans Dietrich Genscher, si kryetar i mbledhjes. Në konkluzionet e takimit thuhej "Ministrat mirëpritën Republikën e Shqipërisë si një shtet pjesëmarrës në KSBE pas marrjes së letrës që Ministri i Jashtëm i Shqipërisë Muhamet Kapllani i drejtoi

---

54. AMEPJ, viti 1991, D. 1706, fl. 52-53: "Non-paper e delegacionit shqiptar, D. 1707, fl. 2."

55. AMEPJ, viti 1991, D. 1707, fl. 19-20: "Letër e Kapllanit për Genscher, 18.6.1991."

Kryetarit në detyrë të këtij Këshilli, Ministrit të Jashtëm Federal Gencher, e ku pranoheshin të gjitha angazhimet dhe përgjegjësitë e KSBE-së<sup>56</sup>. Në unanimitet të plotë u miratua pranimi i Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota në KSBE.<sup>57</sup> Delegacioni shqiptar që kryesohej nga MPJ Muhamet Kapllani dhe përbëhej edhe nga përfaqësues të të gjitha forcave politike të krijuara deri në atë kohë në Shqipëri, zuri vendin si anëtar i 35-të i KSBE-së.

Parlamenti shqiptar i dërgoi menjëherë një letër falënderimi Këshillit të Ministrave të Jashtëm të KSBE-së për këtë zhvillim historik për Shqipërinë. Aty shprehej angazhimi për të forcuar bashkëpunimin me të gjitha vendet anëtare të KSBE-së dhe për të çuar përpara punën e nisur nga parlamenti pluralist dhe qeveria pluraliste e stabilitetit kombëtar.<sup>58</sup>

Sekretari Amerikan i Shtetit Bejker i tha delegacionit shqiptar në takimin e Berlinit se SHBA vlerësonin lart zhvillimet demokratike në Shqipëri dhe pranimin e Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota në KSBE e quante një përkrahje për demokracinë shqiptare e ndihmë ndaj popullit shqiptar në rrugën e demokracisë.<sup>59</sup> Këtij qëllimi – sipas tij – i shërbenin edhe marrëdhëniet e rivendosura me SHBA. Mesazhi i Sekretarit të Shtetit Bejker ishte i qartë. Kjo ishte një mundësi që faktori ndërkombëtar e veçanarisht SHBA i jepnin Shqipërisë për ta mbështetur në rrugën e proceseve demokratike ku kishte hyrë vendi. Pas tre ditësh, me 22 qershor 1991 Bejker vizitoi Tiranën si politikani i parë i lartë perëndimor që shkeli Shqipërinë pas rrëzimit të komunizmit. Ai u prit si mik i madh nga mijëra shqiptarë që kishin mbushur sheshin.

Kanali televiziv i lajmeve CNN, pasi dha njoftimin për mbledhjen e qershorit në Berlin dhe ceremoninë e pranimi të Shqipërisë në

---

56. AMEPJ, viti 1991, D. 1707, fl. 172: "Konkluzione të Takimit të Këshillit të MPJ, Berlin 19-20 qershor 1991."

57. Puto, *KSBE*, 54

58. AMEPJ, viti 1991, D. 1707, fl.14: "Konkluzione të Takimit të Këshillit të MPJ, Berlin 19-20 qershor 1991."

59. *Ibid.*, fl. 178: "Komunikim i delegacionit shqiptar me MPJ."

KSBE, e përfundonte lajmin "...*Tani me demokratizimin e Shqipërisë Evropa u bë e plotë.*"<sup>60</sup>

Procesi i pranimit të Shqipërisë si anëtare me të drejta të plota në KSBE, jo vetëm përshpejtoi proceset demokratizuese në vend, por shënoi edhe një ndryshim rrënjësor të kursit të politikës së jashtme shqiptare, në afrimin me bashkësinë euro-atlantike dhe në pranimin e vlerave perëndimore të lirisë, demokracisë dhe sundimit të ligjit. Me 16 shtator 1991 Shqipëria nënshkroi zyrtarisht Aktin Final të Helsinkit.<sup>61</sup>

---

60. AMEPJ, viti 1991, D.1710, fl. 1: "Komunikimi Misionit të RSH në New York me MPJ, 19.6.1991."

61. AMEPJ, viti 1991, D.1740, fl. 29: "Vizita e Ramiz Alisë në Helsinki, shtator 1991."



RECENSIONE DHE BOTIME TË REJA  
REVIEWS AND NEW PUBLICATIONS



Ermal Baze, *Jeta Agrare në Komunën e Shkodrës gjatë shek. XIV- fillim i shek. XV: një vështrim socio-ekonomik* (Tiranë: Universiteti i Tiranës, 2021), 175 fq., kopertinë e trashë, ISBN 978-9928-358-69-1.



Monografia me titull, “Jeta Agrare në Komunën e Shkodrës gjatë shek. XIV-fillim i shek. XV: një vështrim socio-ekonomik”, e pedagogut Ermal Baze është botuar në 23 dhjetor 2021 nga Departamenti i Historisë i Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës. Recensuesit shkencorë të kësaj monografie janë medievistja veneciane, prof. Lucia Nadin dhe studiuesi i gjeografisë rurale, prof. dr. Sabri Laçi. Kjo monografi është një studim i thelluar në vazhden e kërkimeve shkencore plotësuese të monografisë pararendëse me titull,

“Një Qytet me Statute: Shkodra në gjysmën e parë të shekullit XIV”, botuar në muajin shkurt të vitit 2013.

Studimi i kushtohet jetës agrare në komunën e Shkodrës gjatë shek. XIV - fillim i shek. XV, në fokusin e raporteve të ngushta dhe marrëdhënieve të ndërsjella sociale dhe ekonomike midis qytetit dhe periferisë rurale të tij, bazuar kryesisht në burimet e rëndësishme dokumentare të Mesjetës së vonë, si “Statutet e Shkodrës” dhe “Regjistri i Kadastrës dhe i Koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416 - 1417”, si dhe në një sërë dokumentesh të tjera mesjetare të kohës. Krahas burimeve dokumentare të kohës, monografia është bazuar edhe në studimet e autorëve të huaj (M. Šufflay, K. Jireček, G. Ostrogorsky, G. Valentini, L. Nadin, O. J. Schmitt,) dhe shqiptarë (A. Buda, I. Zamputi,

K. Luka, K. Biçoku, K. Bozhori, L. Malltezi, P. Xhufi, S. Shkurti, P. Huta, P. Bogdani, E. Malaj etj.).

Punimi përmban një analizë historike të imët e tërësore, me të dhëna konkrete e të dokumentuara, të panoramës social-agrare të komunës së Shkodrës, një nga më të mëdhatë e më të rëndësishmet në aspektin hapësinor, e cila në fillim të shek. XIV-XV njihej brenda dhe jashtë Arbërisë si komunë qytetare me kufij e juridiksion relativisht të qartë, ku përfshihehin fshatrat përreth (të Mbishkodrës dhe Nënshkodrës), duke formuar një unitet të brendshëm social-ekonomik e territorial. Procesi i zhvillimit të qytetit mesjetar, si qendër e aktiviteteve tregtare dhe zejtare, mund të kuptohet në mënyrë të qartë, falë raportit të ndërsjellë me ekonominë agrare dhe nën shtytjen e nevojave të juridiksionit rural.

Qëmtimi i raportit të ngushtë që komuna qytetare kishte me ekonominë agrare dhe i juridiksionit që ajo kishte mbi hapësirën rurale hedh dritë mbi procesin e zhvillimit të qytetit mesjetar si qendër e aktiviteteve tregtare dhe zejtare. Mbi rëndësinë që kishte për komunat qytetare kontrolli mbi hapësirën rurale në Arbërinë mesjetare, medievisti shqiptar Luan Malltezi ka shkruar se:

“Nevoja për të forcuar lidhjet me fshatrat përreth shpuri që herët rreth shekullit XIII në formimin e komunave qytetare që vetëqeveriseshin mbi bazën e statuteve, rregullave dhe zakoneve të vjetra të vendit. Me juridiksionin e tyre të gjerë mbi tërë fshatrat përreth komunat paraqisnin unitete të gjera territoriale me lidhje të brendshme ekonomike. Relacionet qytet-fshat në kuadrin e komunës ishin mjaft komplekse e interesante. Vështruar në përgjithësi ato karakterizoheshin nga një bashkësi interesash përballë komunave dhe shtetesh të tjera të kohës”.<sup>1</sup>

---

1. Luan Malltezi, “Qyteti në shoqërinë shqiptare (shek. XI-XV),” *Studime Historike* 3 (1990): 123-130.



Duke filluar nga fillimi i shek. XX e deri në ditët e sotme, historianë të huaj dhe shqiptarë kanë kryer një varg përpjekjesh serioze për të vlerësuar çështje të ekonomisë agrare dhe marrëdhënieve feudale në Shkodër dhe në rrethinat e saj në periudhën venedike (1396-1479) dhe atë osmane (1479-1912). Përpos këtyre arritjeve dhe rezultateve shumë të rëndësishme historiografike në periudha të ndryshme kohore, duhet theksuar se, deri më sot mungon një studim socio-ekonomik i peizazhit të jetës agrare, ku të analizohen në mënyrë të ndërthurur dy dokumentet bazë të Mesjetës së vonë për njohjen *de visu* të historisë së qytetit të Shkodrës dhe arealit të saj. Pjesa më e madhe e studimeve të deritanishme janë fokusuar vetëm mbi bazën e të dhënave burimore të “Kadastrës veneciane të viteve 1416-1417”. Këtu vlen të përmendet një artikull i botuar në vitin 1970 nga studiuesi italian Giuseppe Valentini, që pasqyron në mënyrë specifike ekonominë agrare në Shkodër gjatë qeverisjes venedike (shek. XV). Qysh në fundshënimin e parë të kësaj sprove, G. Valentini thekson se të dhënat ai i kishte marrë kryesisht nga “Kadastra e Shkodrës e vitit 1416-1417” e ribotuar së fundmi në *Acta Albaniae Veneta, t. VIII (et indici t. IX) ai nn. 2045, 2107 e 2158*.<sup>2</sup> Për arsye ideologjike dhe të rrethanave kufizuese të kohës, artikullin e sipërpërmendur të G. Valentinit nuk e gjejmë të cituar tek artikujt studimorë dhe monografitë e autorëve shqiptarë, të cilët në fokus të studimeve të tyre kanë pasur zhvillimin agrar në Shkodër dhe krahinën e saj në shek. XV-XVI.<sup>3</sup> Këtu përjashtim bëjnë L. Malltezi, i cili e ka cituar në monografinë e tij “*Qytetet e bregdetit shqiptar gjatë sundimit venedikas*” të botuar në vitin 1988.

Si autorët e huaj edhe ata shqiptarë, duke mos e pasur mundësinë për të shfrytëzuar “Statutet e Shkodrës”, një “perlë të burimeve dokumentare për Arbërinë mesjetare”, të zbuluara në vitin 1997, objektin e studimeve të tyre rreth ekonomisë agrare në Shkodër dhe arealin

2. Giuseppe Valentini, “L' economia agricola nello Scutarino sotto governo veneto nel secolo XV”, *Shejzat* 4-6 (1970): 103.

3. Artikulli i Giuseppe Valentinit nuk gjendet i cituar tek artikujt dhe monografitë e Kasëm Biçokut, Spiro Shkurtit dhe Përparime Hutës.

e saj e kanë pasur jo shumë të plotë për fillimin e Mesjetës së vonë, siç ishte shek. XIV.

Në këtë mënyrë, me anë të këtij studimi, të bazuar qoftë në burime dokumentare, qoftë në studimet e autorëve të sipërpërmendur, tentohet të tejkalohet ajo çfarë është shkruar deri më sot rreth jetës agrare në komunën e Shkodrës dhe juridiksionin e saj rural.

Në bazë të tematikës kryesore dhe rëndësisë së çështjeve, struktura e punimit është kjo: në kreun e parë trajtohet sfondi historik i zhvillimit socio-politik të komunave qytetare në fasadën e Adriatikut Juglindor në periudhën e Mesjetës së vonë, ku Shkodra dhe juridiksioni i saj rural zë vendin kryesor.

Në kreun e dytë bëhet përpjekje për një sprovë krahasuese në vështirimin historik për ngjashmëri në aspektin agrar midis Statuteve të Shkodrës dhe dokumenteve e traditave juridike të tjera mesjetare të hapësirës ballkanike e arbërore, të ngjashëm me to, siç janë “Ligji bujqësor” i Bizantit, “Kodiku i Stefan Dushanit”, “Statutet e Budvës” dhe “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Kreu i tretë hedh dritë mbi organizimin e ekonomisë agrare të komunës të Shkodrës në shek. XIV-fillim i shek. XV, ku analiza studimore përqendrohet në prioritetet kryesore të veprimtarisë jetike agrare.

Në kreun e katërt pasqyrohet panorama e jetës qytetare në komunën e Shkodrës dhe marrëdhëniet socio-ekonomike të saj me hapësirën rurale përreth.

Kreu i pestë dhe i fundit bën fjalë për praktika të jetës feudale në arealin e Shkodrës gjatë protektoratit e administrimit venecian, ku jemi përpjekur të japim një kuadër më të plotë në lidhje me llojet e pronësisë mbi tokën, si dhe me pozitën dhe funksionin e përfaqësuesve të pushtetit lokal venecian, që prezantohej prej figurës së proniarit, kreut dhe urdhëruesit, dallimeve midis tyre, si dhe ndryshimet që ata pësuan në krahasim me periudhën bizantine.

Enriketa Pandejmoni, Gentiana Kera, Valentina Duka, *Aspekte të historisë së komunizmit në Shqipëri përmes materialeve arkivore dhe burimeve sekondare*. Tekst për përdorim në arsimin parauniversitar. (Tirana: Maluka, 2020), 314 fq., 23 cm. ISBN 978-9928-260-36-9.



Ky vëllim është produkt i një bashkëpunimi midis autoreve dhe Fondacionit Konrad Adenauer në një projekt akademik, i cili si qëllim primar kishte vënien në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve të sistemit parauniversitar, të materialeve arkivore dhe burimeve të tjera të shkruara historike për të plotësuar mangësitë që ka kurrikula aktuale e lëndës së historisë. Teksti paraqet interes edhe për studentët e Masterit Profesional për Mësuesi në lëndën e Historisë, të cilët do të mund të orientohen me burime primare dhe sekondare mbi periudhën komuniste

nga perspektiva të ndryshme.

Gjatë 45 vjetëve të periudhës komuniste, Shqipëria u kthye në një vend të “socializmit real”, çka do të thoshte vendosje e sistemit njëpartiak në qeverisjen e vendit. Regjimi komunist shqiptar e siguroi konsolidimin e tij brenda pak vjetësh, gjatë të cilëve ai asgjësoi dhe shtypi çdo formë opozite në vend. Në këtë mënyrë, udhëheqja komuniste shqiptare i çeli rrugën zbatimit pa asnjë kundërshtim, të modelit stalinist të ndërtimit të komunizmit. Kështu, Shqipëria iu nënshtrua një centralizimi të skajshëm dhe u ekzaltua lufta e klasave. Por lufta politike nuk u kufizua vetëm kundër kundërshtarëve, por ajo u zhvillua edhe brenda radhëve të veta. Në të vërtetë lufta brenda llojit ishte pjesë e filozofisë së partive komuniste të ndërtuara sipas

modelit bolshevik leninist. Ky sistem politik antidemokratik që iu imponua shqiptarëve sundoi në Shqipëri për 45 vjet duke lënë gjurmë të thella në jetën politike, ekonomike, kulturore dhe atë shoqërore. Në fushën ekonomike, u zhduk prona private, u vu në jetë politika e mbështetjes në forcat e veta, u zhdukën sipërmarrësit e vegjël dhe klasa e menaxherëve, politika këto që e çuan të gjithë ekonominë e vendit në amulli. Në fushën sociale, shoqëria shqiptare iu nënshtua një politizimi të skajshëm. Ideologjia marksiste-leniniste ndërhynte në çdo aspekt të jetës së shqiptarëve. Regjimi komunist arriti të kryente këtë ideologjizim të jetës shoqërore përmes institucioneve shtetërore, Partisë së Punës së Shqipërisë dhe levave ndihmëse të saj.

Në planin e politikës së jashtme, regjimi komunist shqiptar u orientua krejtësisht kah bllokut komunist. Ndërkohë, ai mbajti një qëndrim tejet armiqësor dhe ushqeu gjithnjë dyshime të shumta ndaj demokracive perëndimore. Megjithatë, edhe pse Tirana zyrtare orbitoi rreth bllokut komunist, politika e saj e jashtme njohu zhvillime të shumta, të shoqëruara këto me ndryshime rrënjësore në qëndrimin ndaj aleatëve të vetë komunist herë pro jugosllav, herë pro sovjetik herë pro kinez dhe në fund e izoluar plotësisht.

Për të njohur më mirë periudhën e sundimit komunist, vjen ky vëllim, i cili ka karakterin e një teksti ekstrakurrikular, që ofron për mësuesit dhe nxënësit e historisë mundësi për t'u thelluar në njohuritë historike mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri (1945-1990). Ky tekst synon ofrimin e materialeve origjinale arkivore për t'u mundësuar nxënësve dhe mësuesve zhvillimin e projekteve të ndryshme në klasë.

Materialet e tekstit janë përzgjedhur nga arkiva të ndryshme, si Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Qëndror, Arkivi i Ministrisë së Jashtme, Arkivi i Ministrisë së Brendshme, Arkivi i Autoritetit për Informimin e Dosjeve të Ish-Sigurimit të Shtetit apo dhe nga tekste edukative dhe indoktrinuese të asaj periudhe, me qëllimin e pasqyrimin të materialeve burimore historike, duke u krijuar kështu mundësinë mësuesve dhe nxënësve që të lexojnë dhe të shfletojnë informacionin e bollshëm të strukturave shtetërore të politikës, dhunës dhe të propagandës shtetërore. Njëkohësisht, botimi i njeh

ata dhe me aspekte të jetës sociale, edukative dhe kulturore përgjatë komunizmit, qëllim që përmbushet dhe nga burimet arkivore, që janë vënë në dispozicion në këtë tekst.


Duke marrë në konsideratë faktin që informacioni, botimet dhe librat edukativë mbi periudhën e komunizmit në Shqipëri, janë akoma jo aq të shumtë, vlerësojmë se ky tekst ekstrakurrikular do t'u shërbejë mësuesve të historisë për të sjellë në klasë informacione më të detajuara mbi periudhën e komunizmit, nëpërmjet shembujve konkretë që dokumentat e tekstit pasqyrojnë. Teksti u mundëson mësuesve dhe nxënësve materiale të bollshme mbi një shumëllojshmëri temash që lidhen me periudhën e komunizmit në Shqipëri. Për shembull, në tekst ka material mbi një tematikë aq shumë delikate në Shqipëri, siç është data e çlirimit të vendit, 28 apo 29 Nëntori. Kur u vendos data e çlirimit të Shqipërisë nga ushtritë nazifashiste? Një tjetër aspekt i pasqyruar në tekst është njohja ndërkombëtare e qeverisë komuniste dhe marrëdhëniet e saj me aleatët antifashistë pas Luftës së Dytë Botërore. Gjerësisht teksti ka të pasqyruar materiale arkivore mbi terrorin dhe dhunën e ushtruar në Shqipëri nga strukturat shtetërore nëpërmjet materialeve të bollshme arkivore të gjyqeve dhe proceseve hetimore për njerëzit e dënuar si agjentë të shtetit, armiq të popullit. Po ashtu në tekst jepen statistika të detajuara të numrit të të dënuarve në dekadën e parë të regjimit komunist (1945-1955), ku bie në sy numri i lartë i njerëzve të dënuar me dënim me vdekje për krime politike.

Nxënësit dhe mësuesit e historisë me anë të këtij teksti do të gjejnë gjithashtu informacione dhe burime mbi indoktrinimin politik, kulturor dhe edukativ, të botuara në organet e shtypit komunist dhe revistat e kohës. Së fundmi, teksti pasqyron dhe periudhën e izolimit të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, por dhe vitet e fundit të komunizmit, ku burime prej tekstit do t'ju mundësojnë nxënësve të njihen me përpjekjet e shtetit komunist për t'u hapur me botën dhe zbutur pozicionimin ideologjik të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare.

Materialet arkivore në këtë tekst janë shkruar ashtu siç paraqiten në origjinalin e tyre në arkiva dhe nuk janë përshtatur në gramatikën shqipe. Lexueset dhe lexuesit mund të hasin dhe vështirësi në leximin

e parë të tyre. Por autorët kanë preferuar të mos ndërhyjnë në tekst dhe të jenë rigorozë në respektimin e tekstit në origjinal.

Enriketa Pandelejmoni, *Shkodra. Family and Urban Life (1918 - 1939)*. Studies on South East Europe, (LitVerlag: Vienna, 2019), 298 fq., 23 cm. ISBN: 978-3-643-91017-2



Literatura shqiptare mbi historinë urbane dhe transformimin shoqëror në fillim të shek. XX është e kufizuar dhe të pakta janë studimet që trajtojnë drejtpërdrejt çështjet familjare, strukturat shtëpiake dhe jetën urbane të popullsisë shqiptare. Ky libër ofron një perspektivë të gjerë mbi transformimet demografike, familjare, urbane dhe sociale të qytetit të Shkodrës gjatë periudhës ndërmjet luftërave. Temat e diskutuara në këtë studim lidhen edhe me të ashtuquajturin proces të ‘modernizimit’ dhe ‘oksidentializimit’ të shtetit, të sapokrijuar të Shqipërisë (1912). Ato

përfshijnë demografinë, të dhënat e regjistrimit, strukturën e familjes, modelet e martesës, si dhe pamjen e qytetit, paraqitjen hapësinore dhe jetën urbane. Gjithashtu, ofron njohuri mbi transformimin urban të Shkodrës, mbi ndryshimin e modelit urban nga modeli osman dhe çështje të vazhdimësisë së tij.

Duke u ndalur te Shkodra dhe duke krahasuar strukturën e saj familjare me modelin e përgjithshëm të vendit, studimi synon të hedhë dritë mbi dallimet e ndryshme të evidentuara, pasi strukturat familjare dhe modelet e martesës në këtë qytet kanë trajtë ndryshe

nga ato të pjesës tjetër të vendit. Si shkaqe të mundshme për të tilla dallime, nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë së vitit 1918 janë identifikuar faktorët arsimorë dhe ekonomikë së bashku me komponentët etnikë dhe fetarë.


Botimi ofron gjithashtu një përmbledhje të modelit të familjes dhe jetës familjare në Shkodër gjatë periudhës ndërmjet luftërave, bazuar kryesisht në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, si ai i vitit 1918. Po ashtu, studimi synon të hetojë mjedisin dhe jetën urbane të banorëve të Shkodrës dhe çështje që lidhen me strukturën e tyre familjare gjatë viteve 1920 dhe 1930, periudhë kur ndodhën ndryshime të rëndësishme në peizazhin politik, ekonomik dhe social të Shqipërisë. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë pas shpalljes, në vitin 1920, të Tiranës kryeqytet i Shqipërisë tashmë të pavarur prej pak kohësh (1912). Kështu, temat kryesore të kërkimit përfshijnë demografinë, të dhënat e popullsisë, strukturën e familjes, modelin e martesës, si dhe pamjen e qytetit dhe shtrirjen hapësinore dhe jetën urbane.

Autorja e studimit përpiqet për më tepër t'i përgjigjet një sërë pyetjesh, duke përfshirë: A pati një ndryshim në familjen urbane dhe jetën familjare nga të ashtuquajturat "struktura tradicionale" të familjes, të cilat zakonisht përshkruhen në literaturën shkencore për Shqipërinë? A ka ndonjë ndryshim midis modelit të përgjithshëm të martesës urbane të Shkodrës dhe pjesës tjetër të vendit? A u zhvillua ai model nën faktorë lokalë si zhvillimet sociale, kulturore, ekonomike dhe arsimore, apo ka elementë të tjerë të rëndësishëm që ndikuan në këtë model?

Studimi i fokusuar në qytetin e Shkodrës ndërmerr krahasimin e strukturës së saj familjare me modelin e përgjithshëm të vendit, pasi qyteti i Shkodrës ishte ai që ndryshonte më shumë në strukturën e familjes dhe modelin e martesës nga pjesa tjetër e vendit. Bazuar mbi të dhënat e regjistrimit të popullsisë së vitit 1918 si dhe mbi burime të tjera, si shkaqe të mundshme për dallime të tilla në raport me Shqipërinë urbane janë identifikuar faktorët arsimorë dhe ekonomikë së bashku me komponentët etnikë dhe konfesionale.

Së fundi, studimi ndriçon aspekte të transformimit urban të Shkodrës në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore, kur u formua qyteti i ri, pasi Shkodra e vjetër rrëzë Kalasë së Rozafës u braktis kryesisht në fund të shek. XIX. Vëmendje i kushtohet modelit urban, ku dallohet një vazhdimësi e modelit urban osman që karakterizonte qytetin e vjetër. Studimi shqyrton më tej se deri në çfarë mase tendencat e reja u prezantuan në planifikimin urban, infrastrukturën urbane dhe jetën publike të këtij qyteti. Në këtë këndvështrim shtrohen pyetje të tjera: a kishte një lloj modernizimi në planimetrinë e qytetit? A ndikoi modernizimi në mjedisin urban, në jetën familjare dhe në jetën e përditshme të njerëzve? Në çfarë mase u modifikua jeta publike si pasojë?

Margo Rejmer, *Mud Sweeter Than Honey: Voices of Communist Albania*, përkthyer nga Zosia Krasodomska-Jones dhe Antonia Lloyd-Jones. (MacLehose Press, 2021), 320 fq., 23.6 cm. ISBN: 978-1529-411-46-1.



Historitë e jetës të përpiluara nga gazetarja polake Margo Rejmer në botimin *Mud Sweeter Than Honey* ngjajnë, nganjëherë, me nëntë rrathët e ferrit të Dantes: në dhunën, përbuzjen, gënjeshttrat, brutalitetin dhe zbrazëtinë e tyre në rritje. Këto ishin dënimet që regjimi komunist i Enver Hoxhës u bëri shqiptarëve nga viti 1945 deri në fundin e tij në vitin 1991. Libri i Rajmerit, i shkruar me të njëjtën thellësi dhe finesë me atë të poetit shqiptar Çajupi, shpalos për lexuesit Shqipërinë komuniste përmes përvojave të mbledhura gojarisht nga njerëz të zakonshëm.



Përvoja e leximit të librit të rikthen në vitet e fëmijërisë. Shumë prej tregimeve të tij janë jashtëzakonisht të ngjashme me episodet e jetës në atë kohë. Çdo 7 Mars, në “Ditën e Mësuesit”, babai im, mësues historie në gjimnazin e Tiranës, merrte si dhuratë një vëllim nga veprat e shokut Enver Hoxha, liderit komunist që sundoi Shqipërinë në vitet 1945-1985 ose një portret të tij. Një herë i dhanë një bust gipsi të udhëheqësit. Përfundoi mbi bufe (dollar), orendi që gjendej në çdo shtëpi të kohës. Kur vinte çdo 7 mars dhe pritej vizita e studentëve, busti i vogël sillej përpara për t'u parë nga të ftuarit. Por, me kalimin e kohës, pjesa e pasme e bustit u myk dhe babai im duhej të ishte i kujdesshëm dhe të mos e linte të shihej myku në shpinë të udhëheqësit. Kjo ishte rutinë për disa vite deri në ditën kur një tërmet mjaft i fortë bëri që busti i udhëheqësit të rrëzohej dhe të thyhej.

Ishte një kohë e karakterizuar nga standardizimi i gjithçkaje: i veshjeve, arkitekturës, mobilimit shtëpiak. Siç bën shaka një burrë i intervistuar nga Rejmer, "fustanet ishin të gjithë njësoj, këpucët ishin të gjitha njësoj, në çfarëdo shtëpi që të hyje, gjithçka dukej njësoj. Faleminderit Zotit të paktën gratë mund të duken ndryshe nga njëra-tjetra". Sistemi i Hoxhës u përpoq gjithashtu të standardizonte mendimin. “Komunizmi ishte në kontroll, propaganda ishte skalitur në mendjet e njerëzve dhe ne jetonim në kurth”, kujton një burrë nga fshati Dervican, i cili u arrestua në moshën 16-vjeçare pasi tentoi të arratisesh me tre miq të tij në Greqi, “ku njerëzit kishin televizor dhe makina”. Një ëndërr pa kuptim lirie u shndërrua në një makth: dy moshatarët e tij u vranë duke kaluar kufirin dhe ai u fut në burg. Personi që i kishte denoncuar te Sigurimi, policia sekrete e Hoxhës, ishte mësuesi i tyre.

Në vitin 1967, pas spastrimeve të Revolucionit Kulturor të Maos, Hoxha asgjësoi fenë, duke shkatërruar kisha dhe xhami ose duke i kthyer ato në arena sportive dhe magazina. Në vitin 1967, Shqipëria u bë vendi i parë zyrtarisht ateist në botë. “Na u imponua filozofia e marksizëm-leninizmit”, kujton murgesha katolike Motra Roza, “si njerëz të komunizmit ishim të gjithë bosh”.

Kufijtë u mbyllën dhe në çdo faqe kodre u ndërtuan bunkierë betoni për të mbrojtur Shqipërinë nga ‘armiqtë e huaj’. Hoxha e ktheu

Shqipërinë në një “kafaz fort të madh”, duke shpallur se “do të hamë bar para se të përkulemi para presionit të fuqive të huaja”. Mbi 6000 shqiptarë u ekzekutuan, me rreth 7000 të zhdukur në kampet e punës së detyruar. Mbi 1000 të burgosur politikë nuk u liruan kurrë.

Arma kryesore e sistemit ishte frika. Që të zgjaste, njerëzit duhej të kishin frikë, të heshtnin. Bibika Kokalari, kushërira e shkrimtares Musine Kokalari, kujton se si Musineja u burgos në vitin 1946. Ajo vuajti poshtërimin e një gjyqi të shfaqjes publike të zhvilluar nga i njëjti regjim despotik që kishte vlarë vëllezërit e saj dhe më pas e kishte mbajtur nën vëzhgim për pjesën më të madhe të pjesës së mbetur nga jeta e saj. Nga ana tjetër, frika e spiunimit e kushtëzoi sjelljen e Bibikës, në mënyrë që ajo të ishte e vetëdijshme për çdo makinë të zezë që kalonte pranë saj. Shumë besonin se Sigurimi kishte akses në një pajisje që mund të lexonte mendimet.

Pavarësisht kësaj, njerëzit u përpoqën të arratiseshin, duke besuar se vdekja ishte më e mirë se jeta në Shqipëri. Zenel Drangu, sot 70 vjeç, u kap nga policia kufitare jugosllave dhe u kthye në Shqipëri. Ai u burgos për 16 vjet në kampin famëkeq malor të punës në Spaç, sipas modelit të gulagëve të Stalinit. Spaçi ishte një kafaz natyral për të burgosurit. “Pikërisht në Spaç kuptova për herë të parë sa i fortë mund të jetë një njeri dhe sa mizor! Gardianët na torturuan kundër rregullave, vetëm për qejf, sikur të shijonin dhimbjen tonë”.

Paranoja personale e Hoxhës e ktheu Shqipërinë në një kështjellë të komunizmit, një godinë plot dhoma të errëta ku askush nuk kishte të drejtë të thoshte të vërtetën. Neim Pasha kujton se si “sistemi ushqehet me gjakun e shqiptarëve, ishte një përbindësh gjakatar, vazhdimisht në gjueti të mishit njerëzor... Sistemi donte gjak për të mbijetuar, kishte nevojë për terrorin tonë”.

*Mud Sweeter Than Honey* është një lexim thelbësor për këdo që dëshiron të kuptojë Shqipërinë komuniste, ku jashtë apo brenda burgut nuk do të ndihej më kurrë i lirë. Por regjimi i Hoxhës mori fund, përfundimisht.

ENRIKETA PANDELEJMONI  
*Universiteti i Tiranës*

DOKTORATA - PHD DISSERTATIONS



TEMAT E DOKTORATURAVE TË MBROJTURA  
NË DEPARTAMENTIN E HISTORISË

VITI AKADEMIK 2021-2022

1. Sereta Koperaj, “Pushtimi italian i Shqipërisë dhe qëndrimi i diplomacisë britanike”.

Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni

2. Migena Shehu: “Roli i FMN-së në transformimin ekonomik dhe social gjatë kalimit nga komunizmi në kapitalizëm: Rasti i Shqipërisë”

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Petrit Nathanaili

3. Zile Kryeziu: “Krahina e Dibrës gjatë Rilindjes Kombëtare shqiptare”

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ferit Duka

4. Elona Gjellaj: “Pronësia mbi tokën në Myzeqe”

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ajet Shahu

5. Lorena Dervishi: “Arsimi në Shqipëri gjatë mbretërimit të Ahmet Zogut”

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ferit Duka

6. Mirela Lazimi: “Rilindja Kombëtare shqiptare dhe Lidhja e Prizrenit”

Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Petrika Thëngilli

7. Blerina Dervishi: "NATO dhe Shqipëria"  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Jaho Cana
8. Antoneta Hoxha: "Marrëdhëniet shqiptaro-italiane 1930-1939"  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Fatmira Rama
9. Blerta Derhemi: "Marrëdhëniet Shqipëri-OKB gjatë Luftës së Ftohtë"  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Pranvera Teli Dibra
10. Megi Melani: "Shqipëria dhe Organizata e Bashkëpunimit Islamik OBI"  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ferit Duka
11. Brisejda Lala: "Marrëdhëniet Shqipëri-Bashkimi Sovjetik"  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Gentiana Kera
12. Rozeta Ivanova: "Historia e legjislacionit në shtetin shqiptar (1912-1924)"  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ilira Sulo
13. Siri Hoxha: "Islami dhe muslimanët në Shqipëri gjatë periudhës komuniste"  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Çlirim Duro
14. Thoma Shkira: "Bashkësia ortodokse dhe shteti komunist shqiptar (1944-1990)"  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Enriketa Pandelejmoni
15. Albulena Halili: "Marrëdhëniet transatlantike në kuadër të globalizimit"  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Petrit Nathanaili

16. Ornela Shameti: “Koçi Xoxe në kontekstin e marrëdhënieve shqiptaro-jugosllave 1945-1948”  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ksenofon Krisafi
17. Aida Zaka: “çështja e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë tranzicionit”  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Ilira Sulo
18. Emi Yzeiraj: “Politika e Jashtme e Ahmet Zogut Mbret”  
Udhëheqës shkencor: Prof. dr. Valentina Duka
19. Vojsava Kumbulla: “Instituti i Studimeve Shqiptare 1940-1944”  
Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. dr. Gentiana Kera











# SAH

Studime Albanologjike - Histori  
Albanological Studies - History

ISSN 2227-8346



9 772227 834003

